



**AUTORITETI I
KONKURRENCËS**

BULETINI ZYRTAR

NR.7, 2011

TIRANË, 2012

Buletini Zyrtar Nr.7, 2011

Përgatitur nga:
Autoriteti i Konkurrencës

Përpunimi grafik dhe printimi:
Erald Lamja
(Vignette Marketing Agency)

Botuar nga:
Autoriteti i Konkurrencës, 2012

Përmbajtja

- Fq.7 Vendimi Nr. 171, Datë 17.01.2011, Për një ndryshim në Vendimin Nr. 157, datë 28.10.2010 “Për miratimin e hapjes së procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të sheqerit”
- Fq.9 Vendimi Nr. 172, Datë 17.01.2011, Për një ndryshim në Vendimin Nr. 155, datë 28.10.2010 “Për miratimin e hapjes së procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të orizit”
- Fq.11 Vendimi Nr. 173, Datë 17.01.2011, Për një ndryshim në Vendimin Nr. 156, datë 28.10.2010 “Për miratimin e hapjes së procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të vajit vegjetal”
- Fq.13 Vendimi Nr. 174, Datë 25.01.2011, “Për disa rekomandime në lidhje me transparencën dhe komisionet e aplikuara në tregun e shërbimeve bankare”
- Fq.20 Vendimi Nr. 175, Datë 22.02.2011, Për “Miratimin e Raportit Vjetor “Mbi veprimtarinë e Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2010 dhe synimet kryesore për vitin 2011”
- Fq.21 Vendimi Nr. 176, Datë 24.02.2011, Për Miratimin e Rregullores “Për Procedurat Hetimore të Autoritetit të Konkurrencës”
- Fq.39 Vendimi Nr. 177, Datë 25.02.2011, “Për disa rekomandime në lidhje me draft rregulloren për alokimin e kapaciteteve të interkonjeksionit”
- Fq.42 Vendimi Nr. 178, Datë 25.02.2011, “Për disa rekomandime në lidhje me draft rregulloren e procedurave të blerjes së energjisë elektrike nga KESH sh.a nga tregtarët vendas dhe të huaj”
- Fq.45 Vendimi Nr. 179, Datë 02.03.2011, Për miratimin e rregullores “Per kategoritë e marrëveshjeve të transfertave teknologjike”
- Fq.46 Vendimi Nr. 180, Datë 29.03.2011, “Për një ndryshim në Vendimin Nr. 155, datë 28.10.2010 “Për miratimin e hapjes së procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të Orizit” (i ndryshuar)
- Fq.48 Vendimi Nr. 181, Datë 29.03.2011, “Për një ndryshim në Vendimin Nr. 157, datë 28.10.2010 “Për miratimin e hapjes së procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të sheqerit” (i ndryshuar)
- Fq.50 Vendimi Nr. 182, Datë 29.03.2011, “Për një ndryshim në Vendimin Nr. 156, datë 28.10.2010 “Për miratimin e hapjes së procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të vajit vegjetal” (i ndryshuar)
- Fq.52 Vendimi Nr. 183, Datë 29.03.2011, “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet shit-blerjes së 51% të aksioneve të shoqërisë Capital Sh.a. nga shoqëria Sigal Life Uniqa Group Austria Sh.a”

- Fq.57 Vendimi Nr. 184, Datë 07.04.2011, “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prodhimit dhe tregtimit të bukës në qytetin e Vlorës”
- Fq.59 Vendimi Nr. 185, Datë 07.04.2011, “Për marrjen e masave të përkohshme për ndalimin e marrëveshjes në tregun e prodhimit dhe të tregtimit të bukës në qytetin e Vlorës”
- Fq.62 Vendimi Nr. 186, Datë 12.04.2011, “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet shit-blejjes së 75% të aksioneve të shoqërisë Sigma I.P.P Sh.a, nga shoqëria Sicred Sh.a”
- Fq.67 Vendimi Nr. 187, Datë 03.05.2011, Per miratimin e Rregullores “Per perjashtimin e kategorive të marreveshjeve të kerkimit dhe zhvillimit”
- Fq.68 Vendimi Nr. 188, Datë 26.05.2011, “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet shit-blejjes së 100% të aksioneve të shoqërisë Delta Maxo d.o.o Serbia, nga shoqëria Hitomi Financial Limited tek shoqëria Delhaize “The Lion” Nederland B.V”
- Fq.73 Vendimi Nr. 189, Datë 26.05.2011, Për disa ndryshime në Rregulloren “Per funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës”
- Fq.75 Vendimi Nr. 190, Datë 26.05.2011, Per miratimin e rregullores “Per perjashtimin e kategorive të marreveshjeve të specializimit”
- Fq.80 Vendimi Nr. 191, Datë 31.05.2011, “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e prodhimit dhe tregtimit të bukës në qytetin e Vlorës”
- Fq.92 Vendimi Nr. 192, Datë 21.06.2011, “Për mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të orizit”
- Fq.98 Vendimi Nr. 193, Datë 21.06.2011, “Për mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të vajit vegjetal”
- Fq.107 Vendimi Nr. 194, Datë 04.07.2011, “Për mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të sheqerit”
- Fq.118 Vendimi Nr. 195, Datë 22.07.2011, “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfundimit të 55.9 % të të drejtave të votës dhe 53.71 % të kapitalit themeltar nga shoqëria Volkswagen Aktiengesellschaft tek shoqëria MAN SE”
- Fq.122 Vendimi Nr. 196, Datë 29.07.2011, “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun shërbimit të ngarkim-shkarkim të gazit të lëngshëm në Portin “Porto Romano”
- Fq.127 Vendimi Nr. 197, Datë 29.07.2011, “Për marrjen e masave të përkohshme për rivendosjen e konkurrencës në tregun shërbimit të ngarkim-shkarkimit dhe depozitimit të gazit të lëngshëm në portin “Porto Romano”
- Fq.134 Vendimi Nr. 198, Datë 25.08.2011, “Për marrjen e masave të përkohshme për rivendosjen e konkurrencës në tregun shërbimit të ngarkim-shkarkimit dhe depozitimit të gazit të lëngshëm në portin “Porto Romano”

- Fq.141 Vendimi Nr. 199, Datë 15.09.2011, Mbi Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet blerjes së 75%+1 aksione të shoqërisë Intersig Sh.a nga shoqëria Vienna Insurance Group AG
- Fq.146 Vendimi Nr. 200, Datë 15.09.2011, “Mbi Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet shit-bletjes së 100% të kuotave të shoqërisë Haggard Cigarette & Tobacco Factory Ltd., nga shoqëria Japan Tobacco Group”
- Fq.149 Vendimi Nr. 201, Datë 20.09.2011, “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar tregun e shërbimit të ngarkim – shkarkimit të gazit të lëngshëm të naftës në rrugë detare ndaj ndërmarrjes “Romano Port” SHA”
- Fq.163 Vendimi Nr. 202, Datë 26.09.2011, “Për gjatëzimin e ndërmarrjeve pjesëmarrëse në marrëveshjen e ndaluar në tregun e prodhimit dhe tregtimit të bukës në qytetin e Vlorës, si dhe dhënien e disa rekomandimeve për drejtorinë e përgjithshme të tatimeve”
- Fq.176 Vendimi Nr. 203, Datë 08.11.2011, Për miratimin e Rregullores “Për marrëveshjet me rëndësi të vogël”
- Fq.182 Vendimi Nr. 204, Datë 14.11.2011, “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e ofrimit të shërbimit të telefonisë fikse me anë të kartave me parapagesë”
- Fq.187 Vendimi Nr. 205, Datë 14.11.2011, “Për një rekomandim për Ministrin e Arsimit dhe Shkencës për ndryshimin e udhëzimit nr. 36, dt. 9.9.2011 “Për një ndryshim në Udhëzimin nr. 25, dt. 20.07.2011” Për procedurat e pranimit dhe të regjistrimit në ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë në institucionet publike të arsimit të lartë”
- Fq.190 Vendimi Nr. 206, Datë 18.11.2011, “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet bashkimit me përthithje të Alpha Bank S.A dhe EFG Eurobank Ergasias S.A”
- Fq.195 Vendimi Nr. 207, Datë 05.12.2011, “Për miratimin e stemës zyrtare të Autoritetit të Konkurrencës”
- Fq.197 Vendimi Nr. 208, Datë 05.12.2011, “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar ndërmjet shoqërive XLWorld Europe S.r.l dhe Xerox S.p.a me qëllim përftimin e shoqërive Eagle Connect Sh.p.k dhe Voice Star Sh.p.k”
- Fq.201 Vendimi Nr. 209, Datë 21.12.2011, Për miratimin e Udhëzuesit “Mbi analizën e konkurrencës në procedurat për dhënien e koncesioneve”
- Fq.211 Vendimi Nr. 210, Datë 21.12.2011, “Për disa rekomandime AKEP-it në lidhje me tregun e komunikimeve elektronike”
- Fq.214 Vendimi Nr. 211, Datë 23.12.2011, Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike, ndaj ndërmarrjeve: “Eurogjici Security” Sh.p.k, “Eurogjici Security 1” Sh.p.k, “Toni Security” sh.p.k, “Sajmiri AL” sh.p.k, “Nazeri 2000” sh.p.k dhe “Dea Security” sh.p.k



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS

VENDIM

Nr. 171, Datë 17.01.2011

Për një ndryshim në Vendimin Nr. 157, datë 28.10.2010
“Për miratimin e hapjes së procedurës së hetimit paraprak në tregun e
importit dhe tregtimit me shumicë të sheqerit”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Servete Gruda Anëtar
- Koço Broka Anëtar
- Rezana Konomi Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 17.01.2011, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Shtyrja e afatit në lidhje me hetimin paraprak në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të sheqerit.

Baza ligjore: - Neni 24, shkronja d); neni 42, pika 1, të Ligjit nr. 9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (të ndryshuar);

- Ligji Nr. 8485, datë 11. 11. 1999 “Kodi i Procedurave Administrative”;

Pasi mori në shqyrtim informacionin dhe kërkesën e Sekretarit të Përgjithshëm për një shtyrje afati në lidhje me hetimin paraprak në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të sheqerit,

VËREN SE:

1. Me anë të Vendimit Nr. 157, datë 28.10.2010 “Për miratimin e hapjes së procedurës së hetimit paraprak në e importit dhe tregtimit me shumicë të sheqerit”, Komisioni i Konkurrencës, në zbatim të nenit 42, pika 1, të Ligjit nr. 9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (të ndryshuar), ka miratuar hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të sheqerit, për të parë nëse kushtet e tregut sigurojnë konkurrencë të lirë dhe efektive.

2. Në vazhdim të procedurës, Sekretari i Përgjithshëm i Autoritetit të Konkurrencës, ngriti grupin e punës përgjegjës për ndjekjen procedurave të këtij hetimi.
3. Grupi i punës në ushtrim të detyrave të tij dhe me qëllim mbledhjen e fakteve dhe të dhënave të nevojshme në lidhje me hetimin, ka kërkuar të dhëna dhe informacione nga ndërmarrje që operojnë në tregun objekt hetimi.
4. Për arsye objektive, njëra prej ndërmarrjeve ka kërkuar shtyrjen e afatit për sjelljen e të dhënave dhe informacionit të kërkuar në mënyrë të plotë sipas kërkesave të grupit të punës, duke bërë të pamundur përpunimin e tyre brenda afatit të përcaktuar në vendimin nr 157 pika 3.
5. Sigurimi i një informacioni të plotë dhe të saktë është i domosdoshëm për të siguruar një vendim-marrje objektive të Komisionit të Konkurrencës.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të nenit 24, shkronja d), nenit 42, pika 1, të Ligjit nr. 9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si dhe Ligjit Nr. 8485, datë 11. 11. 1999 “Kodi i Procedurave Administrative”,

VENDOSI:

1. Në Vendimin Nr. 157, datë 28.10.2010 “Për miratimin e hapjes së procedurës së hetimit paraprak në e importit dhe tregtimit me shumicë të sheqerit”, pika 3 ndryshohet si vijon:
“3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për ndjekjen e procedurave hetimore të parashikuara në Ligj dhe aktet nënligjore, si dhe përgatitjen e raportit të hetimit paraprak, jo më vonë se data 28 shkurt 2011”.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete Gruda

(_____)

Anëtar

Koço Broka

(_____)

Anëtar

Rezana Konomi

(_____)

Anëtar

Lindita Milo (Lati)

K R Y E T A R



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS**

VENDIM

Nr. 172, Datë 17.01.2011

**Për një ndryshim në Vendimin Nr. 155, datë 28.10.2010
“Për miratimin e hapjes së procedurës së hetimit paraprak në tregun e
importit dhe tregtimit me shumicë të orizit”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Servete Gruda Anëtar
- Koço Broka Anëtar
- Rezana Konomi Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 17.01.2011, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Shtyrja e afatit në lidhje me hetimin paraprak në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të orizit.

Baza ligjore: - Neni 24, shkronja d); neni 42, pika 1, të Ligjit nr. 9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (të ndryshuar);

- Ligji Nr. 8485, datë 11. 11. 1999 “Kodi i Procedurave Administrative”;

Pasi mori në shqyrtim informacionin dhe kërkesën e Sekretarit të Përgjithshëm për një shtyrje afati në lidhje me hetimin paraprak në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të orizit,

VËREN SE:

1. Me anë të Vendimit Nr. 155, datë 28.10.2010 “Për miratimin e hapjes së procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të orizit”, Komisioni i Konkurrencës, në zbatim të nenit 42, pika 1, të Ligjit nr. 9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (të ndryshuar), ka miratuar hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të orizit, për të parë nëse kushtet e tregut sigurojnë konkurrencë të lirë dhe efektive.

2. Në vazhdim të procedurës, Sekretari i Përgjithshëm i Autoritetit të Konkurrencës, ngriti grupin e punës përgjegjës për ndjekjen procedurave të këtij hetimi.
3. Grupi i punës në ushtrim të detyrave të tij dhe me qëllim mbledhjen e fakteve dhe të dhënave të nevojshme në lidhje me hetimin, ka kërkuar të dhëna dhe informacione nga ndërmarrje që operojnë në tregun objekt hetimi.
4. Për arsye objektive, njëra prej ndërmarrjeve ka kërkuar shtyrjen e afatit për sjelljen e të dhënave dhe informacionit të kërkuar në mënyrë të plotë sipas kërkesave të grupit të punës duke bërë të pamundur përpunimin e tyre brenda afatit të përcaktuar në vendimin nr 155 pika 3.
5. Sigurimi i një informacioni të plotë dhe të saktë është i domosdoshëm për të siguruar një vendim-marrje objektive të Komisionit të Konkurrencës.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të nenit 24, shkronja d), nenit 42, pika 1, të Ligjit nr. 9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si dhe Ligjit Nr. 8485, datë 11. 11. 1999 “Kodi i Procedurave Administrative”,

VENDOSI:

1. Në Vendimin Nr. 155, datë 28.10.2010 “Për miratimin e hapjes së procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të orizit”, pika 3 ndryshohet si vijon:
“3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për ndjekjen e procedurave hetimore të parashikuara në Ligj dhe aktet nënligjore, si dhe përgatitjen e raportit të hetimit paraprak, jo më vonë se data 28 shkurt 2011”.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete Gruda

(_____)

Anëtar

Koço Broka

(_____)

Anëtar

Rezana Konomi

(_____)

Anëtar

Lindita Milo (Lati)

K R Y E T A R



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS

VENDIM

Nr. 173, Datë 17.01.2011

Për një ndryshim në Vendimin Nr. 156, datë 28.10.2010
“Për miratimin e hapjes së procedurës së hetimit paraprak në tregun e
importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të vajit vegjetal”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Servete Gruda Anëtar
- Koço Broka Anëtar
- Rezana Konomi Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 17.01.2011, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Shtyrja e afatit në lidhje me hetimin paraprak në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të vajit vegjetal.

Baza ligjore: - Neni 24, shkronja d); neni 42, pika 1, të Ligjit nr. 9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (të ndryshuar);

- Ligji Nr. 8485, datë 11. 11. 1999 “Kodi i Procedurave Administrative”;

Pasi mori në shqyrtim informacionin dhe kërkesën e Sekretarit të Përgjithshëm për një shtyrje afati në lidhje me hetimin paraprak në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të vajit vegjetal,

VËREN SE:

1. Me anë të Vendimit Nr. 156, datë 28.10.2010 “Për miratimin e hapjes së procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të vajit vegjetal”, Komisioni i Konkurrencës, në zbatim të nenit 42, pika 1, të Ligjit nr. 9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (të ndryshuar), ka miratuar hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të vajit vegjetal, për të parë nëse kushtet e tregut sigurojnë konkurrencë të lirë dhe efektive.

2. Në vazhdim të procedurës, Sekretari i Përgjithshëm i Autoritetit të Konkurrencës, ngriti grupin e punës përgjegjës për ndjekjen procedurave të këtij hetimi.
3. Grupi i punës në ushtrim të detyrave të tij dhe me qëllim mbledhjen e fakteve dhe të dhënave të nevojshme në lidhje me hetimin, ka kërkuar të dhëna dhe informacione nga ndërmarrje që operojnë në tregun objekt hetimi.
4. Për arsye objektive, njëra prej ndërmarrjeve ka kërkuar shtyrjen e afatit për sjelljen e të dhënave dhe informacionit të kërkuar në mënyrë të plotë sipas kërkesave të grupit të punës duke bërë të pamundur përpunimin e tyre brenda afatit të përcaktuar në vendimin nr 156 pika 3.
5. Sigurimi i një informacioni të plotë dhe të saktë është i domosdoshëm për të siguruar një vendim-marrje objektive të Komisionit të Konkurrencës.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të nenit 24, shkronja d), nenit 42, pika 1, të Ligjit nr. 9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si dhe Ligjit Nr. 8485, datë 11. 11. 1999 “Kodi i Procedurave Administrative”,

VENDOSI:

1. Në Vendimin Nr. 156, datë 28.10.2010 “Për miratimin e hapjes së procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të vajit vegjetal”, pika 3 ndryshohet si vijon:
“3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për ndjekjen e procedurave hetimore të parashikuara në Ligj dhe aktet nënligjore, si dhe përgatitjen e raportit të hetimit paraprak, jo më vonë se data 28 shkurt 2011”.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete Gruda
(_____)
Anëtar

Koço Broka
(_____)
Anëtar

Rezana Konomi
(_____)
Anëtar

Lindita Milo (Lati)

K R Y E T A R



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS**

VENDIM

Nr. 174, Datë 25.01.2011

“Për disa rekomandime në lidhje me transparencën dhe komisionet e aplikuar në tregun e shërbimeve bankare”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Servete Gruda Anëtar
- Koço Broka Anëtar
- Rezana Konomi Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 25.01.2011, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Për disa rekomandime për Bankën e Shqipërisë dhe Komisionin e Mbrojtjes Konsumatore në lidhje me transparencën dhe komisionet e aplikuar në tregun e shërbimeve bankare.

Baza ligjore: Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, (i ndryshuar), nenet, 2 pika c), 24 pika d), 69 dhe 70.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të raportit të grupit të punës “Për monitorimin e tregut të shërbimeve bankare” të paraqitur nga Sekretariati, si edhe pas zhvillimit të seancës konsultative me përfaqësues të Bankës së Shqipërisë dhe Drejtorisë së Mbrojtjes së Konsumatorit pranë Ministrisë së Ekonomisë Tregtisë dhe Energjetikës, si dhe pas administrimit të opinionit të Bankës së Shqipërisë të datës 12.01.2011:

VËREN SE:

Autoriteti i Konkurrencës që nga fundi i vitit 2009 dhe gjatë vitit–2010, ka kryer një monitorim të tregut të shërbimeve bankare me qëllim vlerësimin e sjelljes së bankave të nivelit të dytë në lidhje me transparencën për klientët si dhe krahasimin e tarifave të shërbimeve bankare në Shqipëri me bankat homologe në rajon. Metodologjia e zbatuar është e ngjashme me atë të Komisionit Evropian për monitorimin e tregut të shërbimeve

bankare dhe ka si qëllim matjen e nivelit të transparencës së kushteve të punës në banka. Në vazhdim të procedurës, Sekretari i Përgjithshëm i Autoritetit të Konkurrencës, ngriti grupin e punës përgjegjës për ndjekjen procedurave të këtij hetimi.

I. Kuadri ligjor dhe nënligjor

Sistemi bankar në Shqipëri e ushtron veprimtarinë e tij mbështetur në tre ligjet kryesore::

- Ligji Nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë,”. (i ndryshuar 2 herë, respektivisht në vitet 1998 dhe 2002);
- Ligji Nr. 9662, dt. 18.12.2006 “Për Bankat në Republikën e Shqipërisë”,
- Ligji nr. 9902 datë 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatoreve,

si dhe në në aktet nënligjore si vijon:

- Rregullorja: ‘Mbi rregullat e brendshme të funksionimit të sistemit të klerimit të pagesave me vlerë të vogël AECH’
- Rregullorja: ‘Mbi rregullat e brendshme të funksionimit të sistemit të pagesave ndërbankare me vlerë të madhe AIPS’
- Vendimi Nr. 2, datë 28.01.2004 i Këshillit Mbikëqyrës të BSH: ‘Për miratimin e tarifave të përdorimit të sistemit të pagesave ndërbankare AIPS’
- Vendimi Nr. 53, datë 29.06.2005 i Këshillit Mbikëqyrës të BSH: ‘Për miratimin e tarifave të përdorimit të sistemit shqiptar të kryqëzimit të pagesave me vlerë të vogël AECH’
- Vendimi Nr. 59, datë 29.08.2008 i Këshillit Mbikëqyrës të BSH: ‘Për miratimin e rregullores “Mbi transparencën për produktet dhe shërbimet bankare e financiare”.

II. Analiza e Konkurrencës

Monitorimi në tregun e shërbimeve bankare u ndërmor nga ana e Autoritetit të Konkurrencës për shkak të shqetësimit publik të komunitetit të biznesit dhe klientëve individë për rritjen e komisioneve të shërbimeve bankare dhe mungesën e transparencës nga ana e bankave. Transparenca e shërbimeve bankare dhe tarifave përkatëse është faktor i rëndësishëm për zgjedhjen konsumatore dhe si rrjedhojë për konkurrencën e lirë dhe efektive në tregun bankar, të cilat janë objekt i Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

II.1 Transparenca e tarifave të shërbimeve bankare

Në zbatim të metodologjisë së përcaktuar për realizimin e këtij studimi, vlerësimi i treguesve të transparencës së bankave në lidhje me produktet dhe shërbimet që ofrojnë u realizua nëpërmjet lidhjes midis nivelit të tarifave dhe transparencës së bankave.

Gjatë vëzhgimit të faqeve të internetit të bankave të nivelit të dytë u konstatua se 10 banka kanë faqe interneti ku gjenden të publikuara kushtet e punës në shqip dhe në anglisht. Gjatë periudhës objekt monitorimi, Banka e Bashkuar e Shqipërisë dhe Banka e Kreditit të Shqipërisë

nuk kanë faqe interneti. Banka Kombëtare Greke, Banka Alpha, Banka Ndërkombëtare Tregtare dhe Banka Emporiki kanë faqe të internetit të bankave të tyre qendrore ku paraqitet rrjeti ndërkombëtar i degëve të tyre por nuk kanë informacion për Kushtet e Punës të degëve që operojnë në Shqipëri. Pas monitorimit të Autoritetit të Konkurrencës, vetëm banka Emporiki, pjesë e grupit Credit Agricole ka hapur faqen e internetit në gjuhën shqipe.

Përgjithësisht informacioni që ndodhet në faqet e internetit, të bankave që kanë faqe, është informacion i plotë dhe aktual. Ky informacion është i aksesueshëm nga të gjithë klientët që janë të interesuar për të klikuar në faqet e internetit të bankave.

Gjatë monitorimit u konstatua se përgjithësisht bankat e nivelit të dytë nuk i informojnë klientët e tyre në lidhje me ndryshimin e kushteve të punës duke sjellë mos informim të klientëve në lidhje me ndryshimet e komisionit të shërbimeve bankare, tarifave të shërbimeve dhe norma e interesit në rastet kur kjo norme varet nga Euribor apo Libor. Sipas dokumenteve të administruara gjatë monitorimit në muajin prill 2009 njëra nga bankat e nivelit të dytë ka rritur nga 1 në 2 dollarë, pra 100 për qind komisionin për mbajtjen e llogarisë rrjedhëse në dollarë dhe nuk ka njoftuar klientët. Kjo sjellje e bankave bie ndesh me rregulloren e Bankës së Shqipërisë të miratuar më anë të vendimit Nr. 59, datë 29.08.2008 “ Mbi transparencën për produktet dhe shërbimet bankare e financiare”.

Konstatimi i Autoritetit të Konkurrencës për bërjen transparente të ndryshimeve të kushteve të punës dhe tarifave nga ana e bankave të nivelit të dytë është element i rëndësishëm i mbrojtjes së konkurrencës së lirë dhe zgjedhjes konsumatore në veçanti dhe mbrojtjes së interesit publik në përgjithësi. Transparenca e bankave dhe asimetria e informacionit është vlerësuar nga Autoriteti i Konkurrencës edhe në bazë të Ligjit nr. 9902 datë 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, në të cilin është parashikuar që kontratat e bankave me klientët rregullohet me akte nënligjore të Bankës së Shqipërisë si enti mbikëqyrës i sistemit bankar.

II.2 Vlerësimi i tarifave të shërbimit

Autoriteti i konkurrencës ka kryer një vlerësim të tarifave të shërbimeve duke i krahasuar sipas grupeve të bankave G3, G2 dhe G1. Ky vlerësim është bërë për komisionet (i) për llogarite rrjedhëse; (ii) e kredive dhe overdraft; (iii) për çeqet bankare; (iv) për kartat (kreditit dhe debiti) si dhe për (v) transfertat ndër-bankare.

Nga monitorimi u konstatua se disa banka janë pjesë e një rrjeti ndërkombëtar bankash, që veprojnë në vendet e ndryshme të rajonit të Ballkanit si Kosova, Maqedonia, Bullgaria, Rumania, Bosnje-Hercegovina, Serbia dhe Greqia¹. Në këtë kuadër u krahasuan tarifave të shërbimit të bankave që operojnë në Shqipëri, me degët brenda të njëjtimit rrjet të bankave në rajon.

II.2.1 Komisionet për llogarite rrjedhëse

Nga vlerësimi i shërbimeve dhe tarifave të shërbimeve për llogaritë rrjedhëse, u vu re se bankat, brenda grupeve përkatëse, aplikojnë tarifa të ndryshme për të njëjtat shërbime. Tarifave të shërbimit për bankat brenda grupeve (G1, G2, G3) janë të krahasueshme.

¹ Vetëm për rrjetin e bankave me kapital grek.

Tarifat e shërbimeve në pjesën më të madhe të bankave të nivelit të dytë, ofrohen në monedhën euro, duke e detyruar klientin të kryejë pagesën në valutë ose në lekë, por të konvertuar sipas kursit ditor të këmbimit të bankës. Në kushtet kur çdo biznes që operon në Shqipëri është i detyruar të regjistrojë aktivitetin financiar në monedhën vendase (Ligji për Kontabilitetin), është e padrejtë që arkëtimet, të ardhurat që sigurojnë bankat nga ofrimi i shërbimeve të jenë në euro dhe tarifa e shërbimit në monedhe vendase të jetë variabël sipas kursit të këmbimit. Kjo mënyrë aplikimi e bankave krijon një paqartësi tek klientët dhe për me tepër i vendos përpara riskut të kursit të këmbimit.

Tarifat e shërbimeve për llogaritë rrjedhëse nuk kanë ndryshuar gjatë periudhës objekt monitorimi. Gjatë kësaj periudhe bankat kanë konkurruar në treg nëpërmjet ofrimit të shërbimeve të reja

II.2.2. Komisionet e kredive dhe overdraft-et

Nga analiza e tarifave të shërbimeve për kreditë dhe overdraft u vu re se:

1. Për sa i përket kredive dhe overdrafteve, bankat e nivelit të dytë ofrojnë një gamë shumë të gjerë shërbimesh të cilat ndryshojnë nga një bankë në tjetrën dhe shprehen në forma të ndryshme (në vlerë ose në përqindje).
2. Pothuajse të gjitha bankat aplikojnë komision administrimi. Ai varion nga 1%-3% për kredinë konsumatore, nga ku BIS dhe FIB kanë komision fiks më të ulët 1%; nga 1%-2.5% për kredinë për shtëpi, nga ku BKT, BC, BP, NBG dhe BIS e kanë komisionin 1%; dhe nga 1%-2% për kredinë për makina.
3. Ekzistenca e shumëllojshmërisë së shërbimeve dhe formave të tarifimit nga banka të ndryshme bën që bankat të konkurrojnë midis tyre. Konkurrenca midis bankave shfaqet edhe nëpërmjet paketave të kredive që ato ofrojnë për klientët që marrin pagën në një bankë të veçantë apo kanë depozitë (klientët preferencialë) në krahasim me klientët e tjerë.

Nga analiza vërehet se bankat i ndryshojnë kushtet e punës afërsisht një herë në vit ose atëherë kur ofrohet ndonjë shërbim i ri që bën të nevojshëm publikimin e kushteve të reja.

II.2.3 Komisionet për çeqet bankare

Nga vlerësimi i tarifave të lëshimit dhe pranimit të çeqeve u konstatua se:

1. Tarifat e publikuara nga bankat për shërbimin e çeqeve janë kryesisht në Euro.
2. Të gjitha bankat emetojnë blloqe çeqesh, çmimi i blerjes së të cilave është i ndryshëm për banka të ndryshme.
4. Komisionet e lëshimit të çeqeve, të pranimit të çeqeve dhe për ndalimin e ekzekutimit të cekut janë të ndryshme për banka të ndryshme ndërsa komisionet e pranimit të çeqeve të lëshuara nga vetë banka janë zero ose shumë të ulëta.

II.2.4 Komisionet për kartat (kreditë dhe debiti).

Numri i bankave që përdorin produktet elektronike² shkoi në 12 në vitin 2008, dhe sasia e kartave elektronike të emetuara gjatë këtij viti ishte 513,232 nga të cilat 496,301 ishin

² Sipas të dhënave të BSH në lidhje me plotësimin e pyetësorit të BE

karta debiti dhe 15,391 karta krediti. Ndërkohë që numri total i ATM-ve të instaluar në sistemin bankar shkoi në 642 dhe i POS-eve në 2,953.

Përdorimi i kartave kërkon një infrastrukturë teknologjike si dhe licencat për emetim dhe përvetësim të kartave. Nga monitorimi u vu re se vetëm një bankë e grupit G1 nuk ofron produktin e kartave bankare³ dhe vetëm nëntë prej tyre ofrojnë si kartën e debitit dhe të kreditit.

Nga analiza e të dhënave, vihet re se në lidhje me kartat e debitit, asnjë bankë nuk aplikon tarifa shërbimi për tërheqje kesh nga ATM e vetë bankës⁴ si dhe për përdorimin e pikave POS të vetë bankës. Të gjitha kartat e debitit mund të përdoren në ATM bankave të tjera kundrejt tarifave të shërbimit të cilat variojnë nga 150 leke tek Intesa SanPaolo në 600 leke tek Tirana Bank. Kartat e debitit të emetuara nga BIS bank dhe BNT përdoren vetëm në ATM e këtyre bankave. Tarifatat e shërbimeve në ATM dhe POS e disa banka janë në vlerë fikse dhe në disa të tjera në % por me kufi minimal. Gjithsesi kjo tarife është e ndryshme për banka të ndryshme.

Për kartat e kreditit, të gjitha bankat aplikojnë tarifa shërbimi për tërheqje cash nga ATM e vet bankës dhe bankave të tjera si dhe për përdorimin e pikave POS. Tarifatat e komisioneve për shërbimet kartave të kreditit janë të ndryshme për banka të ndryshme.

II.2.5 Transfertat ndërbankare.

Sistemi i transfertave ndër-bankare ndahet në dy grupe në transfertat me vlerë të vogël dhe transfertat me vlerë të madhe. Transfertat ndërbankare kryhen nëpërmjet sistemit AIPS dhe sistemit AECH. Sistemi AIPS (Albanian Interbank Payment System) është sistemi i shlyerjes së pagesave ndërbankare me vlerë të madhe ndërsa sistemi AECH (Albanian Electronic Clearing House) është sistemi i klerimit të pagesave me vlerë të vogël.

Në sistemin AIPS kryhen 5 lloj shërbimesh që janë: transaksione/instrumente financiare BSH, transferata cash për/nga emisioni, pagesa ndër-bankare, pagesa për klientët dhe shlyerje për sistemet e klerimit neto. Monitorimi është përqendruar etëm në pagesat për klientët të cilat zënë 51% të totalit të shërbimeve të ofruara në sistemin AIPS.

Bankat e nivelit të dytë aplikojnë tarifa të ndryshme për transfertat ndër-bankare në sistemin AECH dhe AIPS.

II.3. Krahasimi me rajonin

Nga vlerësimi i bankave të sistemit bankar në Shqipëri u konstatua se disa banka janë pjesë e një rrjeti ndërkombëtar bankash. Për të pasur një panoramë më të qartë për tarifatat e shërbimeve bankare që paguan konsumatori shqiptar është bërë një krahasim me tarifatat e përdorura në vendet e rajonit në të cilin veprojnë të njëjtat rrjete bankare. Vendet e marra në shqyrtim janë Kosova, Maqedonia, Bullgaria, Rumania, Bosnje- Hercegovina, Serbia dhe Greqia.

Për shkak të treguesve të ndryshëm makroekonomike dhe karakteristikave të ndryshme të sistemeve bankare për këto vende, krahasimi me rajonin ka për qëllim vetëm të përcaktojë nivelin në të cilin gjenden tarifatat e shërbimit në Shqipëri dhe jo të arrijë në konkluzionin nëse

³ Banka e Kreditit e Shqipërisë

⁴ Vetëm Banka Credins aplikon komision pas tërheqjes së trete Brenda muajit.

këto tarifa janë abuzive dhe jo-konkurrenciale. Konkluzioni nëse tarifat e shërbimit janë abuzive apo jo, do të kërkonte një përlllogaritje të saktë të kosto/përfitim nga bankat e nivelit të dyte apo nga Banka Qendrore. Deri tani, sipas informacionit verbal të marre nga Banka e Shqipërisë nuk ekziston një analizë e tillë. Departamenti i Mbikëqyrjes pranë BSH nuk i mbikëqyr kostot e shërbimeve të ofruar nga bankat e nivelit të dyte.

Disa nga bankat që janë të përfshira në rrjete të tilla ndërkombëtare janë Raiffeisen bank; Intesa Sanpaolo Bank; Alpha Bank, Tirana Bank (Grupi i Bankave të Pireut), Procredit bank etj. Vlerësimi i tarifave⁵ të shërbimeve janë ndarë sipas llojit të shërbimit brenda të njëjtit rrjet bankash.

Nga të dhënat e administruara rezulton se bankat që operojnë në Shqipëri aplikojnë kryesisht tarifa më të larta të shërbimeve bankare sesa bankat homologe në rajon, kryesisht kjo për komisionet fikse si komisioni për mbyllje llogari rrjedhëse, mirëmbajtje llogarie, komisioni për lëshimin dhe komisioni për shërbimin vjetor të kartave plastike

III. Konkluzione

Nga monitorimi i kryer në tregun e shërbimeve në bankat e nivelit të dyte rezulton se;

1. Mungesa e transparencës reflektohet në mungesën e elasticitetit të kërkesës për shërbimet bankare dhe në këto kushte behët e vështirë analiza e shkallës së konkurrencës efektive midis operatorve të këtij tregu.
2. Bankat e nivelit të dytë aplikojnë kryesisht tarifa të ndryshme për të njëjtin shërbim.
3. Bankat e nivelit të dytë për disa nga shërbimet si p.sh llogaritje rrjedhëse dhe çeqet aplikojnë komisione në euro dhe jo në monedhë vendase, duke i vendosur konsumatorët përballë riskut të kursit të këmbimit.
4. Nga vlerësimi i treguesve të transparencës u konstatua se jo të gjitha bankat e nivelit të dytë kanë faqe interneti dhe si rrjedhojë nuk kanë të publikuara kushtet e punës në gjuhën shqipe. Thekssojmë se megjithëse disa janë degë të bankave të huaja, për sa kohë veprojnë në territorin gjeografik të Republikës së Shqipërisë duhet të informojnë klientët në gjuhën shqipe.
5. Në disa raste është vënë re se bankat nuk i njoftojnë klientët kur ndryshojnë kushtet e punës për kontratat e shërbimeve, në mënyrë të veçantë kur rriten komisionet e llogarive rrjedhëse apo kartave të debitit/kreditit, duke mos zbatuar në këtë mënyrë rregulloren Nr. 59, datë 29.08.2008 “Mbi transparencën për produktet dhe shërbimet bankare e financiare”.
6. Nga krahasimi i tarifave të shërbimeve më bankat e rajonit, brenda të njëjtit Grup Bankar, u konstatua se bankat që operojnë në Shqipëri aplikojnë tarifa më të larta të shërbimeve bankare (si komisioni për mbyllje llogarie rrjedhëse, mirëmbajtje llogarie, kartat plastike) sesa bankat homologe në rajon, duke vështirësuar përfitimin e këtyre shërbimeve nga klientët dhe mundësinë e ndërrimit të bankës.

⁵ Duke qenë se tarifat e shërbimeve paraqiten kryesisht në monedhat vendase të vendeve të rajonit, kemi bërë konvertimin në monedhën EURO përkatëse në monedhën euro sipas kursit të këmbimit ofruar nga website: www.xe.com.

PËR KËTO ARSYE:

Në bazë të nenit 24, shkronja d, nenit 28 dhe nenit 70, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar), Komisioni i Konkurrencës,

VENDOSI:

1. Ti rekomandojë Bankës së Shqipërisë:
 - a. Të përmirësojë instrumentat për të forcuar zbatimin e kuadrit ligjor dhe nënligjor për transparencën e bankave të nivelit të dytë, në mënyrë të veçantë në rastet kur bankat rrisin në mënyrë të njëanshme dhe pa njoftuar tarifat e shërbimeve për klientët.
 - b. Të marrë masa për rritjen e transparencës së bankave të nivelit të dytë për produktet dhe shërbimet bankare dhe financiare nëpërmjet vendosjes së detyrimit për krijimin dhe përditësimin e informacionit në faqet e internetit të bankave të nivelit të dytë në lidhje me publikimin e kushteve të punës.

Rritja e transparencës do t’ju ofronte më shumë mundësi zgjedhje klientëve duke rritur në këtë mënyrë konkurrencën midis bankave.

2. T’i rekomandojë Komisionit të Mbrojtjes Konsumatore propozimin e nismës ligjore për ngritjen e një strukture të veçantë (Ombdusman) për mbrojtjen e konsumatorëve nga abuzimet e mundshme të sistemit bankar. Ombdusmani për klientët e bankave duhet të ngrihet si një autoritet publik në shqyrtimin e ankesave të klientëve në lidhje me produkte të ndryshme të ofruara nga bankat e nivelit të dytë.
3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e vendimit për Bankën e Shqipërisë dhe Komisionin e Mbrojtjes Konsumatore.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete Gruda

()

Anëtar

Koço Broka

()

Anëtar

Rezana Konomi

()

Anëtar

Lindita Milo (Lati)

K R Y E T A R



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 175, Datë 22.02.2011

Për Miratimin e Raportit Vjetor
“Mbi veprimtarinë e Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2010 dhe synimet kryesore për vitin 2011”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Servete Gruda Anëtar
- Koço Broka Anëtar
- Rezana Konomi Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 22.02.2011, shqyrtoi materialin e paraqitur nga Sekretari i Përgjithshëm, të titulluar “Raporti vjetor 2010 dhe synimet kryesore për vitin 2011”.

Bazuar në nenet 24, gërma e, dhe 29, gërma ç, të Ligjit nr. 9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (të ndryshuar), pas shqyrtimit të projekt-raportit të paraqitur nga Sekretari i Përgjithshëm,

VENDOSI:

1. Të miratojë Raportin Vjetor “Mbi veprimtarinë e Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2010 dhe synimet kryesore për vitin 2011” sipas raportit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete Gruda
 (_____)
 Anëtar

Koço Broka
 (_____)
 Anëtar

Rezana Konomi
 (_____)
 Anëtar

Lindita Milo (Lati)

KRYETAR



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 176, Datë 24.02.2011

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES
“PËR PROCEDURAT HETIMORE TË AUTORITETIT TË KONKURRENCËS”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Servete Gruda Anëtar
- Koço Broka Anëtar
- Rezana Konomi Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 24.02.2011, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Miratimin e Rregullores “Për Procedurat Hetimore të Autoritetit të Konkurrencës” në zbatim të Ligjit nr 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” (i ndryshuar);

Baza ligjore: Ligji nr 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” (i ndryshuar), neni 24, shkronja d), dh).

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të Projekt Rregullores ”Për Procedurat Hetimore të Autoritetit të Konkurrencës ”:

VENDOSI:

1. Të miratojë Rregulloren “Për Procedurat Hetimore të Autoritetit të Konkurrencës”
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete Gruda
()
Anëtar

Koço Broka
()
Anëtar

Rezana Konomi
()
Anëtar

Lindita Milo (Lati)

KRYETAR

Rregullore

”Për procedurat hetimore të Autoritetit të Konkurrencës”¹

Kreu I

Dispozita të Përgjithshme

Neni 1

Qëllimi

1. Kjo rregullore ka për qëllim të përcaktojë procedurat që ndjek Autoriteti i Konkurrencës në zbatim të neneve 4, 5, dhe 9, si dhe për hetimin në sektorët e ekonomisë sipas nenit 41, të Ligjit Nr.9121, datë 23.07.2003, “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”.

Neni 2

Përcaktime

1. Në këtë rregullore, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:
 - “Ligj” do të kuptojmë Ligjin nr 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar;
 - “Autoriteti i Konkurrencës”, që më poshtë do të quhet Autoriteti, është struktura e ngarkuar me kontrollin e zbatimit të këtij ligji;
 - “Komisioni i Konkurrencës”, që më poshtë do të quhet Komisioni, është struktura vendimmarrëse e Autoritetit të Konkurrencës;
 - “Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës”, që më poshtë do të quhet Sekretariati është struktura që kryen procedurat hetimore të Autoritetit;
 - “Sekretari i Përgjithshëm” drejton Sekretariatit dhe përgjigjet për mbarëvajtjen e veprimtarisë së Sekretariatit;
 - “Grupi i Punës”, është grupi i nëpunësve të Sekretariatit të caktuar nga Sekretari i Përgjithshëm për të kryer procedurat hetimore;
 - “Dokument” do të kuptojmë çdo grafikë, fotografimi ose kinematografike, elektromagnetike ose çdo lloj tjetër përfaqësimi të dokumenteve. Këtu përfshihen edhe dokumentet e brendshme dhe jozyrtare, të cilat janë hartuar dhe janë përdorur për qëllime të veprimtarive të ndërmarrjes, pavarësisht nga niveli i përgjegjësisë së autorit të dokumentit si përfaqësues i ndërmarrjes, si dhe çdo dokument tjetër që është hartuar ose është ruajtur në një kompjuter.

¹ 32003R0001, Rregullore e Këshillit(EC) nr 1/2003 e datës 16 Dhjetor 2002 “Për zbatimin e rregullave të konkurrencës të përcaktuara në nenet 81 dhe 82 të Traktatit”(OJ L1, 04.01.2003, p 1-25)

Kreu II

Procedurat Hetimore

Neni 3

Hetimi në sektorët e ekonomisë

1. Komisioni, në zbatim të Nenit 41 të Ligjit, mund të autorizojë në çdo kohë Sekretariatit për të filluar mbledhjen e fakteve për hetim, me qëllim vlerësimin e konkurrencës në treg, si dhe evidentimin e shtrembërimeve të mundshme të saj. Ky hetim mund të kërkohet nga Kuvendi ose nga entet rregullatorë të sektorëve të veçantë.
2. Gjatë periudhës së hetimit referuar pikës 1 të këtij neni, Autoriteti mund të kërkojë informacione dhe dokumente si dhe të urdhërojë inspektive, dëshmi ekspertësh, analiza statistikore dhe ekonomike, apo të konsultohet me ekspertë duke ndjekur procedurat sipas neneve 8, 9, 10 dhe 12, të kësaj Rregulloreje. Gjithashtu, janë të zbatueshme sanksionet e parashikuara në nenet 73 dhe 76 të Ligjit. Gjatë kësaj procedure hetimore nuk lejohet konsultimi me dosjen.
3. Sekretariati informon Komisionin për rezultatet e hetimit. Njoftimi mbi rezultatet e hetimit **publikohet** në Buletinin Zyrtar të Autoritetit, në faqen e internetit² të Autoritetit, **si dhe mund të ftojë palët e interesuara të shprehen për rezultatet e hetimit.**
4. Nëse gjatë këtij hetimi ka të dhëna që tregojnë se nenet 4 dhe/ose 9 të Ligjit, mund të jenë shkelur, Sekretariati njofton menjëherë Komisionin, i cili, nëse është i bindur që ka shenja të mjaftueshme lidhur me shkeljen e nenit 4 dhe /ose 9 të Ligjit, autorizon Sekretariatit që të fillojë procedurat e hetimit të thelluar siç përcaktohen në nenin 5 të kësaj rregulloreje.

Neni 4

Hetimi Paraparak

1. Në zbatim të nenit 42 të Ligjit, Sekretariati mund të fillojë një procedurë paraprake hetimore:
 - a) Me nismën e tij, me **vendim** të Komisionit;
 - b) Në bazë të një ankese të të tretëve,
 - c) Çdo herë që kërkohet nga Komisioni.
2. Qëllimi i hetimit paraprak është evidentimi nëse ka ose jo shenja të pengimit, kufizimit ose shtrembërimit të konkurrencës në treg, të cilat mund të shërbejnë si shkaqe për hapjen e hetimit të thelluar nga Komisioni, sipas nenit 5 të kësaj Rregulloreje.
3. **Vendimi i Komisionit për hapjen e këtij hetimi, ndër të tjera duhet të përmbajë:**
 - a) qëllimin e hetimit;

² www.caa.gov.al

- b) faktet që janë bërë shkas për nxjerrjen e vendimit, si dhe,
 - c) bazën ligjore.
4. Sekretari i përgjithshëm me Urdhër ngre grupin e punës. Për çështje komplekse për të cilat kërkohet njohuri të thelluara të fushës përkatëse, Autoriteti mund të kontraktojë një ekspert i jashtëm, i cili mund të jetë pjesë e grupit të punës.
 5. Në fillim të kësaj procedure, Grupi i punës është përgjegjës për hartimin e **planit të** veprimeve. Në përfundim të hetimit, grupi i punës është përgjegjës për hartimin e raportit të hetimit paraprak. **Plani i veprimeve** dhe Raporti i hetimit i paraqitet për miratim Sekretarit të Përgjithshëm.
 6. Gjatë kësaj procedure hetimore, **Sekretariati** mund të kërkojë informacione dhe dokumente si dhe të urdhërojë inspektive, dëshmi ekspertësh, analiza statistikore dhe ekonomike, apo të konsultohet me ekspertë duke ndjekur procedurat sipas neneve 8, 9, 10 dhe 12, të kësaj Rregulloreje. Gjithashtu, janë të zbatueshme sanksionet e parashikuara në nenet 73 dhe 76 të Ligjit. Gjatë kësaj procedure hetimore nuk lejohet konsultimi me dosjen.
 7. Raporti i hetimit paraprak së bashku me relacionin e Sekretarit të Përgjithshëm i paraqitet për vendimmarrje Komisionit.
 8. Raporti i hetimit paraprak, ndër të tjerave përmban:
 - a) Tregun përkatës, Objekti i hetimit, bazën ligjore, datën e fillimit të hetimit;
 - b) Emri, adresa dhe të dhëna të tjera të palëve të dyshuara për shkelje të ligjit;
 - c) Të dhënat dhe informacionet e grumbulluara gjatë hetimit, si dhe analizën e tyre;
 - d) Shpjegimet e dhëna nga palët, intervistat e kryera me persona të lidhur me çështjen;
 - e) Gjetjet dhe rekomandimet përkatëse.
 9. Komisioni, bazuar në raportin e paraqitur, në fund të procedurave të hetimit paraprak, mund të vendosë:
 - a) Mbylljen e hetimit;
 - b) Hapjen e procedurës së Hetimit të Thelluar, sipas nenit 5 të kësaj Rregulloreje;
 - c) Kthimin për rishikim të raportit të hetimit, duke kërkuar hetime shtesë, si dhe **duke përcaktuar çështjet që kërkojnë analiza të mëtejshme**.

Neni 5

Hetimi i Thelluar

1. Pas shqyrtimit të propozimeve të Sekretariatit, kur vihen re shenja të shkeljes së neneve 4 dhe/ose 9 të Ligjit, Komisioni autorizon Sekretariatit të ndërmarrë një hetim sipas nenit 43 të Ligjit. Sekretariati fillon këtë hetim në çdo kohë që i kërkohet nga Komisioni.
2. Në rastin e një kërkesë për përjashtim sipas nenit 5 të Ligjit, procedurat e hetimit do të fillojnë në momentin që formulari i njoftimit është depozituar së bashku me të gjithë informacionin dhe të dhënat e nevojshme. **Njoftimi i marrëveshjeve kryhet sipas udhëzimit “Për formën e Njoftimit të marrëveshjeve”**. Nëse kërkesa për një përjashtim është depozituar gjatë kohës që po kryhet një procedurë hetimore, e cila

është tashmë në proces, Sekretariati mund të vlerësojë një kërkesë të tillë përgjatë kësaj procedure dhe, kur është e nevojshme, i kërkon Komisionit zgjatjen e afatit.

3. Vendimi i Komisionit për fillimin e hetimit përmban: ndërmarrjet nën hetim, elementët thelbësorë lidhur me shkeljen e pretenduar, afatin kohor për përfundimin e procedurave, adresën dhe mënyrat e komunikimit me Autoritetin, si dhe afatin kohor brenda të cilit ndërmarrja dhe personat e tjerë të interesuar mund të ushtrojnë të drejtën për të bërë të njohur këndvështrimet e tyre.
4. Vendimi për fillimin e hetimit, ju njoftohet ndërmarrjeve dhe palëve përkatëse, si dhe personit i cili ka interes të drejtpërdrejtë dhe të menjëhershëm në këtë hetim dhe që ka depozituar të dhëna dhe/ose ankesë lidhur me fillimin e këtij hetimi.
5. Njoftimi dorëzohet nga një zyrtar i Sekretariatit, ose një nëpunës tjetër, dorazi, ose nëpërmjet postës, duke konfirmuar marrjen dijeni.
6. Nëse është e pamundur ose veçanërisht e vështirë që ky shërbim të kryhet personalisht, nisur nga numri i madh i adresave dhe njoftimeve, ai gjithashtu mund të njoftohet edhe nëpërmjet publikimit tek të paktën dy gazeta ditore kombëtare me shtrirje të gjerë ose ndonjë formë tjetër e përshtatshme publikimi.
7. Njoftimi që hetimi ka filluar duhet gjithashtu të publikohet në Buletinin Zyrtar të Autoritetit duke treguar detajet përkatëse, si dhe në faqe interneti-n e Autoritetit.
8. Gjatë kësaj procedure hetimore, Autoriteti mund të kërkojë informacione dhe dokumente si dhe të urdhërojë inspektive, dëshmi ekspertësh, analiza statistikore dhe ekonomike, apo të konsultohet me ekspertë duke ndjekur procedurat sipas neneve 8, 9, 10 dhe 12, të kësaj Rregulloreje. Gjithashtu, janë të zbatueshme sanksionet e parashikuara në nenet 73 dhe 76 të Ligjit. Gjatë kësaj procedure hetimore është lejuar konsultimi me dosjen e hetimit, vetëm pasi palëve përkatës ju është dorëzuar raporti i hetimit, referuar nenit 18 kësaj Rregulloreje.
9. Komisioni mund të refuzojë një ankesë, pa filluar procedurat hetimore.

Kreu III

Hetimet

Neni 6

Pjesëmarrja në një hetim

1. Në hetim mund të marrin pjesë:
 - a) Ndërmarrjet, të cilave ju është dorëzuar njoftimi për fillimin e hetimit, sipas nenit 5, pika 4, të kësaj rregulloreje;
 - b) Personat, që përfaqësojnë interesa publike ose private dhe shoqatat që përfaqësojnë konsumatorët, të cilët mund të jenë dëmtuar drejtpërsëdrejti dhe menjëherë nga çdo shkelje që përbën objekt hetimi, ose çdo masë e marrë si rezultat i kësaj. Ata duhet të depozitojnë pranë Autoritetit një kërkesë të arsyetuar për të ndërhyrë, brenda 30 ditëve nga data e publikimit të Vendimit për fillimin e hetimit, në faqen zyrtare të Autoritetit, ose në Buletinin e Vendimeve të tij.

2. Këto palë pjesëmarrëse në hetim:
 - a) Mund të japin deklarata me shkrim, dokumente, argumentime dhe opinione;
 - b) Kanë të drejtë të shqyrtojnë dosjen e hetimit sipas nenit 17 të kësaj Rregulloreje;
 - c) Mund të dëgjohen në lidhje me pretendimet e Sekretariatit që u drejtohen atyre, sipas neneve 19, 20 dhe 21 të kësaj Rregulloreje.

Neni 7

Kryerja e hetimit

1. Në bazë të neneve 41, 42 dhe 43 të Ligjit, hetimi kryhet sipas neneve 33, 34, 36, 37 dhe 38 të Ligjit nga Sekretariati, nga data në të cilën njoftimi i vendimit të Komisionit që e autorizon ose i kërkon Sekretariatit fillimin e hetimit ju është dorëzuar ndërmarrjeve dhe personave të interesuar. Hetimi mund të fillojë njëkohësisht me njoftimin. Në rastin kur ka disa palë nën hetim, hetimi kryhet pasi njoftimi drejtuar atyre është dorëzuar te secili prej tyre individualisht.
2. Sekretariati mund të marrë informacione të ofruara nga çdo individ, ndërmarrje apo person, për qëllime të plotësimit të hetimit, si dhe të realizojë regjistrime ose procesverbale për çdo informacioni të mbledhur.
3. Komisioni, në çdo fazë të hetimit informohet lidhur me rezultatet e hetimit të kryer nga Sekretariati.

Neni 8

Kërkesa për informacion dhe dhënia e dokumenteve

1. Në bazë të nenit 33 të Ligjit, kërkesa dhe vendimi për informacion dhe dhënia e dokumentacionit kryhet me shkrim dhe dorëzohet duke ndjekur procedurat sipas nenit 26 të kësaj Rregulloreje.
2. Ato duhet të përmbajnë shkurtimisht si më poshtë:
 - a) faktet dhe rrethanat në lidhje me sqarimin që është kërkuar;
 - b) qëllimin e kërkesës;
 - c) afatin kohor për përgjigje ose dhënien e dokumenteve, përputhshmërinë me urgjencën e rastit dhe natyrën, sasinë dhe llojin e informacionit të kërkuar, si dhe marrjen parasysh të kohës së nevojshme për ta zotëruar atë;
 - d) Procedurat dhe mënyrat që do të ndiqen për dhënien e informacionit, nga ndërmarrjet tek të cilat gjenden këto dokumente ose informacioni i kërkuar;
 - e) Sanksionet e parashikuara në nenin 73 dhe 76 të Ligjit në rastin e refuzimit të ofrimit të informacionit, ose të dhënies të dokumenteve të kërkuara, ose për çdo informacion të pasaktë, të paplotë, ose të rremë apo vonesë në dhënien e tyre.
3. Kopjet origjinale, ose të njehsuara me origjinalin të të gjitha dokumenteve të kërkuara për t'u dorëzuar duhet të depozitohen, duke treguar pronësinë, ose përfaqësinë ligjore të ndërmarrjes në fjalë.
4. Kërkesat për informacion dhe dhënien e dokumenteve, mund të bëhet gjithashtu edhe verbalisht përgjatë inspektimeve nga inspektorët e sekretariatit. Kërkesa të

tilla duhet të bëhen në përputhje me pikën (2) të këtij neni dhe përgjigjet e tyre duhet të regjistrohen në çdo formë. Një kopje e çdo regjistrimi të bërë duhet ti vihet në dispozicion ndërmarrjes ose bashkimit të ndërmarrjeve pas inspektimit.

5. Në rastet kur një anëtar i stafit të një ndërmarrjeje, i cili nuk është/nuk ishte autorizuar nga ndërmarrja që të jepte shpjegime në emër të ndërmarrjes, është pyetur për shpjegime, inspektorët e Sekretariatit duhet të vendosin një afat kohor, brenda të cilit ndërmarrja, mund të depozitohet pranë sekretariatit çdo korrigjim, ndryshim ose shtesë në shpjegimet e dhëna nga ky anëtar i stafit. Korrigjimet, ndryshimet apo shtesat duhet ti shtohen shpjegimeve siç janë regjistruar sipas pikës (4) të këtij neni.
6. Përgjegjësia për të ofruar informacionin dhe dhënien e dokumenteve të kërkuara nga ndërmarrja, ose degët/filialet, është e ndërmarrjes dhe përfaqësuesve të tyre dhe, në rastin e degët/filialet, pa ose me personalitet juridik, përgjegjësia është e përfaqësuesve të tyre ligjor sipas dispozitave të Statutit dhe/ose Aktit të Themelimit.

Neni 9

Inspektimet

1. Komisioni autorizon me shkrim inspektorët e Sekretariatit, bazuar në nenin 36 dhe 37 të Ligjit, për të kryer inspektimeve në mjediset e çdo pale, kur dyshohet se posedon dokumente që lidhen me hetimin.
2. Përfaqësues të Sekretariatit, të autorizuar nga Komisioni që të kryejnë një inspektim në mjediset e ndërmarrjes (sipas nenit 36 të Ligjit), duhet të ushtrojnë të drejtat nëpërmjet paraqitjes së autorizimit me shkrim të Komisionit, i cili përcakton ndërmarrjen objekt hetimi, si dhe sanksionet për ndonjë refuzim të pajustificuar, dështim apo vonesë në ofrimin e informacionit apo dhënien e dokumenteve të kërkuara përgjatë inspektimit, si dhe për ofrimin e informacionit të pasaktë, të paplotë ose të rremë.
3. Gjatë inspektimeve në ndërmarrje, inspektorët mund:
 - a) Të hyjnë në mjediset, mjetet e transportit dhe në territorin e ndërmarrjeve, gjatë orarit të punës;
 - b) të shqyrtojnë librat dhe regjistrat e veprimtarisë ekonomike dhe dokumentet e tjera, pavarësisht nga mënyra e ruajtjes së këtij dokumentacioni, në formë të shkruar ose elektronike;
 - c) të marrin ose të sigurojnë kopje ose pjesë nga këto libra, regjistra ose dokumente;
 - d) të vulosin çdo seli, libër ose regjistër të veprimtarisë ekonomike për jo më shumë se 72 orë, nëse një gjë e tillë është e nevojshme për inspektimin;
 - e) t'i kërkojnë çdo përfaqësuesi ose punonjësi të ndërmarrjes shpjegime për fakte dhe dokumente, që lidhen me objektin dhe qëllimin e inspektimit.
4. Përfaqësues të Sekretariatit, të autorizuar nga Komisioni që të kryejnë një inspektim në mjedise private (sipas nenit 37 të Ligjit), duhet të paraqesin përpara gjykatës kompetente, një kërkesë për autorizim për inspektim në mjedise private. Kjo kërkesë duhet të përmbajë ndër të tjera, llojin e shkeljes së dyshuar të ligjit, të dhënat e sakta ose sa më të përafërta për identifikimin e mjedisit privat që kërkohet të inspektohet, arsyetimin e nevojës për inspektim në këto mjedise.

5. Gjatë inspektimeve në mjediset e parashikuara në pikën 4 të këtij neni, Sekretariati mund të hyjë:
 - a) në banesat e administratorëve, menaxherëve, drejtorëve dhe punonjësve të tjerë të ndërmarrjes, si dhe në banesat e selitë e veprimtarisë ekonomike të personave fizikë dhe juridikë, të brendshëm ose të jashtëm, të ngarkuar për menaxhimin tregtar, kontabël, administrativ, fiskal ose financiar nga ora 7⁰⁰ deri në orën 18⁰⁰;
 - b) në mjedise të tjera, të njësuara me banesat, kur ka arsye të bazuara për fakte dhe rrethana konkrete se në këto mjedise gjenden ditare ose dokumente të tjera profesionale, që mund të jenë të nevojshme për të vërtetuar shkeljet e neneve 4 dhe 9 të Ligjit.
6. Sekretariati me autorizim të Komisionit, për kryerjen e kontrollit mund të sekuestrojë objekte që kanë vlerën e provës materiale në hetim, për jo më shumë se 72 orë, nëse një gjë e tillë është e domosdoshme. Personi që preket nga sekuestrimi njoftohet për këtë pa vonesë. Autoriteti mund të paraqesë kërkesë në Gjykatë e cila ka në juridiksion vendin ku ndodh sekuestrimi dhe mund ta zgjasë afatin e mbajtjes në sekuestro jo më shumë se 6 muaj. Inspektorët hartojnë një procesverbal për sekuestrimin, një kopje e të cilit i jepet personit të interesuar. Ky person vihet në dijeni për të drejtën e ankimit në gjykatë.
7. Në asnjë fazë të hetimit, pikat e mëposhtme nuk konsiderohen si arsye të justifikuara për refuzimin e ofrimit të informacionit dhe dokumenteve të kërkuara në përputhje me këtë nen:
 - a) konfidencialiteti, ose ushtrimi i të drejtave dhe autoritetit të vendosur nga rregulloret e ndërmarrjeve, ose urdhra të brendshme duke përfshirë edhe instruksionet verbale;
 - b) nevoja për të mbrojtur palët në fjalë nga rreziku i sanksioneve fiskale apo administrative;
 - c) nevoja për të mbrojtur konfidencialitetin e ndërmarrjes ose sekretin tregtar.
8. Gjatë inspektimit, palët e interesuara mund të ndihmohen nga konsulentët dhe këshilltarët e zgjedhur të tyre edhe pse mungesa e tyre nuk sjell pezullimin e inspektimit.
9. Në të gjitha veprimet e kryera gjatë inspektimit duhet mbajtur shënim me shkrim në çfarëdo forme, me referencë të veçantë për çdo deklaratë të marrë dhe dokumente të mbledhura nga inspektorët.
10. Në kryerjen e inspektimit, inspektorët e Sekretariatit mund të kërkojnë gjithashtu ndihmën e policisë së shtetit, sipas nenin 35 të Ligjit.

Neni 10

Marrja e deklaratave

1. Komisioni autorizon inspektorët për të intervistuar çdo person me pëlqimin e tij, për zbulimin e shkeljes së rregullave të konkurrencës. Për këtë qëllim, inspektorët duhet që në fillim të intervistës t'u lexojë bazën ligjore dhe qëllimin e intervistës dhe t'u kujtojë natyrën e saj vullnetare. Ata gjithashtu duhet të informojnë personin e intervistuar mbi qëllimin e tyre për të regjistruar intervistën.

2. Intervista mund të bëhet me çdo formë, duke përfshirë dhe atë me anë të telefonit ose në mënyrë elektronike.
3. Inspektorët regjistrojnë çdo deklaratë të dhënë nga ana e personave të intervistuar në çdo formë. Një kopje e regjistrimit i vihet në dispozicion personit të intervistuar për miratim. Kur është e nevojshme, inspektorët caktojnë një afat kohor brenda të cilit personi i intervistuar mund të deklarojë çdo korrigjim të bërë në deklaratë.

Neni 11

Masat e përkohshme

1. Në zbatim të nenit 44 të Ligjit, në çdo kohë gjatë procedurave hetimore Sekretariatit mund t'i propozojë Komisionit marrjen e masave të përkohshme kur ka të ngjarë që ndërmarrja nën hetim të ketë kryer një shkelje prima facie të nenit 4 dhe/ose 9 të Ligjit, e cila mund të shkaktojë dëme rënda dhe të pariparueshme të konkurrencës në treg.
2. Para marrjes së një vendim bazuar në pikën 1 të këtij neni, Komisioni i jep mundësinë personit, ndërmarrjes ose përfaqësuesit të ndërmarrjes, apo grupimeve të ndërmarrjeve, për të dhënë këndvështrimet e tyre lidhur me pretendimet e Sekretariatit.

Neni 12

Raportet e ekspertëve, analiza statistikore dhe ekonomike, si dhe dëshmitë e tyre

1. Në lidhje me çdo çështje me rëndësi për hetimin, Komisioni dhe inspektorët mund të konsultohen me ekspertë dhe të kërkojnë hartimin e raporteve të tyre, si dhe analiza statistikore dhe ekonomike.
2. Bazuar në nenin 30 të Ligjit, ekspertët duhet ti nënshtrohen ruajtjes së konfidencialitetit dhe sekretit profesional, *si dhe deklaramit të konfliktit të interesit*.
3. Dokumentet e mësipërme ju vihen në dispozicion palëve nën hetim, si dhe atyre që kanë një interes të drejtpërdrejtë dhe të menjëhershme, si dhe atyre që kanë depozituar një ankesë, pretendim ose raport, të rëndësishëm për fillimit e hetimit ose kanë ndërhyrë në çfarëdo mënyre në procedurë, me qëllim që t'i mundësojnë ushtrimin e të drejtës së tyre, parashikuar në Nenin 6, pika 2 të kësaj Rregulloreje.

Kreu IV

Trajtimi i Ankesave

Neni 13

Ankesat

1. Procedurat mbi trajtimin e ankesave rregullohen sipas dispozitave përkatëse të kësaj rregulloreje, si dhe Rregullores për Funkcionimin e Autoritetit të Konkurrencës.

2. Personat fizikë dhe juridikë kanë të drejtë të ligjshme të paraqesin një ankesë ku ata janë direkt dhe individualisht të prekur nga një shkelje e mundur e konkurrencës. Ankesat e këtij lloji duhet të përmbajnë informacionin e kërkuar në një formë të veçantë dhe të miratuar nga **Komisioni**. Komisioni mund të veprojë pa këtë detyrim në lidhje me mungesën e informacionit, duke përfshirë dokumentet e kërkuara në formular.
3. Ankesa e plotësuar dhe, nëse është e mundur, kopja elektronike e saj, dorëzohet në Sekretariat. Ankuesi duhet gjithashtu të paraqesë një version jo-konfidencial të ankesës në qoftë se konfidencialiteti është deklaruar për çdo pjesë të ankesës.
4. Ankesa duhet të jetë e plotësuar në gjuhën Shqipe, **sipas Formularit bashkëngjitur kësaj Rregulloreje**.

Neni 14

Pjesëmarrja e ankuesve në procedura

1. Në rastet kur Komisioni autorizon Sekretariatit për dërgimin e Raportit të Hetimit, (në bazë të nenit 18 të kësaj Rregulloreje), në lidhje me një çështje për të cilën ajo ka marrë një ankesë, Sekretariati i jep ankuesit një kopje të Raportit ku janë fshirë të dhënat konfidenciale dhe i vendos një afat kohor brenda të cilit parashtruesi i ankesës mund të prezantojë pretendimet e tij me shkrim.
2. Komisioni i Konkurrencës kur është e nevojshme, mund t'i kërkojë Sekretariatit që t'i japi ankuesit mundësinë për të shprehur pretendimet e tij në seancë dëgjimore të palëve të cilave ju është dërguar Raporti i Hetimit, nëse ankuesit e kërkojnë këtë në komentet e tyre me shkrim.

Neni 15

Refuzimi i ankesave

1. Në rastet kur Komisioni konstaton se në bazë të informacionit të vënë në dispozicion të tij nuk ka prova të mjaftueshme për të vepruar mbi një ankesë, ai kërkon nga Sekretariati të informojë ankuesin mbi vendimin e Komisionit dhe të vendosë një afat kohor brenda të cilit ankuesi mund të paraqesë pretendimet e tij me shkrim. Komisioni nuk është i detyruar të marrë parasysh asnjë pretendim me shkrim të dorëzuar pas këtij afati kohor.
2. Nëse ankuesi paraqet pretendimet e tij brenda afatit kohor të caktuar nga Sekretariati dhe pretendimet me shkrim të bëra prej tij nuk çojnë në një vlerësim ndryshe nga ai i ankesës, Komisioni e refuzon ankesën me vendim. Ky vendim mund të ankimohet para gjykatës kompetente.
3. Nëse ankuesi nuk arrin të paraqesë pretendimet brenda afatit të përcaktuar nga Sekretariati, ankesa do të konsiderohet si e tërhequr.

Neni 16

E drejta për t'u informuar

1. Kur Komisioni i kërkon Sekretariatit të informojë ankuesin mbi vendimin e tij për refuzimin e ankesës, sipas Nenit 15, pika 1, të kësaj Rregulloreje, ankuesi ka

të drejtën të shqyrtojë dokumentet mbi të cilat Komisioni bazon vlerësimin e tij. Megjithatë, ankuesi nuk mund të shqyrtojë dokumentet që përmbajnë sekretet e biznesit dhe informacionet e tjera konfidenciale që u përkasin palëve të tjera të përfshira në procedurë.

2. Dokumentet të cilat ankuesi i ka shqyrtuar gjatë procedimeve të kryera sipas neneve 4 dhe/ose 9 të Ligjit mund të përdoren prej tij vetëm për qëllime të procedurave gjyqësore ose administrative për zbatimin e këtyre dispozitave.

Kreu V

E drejta për t'u dëgjuar

Neni 17

Aksesi në dokumentet dhe informacionet konfidenciale të kërkuara

1. Palët e përfshira drejtpërdrejtë në procedurat lidhur me nenet 4, 5 dhe 9 të Ligjit kanë të drejtë për akses në çdo dokument të hartuar ose përkohësisht të ruajtur nga Komisioni dhe Sekretariati pas njohjes së tyre me Raportin e Hetimit sipas nenit 18 të kësaj Rregulloreje.
2. Në rastet kur dokumentet sipas pikës (1) të këtij neni, përmbajnë informacion personal, tregtar, industriale dhe financiare të një natyre konfidenciale në lidhje me individët ose ndërmarrjet e përfshira në procedurë, e drejta e shqyrtimit është e lejuar, në tërësi ose pjesërisht, vetëm deri në masën që është e nevojshme për ti mundësuar palëve të përfshira drejtpërsëdrejti në procedura që të ushtrijnë të drejtën e tyre të mbrojtjes.
3. Në përputhje me kushtet e nenit 30 të Ligjit, kur lejohet akses në rastet e parashikuara nga pikën (2), të këtij neni dhe në përputhje të kriterëve e kësaj pike, do të merren parasysh të gjitha masat e nevojshme të marra për të mbrojtur interesat e individëve dhe ndërmarrjeve përkatëse kundër përhapjes së informacioneve konfidenciale ose sekreteve tregtare në fjalë.
4. Aksesi nuk do të jepet për: shënimet, propozimet dhe dokumentet e tjera të hartuar nga Sekretariati ose Komisioni, si pjesë e studimit ose përgatitjes së dokumenteve zyrtare në lidhje me rastin.
5. Aksesi mund të kufizohet plotësisht ose pjesërisht për minutat dhe procesverbalet e mbledhjeve të Komisionit, si dhe për dokumentet që kanë të bëjnë me marrëdhëniet ndërmjet Komisionit dhe institucioneve të tjera, apo marrëdhëniet ndërmjet Komisionit dhe autoriteteve të shteteve të tjera ose organizatave ndërkombëtare, për të cilat nuk është autorizuar dhënia e këtyre dokumenteve.
6. Çdo palë që kërkon të mbrojë fshehtësinë e informacionit konfidencial të dhënë gjatë hetimeve, duhet të dorëzojë një kërkesë të veçantë për këtë qëllim pranë Sekretariatit. Kjo kërkesë duhet të përmbajë detaje të dokumenteve ose pjesë të dokumenteve për të cilat ata mendojnë se aksesit nuk duhet të jepet, si dhe të identifikojnë ndërmarrjet në lidhje me të cilat këto dokumente do të konsiderohen konfidenciale, duke specifikuar dhe arsyet për këtë kërkesë.
7. Kur Sekretariati gjykon se ekzistojnë baza të pamjaftueshme në lidhje me ruajtjen e fshehtësisë së informacionit konfidencial, për të justifikuar kërkesën e përmendur në

pikën (6) të këtij neni, duhet të informojë Komisionin me një mendim të arsyetuar. Komisioni mund ta kthejë mendimin e Sekretariatit në rast se kërkesa e referuar në pikën (6) të këtij neni do të konsiderohet e pranuar. Nga ana tjetër, nëse Komisioni vendos ta konfirmojë mendimin e Sekretariatit, duhet që vendimi t'i dërgohet palës kërkuese, sipas nenit 25 të kësaj Rregulloreje.

8. Kur komunikimet, njoftimet, informacionet, deklaratat ose kërkesat janë paraqitur individualisht ose së bashku, nga një ose më shumë ndërmarrje, informacioni që përbën për ndërmarrjen sekret tregtar, mund të paraqitet veçmas në një aneks. Masa të ngjashme mund të kërkoen nga ndërmarrjet në lidhje me çfarëdo lloj seance të përbashkët nga e cila janë mbajtur procesverbale ose regjistrime.
9. E drejta e aksesit duhet të ushtrohet duke paraqitur një kërkesë të arsyetuar me shkrim, sipas të cilës personi përgjegjës i Sekretariatit duhet të veprojë sipas rastit, brenda 30 ditëve, duke njoftuar kështu dhe Komisionin.

Neni 18

Raporti i Hetimit dhe Prapësimet ndaj tij

1. Kur Komisioni konstaton se pretendimet e paraqitura nga inspektorët e Sekretariatit, në bazë të të dhënave të mbledhura gjatë hetimit, janë të bazuara, autorizon Sekretariatit që të informojë palët me shkrim mbi pretendimet e ngritura kundër tyre. Raporti i Hetimit duhet t'i vihet në dispozicion secilit prej tyre.
2. Sekretariati, kur u dërgon Raportin e Hetimit palëve, duhet të përcaktojë një afat kohor brenda të cilit palët mund të sjellin me shkrim pretendimet e tyre. Komisioni nuk është i detyruar të pranojë pretendimet e paraqitura pas këtij afati të vendosur kohor.
3. Palët mundën që në paraqitjen e prapësimeve të tyre me shkrim, të përcaktojnë të gjitha pretendimet, të cilat janë të përshtatshme për mbrojtjen e tyre kundrejt pretendimeve të ngritura nga inspektorët e Sekretariatit. Ata duhet të bashkëlidhin çdo dokument përkatës, si prova të pretendimeve të tyre. Ata duhet të japin një kopje origjinale, si dhe një kopje elektronike, ose në rastet kur nuk e posedojnë një kopje elektronike 3 (tre) kopje të pretendimeve të tyre, si dhe dokumenteve bashkëlidhur. Ata mund t'i propozojnë Komisionit që të dëgjojë persona të tjerë që mund të mbështesin pretendimet e tyre.

Neni 19

E drejta për t'u dëgjuar

1. Komisioni (në zbatim të nenit 39 të Ligjit), duhet t'u japë palëve, tek të cilat Sekretariati ka dërguar Raportin e Hetimit, në bazë të nenit 18 të kësaj Rregulloreje, mundësinë për t'u dëgjuar para se të merret një vendim.
2. Komisioni në vendimet e tij shprehet vetëm mbi pretendimet për të cilat palët, referuar pikës (1) të këtij neni u është dhëna e drejta për t'u dëgjuar.
3. Komisioni u jep palëve, tek të cilat është dërguar Raporti i Hetimit nga Sekretariati, mundësinë për të paraqitur argumentet e tyre në një seancë dëgjimore verbale, nëse kjo është kërkuar në prapësimet e tyre me shkrim.

Neni 20

Dëgjimi i palëve të tjera

1. Nëse personat fizik dhe juridik, përveç palëve të cilave i drejtohet Raporti i Hetimit, ose ankuesi, kërkojnë të dëgjohen dhe që kanë interes të ligjshëm, atëherë Komisioni mund t'i kërkojë Sekretariatit informimin e tyre me shkrim për natyrën dhe objektin e hetimit. Sekretariati cakton një afat kohor brenda të cilit ata mund të paraqesin argumentet e tyre me shkrim.
2. Komisioni, kur është e nevojshme, mund t'i kërkojë Sekretariatit të ftojë personat sipas pikës (1) më sipër, të sjellin argumentet e tyre në seancën dëgjimore të palëve, të cilave u është dërguar Raporti i Hetimit, nëse këta persona e kërkojnë këtë me shkrim.
3. Komisioni mund të kërkojë nga Sekretariati që të ftojë çdo person tjetër për të shprehur pikëpamjet e tij në formë të shkruar dhe për të marrë pjesë në seancën dëgjimore të palëve, të cilave u është dërguar Raporti i Hetimit. Komisioni gjithashtu mund t'i kërkojë Sekretariatit të ftojë personat e përmendur në pikën (1) të këtij neni, që të shprehin pretendimet e tyre në këtë seancë.

Neni 21

Organizimi i seancave dëgjimore

1. Komisioni fton personat që do të dëgjojnë, për të marrë pjesë në seancën dëgjimore, në datën e caktuar prej tij.
2. Para seancës dëgjimore, Sekretariati është përgjegjës për hartimin e axhendës së seancës dëgjimore, e cila miratohet nga Komisioni dhe që në vijim i dërgohet palëve pjesëmarrëse për komente dhe sugjerime nga ana e tyre.
3. Personat e ftuar të marrin pjesë mund të paraqiten personalisht, ose të përfaqësohen nga përfaqësuesit e tyre ligjor, ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre. Ndërmarrjet dhe shoqatat e ndërmarrjeve mund të përfaqësohen nga një person i autorizuar.
4. Personat që do të dëgjohen nga Komisioni mund të asistohen nga avokatët e tyre apo dhe persona të tjerë të kualifikuar, të cilët pranohen nga Komisioni.
5. Seanca dëgjimore nuk është publike. Çdo person mund të dëgjohet veçmas ose në praninë e personave të tjerë të pjesëmarrës në seancë, duke pasur parasysh interesin e ligjshëm të ndërmarrjeve për mbrojtjen e sekreteve të tyre tregtare dhe informacione të tjera konfidenciale.
6. Komisioni mund t'u lejojë palëve, të cilave u është dërguar Raporti i Hetimit, ankuesve, si dhe personave të tjerë pjesëmarrës në seancë dëgjimore, si dhe inspektorëve të Sekretariatit, të bëjnë pyetje gjatë seancës.
7. Deklarimet e dhëna nga çdo person duhet të regjistrohen. Sipas kërkesës, regjistrimi i seancës dëgjimore vihet në dispozicion të personave të cilët marrin pjesë në seancë, duke mbrojtur interesin e ligjshëm të palëve, sekretet e tyre biznesit dhe informacione të tjera konfidenciale të palëve.

Neni 22

Ankimi i vendimeve

Kundër Vendimeve të Komisionit, mund të ushtrohet ankim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, *brenda 30 ditëve nga njoftimi i vendimit.*

Kreu VI

Kërkesa për përjashtim

Neni 23

Njoftimi vullnetar i marrëveshjeve

1. Njoftimi vullnetar i marrëveshjeve (në zbatim të nenit 49 të Ligjit), me qëllim përjashtimin sipas nenit 5 të Ligjit, duhet të depozitohet nga secila ndërmarrje ose nga të gjitha ndërmarrjet, të cilat janë palë në një marrëveshje, ose grupimi i ndërmarrjeve në lidhje me vendimin e marrë nga ata. Ato duhet të depozitohen në një format të veçantë të siguruar nga Sekretariati, i cili duhet të përmbajë të gjithë informacionin dhe të përfshijë të gjitha anekset që janë të nevojshme për të vlerësuar marrëveshjen apo praktikën, bazuar në Udhëzimin “Për Formën e Njoftimit të Marrëveshjeve”.
2. Një ekstrakt i njoftimit (në zbatim të nenit 52 të Ligjit), duhet të publikohet në Buletinin Zyrtar të Autoritetit/Buletinin e Vendimeve të AK-së dhe/ose publikimi në faqen e internetit të Autoritetit, me qëllim që të ftohen palët e treta të japin komentet e tyre brenda 30 ditëve nga publikimi. Publikimi duhet të përcaktojë emrat, selitë, aktivitetin ekonomik të ndërmarrjeve në fjalë, si dhe përmbajtjen kryesore të marrëveshjes.
3. Sekretariati duhet të njoftojë ndërmarrjen nëse njoftimi është i paplotë dhe i pasaktë. Në këto rrethana, afati tremujor i përcaktuar në nenin 50, pika 1, të Ligjit, fillon të llogaritet nga data që është marrë informacioni që do të shtohet njoftimit origjinal.
4. Sekretariati mund të kërkojë informacion shtesë dhe elementë shtesë nga ndërmarrja në fjalë me qëllim që të bëjë të mundur vlerësimin e njoftimit. Në këtë rast, afati tremujor i referuar në nenin 50, pika 1, e Ligjit, fillon nga momenti që ky informacion është marrë.
5. Çdo ndryshim i ndonjë elementi thelbësor në njoftimin origjinal duhet të bëhet i ditur në Sekretariat sapo palët ose njëra prej tyre merr dijeni për këtë. Për qëllime të afatit tremujor të përcaktuar në nenin 50, pika 1, e Ligjit, njoftimi i ndryshimit është i barazvlefshëm me një njoftim të ri.
6. Njoftimi duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesit ligjor të ndërmarrjeve, ose nga personat që iu është dhënë e drejta e përfaqësimit dhe duhet të depozitohet në Sekretariat së bashku me dokumentin përkatës të përfaqësimit, nëpërmjet librit të postës, ose dorazi kundrejt marrjes së konfirmimit.
7. Vendimi i përjashtimit i Komisionit i përcaktuar në nenin 50, pika 1 e Ligjit, nuk sjell asnjë efekt para datës së njoftimit të palëve.

Neni 24

Revokimi i Vendimit të Përjashtimit të Marrëveshjes

1. E njëjta procedurë e parashikuar në këtë Rregullore do të ndiqet kur Komisioni bazuar në nenin 51 të Ligjit, revokon një përjashtim të dhënë sipas Neni 5 Ligjit, pasi i njofton me shkrim palët e interesuara për fillimin e procedurës, në përputhje me kushtet e parashikuara në nenin 5 të kësaj Rregulloreje.

Kreu VII
Dispozita përfundimtare

Neni 25
Njoftimet

1. Aplikimi, kërkesat, dërgimi i dokumenteve dhe thirrja e palëve, kryhet si vijon:
 - a) me postë, me shpërndarje të regjistruar;
 - b) dorazi me konfirmimin e marrjes dijeni;
 - c) faks, me një kërkesë për konfirmim me shkrim në datën e mbërritjes;
 - d) teleks ose telegram.
2. Të njëjtat dispozita zbatohen dhe për dorëzimin e dokumenteve dhe të kërkesave për Komisionin dhe Sekretariatit në lidhje me hetimin, nga ana e palëve të interesuara, ose nga palët e treta. Në rastin e shërbimit me teleks, telegram ose me faks, dokumentet konsiderohen se janë marrë në datën në të cilën janë dërguar, përveç rasteve kur mund të provohet e kundërta.
3. Kur njoftimet nënshkruhen nga përfaqësuesit e individëve, të ndërmarrjeve ose të subjekteve, këta përfaqësues duhet të jenë të pajisur me dokument përfaqësimi.

Neni 26
Hyrja në fuqi

1. Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.

FORMULARI I ANKESËS

I. Informacioni përsa i përket, ankuesit ose bashkimit të ndërmarrjeve që ngrenë ankimin.

<p>(1). Jepni të dhëna të plota për identitetin e personave fizik ose juridik të cilët bëjnë ankimin.</p> <p>Në rast se autori i ankesës është një Ndërmarrje, identifikoni grupin në të cilin juve bëni pjesë, dhe saktësoni fushën në të cilën kryeni aktivitetin tuaj.</p> <p>Përmendni një person kontakti: (me numër telefoni, adresë postare dhe e-mail) nga i cili mund të sigurohen shpjegime suplementare.</p>	<p>Emri mbiemër _____</p> <p>Adrese _____</p> <p>_____</p> <p>Nr. Pasaporte _____</p> <p>Nr ID karte _____</p> <p>Nr tel/fax _____</p> <p>Cel; _____</p> <p>e-mail; _____</p> <p>_____</p> <p>_____</p> <p>Emri mbiemër _____</p> <p>Nr. tel/fax _____</p> <p>Adrese _____</p> <p>e-mail _____</p>
<p>(2) Identifikoni Ndërmarrjen / Grupim ndërmarrjesh (shoqata), sjellja e të cilëve përbën objektin e ankesës, përfshirë informacionin në c'farë grupi bëjnë pjesë dhe natyrën, fushën e aktivitetit në të cilën ata veprojnë.</p> <p>Identifikoni pozicionin tuaj përball ndërmarrjeve ose agjencive ekonomike kundrejt të cilave bëni ankesën. (ish klient, konkurrent, etj)</p>	<p>Emri ndërmarrjes _____</p> <p>_____</p> <p>Aktiviteti _____</p> <p>_____</p> <p>_____</p> <p>Pozicioni _____</p> <p>_____</p> <p>_____</p>

II . Të dhëna për shkeljen e pretenduar dhe prova

<p>(3) Tregoni në detaje faktet nga të cilat ju rezulton, në opinionin tuaj, që ekzistojnë shkelje të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.</p> <p>Tregoni në mënyrë specifike, natyrën e produkteve (mallra dhe shërbime) të ndikuara nga shkelja dhe shpjegoni kur është e nevojshme lidhjen tregtare që i përket këtyre produkteve.</p>	<p>Ligji Nr .9121date, 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”</p> <hr/> <hr/> <p>mallra /shërbime _____</p> <hr/> <hr/> <hr/>
<p>Sigurori të gjitha detajet e disponueshme për marrëveshjen ose praktikën e ndërmarrjeve ose bashkimit të ndërmarrjeve të cilat lidhen me këtë ankesë.</p> <p>Tregoni, sa më gjerë që të mundeni, pozicionin e mbajtur në treg nga ndërmarrjet ose bashkimet e ndërmarrjeve të cilat lidhen me këtë ankesë.</p>	<p>Detaje _____</p> <hr/> <hr/> <hr/> <hr/> <p>Pozicioni _____</p> <hr/> <hr/> <hr/>
<p>(4) Paraqisni të gjithë dokumentacionin që dispononi që lidhet ose përkon direkt me faktet e vendosura në ankim (p.sh. tekstet e marrëveshjeve, minutat e negociimit ose takimit, termat e transaksionit, dokumentet e biznesit, korrespondenca, shënime të bisedave telefonike, etj)</p>	<p>fakte direkte: _____</p> <hr/> <hr/> <hr/> <hr/>
<p>Shënoni emrat dhe adresat e personave të aftë të deponojnë faktet e vendosura në ankim, në veçanti të personave të prekur nga shkelja e ligjit.</p> <p>Paraqisni statistika ose të dhëna në administrimin tuaj lidhur me faktet e vendosura në ankesë; lidhur me tendencën e çmimeve, barrierat e hyrjes ne treg, sasitë e shitjeve, etj.</p>	<p>Emrat: _____</p> <hr/> <hr/> <hr/> <p>Grafike _____</p> <p>Tabela _____</p> <hr/> <hr/> <hr/>
<p>(5) Tregoni pikëpamjen tuaj për sa i përket, tregut gjeografik në të cilin është bërë shkelja e pretenduar, dhe shpjegoni nëse nuk është e qartë, në c`farë mase është shkelur konkurrenca.</p>	<p>Tregu gjeografik; _____</p> <hr/> <hr/> <hr/>

III. Zgjidhja e çështjes nga Autoriteti i Konkurrencës dhe interesi legjitim

(6) Shpjegoni rezultatin që prisni në momentin e nisjes së procedurave nga ana e Autoritetit të Konkurrencës	Pritshmëria _____ _____ _____
(7) Tregoni motivet mbi të cilat vendosni interesin legjitim për tu ankuar sipas Ligjit “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”. Tregoni në mënyrë specifike, ndikimin që ka sjellja në kundërshtim me Ligjin	Cila dispozite e ligjit për Mbrojtjen e konkurrencës është cenuar; _____ _____ _____ _____ _____ _____

IV. Procedurat e nisura në instancat e drejtësisë

(8) Specifikoni nëse keni bërë/ ndërhyrë një ankesë kundrejt autoriteteve administrative dhe / ose një çështje është sjellë para autoriteteve gjyqësore për të njëjtat motive, ose për motive të ngjashme. N.q.s po, siguroni informacion sa me të plotë për autoritetin administrativ ose ligjor të kontaktuar, si edhe kërkesën ndaj këtij autoriteti.	_____ _____ _____ _____ autoriteti administrativ; _____ _____ _____
Deklaroni nën përgjegjësin tuaj, që informacioni i dhënë në këtë formular është i plotë dhe i dhënë në mirëbesim.	_____ _____ _____ _____

Data dhe firma.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS

VENDIM

Nr. 177, Datë 25.02.2011

“Për disa rekomandime në lidhje me draft rregulloren për alokimin e kapaciteteve të interkonjeksionit”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Servete Gruda Anëtar
- Koço Broka Anëtar
- Rezana Konomi Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 25.02.2011, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Për disa rekomandime për Entin Rregullator të Energjisë në lidhje me draft rregulloren për alokimin e kapaciteteve të interkonjeksionit”.

Baza ligjore: Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, nenet, 2 pika c), 24 pika d), 69 dhe 70.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të informacion në lidhje me draft rregulloren për alokimin e kapaciteteve të interkonjeksionit, materialeve të paraqitura nga ERE, si dhe të shkresës nr. dt. të Shoqatës Shqiptare të Furnizuesve të Energjisë Elektrike:

VËREN SE:

Autoriteti i Konkurrencës i ka ndjekur me kujdes zhvillimet në tregun e energjisë elektrike në drejtim të mbrojtjes së konkurrencës së lirë dhe efektive në zbatimin të kompetencave që i jepen këtij institucioni sipas ligjit 9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës”. Ndër të tjera ky ligj kërkon bashkëpunimin e Autoritetit me entet rregullatore për zbatimin e tij në sektorët e rregulluar

Veprimtaria e Autoritetit të Konkurrencës në këtë sektor ka synuar rritjen e transparencës dhe të konkurrencës ndërmjet aktorëve të tregut në ato rrethana që lejon natyra e veçantë e këtij sektori.

Kapacitetet e interkonjeksionit janë një ndër elementet më të rëndësishme për zhvillimin e konkurrencës duke mbajtur parasysh se operatori i sistemit të transmetimit është operatori i vetëm që ofron kapacitetet transmetuese në tregun e energjisë elektrike. .

Në këto rrethana është e rëndësishme që për të pasur një konkurrencë efektive në këtë treg, të mos ketë kufizime në ofrimin e shërbimit të kapaciteteve të transmetimit, dhe t'u krijohet mundësia të gjithë operatorëve të rinj dhe ekzistues të licencuar për të vepruar në këtë treg.

Në këtë fazë të zhvillimit, tregu i interkonjeksionit të transmetimit të energjisë, për arsye teknike, është i kufizuar dhe nuk mund të ketë një hapje të plotë për të gjithë subjektet e licencuar. Megjithatë kapacitetet e interkonjeksionit janë në zgjerim dhe në këtë mënyrë edhe mundësitë e veprimit në këtë treg do të rriten.

Në këtë periudhë tranzitore gjatë së cilës rezervohet kapaciteti hyrës ndërmjet tre tipeve të operatorëve të tregut të energjisë (KESH sha, OSSH sha dhe furnizuesve të kualifikuar) bën që të kufizohet apo të diskriminohen operatorët e tjerë të licencuar të tregut të energjisë elektrike, si tregtarët, prodhuesit e vegjël apo operatorëve të tjerë te tregut.

Autoriteti i Konkurrencës vlerëson bashkëpunimin me Entin Rregullator të Energjisë në përgjithësi, si dhe veçanërisht marrjen e mendimit të Autoritetit për miratimin e akteve të ndryshme nën-ligjore nga ky Ent. Në kuadër të shqyrtimit sa më të plotë të faktorëve që ndikojnë në konkurrencë është e domosdoshme që Autoritetit të Konkurrencës t'i vihen në dispozicion informacione të detajuara mbi kërkesën dhe ofertën aktuale në tregun e energjisë për shërbimin e kapaciteteve transmetuese.

PËR KËTO ARSYE:

Në bazë të nenit 24, shkronja d, nenit 28 dhe nenit 70, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar), Komisioni i Konkurrencës,

VENDOSI:

1. Ti rekomandojë Entit Rregullator të Energjisë që në hartimin e rregullores për alokimin e kapaciteteve të interkonjeksionit:
 - a. Të saktësohet se sa do të jetë kohëzgjatja e “periudhës tranzitore”, apo kushti përkatës me plotësimin e të cilit do të përfundojë kjo periudhë tranzitore.
 - b. Të saktësohet se çfarë do të ofrohet për tregun (operatorët e tregut) pas periudhës tranzitore, me qëllim që operatorët e licencuar apo që kanë investuar për të operuar në tregun e energjisë elektrike të konkurrojnë duke ofruar shërbime të cilat të ndikojnë drejtpërdrejtë në përfitime për klientin tarifor.
 - c. Të mos ketë kufizime në lidhje me numrin e ofertave për zhvillimin e ankandeve.
 - d. Në alokimin e kapaciteteve të rezervuara t'i jepet prioritet kërkesave për plotësimin e nevojave për transmetim e interkonjeksion për klientët tariforë.
 - e. Në alokimin e kapaciteteve të rezervuara të parashikohet në mënyrë të veçantë mënyra e përballimit të situatave emergjente hidroenergetike.

2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e vendimit Entit Rregullator të Energjisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURENCËS

Servete Gruda
()
Anëtar

Koço Broka
()
Anëtar

Rezana Konomi
()
Anëtar

Lindita Milo (Lati)

K R Y E T A R



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 178, Datë 25.02.2011

“Për disa rekomandime në lidhje me draft rregulloren e procedurave të blerjes së energjisë elektrike nga KESH sh.a nga tregtarët vendas dhe të huaj”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Servete Gruda Anëtar
- Koço Broka Anëtar
- Rezana Konomi Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 25.02.2011, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Për disa rekomandime për Entin Rregullator të Energjisë në lidhje me draft rregulloren e procedurave të blerjes së energjisë elektrike nga KESH sh.a nga tregtarët vendas dhe të huaj”.

Baza ligjore: Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, nenet, 2 pika c), 24 pika d), 69 dhe 70.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të informacionit në lidhje me draft rregulloren e procedurave të blerjes së energjisë elektrike nga KESH sh.a nga tregtarët vendas dhe të huaj:

VËREN SE:

Autoriteti i Konkurrencës ka monitoruar gjatë viteve të fundit funksionimit e tregut të prodhimit dhe tregtimit të energjisë elektrike për të vlerësuar kufizimet e mundshme të konkurrencës së lirë dhe efektive në treg duke ndjekur me kujdes zhvillimet në tregun e energjisë.

Që me vendimin nr. 90 të datës 7.10.2008, Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës ka vendosur t'i rekomandojë Entit Rregullator të Energjisë ndërmarrjen e hapave të nevojshëm për konsolidimin dhe hapjen reale të tregut të energjisë elektrike në përputhje me direktivat europiane (veçanërisht 2003/54/EC) dhe kërkesat e Sekretariatit për Energjinë për Evropën Juglindore, për të siguruar një treg të energjisë funksional dhe që ofron produktin e mjaftueshëm dhe shërbimin më të mirë në çmimet më të lira të mundshme për konsumatorët.

Gjithashtu me vendimin nr. 159 të datës 19.11.2010 Komisioni i Konkurrencës i ka rekomanduar Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Entit Rregullator të Energjisë Elektrike “ndarjen funksionale dhe financiare reale të “Furnizuesit Publik me Shumicë” nga KESH-Gen, e cila do të krijojë kushtet për konkurrencë në këtë nivel tregu për të gjithë të interesuarit (PPE, PVE, Furnizuesit e Kualifikuar) për të kryer transaksione konkurruese dhe është në zbatim të modelit të tregut”.

Si konkluzion, nga shqyrtimi i draft-rregullores së procedurave të blerjes së energjisë elektrike nga KESH sh.a të energjisë elektrike nga tregtarët vendas dhe të huaj, dhe në vijim të vendimeve rekomanduese të Komisionit të Konkurrencës duhet të nxitet konkurrenca në këtë segment tregu siç përcakton edhe “Modeli shqipëtar i tregut” të energjisë elektrike.

PËR KËTO ARSYE:

Në bazë të nenit 24, shkronja d, nenit 28 dhe nenit 70, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar), Komisioni i Konkurrencës,

VENDOSI:

1. Ti rekomandojë Entit Rregullator të Energjisë që në rregulloren e procedurave të blerjes së energjisë elektrike nga KESH sh.a nga tregtarët vendas dhe të huaj:
 - a. Të ndryshohet përcaktimi i rregullores në: “Rregullorja e procedurave të blerjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi Publik me Shumicë nga tregtarët vendas dhe të huaj”
 - b. Në nenin 2, “Objekti dhe Qëllimi” të ndryshohet autoriteti blerës i energjisë elektrike nga tregtarët vendas apo të huaj për diferencat e sasive të energjisë elektrike nga KESH sh.a. me Furnizuesin Publik me Shumicë.
 - c. Zëvendësimi i KESH sh.a me Furnizuesin Publik me Shumicë të bëhet në të gjitha nenet e kësaj draft-rregulloreje.
2. Enti Rregullator i Energjisë të informojë Komisionin e Autoritetit të Konkurrencës mbi zbatimin e vendimit nr. 159 të datës 19.11.2010 të Komisionit të Konkurrencës për ndarjen funksionale dhe financiare reale të “Furnizuesit Publik me Shumicë” nga KESH-Gen.
3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e vendimit për Entin Rregullator të Energjisë .

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete Gruda
()
Anëtar

Koço Broka
()
Anëtar

Rezana Konomi
()
Anëtar

Lindita Milo (Lati)

K R Y E T A R



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS

VENDIM

Nr. 179, Datë 02.03.2011

Për miratimin e rregullores
“Për kategoritë e marrëveshjeve të transfertave teknologjike”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Servete Gruda Anëtar
- Koço Broka Anëtar
- Rezana Konomi Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 02.03.2011, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Miratimin e Rregullores “Për kategoritë e marrëveshjeve të transfertave teknologjike” në zbatim të Ligjit nr 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar.

Baza ligjore: Ligji nr 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar), neni 6 dhe 24, shkronja d), dh).

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të projekt rregullores ”Për kategoritë e marrëveshjeve të transfertave teknologjike”:

VENDOSI:

1. Të miratojë Rregulloren “Për kategoritë e marrëveshjeve të transfertave teknologjike”, sipas materialit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURENCËS

Servete Gruda
()
Anëtar

Koço Broka
()
Anëtar

Rezana Konomi
()
Anëtar

Lindita Milo (Lati)

KRYETAR



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 180, Datë 29.03.2011

**“Për një ndryshim në Vendimin Nr. 155, datë 28.10.2010
 “Për miratimin e hapjes së procedurës së hetimit paraprak në tregun e
 importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të Orizit” (i ndryshuar)**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Servete Gruda Anëtar
- Koço Broka Anëtar
- Rezana Konomi Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 24.03.2011, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Zgjatja e periudhës së hetimit paraprak në tregun e importit, dhe tregtimit me shumicë të orizit dhe afatit për përfundimin e hetimit.

Baza ligjore: - Neni 24, shkronja d); neni 42, pika 1, të Ligjit nr. 9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (të ndryshuar);
 - Ligji Nr. 8485, datë 11. 11. 1999 “Kodi i Procedurave Administrative”;

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të Raportit “Mbi Hetimin Paraprak në Tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të orizit” të paraqitur nga Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës, dhe Relacionit përkatës të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës:

VËREN SE:

1. Me anë të Vendimit Nr. 155, datë 28.10.2010 “Për miratimin e hapjes së procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të orizit”, ndryshuar me Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 172, datë 17.01.2011 “Për një ndryshim në Vendimin Nr. 155, datë 28.10.2010 “Për miratimin e hapjes së procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë

të orizit”, Komisioni i Konkurrencës, si dhe në zbatim të nenit 42, pika 1, të Ligjit nr. 9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (të ndryshuar), ka miratuar hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të orizit, për të parë nëse kushtet e tregut sigurojnë konkurrencë të lirë dhe efektive.

2. Në zbatim të vendimit të mësipërm, Sekretari i Përgjithshëm i Autoritetit të Konkurrencës, ka ndjekur procedurat hetimore të parashikuara në Ligjin 9121 dhe aktet nënligjore përkatëse, si dhe ka përgatitur raportin e hetimit paraprak në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të orizit brenda afatit kohor të percaktuar në vendimin e Komisionit të Konkurrencës.
3. Gjatë shqyrtimit të Raportit të hetimit paraprak u vu re se që nga muaji Shtator 2010 e në vazhdim tendenca e çmimit të orizit ka qenë në rritje, periudhë kjo e cila nuk është e përfshirë plotësisht në hetim. Komisioni e sheh të nevojshme vazhdimin e hetimit, duke marrë në shqyrtim edhe këtë periudhë. Kjo do të çonte në një vlerësim më të plotë të konkurrencës në tregun nën hetim.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të nenit 24, shkronja d), nenit 42, pika 1, të Ligjit nr. 9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si dhe Ligjit Nr. 8485, datë 11. 11. 1999 “Kodi i Procedurave Administrative”,

VENDOSI:

1. Në Vendimin Nr. 155, datë 28.10.2010 “Për miratimin e hapjes së procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të orizit”, pika 2 dhe 3, ndryshohen si vijon:
 “2. Periudha e hetimit do të jetë nga janari 2008 deri më 31 dhjetor 2010.”
 “3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për ndjekjen e procedurave hetimore të parashikuara në Ligj dhe aktet nënligjore, si dhe përgatitjen e raportit të hetimit paraprak, jo më vonë se data 30 majt 2011”
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete Gruda
 ()
 Anëtar

Koço Broka
 ()
 Anëtar

Rezana Konomi
 ()
 Anëtar

Lindita Milo (Lati)

K R Y E T A R



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 181, Datë 29.03.2011

**“Për një ndryshim në Vendimin Nr. 157, datë 28.10.2010
 “Për miratimin e hapjes së procedurës së hetimit paraprak në tregun e
 importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të sheqerit” (I ndryshuar)**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Servete Gruda Anëtar
- Koço Broka Anëtar
- Rezana Konomi Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 24.03.2011, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Zgjatja e periudhës së hetimit paraprak në tregun e importit, dhe tregtimit me shumicë të sheqerit dhe afatit për përfundimin e hetimit.

Baza ligjore: - Neni 24, shkronja d); neni 42, pika 1, të Ligjit nr. 9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (të ndryshuar);
 - Ligji Nr. 8485, datë 11. 11. 1999 “Kodi i Procedurave Administrative”;

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të Raportit “Mbi hetimin paraprak në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të sheqerit” të paraqitur nga Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës, dhe relacionit përkatës të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës:

VËREN SE:

1. Me anë të Vendimit Nr. 157, datë 28.10.2010 “Për miratimin e hapjes së procedurës së hetimit paraprak në e importit dhe tregtimit me shumicë të sheqerit”, ndryshuar me Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 171, datë 17.01.2011 “Për një ndryshim në Vendimin Nr. 157, datë 28.10.2010 “Për miratimin e hapjes së procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të sheqerit”, Komisioni i Konkurrencës, në zbatim të nenit 42, pika 1, të Ligjit nr. 9121

“Për mbrojtjen e konkurrencës” (të ndryshuar), ka miratuar hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të sheqerit, për të parë nëse kushtet e tregut sigurojnë konkurrencë të lirë dhe efektive.

2. Në zbatim të vendimit të mësipërm, Sekretari i Përgjithshëm i Autoritetit të Konkurrencës ka ndjekur procedurat hetimore të parashikuara në Ligjin 9121 dhe aktet nënligjore përkatëse, si dhe ka përgatitur raportin e hetimit paraprak në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të sheqerit brenda afatit kohor të përcaktuar në vendimin e Komisionit të Konkurrencës.
3. Gjatë shqyrtimit të raportit të hetimit paraprak u vu re se që nga muaji Shtator 2010 e në vazhdim tendenca e çmimit të sheqerit ka qenë në rritje, periudhë kjo e cila nuk është e përfshirë plotësisht në hetim. Komisioni e sheh të nevojshme vazhdimin e hetimit, duke marrë në shqyrtim edhe këtë periudhë. Kjo do të çonte në një vlerësim më të plotë të konkurrencës në tregun nën hetim.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të nenit 24, shkronja d), nenit 42, pika 1, të Ligjit nr. 9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si dhe Ligjit Nr. 8485, datë 11. 11. 1999 “Kodi i Procedurave Administrative”,

VENDOSI:

1. Në Vendimin Nr. 157, datë 28.10.2010 “Për miratimin e hapjes së procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të sheqerit”, pika 2 dhe 3, ndryshohen si vijon:
 “2. Periudha e hetimit do të jetë nga janari 2008 deri më 31 dhjetor 2010.”
 “3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për ndjekjen e procedurave hetimore të parashikuara në Ligj dhe aktet nënligjore, si dhe përgatitjen e raportit të hetimit paraprak, jo më vonë se data 30 maj 2011”
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete Gruda

()

Anëtar

Koço Broka

()

Anëtar

Rezana Konomi

()

Anëtar

Lindita Milo (Lati)

K R Y E T A R



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 182, Datë 29.03.2011

“Për një ndryshim në Vendimin Nr. 156, datë 28.10.2010 “Për miratimin e hapjes së procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të vajit vegjetal” (I ndryshuar)

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Servete Gruda Anëtar
- Koço Broka Anëtar
- Rezana Konomi Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 24.03.2011, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Zgjatja e periudhës së hetimit paraprak në tregun e importit, dhe tregtimit me shumicë të vajit vegjetal dhe i afatit për përfundimin e hetimit.

Baza ligjore: - Neni 24, shkronja d); neni 42, pika 1, të Ligjit nr. 9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (të ndryshuar);
 - Ligji Nr. 8485, datë 11. 11. 1999 “Kodi i Procedurave Administrative”;

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të raportit “Mbi hetimin paraprak në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të vajit vegjetal” të paraqitur nga Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës, dhe relacionit përkatës të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës:

VËREN SE:

1. Me anë të Vendimit Nr. 156, datë 28.10.2010 “Për miratimin e hapjes së procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të vajit vegjetal”, ndryshuar me Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 173, datë 17.01.2011 “Për një ndryshim në Vendimin Nr. 156, datë 28.10.2010 “Për miratimin e hapjes së procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të vajit vegjetal”, Komisioni i Konkurrencës, në zbatim të nenit 42, pika 1, të Ligjit nr. 9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (të ndryshuar),

ka miratuar hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të vajit vegjetal, për të parë nëse kushtet e tregut sigurojnë konkurrencë të lirë dhe efektive.

2. Në zbatim të vendimit të mësipërm, Sekretari i Përgjithshëm i Autoritetit të Konkurrencës ka ndjekur procedurat hetimore të parashikuara në Ligjin 9121 dhe aktet nënligjore përkatëse, si dhe ka përgatitur raportin e hetimit paraprak në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të vajit vegjetal brenda afatit kohor të përcaktuar në vendimin e Komisionit të Konkurrencës.
3. Gjatë shqyrtimit të raportit të hetimit paraprak u vu re se që nga muaji shtator 2010 e në vazhdim tendenca e çmimit të vajit vegjetal ka qenë në rritje, periudhë kjo e cila nuk është e përfshirë plotësisht në hetim. Komisioni e sheh të nevojshme vazhdimin e hetimit, duke marrë në shqyrtim edhe këtë periudhë. Kjo do të çonte në një vlerësim më të plotë të konkurrencës në tregun nën hetim.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të nenit 24, shkronja d), nenit 42, pika 1, të Ligjit nr. 9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si dhe Ligjit Nr. 8485, datë 11. 11. 1999 “Kodi i Procedurave Administrative”,

VENDOSI:

1. Në Vendimin Nr. 156, datë 28.10.2010 “Për miratimin e hapjes së procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të vajit vegjetal”, pika 2 dhe 3, ndryshohen si vijon:
“2. Periudha e hetimit do të jetë nga janari 2008 deri më 31 dhjetor 2010.”
“3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për ndjekjen e procedurave hetimore të parashikuara në Ligj dhe aktet nënligjore, si dhe përgatitjen e raportit të hetimit paraprak, jo më vonë se data 30 maj 2011”
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete Gruda

()

Anëtar

Koço Broka

()

Anëtar

Rezana Konomi

()

Anëtar

Lindita Milo (Lati)

K R Y E T A R



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS

VENDIM

Nr. 183, Datë 29.03.2011

“Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet shit-blerjes së 51% të aksioneve të shoqërisë Capital Sh.a. nga shoqëria Sigal Life Uniqa Group Austria Sh.a”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Servete Gruda Anëtar
- Koço Broka Anëtar
- Rezana Konomi Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 29.03.2011, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet shit-blerjes së 51% të aksioneve të shoqërisë Capital Sh.a, nga shoqëria Sigal Life Uniqa Group Austria Sh.a.

Baza ligjore: Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, neni 24, shkronja d, nenet 10-12, dhe 16-17, në veçanti Kreu III “Përqendrimet e Ndërmarrjeve” nenet 53-56, 58, Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit dhe mundësinë për njoftim të thjeshtuar” dhe Formulari “Për njoftimin e përqendrimit”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të raportit mbi njoftimin e përqendrimit Sigal Life Uniqa Group Austria Sh.a - Capital Sh.a, dhe relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm:

VËREN SE:

1. Transaksioni dhe përqendrimi

Transaksioni i shitblerjes së 51% të aksioneve të shoqërisë Capital Sh.a, nga shoqëria Sigal Life Uniqa Group Austria Sh.a, është realizuar nëpërmjet ‘Marrëveshje Blerje Aksionesh’

të datës 15 Dhjetor 2010, e nënshkruar nga palët Sigal Life Uniqa Group Austria Sh.a dhe Avel Sh.p.k në cilësinë e shitësit.

Shoqëria Sigal Life Uniqa Group Austria Sh.a blen me anë të kësaj kontrate 51% të aksioneve me të drejtë vote të shoqërisë Capital Sh.a dhe përfton kështu kontrollin në këtë të fundit.

Transaksioni i realizuar ndërmjet palëve pjesëmarrëse në kuptim të nenit 10/1/b të Ligjit, është ndryshim kontrolli në formën ndryshimit të pronësisë. Gjithashtu përqendrimi njoftuar përmbush edhe kushtet e nenit 12 të Ligjit për sa i përket xhirove (neni 12/1) dhe është njoftuar brenda afatit të parashikuar (neni 12/2).

2. Palët në transaksion:

- Sigal Life Uniqa Group Austria Sh.a, një shoqëri aksionare, e themeluar dhe që ushtron aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar në fushën sigurimit të jetës, në cilësinë e Blerësit të pjesës prej 51% të kapitalit aksionar të shoqërisë Capital Sh.a. Veprimtaria kryesore e shoqërisë është sigurimi dhe risigurimi i Jetës si dhe çdo veprimtari që i shërben kryerjes sigurimit dhe risigurimit të Jetës.
- Capital Sh.a, është një shoqëri aksionere e themeluar dhe që funksionon në përputhje me legjislacionin shqiptar në fushën e pensioneve private, është shoqëria objekt i transaksionit. Shoqëria ushtron veprimtarinë në fushën e mbledhjes dhe investimit të fondeve të pensioneve, për ofrimin e përfitimeve të pensionit për personat që bashkohen në fondin e pensionit.
- Avel Sh.p.k: është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar dhe që funksionon në përputhje me legjislacionin shqiptar, në cilësinë e Shitësit të pjesës prej 51% të kapitalit aksionar të shoqërisë Capital Sh.a me të drejtë vote. Shoqëria ushtron veprimtarinë e saj në sektorin e shitblerjes së automjeteve dhe riparimit të tyre.

3. Përshkrimi i transaksionit

Transaksioni i shitblerjes së aksioneve është realizuar në bazë të “Marrëveshje Blerje Aksionesh” të datës 15 Dhjetor 2010, me qëllim transferimin e pjesës prej 51% të kapitalit aksionar të shoqërisë Capital Sh.a tek Sigal Life Uniqa Group Austria Sh.a, e nënshkruar nga palët.

Transaksioni është kryer për efekt të dispozitave ligjore, më konkretisht neni 20 të Ligjit Nr. 10 197, date 10.12.2009 “Për fondet e pensionit vullnetar” ku përcaktohet se të paktën 51 % të aksioneve në një shoqëri administrimi të fondeve të pensioneve duhet të zotërohen nga shoqëri sigurimi jete ose banka. Ai konsiston në përfitim të kontrollit nëpërmjet blerjes së 51% të aksioneve me të drejtë vote nga Shitësi tek Blerësi. Transaksioni do të përfundojë me përmbushjen e kushteve dhe detyrimet e marra përsipër në lidhje me garancitë e bëra nga palët.

4. Xhiro për vitin 2009

- I. Xhiro totale në tregun ndërkombëtar është xxxxx Lek dhe përbëhet nga xhiro e:
 - Uniqa Versicherung AG për vitin 2009 = xxxx Euro(TP1PT) ose xxxxx Lek.

¹ TPPT Kursi i këmbimit për vitin 2009, 1 Euro = 132.0475 Lek; Burimi: Banka e Shqipërisë.

II. Xhiro totale në tregun e kombëtar është xxxx Lek dhe përbëhet nga xhiro e:

Capital sh.a për vitin 2009 = xxxx lek;

Avel sh.p.k për vitin 2009 = xxxx lek;

Sigal Life Uniqa Group Austria për vitin 2009 = xxxx lek;

Sigal Uniqa Group Austria për vitin 2009 = xxxx lek.

Palët në transaksion plotësojnë kriteret e xhiros të përcaktuara në nenin 12, pika 1 të ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe si rrjedhojë, ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

5. ANALIZA E KONKURRENCËS

5.1. Tregu Përkatës

Referuar nenit 3, pika 7, të Ligjit, përcaktimi “treg përkatës”, përfshin dy komponentë:

- a) tregu i produktit, dhe
- b) tregu gjeografik.

5.1.a Tregu i produktit:

Referuar Udhëzimit të Komisionit të Konkurrencës, Nr. 76, datë 07.04.2008 , “Për përcaktimin e tregut përkatës”, si dhe mbështetur në veprimtarinë e palëve, treg përkatës do të konsiderohet tregu i pensioneve private vullnetare.

Shoqëria Sigal Life Uniqa Group Austria sh.a, ofron produkte sigurimi për të gjitha klasat e jetës.

Capital sh.a, është fond pensioni, i cili përbëhet nga një grup asetesh në pronësi të anëtarëve të fondit. Në asetet e fondit përfshihen kontributet e derdhura dhe fitimi neto i realizuar nga investimi i tyre.

Ekzistojnë dy lloje fondesh pensioni:

- 1) Fondi i pensionit vullnetar,
- 2) Fondi i pensionit profesional

5.1.b Tregu përkatës gjeografik:

Ky treg përfshin hapësirën ku tregtohen produktet apo shërbimet e ofruara të përcaktuara në tregun e produktit.

Shoqëria ‘Capital sh.a’ ushtron aktivitetin e saj në të gjithë territorin e Shqipërisë, ku prurjet më të mëdha të kontributeve janë nga qytetet e mëdha, si Tirana, Durrësi, Vlora, Saranda, Korça etj.

Sa më sipër, në vlerësimin e këtij përqendrimi, tregu përkatës gjeografik është konsideruar tregu kombëtar.

5.2. Struktura e tregut para përqendrimit.

Tregu i pensioneve private është një treg i cili mbikëqyret nga ana e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF). Ai mbetet ende një treg i vogël porë kjo si nga këndvështrimi i numrit të kontribuesve ashtu edhe nga sasia e kontributeve përgjatë viteve, krahasuar kjo dhe me numrin dhe volumin e kontributeve pranë ISSH-së. Ky treg aktualisht konsiderohet si një treg në fazat fillestare të tij dhe mund të thuhet se paraqet një treg me potencial të madh për të ardhmen. Deri sot këtë treg e mbulojnë me aktivitetin e tyre vetëm tre shoqëri, të cilat zotërojnë pjesë të konsiderueshme të tregut dhe në përbërje të të cilëve nuk është futur as 5% të tij.

Duke pasur parasysh numrin e shoqërive të cilat ushtrojnë aktivitetin e tyre në këtë treg, por edhe nga pjesët e tregut të zotëruara nga këto shoqëri, mund të thuhet se tregu i pensioneve private vullnetare është një treg me përqendrim të lartë

Shoqëria “Capital” zë pjesën më të madhe të tregut si për vitin 2009, ashtu edhe për vitin 2010, nëse i referohemi numrit të kontribuesve, me përkatësisht 40.05% dhe 43.89% të numrit total të tyre, ndërsa për sa i përket volumit të kontributeve të akumuluar ajo renditet si shoqëria e dytë në treg, pas shoqërisë Raiffeisen Pensions.

Por pavarësisht zhvillimeve pozitive që ka pësuar tregu gjatë viteve të fundit, numri i kontribuesve për vitin 2010 rezulton vetëm 4992, me një vlerë mesatare kontributësh prej afërsisht 22420 lekë në vit/kontribues, ose 1868 lekë në muaj/kontribues.

5.3. Struktura e tregut pas përqendrimit

Përqendrimi nuk ndryshon strukturën e përgjithshme të tregut të pensioneve private vullnetare në Shqipëri, pasi ai lidhet vetëm me ndryshimin e strukturës së zotërimit të aksioneve brenda shoqërisë “Capital”.

Pas përqendrimit, në tregun e pensioneve private vullnetare do të vazhdojnë të ushtrojnë aktivitetin e tyre tre kompani: Raiffeisen PENSIONS; Sigal Life Uniqa Group Austria dhe Sigma IPP.

6. Vlerësimi i konkurrencës pas përqendrimit

Tregu i pensioneve private është një treg i cili mbikëqyret nga ana e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF). Përqendrimi nuk ndryshon strukturën e përgjithshme të tregut të pensioneve private vullnetare në Shqipëri, pasi ai lidhet vetëm me ndryshimin e strukturës së zotërimit të aksioneve brenda shoqërisë “Capital”.

Ai mbetet ende një treg i vogël edhe pas përqendrimit, porë kjo si nga këndvështrimi i numrit të kontribuesve ashtu edhe nga sasia e kontributeve përgjatë viteve.

Duke pasur parasysh numrin e shoqërive të cilat ushtrojnë aktivitetin e tyre në këtë treg, por edhe nga pjesët e tregut të zotëruara nga këto shoqëri, mund të thuhet se tregu i pensioneve private vullnetare është një treg me përqendrim të lartë.

Pas përqendrimit, në tregun e pensioneve private vullnetare do të vazhdojnë të ushtrojnë aktivitetin e tyre tre kompani: Raiffeisen PENSIONS; Sigal Life Uniqa Group Austria dhe Sigma IPP.

Përqendrimi i realizuar nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

PËR KËTO ARSYE:

Në bazë të nenit 24, shkronja d, dhe nenit 56 pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”:

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet shit-blerjes së 51% të aksioneve të shoqërisë Capital Sh.a, nga shoqëria Sigal Life Uniqa Group Austria Sh.a.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete Gruda

()

Anëtar

Koço Broka

()

Anëtar

Rezana Konomi

()

Anëtar

Lindita Milo (Lati)

K R Y E T A R



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS**

VENDIM

Nr. 184, Datë 07.04.2011

“Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prodhimit dhe tregtimit të bukës në qytetin e Vlorës”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Servete Gruda Anëtar
- Koço Broka Anëtar
- Rezana Konomi Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 07.04.2011, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Ekzistencën ose jo të një marrëveshje të ndaluar midis ndërmarrjeve të prodhimit dhe tregtimit të bukës në qytetin e Vlorës.

Baza ligjore: Neni 28, shkronja b); neni 29, pika 2, shkronja b) dhe c); neni 4, pika 1 dhe neni 42, pika 1, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës në mbledhjen e datës 07.04.2011, pasi mori në shqyrtim relacionin e Sekretarit të Përgjithshëm në lidhje me monitorimin e realizuar nga Inspektorët e Drejtorisë së Mbikëqyrjes së Tregut në lidhje me kufizimet e mundshme të konkurrencës në tregun e prodhimit dhe tregtimit të bukës në qytetin e Vlorës:

VËREN SE:

Në datë 25.03.2011 në median e shkruar dhe atë vizive, janë botuar disa artikuj në lidhje me rritjen e çmimit të bukës qytetin e Vlorës.

Bazuar në artikujt e mësipërm rezultoi që çmimi i bukës është rritur në mënyrë të menjëhershme nga të gjithë prodhuesit dhe tregtuesit e bukës dhe se çmimi i bukës ka arritur çmimin 120 lek.

Nga monitorimi i realizuar u konstatua se rritja e çmimit të bukës në qytetin e Vlorës ka ardhur në mënyrë të menjëhershme, pas një mbledhje të rreth 42 prodhuesve dhe

tregtuesve të bukës ku është rënë dakord se që nga data 23.03.2011 çmimi i bukës 900 gr do të jetë 120 lek dhe çmimi i bukës 450 gr. do të jetë 60 lek.

Sjellja e këtyre ndërmarrjeve për fiksimin e çmimit të shitjes së bukës në qytetin e Vlorës në kuptim të nenit 4, pika 1, germa a) të Ligjit Nr 9121, dt 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” i ndryshuar është marrëveshje e ndaluar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në zbatim të nenit 42, pika 1, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” i ndryshuar:

VENDOSI:

1. Të miratojë hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prodhimit dhe tregtimit të bukës në qytetin e Vlorës për ekzistencën ose jo të një marrëveshje të ndaluar dhe efektet e saj në tregun perkates.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për ndjekjen e procedurave hetimore të parashikuara në Ligj dhe aktet nënligjore, si dhe përgatitjen e raportit të hetimit paraprak jo më vonë se data 22.04.2011

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete Gruda

(_____)

Anëtar

Koço Broka

(_____)

Anëtar

Rezana Konomi

(_____)

Anëtar

Lindita Milo (Lati)

K R Y E T A R



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS

VENDIM

Nr. 185, Datë 07.04.2011

“Për marrjen e masave të përkohshme për ndalimin e marrëveshjes në tregun e prodhimit dhe të tregtimit të bukës në qytetin e Vlorës”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Servete Gruda Anëtar
- Koço Broka Anëtar
- Rezana Konomi Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 07.04.2011, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Mbi marrjen e masave të përkohshme për ndalimin e marrëveshjes në tregun e prodhimit dhe të tregtimit të bukës në qytetin e Vlorës midis ndermarrjeve që operojnë në këto treg.

Baza ligjore: Nenet 4, pika 1, 24, germa d, 44, pika 1 dhe 2, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, këtu dhe me poshte Ligji.

Komisioni i Konkurrencës, në mbledhjen e tij të datës 07.04.2011, pasi shqyrtoi relacionin e Sekretarit të Përgjithshëm dhe Raportin e Grupit të Punës për monitorimin e tregut përkatës të prodhimit dhe tregtimit të bukës në qytetin e Vlorës:

KONSTATOI:

Nga raportet e medias të datës 25 Mars 2011 është informuar se ka një rritje të menjëhershme dhe thujtje nga të gjithë ofruesit të çmimit të bukës në qytetin e Vlorës.

Nga monitorimi i realizuar nga inspektorët e Autoritetit të Konkurrencës në bazë të nenit 28, germa a të Ligjit, u konstatua se rritja e çmimit të bukës në qytetin e Vlorës ka ardhur në mënyrë të menjëhershme pas një mbledhje të 42 prodhuesve dhe tregtuesve të bukës, ku është rënë dakord se që nga data 23.03.2011 çmimi i bukës 900 gr do të jetë 120 lek dhe çmimi i bukës 450 gr do të jetë 60 lek.

Nga procesverbalet e mbajtura nga inspektorët e Autoritetit të Konkurrencës të firmosur nga disa prej prodhuesve dhe tregtuesve të bukës në qytetin e Vlorës, rezulton se në mbledhje është rënë dakord që: “Shoqata e furrave të bukës Vlorë vendosi në datën 21.03.2011 që buka në datën 23.03.2011 të ketë çmimin 900 gr = 120 lek dhe 450 gr = 60 lek’.

Ky dokument është afishuar në të gjitha njësitë tregtare dhe prodhuese të bukës dhe çmimi i fiksuar nga inspektimet e kryera rezulton se është zbatuar nga të gjithë pjesëmarrësit në mbledhjen e datës 21.3.2011, sipas procesverbalit të administruar.

Sjellja e këtyre ndërmarrjeve për fiksimin e çmimit të shitjes së bukës në qytetin e Vlorës ka të ngjarë të jetë një shkelje e nenit 4, pika 1, germa a) të Ligjit Nr 9121, dt 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” i ndryshuar.

Kjo shkelje e mundshme sjell një dëm të rëndë për konkurrencën në treg, dhe për konsumatorët.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në zbatim të neneve 24, shkronja d, 44, pika 1 dhe 2 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”i ndryshuar, për shkak të dëmit që mund t’i shkaktohet konsumatorëve të qytetit të Vlorës nga sjellja anti-konkurrese e 42 prodhuesve dhe tregtuesve të bukës, dhe meqenëse ka të ngjarë të ketë shkelje të nenit 4 të Ligjit,

VENDOSI:

1. Marrjen e masave të përkohshme sipas nenit 44, pika 1, si vijon:
 - Pjesëmarrësit në marrëveshjen e ndaluar për rritjen dhe fiksimin e çmimit të bukës në qytetin e Vlorës, duhet t’i japin fund menjëherë sjelljes së bashkërenduar për fiksimin e çmimit të bukës.
2. Masat e përkohshme duhet të zbatohen me marrjen në dijeni të këtij vendimi.
3. Këto masa të përkohshme do të zbatohen për një periudhë kohe deri në perfundim të hetimit.
4. Moszbatimi i vendimit për masa të përkohshme, i cituar në piken 1 të këtij vendimi, ndëshkohet me gjobë deri në 10 % të xhiros vjetore për shkelje të rëndë të konkurrencës në zbatim të nenit 74, pika 1, germa b të Ligjit
5. Në rast të moszbatimit të masave të përkohshme brenda afateve të përcaktuara në këtë vendim, në bazë të nenit 76, pika b të Ligjit 9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, Komisioni i Konkurrencës mund të vendosë gjoba periodike deri në 5 % të xhiros mesatare ditore të vitin financiar para-ardhës, e cila llogaritet nga data e marrjes së këtij vendimi.
6. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për komunikimin e vendimit të gjithë pjesëmarrësve në marrëveshje dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURENCËS

Servete Gruda
()
Anëtar

Koço Broka
()
Anëtar

Rezana Konomi
()
Anëtar

Lindita Milo (Lati)

K R Y E T A R



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS**

VENDIM

Nr. 186, Datë 12.04.2011

“Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet shit-blerjes së 75% të aksioneve të shoqërisë Sigma I.P.P Sh.a, nga shoqëria Sicred Sh.a”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Servete Gruda Anëtar
- Koço Broka Anëtar
- Rezana Konomi Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 12.04.2011, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet shit-blerjes shitblerjes së 75% të aksioneve të shoqërisë Sigma I.P.P Sh.a, nga shoqëria Sicred Sh.a.

Baza ligjore: Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, neni 24, shkronja d, nenet 10-12, dhe 16-17, në veçanti Kreu III “Përqendrimet e ndërmarrjeve” nenet 53-56, 58, Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit dhe mundësinë për njoftim të thjeshtuar” dhe Formulari “Për njoftimin e përqendrimit”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të raportit mbi njoftimin e përqendrimit Sicred Sh.a – Sigma I.P.P Sh.a, dhe relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm,

VËREN SE:

1. Transaksioni dhe përqendrimi

Transaksioni i shitblerjes së 75% të aksioneve të shoqërisë Sigma I.P.P Sh.a, nga shoqëria Sicred Sh.a, është realizuar nëpërmjet ‘Kontratë për Shitblerje Aksionesh’ të datës 1 Shkurt 2011, e nënshkruar nga palët Sicred Sh.a në cilësinë e blerësit dhe Sigal Vienna Insurance Group Sh.a në cilësinë e aksionerit shitës.

Shoqëria Sicred Sh.a blen me anë të kësaj Kontrate 75% të aksioneve me të drejtë vote të shoqërisë Sigma I.P.P Sh.a dhe përfton kështu kontrollin në këtë të fundit.

Transaksioni i realizuar ndërmjet palëve pjesëmarrëse në kuptim të nenit 10/1/b të Ligjit, është ndryshim kontrolli në formën ndryshimit të pronësisë. Gjithashtu përqendrimi njoftuar përmbush edhe kushtet e nenit 12 të Ligjit përsa i përket xhirove (neni 12/1) dhe është njoftuar brenda afatit të parashikuar (neni 12/2).

2. Palët në transaksion

- **SICRED Sh.a**, një shoqëri aksionare, e themeluar dhe që ushtron aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar në fushën sigurimit të jetës, në cilësinë e **Blerësit** të pjesës prej 75% të kapitalit aksionar të shoqërisë Sigma I.P.P Sh.a. Veprimtaria kryesore e shoqërisë është sigurimi dhe ri-sigurimi i Jetës.
- **SIGMA I.P.P Sh.a**, është një shoqëri aksionere e themeluar dhe që funksionon në përputhje me legjislacionin shqiptar në fushën e pensioneve private, është shoqëria **objekt i transaksionit**. Shoqëria ushtron veprimtarinë në fushën e mbledhjes së kontributeve suplementare dhe dhënien e përfitimeve suplementare personave të përfshirë në institutin privat si dhe në përputhje me parimin e shpërndarjes së riskut (diversifikimin) për ofrimin e përfitimeve të pensionit për personat që bashkohen në fondin e pensionit.
- **SIGMA Vienna Insurance Group Sh.a**, është një shoqëri aksionere, e themeluar dhe që funksionon në përputhje me legjislacionin shqiptar, në cilësinë e **Shitësit** të pjesës prej 75% të kapitalit aksionar të shoqërisë Sigma I.P.P Sh.a me të drejtë vote. Shoqëria ushtron veprimtarinë e saj në sigurimin e të gjitha kategorive të sigurimeve të Jo-Jetës por nuk ushtron veprimtari në sigurimin e jetës.

3. Përshkrimi i transaksionit

Transaksioni i shitblerjes së aksioneve është realizuar në bazë të “Kontratë për Shitblerje Aksionesh” të datës 1 Shkurt 2001, me qëllim tranfserimin e pjesës prej 75% të kapitalit aksionar të shoqërisë Sgma I.P.P Sh.a tek Shoqëria Sicred Sh.a, e nënshkruar nga Palët (Sicred Sh.a në cilësinë e blerësit dhe Sigal Vienna Insurance Group Sh.a në cilësinë e aksionerit shitës).

Transaksioni është kryer në përputhje me dispozitat ligjore, më konkretisht **neni 20 të Ligjit Nr. 10 197, datë 10.12.2009 “Për fondet e pensionit vullnetar” ku përcaktohet se të paktën 51 % të aksioneve në një shoqëri administrimi të fondeve të pensioneve duhet të zotërohen nga shoqëri sigurimi jete ose banka**. Ai konsiston në përftimin e kontrollit nëpërmjet blerjes së 75% të aksioneve me të drejtë vote nga Shitësi tek Blerësi.

Transaksioni i transferimit të pronësisë së aksioneve të shoqërisë Objekt nga Shitësi tek Blerësi është miratuar nga Bordi i Autoritetit të Mbikqyrjes Financiare me Vendim Nr. 39, datë 23.02.2011.

4. Xhiro për vitin 2010

- Xhiro totale në tregun ndërkombëtar është xxxx Lek dhe përbëhet nga xhiro e:
 - Vienna Insurance Group për vitin 2010 = xxx miliard Euro ose xxxx Lek.

II. Xhiro totale në tregun e kombëtar është xxxx Lek¹ dhe përbëhet nga xhiro e:

- Sigma IPP për vitin 2010 = xxxx Lek;
- Sigma Vienna Insurance Group Sh.a për vitin 2010 = xxxx Lek;

dhe

- SiCRED Sh.a për vitin 2010 = xxxx Lek;

Palët në transaksion plotësojnë kriteret e xhiros së përcaktuar në nenin 12, pika 1 të Ligjit “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” dhe si rrjedhojë ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

5. Analiza e konkurrencës

5.1. Tregu përkatës

Referuar nenit 3, pika 7, të Ligjit, përcaktimi “treg përkatës”, përfshin dy komponentë:

- a) tregu i produktit, dhe
- b) tregu gjeografik.

5.1.a Tregu i produktit:

- a) Tregu përkatës i produktit:

Referuar Udhëzimit të Komisionit të Konkurrencës, Nr. 76, datë 07.04.2008 , “Për përcaktimin e tregut përkatës”, si dhe në përputhje me veprimtarinë që ushtrojnë palët, treg përkatës të produktit do të konsiderohet *tregu i pensioneve private vullnetare*.

Shoqëria SiCRED Sh.a, palë pjesëmarrëse në këtë transaksion, ushtron aktivitetin e saj ekonomik në fushën e sigurimit të jetës. Bazuar tek të dhënat e Autoritetit të Mbikqyrjes Financiare (AMF), gjatë vitit 2009 dhe 2010, shoqëria SiCRED është renditur si kompania e dytë në tregun e sigurimeve të jetës dhe është e vetmja shoqëri e cila ka shfaqur një rritje në pjesën që ajo zotëron në treg.

Shoqëria Sigma I.P.P, është një shoqëri e cila është e pranishme në tregun shqiptar të pensioneve private vullnetare që prej vitit 2005 dhe për objekt të veprimtarisë së saj ka krijimin e fondit të pensioneve private, mbledhjen e kontributeve suplementare dhe dhënien e përfitimeve suplementare anëtarëve të përfshirë në institutin privat të pensioneve në përputhje me rregulloren e pensioneve dhe kushteve të kontratave individuale të lidhura me ta, si dhe investimin e pasurisë së institutit privat të pensioneve në vende të sigurta.

5.1.b Tregu përkatës gjeografik:

Referuar shtrirjes aktuale gjeografike të veprimtarisë ekonomike të Sigma I.P.P vërehet se ajo është kryesisht e përqendruar në qarqet Tiranë, Vlorë, Elbasan dhe Fier.

Duke patur parasysh se tregu në të cilin ky përqendrim do të ketë ndikim është tregu i pensioneve private vullnetare, një treg i cili është i krijuar dhe ushtruar në hapësirën territoriale të Republikës së Shqipërisë, në vlerësimin e këtij përqendrimi, tregu përkatës gjeografik është konsideruar Tregu kombëtar.

¹ Xhirot e ndërmarrjeve të mëposhtme janë marrë nga pasqyrat financiare respektive të vitit 2010, ende të paaudituar.

5.2. Struktura e tregut para përqendrimit.

Tregu i pensioneve private është një treg i cili mbikqyret nga ana e Autoritetit të Mbikqyrjes Financiare (AMF). Ai ngelet ende një treg i vogël parë kjo si nga këndvështrimi i numrit të kontribuesve ashtu edhe nga sasia e kontributeve përgjatë viteve, krahasuar kjo dhe me numrin dhe volumin e kontributeve pranë ISSH-së. Ky treg aktualisht konsiderohet si një treg në fazat fillestare të tij. Deri sot këtë treg e mbulojnë me aktivitetin e tyre vetëm tre shoqëri, të cilat zotërojnë pjesë të konsiderueshme të tregut.

Duke patur parasysh numrin e shoqërive të cilat ushtrojnë aktivitetin e tyre në këtë treg, por edhe nga pjesët e tregut të zotëruara nga këto shoqëri, mund të thuhet se tregu i pensioneve private vullnetare është një treg me përqëndrim të lartë

5.3 Struktura e tregut pas përqendrimit

Përqëndrimi nuk ndryshon strukturën e përgjithshme të tregut të pensioneve private vullnetare në Shqipëri, pasi ai lidhet vetëm me ndryshimin e strukturës së zotërimit të aksioneve brenda shoqërisë “Sigma I.P.P”.

Pas përqendrimit, në tregun e pensioneve private vullnetare do të vazhdojnë të ushtrojnë aktivitetin e tyre tre kompani: Raiffeisen PENSIONS; Sigal Life Uniqa Group Austria dhe Sigma IPP.

6. Vlerësimi i konkurrencës pas përqendrimit

Tregu i pensioneve private është një treg i cili mbikqyret nga ana e Autoritetit të Mbikqyrjes Financiare (AMF). Ai mbetet ende një treg i vogël parë kjo si nga këndvështrimi i numrit të kontribuesve ashtu edhe nga sasia e kontributeve përgjatë viteve.

Pavarësisht zhvillimeve pozitive që ka pësuar tregu gjatë viteve të fundit, numri i kontribuesve për vitin 2010 rezulton vetëm 4992 kontribues, me një vlerë mesatare kontributesh prej afërsisht 22420 lekë në vit/kontribues, ose 1868 lekë në muaj/kontribues.

Shoqëria “Sigma I.P.P” zë pjesën më të vogël të tregut si për vitin 2009, ashtu edhe për vitin 2010 nëse i referohemi numrit të kontribuesve apo edhe volumit të kontributeve të akumuluar. Ajo renditet si shoqëria e tretë në treg, pas shoqërisë “Raiffeisen Pensions” dhe shoqërisë “Capital”.

Përqëndrimi i realizuar i cili konsiston në ndryshim të kontrollit në formën ndryshimit të pronësisë nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

PËR KËTO ARSYE:

Në bazë të nenit 24, shkronja d, dhe nenit 56 pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”:

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin përqendrim të realizuar nëpërmjet shit-blerjes së 75% të aksioneve të shoqërisë Sigma I.P.P Sh.a, nga shoqëria Sicred Sh.a .
2. Ngarkohet Sekretari i përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete Gruda

(_____)

Anëtar

Koço Broka

(_____)

Anëtar

Rezana Konomi

(_____)

Anëtar

Lindita Milo (Lati)

K R Y E T A R



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS

VENDIM

Nr. 187, Datë 03.05.2011

Per miratimin e Rregullores
“Per perjashtimin e kategorive te marreveshjeve te kerkimit dhe zhvillimit”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Servete Gruda Anëtar
- Koço Broka Anëtar
- Rezana Konomi Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 03.05.2011, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Miratimin e Rregullores “Për kategoritë e marrëveshjeve të kërimit dhe zhvillimit” në zbatim të Ligjit nr 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar);

Baza ligjore: Ligji nr 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar), neni 6 dhe 24, shkronja d), dh).

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të Projekt Rregullores ”Për përjashtimin e kategorive të marrëveshjeve të kërimit dhe zhvillimit”:

VENDOSI:

1. Të miratojë Rregulloren “Për përjashtimin e kategorive të marrëveshjeve të kërimit dhe zhvillimit”, sipas materialit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURENCËS

Servete Gruda
()
Anëtar

Koço Broka
()
Anëtar

Rezana Konomi
()
Anëtar

Lindita Milo (Lati)

KRYETAR



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 188, Datë 26.05.2011

“Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet shit-blerjes së 100% të aksioneve të shoqërisë Delta Maxo d.o.o Serbia, nga shoqëria Hitomi Finacial Limited tek shoqëria Delhaize “The Lion” Nederland B.V”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Servete Gruda Anëtar
- Koço Broka Anëtar
- Rezana Konomi Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 26.05.2011, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet shit-blerjes së 100% të aksioneve të shoqërisë Delta Maxo d.o.o Serbia, nga shoqëria Hitomi Finacial Limited tek shoqëria Delhaize “The Lion” Nederland B.V.

Baza ligjore: Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, neni 24, shkronja d, neni 2, nenet 10-12, dhe 16, në veçanti Kreu III “Përqendrimet e ndërmarrjeve” nenet 53-64, Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit dhe mundësinë për njoftim të thjeshtuar” dhe Formulari “Për njoftimin e përqendrimit”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të raportit mbi njoftimin e përqendrimit Delhaize “The Lion” Nederland B.V / Hitomi Finacial Limited / Delta Maxo d.o.o Serbia, dhe relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm,

VËREN SE:

1. Transaksioni dhe përqendrimi

Transaksioni i shitblerjes së 100 % të aksioneve të shoqërisë Delta Maxo d.o.o Serbia,

nga shoqëria Hitomi Finacial Limited tek shoqëria Delhaize “The Lion” Nederland B.V, është realizuar nëpërmjet ‘Marrëveshje transaksioni’ të datës 2 Mars 2011, e nënshkruar nga palët Delhaize “The Lion” Nederland B.V në cilësinë e blerësit Hitomi Finacial Limited në cilësinë e shitësit dhe Delhaize Group SA në cilësinë e garantit të blerësit (Palët). Pas plotësimit të informacionit të plotë, më datë 19 prill 2011, Autoriteti i Konkurrencës i ka konfirmuar palës njoftuese plotësinë e njoftimit më datë 4 Maj 2011.

Shoqëria Delhaize “The Lion” Nederland B.V blen me anë të kësaj kontrate 100% të aksioneve me të drejtë vote të shoqërisë Delta Maxo d.o.o Serbia dhe përfton kështu kontrollin në këtë të fundit.

Transaksioni i realizuar ndërmjet palëve pjesëmarrëse në kuptim të nenit 10/1/b të Ligjit, është ndryshim kontrolli në formën ndryshimit të pronësisë. Gjithashtu përqendrimi i njoftuar përmbush edhe kushtet e nenit 12 të Ligjit përsa i përket xhirove (neni 12/1) dhe është njoftuar brenda afatit të parashikuar (neni 12/2).

2. Palët në transaksion

- **Delhaize “The Lion” Nederland B.V** në cilësinë e **blerësit**, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar dhe që funksionon sipas legjislacionit holandez. Shoqëria ushtron veprimtari në fushën e tregtimit, zhvillimin dhe investimit në prona të paluajtshme në kuptimin më të gjerë, investimit në astetet e shoqërive në fushën e shpërndarjes së ushqimeve, si dhe pjesëmarrjen në menaxhimin dhe financimin në ndërmarrje të tjera dhe garantimin e sigurisë mbi debitet e të tretëve.
- **Hemslade Trading Limited Cyprus** në cilësinë e **shitësit**, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e krijuar dhe që funksionon sipas legjislacionit Qipriot. Veprimtaria e shoqërisë është tregtimi i ilaçeve, pronësive dhe produkteve të tjera. Hemslade zotëron 100% të kapitalit të *shoqërisë objekt i* këtij përqendrimi Delta Maxi d.o.o Serbia.
- **Delta Maxi Serbia d.o.o** në cilësinë e **shoqërisë objekt i përqendrimit**, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e krijuar dhe që funksionon sipas legjislacionit serb. Veprimtaria e shoqërisë konsiston në shitjen me pakicë në dyqane të paspecializuara të cilat ofrojnë produkte të kategorive të ndryshme kryesisht ushqimi, pije dhe duhan.

Delta Maxi në Shqipëri zotëron në masën 100% shoqërinë Euromax Sh.p.k.

- **Euromax Sh.p.k.**, është një shoqëri e themeluar dhe funksionon sipas legjislacionit shqiptar. Objekti i kësaj shoqërie ishte importi eksporti; tregtimi i artikujve të ndryshëm, servis paisjesh elektronike dhe elektroshtëpiake, automjetesh etj; transport të mallrave dhe udhëtarëve urbanë, ndërurbanë dhe ndërkombëtarë.

3. Përshkrimi i transaksionit

Transaksioni i shitblerjes së aksioneve është realizuar në bazë të “Marrëveshje transaksioni” të datës 2 Mars 2011, me qëllim transferimin e pjesës prej 100% të kapitalit aksionar të shoqërisë Delta Maxi d.o.o Serbia nga shoqëria kontrolluese Hitomi Finacial Limited tek shoqëria Delhaize “The Lion” Nederland B.V, e nënshkruar nga palët.

Transaksioni është njoftuar në Autoritetin e Konkurrencës si pasojë e xhiros së ndërmarrjeve pjesëmarrëse në nivel botëror dhe shitjeve të shoqërisë Delta Maxi d.o.o Serbia në Shqipëri nëpërmjet filiat të saj shoqëria Euromax Sh.p.k. Përqendrimi konsiston në përftimin e kontrollit nëpërmjet blerjes së 100% të aksioneve me të drejtë vote nga Shitësi tek Blerësi. Përftimi i kontrollit të vetëm nga shoqëria Delhaize në shoqërinë Delta Maxi do të realizohet si një transaksion progresiv në disa hapa, ku secila prej tyre është e kushtëzuar nga njëra tjetra. Të gjitha transaksionet e ndërmjetme (që nga krijimi i 3 shoqërive të përkohshme, kontrolli i përbashkët i tyre dhe deri në përftimin e kontrollit të vetëm nga shoqëria Delhaize) përbëjnë një përqendrim të vetëm, nëpërmjet të cilit Delhaize përfton kontrollin e vetëm mbi Delta Maxi dhe në mënyrë indirekte mbi shoqërinë Euromax Sh.p.k, në kuptim të nenit 10, pika 2 e ligjit.

4. Xhiro për vitin 2010

Xhiro totale e palëve pjesëmarrëse në tregun ndërkombëtar për vitin 2010 është xxxxxxxxxxxx Lek ose përafërsisht xxxx miliard Lek, e ndarë në:

- a) Xhiro e Delhaize Grup për vitin 2010 = xxx milion EUR = xxxxx Lek ;
- b) Xhiro e Delhaize “The Lion” Nederland B.V = xxxx milion EUR = xxxx Lek;
- c) Xhiro e Delta Maxi Doo = xxxx Dinar = xxxx milion EUR = xxxxx Lek.

Xhiro totale në tregun e brendshëm për vitin 2010 është:

- d) Xhiro e Euromax Sh.p.k = xxxx Lek.

Palët në transaksion plotësojnë kriteret e xhiros së përcaktuar në nenin 12, pika 1 të Ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe si rrjedhojë ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

5. Analiza e konkurrencës

5.1. Tregu përkatës

Referuar nenit 3, pika 7, të Ligjit, përcaktimi “treg përkatës”, përfshin dy komponentë:

- a) tregu i produktit, dhe
- b) tregu gjeografik.

5.1.a Tregu i produktit:

Referuar Udhëzimit të Komisionit të Konkurrencës, Nr.76, datë 07.04.2008, “Për përcaktimin e tregut përkatës”, si dhe mbështetur në veprimtarinë e palëve:

Duke patur parasysh se Delhaize Grup dhe Delhaize “The Lion” Nederland B.V nuk kanë prezencë ligjore dhe nuk kryejnë ndonjë veprimtari në Shqipëri, përcaktimi i tregut përkatës të produktit, do të bazohet në veprimtarinë ekonomike të Euromax Sh.p.k në Shqipëri, mbi të cilin Delta Maxi ka kontroll të drejtpërdrejtë.

Sa më sipër, tregu përkatës i produktit do të përkufizohet si tregtia me pakicë e produkteve ushqimore dhe mallrave të konsumit që kanë qëllim furnizimin ditor dhe të rastit të

familjeve nëpërmjet formateve të dyqaneve të paspecializuara si dyqanet në afërsi të lagjes, supermarketeve dhe hipermarketeve.

5.1.b Tregu përkatës gjeografik:

Ky treg përfshin hapësirën ku tregtohen produktet apo shërbimet e ofruara të përcaktuara në tregun e produktit.

Grupi Delhaize e kryen aktivitetin e tij në Belgjikë, Rumani, Greqi, Luksemburg, Amerikën e Veriut dhe Indonezi. Ky grup nuk ka asnjë veprimtari në Shqipëri.

Nga ana tjetër aktiviteti i Delta Maxi në Shqipëri kryhet në territorin e Shqipërisë nëpërmjet filialit të zotëruar 100% prej saj, Euromax Sh.p.k, i cili e ka aktivitetin e tij të lokalizuar në qytetet më kryesore, përkatësisht në Tiranë, Durrës, Elbasan, Fier dhe Vlorë.

Për vlerësimin e këtij përqendrimi, tregu përkatës gjeografik është konsideruar si tregu kombëtar.

5.2. Struktura e tregut para dhe pas përqendrimit.

Tregu i shitjes me pakicë në Shqipëri konsiderohet si një treg i vogël por me tendencë pozitive zhvillimi. Referuar indeksit GRDI, Shqipëria renditet në vendin e 12-të, si një treg ende i pangopur përse i përket rrjetit të supermarketeve/hipermarketeve apo formave të tjera të shitjes me pakicë në format modern.

Pjesa e tregut që Euromax Sh.p.k do të zotërojë pas transaksionit do të ngelet po e njëjtë me pjesën e tregut të zotëruar nga kjo shoqëri para tij, pasi blerësi dhe Delhaize Group nuk kanë prezencë ligjore apo shitje në Shqipëri. Si pasojë, transaksioni nuk sjell ndryshime në strukturën e tregut pas përqendrimit dhe nuk krijon dhe as forcon një pozicion dominues të Euromax në tregun përkatës, duke mos e kufizuar kështu konkurrencën në tregun përkatës të produktit.

6. Vlerësimi i konkurrencës pas përqendrimit

Tregu i shitjes me pakicë i ushqimeve dhe mallrave të konsumit është i formuar kryesisht nga dyqane të mesëm e të vegjël dhe të pavarur nga njëri tjetri, duke patur kështu karakteristikat e një tregu kryesisht tradicional. Tregtia me pakicë në format modern përfaqëson vetëm 9% të tregut me pakicë dhe është kryesisht prezente nëpërmjet formatit të supermarketeve dhe dyqaneve të vogla në afërsi.

Përqendrimi nuk sjell asnjë ndryshim në pjesën e tregut që zë aktualisht shoqëria Euromax SHPK pasi përfituesi i kontrollit nuk është prezent në tregun shqiptar para përqendrimit dhe për pasojë nuk ndryshon struktura e tregut pas përqendrimit. Gjithashtu, pas përqendrimit nuk do të kemi krijim apo forcim të pozitës dominuese të shoqërisë Euromax në tregun përkatës.

Përqendrimi i realizuar nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

PËR KËTO ARSYE:

Në bazë të nenit 24, shkronja d, dhe nenit 56 pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”:

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet shit-blerjes së 100% të aksioneve të shoqërisë Delta Maxo d.o.o Serbia, nga shoqëria Hitomi Finacial Limited tek shoqëria Delhaize “The Lion” Nederland B.V.
2. Ngarkohet Sekretari i përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete Gruda

()

Anëtar

Koço Broka

()

Anëtar

Rezana Konomi

()

Anëtar

Lindita Milo (Lati)

K R Y E T A R



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS

VENDIM

Nr. 189, Datë 26.05.2011

PËR
DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN “PER FUNKSIONIMIN E
AUTORITETIT TË KONKURENCËS”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Servete Gruda Anëtar
- Koço Broka Anëtar
- Rezana Konomi Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 26.05.2011, në mbështetje të nenit 24, germa “c”, me propozim të Sekretariatit,

VENDOSI:

Neni 1

Në Rregulloren “Për funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës”, neni 9 ndryshohet si vijon:

“Neni 9

Thirrja e mbledhjeve

1. *Kryetari është i detyruar të thërrasë një mbledhje kur kjo kërkohet me shkrim nga të paktën 1 (një) anëtar i Komisionit, duke përcaktuar çështjet për të cilat thirret kjo mbledhje. Si objekt i mbledhjes konsiderohen çështje për të cilat Komisioni është i mandatuar sipas Ligjit. Në mënyrë të veçantë, hapja e Hetimit mund t’i kërkohet Komisionit nga Kryetari, ose çdo anëtar.*
2. *Këto kërkesa paraqiten me shkrim në Kabinet dhe shqyrtohen nga Komisioni në një mbledhje me rend dite: shqyrtim kërkesë.*
3. *Lajmërimet për thirjen e mbledhjeve për shqyrtimin e kërkesës bëhen brenda 7 (shtatë) ditëve pas paraqitjes së kërkesës nga anëtarët e Komisionit dhe të paktën*

3 (tre) ditë para datës së thirrjes së mbledhjes. Ato duhet të tregojnë në mënyrë të qartë dhe të detajuar çështjet për të cilat do të diskutohet.”

Neni 2

1. Në nenin 22 të rregullores, pas pikës 1 shtohet një pikë për kompetencat e drejtuesit të Grupit të Punës me numërtimin 1/1:

1/1 Drejtuesi i një Grupi Pune ka këto kompetenca administrative:

- a. Administron dhe drejton procesin monitorues, ose hetimor te Grupit të Punës ne përgjithësi dhe anëtarëve te Grupit te Punës në vecanti;
Ai evidenton në dosjen hetimore, në proces-verbalet e inspektimit, ne proces verbalet e mbledhjeve te grupit te punes dhe në raportet hetimore gjithë materialin e nevojshëm, si dhe mendimet e dhëna nga anëtarët e Grupit të Punës;*
- b. Këshillohet me drejtorët e anëtarëve të tij të grupit të punës për rradhën e planifikimin e cdo veprimi hetimor, ose inspektues të paktën deri një ditë para realizimit të parashikuar;*
- c. Përgjigjet për përgatitjen e shkresave dhe propozon tek Sekretari i Përgjithshëm përmbajtjen e tyre, që, për nevoja të hetimit, vënies në dijeni, ose inspektimit, do t'i adresohen ndërmarrjeve në hetim, ose institucioneve të treta që mund të ndihmojnë me prova hetimin dhe inspektorët.*

2. Po në këtë nen në pikën 3 të tij, bëhen këto shtesa:

- a- Pas fjalisë së parë shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

Në punën e tij të përditshme Grupi i Punës duhet:

- *të mbajë parasysh dhe tu qëndrojë standarteve me të mira të procedurës hetimore paraprirëse,*
 - *të realizojë rrahjen e mendimeve dhe shkallën e lartë të ballafaqimit të tyre me ekspertizën;*
- b- në fjalinë e fundit shtohet shprehja: ”ose hartohen si kapitull më vete dhe i bashklidhen mendimit të shumicës në konkluzionet e raportit përfundimtar, si dhe konsiderohen pjesë integrale e këtij të fundit.”

3. Në fund të pikës 4 të shtohet një paragraf me këtë përmbajtje: “Sekretari i Përgjithshëm në të gjithë hapat procedurale të Grupit hetimor të Punës mbikqyr, vëzhgon dhe kontrollon veprimtarinë e tij, por njëkohësisht duke siguruar dhe pa cënuar pavarësinë e grupit të punës gjatë këtyre procedurave”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete Gruda
()
Anëtar

Koço Broka
()
Anëtar

Rezana Konomi
()
Anëtar

Lindita Milo (Lati)

K R Y E T A R



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS

VENDIM

Nr. 190, Datë 26.05.2011

Per miratimin e rregullores
“Per perjashtimin e kategorive te marreveshjeve te specializimit”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Servete Gruda Anëtar
- Koço Broka Anëtar
- Rezana Konomi Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 26.05.2011, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Miratimin e Rregullores “Për përjashtimin e kategorive të marrëveshjeve të specializimit” në zbatim të Ligjit nr 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar);

Baza ligjore: Ligji nr 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar), neni 6 dhe 24, shkronja d), dh).

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të Projekt Rregullores ”Për përjashtimin e kategorive të marrëveshjeve të specializimit”:

VENDOSI:

1. Të miratojë Rregulloren “Për përjashtimin e kategorive të marrëveshjeve të specializimit”, sipas materialit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURENCËS

Servete Gruda
 (_____)

 Anëtar

Koço Broka
 (_____)

 Anëtar

Rezana Konomi
 (_____)

 Anëtar

Lindita Milo (Lati)

KRYETAR

Rregullore

“Për Kategoritë e Marrëveshjeve të Specializimit¹”

Neni 1

Objekti

1. Objekt i kësaj rregulloreje janë të gjitha marrëveshjet e tjera që janë lidhur nga ndërmarrjet dhe që kanë të bëjnë me kushtet në të cilat ato specializohen për prodhimin e të mirave dhe/ose ofrimin e shërbimeve që duhet të jenë përfshirë në fushën e zbatimit të kësaj rregulloreje. Përfshirja do të zbatohet edhe për dispozitat e atyre marrëveshjeve të specializimit të cilat nuk kanë specializimin objektiv primar të tyre, por që janë të lidhura direkt me zbatimin, si dhe me probleme blerjeje, ose/ dhe marketingu.
2. Ne këtë rregullore përfshihen:
 - α) Marrëveshjet, ku njëra palë i jep plotësisht, apo pjesërisht të drejtën e prodhimit, ose ofrimin të produkteve, ose shërbimeve të caktuara në favor të një pale tjetër (i ashtuquajtur *specializim i njëanshëm*) ;
 - β) Marrëveshjet, në të cilat çdo palë plotësisht apo pjesërisht i jep të drejtën e prodhimit, ose ofrimin të produkteve ose shërbimeve të caktuara në favor të një pale tjetër (i ashtuquajtur *specializim i ndërsjelltë*); dhe
 - χ) Marrëveshjet, në të cilat palët ndërmarrin nismën të prodhojnë, ose ofrojnë bashkërisht produkte, ose shërbime të caktuara (*prodhim i përbashkët*).

Neni 2

Natyra e Marrëveshjeve

1. Marrëveshjet e Specializimit në prodhim, nëse palët kanë aftësi plotësuese, asete, ose veprimtari, kontribuojnë në përmirësimin e prodhimit, ose shpërndarjen e produkteve. Këto palë në marrëveshje mund të përqendrohen në prodhimin e produkteve të caktuara duke vepruar kështu në mënyrë më eficiente për të ofruar produkte me kosto sa më të ulët. Duke synuar mbrojtjen e konkurrencës së lirë dhe efektive, marrëveshja, do të vlerësohet ndër të tjera, edhe duke pasur parasysh që konsumatorët të marrin një ndarje sa më të drejtë të përfitimeve ekonomike që rrjedhin prej saj.
2. Natyra e marrëveshjeve, të njëanshme ose/dhe të ndërsjellta, kërkon që ato të jenë aktive në të njëjtin treg produkti, por nuk është e nevojshme të jenë aktive në të njëjtin treg gjeografik. Marrëveshjet e prodhimit të përbashkët mund të lidhen midis palëve, të cilat janë aktive në të njëjtin treg produkti, por gjithashtu edhe për ato palë, të cilat dëshirojnë të hyjnë në një treg produkti nëpërmjet një marrëveshjeje.

¹ (32010R1218) Rregullorja e Komisionit nr.1218/2010 e datës 14 Dhjetor 2010 “Mbi zbatimin e nenit 101/3 të Traktatit të Funkcionit të Bashkimit Europian për disa kategori të marrëveshjeve të specializimit”

Neni 3

Përkufizime

Në kuptim të kësaj rregulloreje, shprehjet e mëposhtme kanë këto kuptime:

1. “*Marrëveshje specializimi*” nënkupton një marrëveshje të njëanshme specializimi, një marrëveshje reciproke specializimi ose një marrëveshje prodhimi të përbashkët;
2. “*Marrëveshje e njëanshme specializimi*” nënkupton një marrëveshje midis dy palëve, të cilat janë aktive në të njëjtin treg të produktit, nga të cilat njëra palë bie dakord që të ndërpresë plotësisht, ose pjesërisht prodhimin e produkteve të caktuara, ose të shmanget nga prodhimi i këtyre produkteve dhe t’i blejë ato nga palë të tjera, të cilat bien dakord ti prodhojnë dhe ofrojnë këto produkte;
3. “*Marrëveshje reciproke specializimi*” nënkupton një marrëveshje ndërmjet dy ose më shumë palëve të cilat janë aktive në të njëjtin treg produkti, sipas të cilit dy ose më shumë palë pranojnë, mbi baza reciproke, të bien dakord që të ndërpresin, plotësisht ose pjesërisht, apo të shmangen nga prodhimi i disa mallrave, (të cilët nuk janë të njëjtat) dhe ti blejnë këto produkte nga palë të tjera, të cilat bien dakord që ti prodhojnë dhe ti shesin ato atyre;
4. “*Marrëveshje e prodhimit të përbashkët*” nënkupton një marrëveshje, në të cilën dy ose më shumë palë, bien dakord që të prodhojnë disa mallra ngushtësisht të bashkëlidhura;
5. “*Prodhim*” nënkupton prodhimin e të mirave materiale (mallrave) ose përgatitjen e shërbimeve dhe i cili përfshin edhe prodhimin realizuar nëpërmjet nënkontraktorëve;
6. “*Përgatitja e shërbimeve*” nënkupton veprimtari të kryera në rrjedhën e sipërme të ofrimit të shërbimeve ndaj klientëve;
7. “*Produkt i specializuar*” nënkupton një produkt, i cili është prodhuar sipas një marrëveshjeje specializimi;
8. “*Produkt i Rrjedhës së Poshtme*” nënkupton një produkt, për të cilin një produkt i specializuar është përdorur nga një ose më shumë palë si një lëndë e parë e cila është shitur nga këto palë në treg;
9. “*Ndërmarrje konkurruese*” nënkupton një konkurent aktual ose potencial;
10. “*Konkurent aktual*” nënkupton një ndërmarrje e cila është aktive në të njëjtin treg përkatës;
11. “*Konkurent potencial*” nënkupton një ndërmarrje, e cila në mungesë të një Marrëveshjeje Specializimi, mundet, mbi baza reale (jo teorike), në rastin e një rritjeje të vogël, por permanente të çmimeve përkatëse, të jetë në gjendje të ndërmarrë, brenda jo më tepër se 3 vjetëve, investimet e nevojshme shtesë, ose kosto të tjera, këmbyses dhe të nevojshme, për të hyrë në tregun përkatës;
12. “*Detyrime eksklusive të furnizimit*” nënkupton një detyrim për të mos i ofruar produktet e specializimit një ndërmarrjeje konkurruese, e cila nuk është palë në marrëveshje;

13. “*Detyrim ekskluziv i blerjes*” nënkupton një detyrim për të blerë produktet e specializuara vetëm nga një palë në marrëveshje;
14. “*E përbashkët*” sipas kontekstit të shpërndarjes, nënkupton kur palët:
 - α) Marrin përsipër shpërndarjen e produkteve si një grup i përbashkët, organizatë ose ndërmarrje, ose
 - β) Caktojnë një palë të tretë si shpërndarës mbi baza ekskluzive ose jo, me kusht që ky i tretë të mos jetë një ndërmarrje konkurente.
15. “*Shpërndarje*” nënkupton pikërisht shpërndarjen, përfshirë edhe shitjen e mallrave dhe ofrimin e shërbimeve;
16. “*Ndërmarrje e lidhur*” nënkupton ato ndërmarrje, të cilat drejtpërdrejt ose jo, kanë fuqinë të:
 - α) ushtrojnë më tepër sesa gjysmën e të drejtave të votës;
 - β) caktojnë më tepër sesa gjysmën e anëtarëve të bordit mbikëqyrës, bordit menazherial, ose bordit ligjor të përfaqësuesve të ndërmarrjes; ose
 - χ) menaxhojnë veprimtarinë e ndërmarrjes.

Neni 4

Përfshirja nga zbatimi i nenit 4 të Ligjit

Në përputhje me nenin 6 të Ligjit nr 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” (i ndryshuar), neni 4 i ligjit nuk do të zbatohet për marrëveshjet e specializimit. Ky përjashtim do të për ato marrëveshje të specializimit, të cilat nuk përmbajnë kufizime të konkurrencës, ku këto të fundit janë objekt i nenit 4 të ligjit.

1. Përfshirja e parashikuar sipas pikës 1 të këtij neni do të zbatohet për marrëveshjet e specializimit, që përmbajnë dispozita, të cilat lidhen me dhënien, ose licencimin e të drejtave të pronësisë intelektuale të një ose më shumë palëve, duke siguruar që këto dispozita nuk përbëjnë objektin parësor të kësaj marrëveshjeje, por janë të nevojshme dhe drejtpërdrejtë të lidhura me zbatimin e tyre.
2. Përfshirja e parashikuar në pikën 1 të këtij neni, do të zbatohet për marrëveshjet e specializimit ku:
 - a) Palët bien dakord për një blerje ekskluzive ose detyrim ekskluziv për të ofruar; ose,
 - b) Palët nuk shesin në mënyrë të pavarur produktet e specializimit por bashkërisht shpërndajnë këto produkte.

Neni 5

Pragu i pjesës së tregut

Përfshirja e parashikuar në nenin 4 të kësaj rregulloreje do të zbatohet me kushtin që pjesa e kombinuar e tregut e palëve të mos tejkalojë 20% të tregut përkatës.

Neni 6

Kufizime të rënda

Përjashtimi i parashikuar në nenin 4 të kësaj rregulloreje, nuk do të zbatohet për ato marrëveshje specializimi të cilat, direkt ose indirekt, veçmas ose së bashku me faktorë të tjerë nën kontrollin e palëve, kanë për objekt:

- α) Fiksimin e çmimeve për shitjen e mallrave tek të tretët, me përjashtim të fiksimit të çmimeve të zbatuara tek klientët e drejtpërdrejtë në kuadër të shpërndarjes së përbashkët;
- β) Kufizimin e prodhimit, ose shitjes me përjashtim të:
 - 1) Dispozitave mbi sasinë e produkteve në kuadër të marrëveshjeve të specializimit të njëanshme, ose reciproke, ose vendosjen e kapaciteteve dhe volumit të prodhimit në kuadër të një marrëveshjeje prodhimi të përbashkët, dhe
 - 2) Vendosjes së shitjeve të planifikuara në kuadër të shpërndarjes së përbashkët.
- χ) Ndarjen e tregjeve ose klientëve/konsumatorëve.

Neni 7

Përlllogaritja dhe Zbatimi i Pragut të Pjesës së Tregut

Për qëllime të përlllogaritjes së Pragut të Pjesës së Tregut sipas neni 5 të kësaj rregulloreje, do duhet të zbatohen rregullat e mëposhtme:

- 1) Pjesa e tregut duhet të përlllogaritet mbi bazën e vlerës së shitjeve në treg. Në mungesë të të dhënave lidhur me vlerën e shitjeve në treg, përcaktimi i pjesës së tregut të palëve, mund të gjendet mbi bazën e vlerësimeve të mbështetura mbi informacione të tjera të besueshme të cilat kanë të bëjnë me tregun dhe pikërisht vëllimin e shitjeve mbi këtë të fundit;
- 2) Pjesa e tregut përlllogaritet mbi bazën e të dhënave që lidhen me vitin paraardhës kalendarik;
- 3) Nëse pjesa e tregut e referuar në nenin 5 të kësaj rregulloreje është fillimisht jo më tepër se 20%, por në vijim rritet mbi këtë prag pa e kaluar 25%, përjashtimi i ofruar në nenin 4 do të vazhdojë të zbatohet për një periudhë prej 2 vitesh të njëpasnjëshme kalendarike, duke pasuar vitin në të cilin pragu prej 20% është tejkaluar për herë të parë;
- 4) Nëse pjesa e tregut e referuar në nenin 5 është fillimisht jo më tepër se 20%, por ndërkohë tejkalon mbi 25%, përjashtimi i parashikuar në nenin 4 do të vazhdojë të zbatohet për një periudhë prej 1 viti kalendarik që ndjek vitin në të cilin niveli prej 25% është tejkaluar për herë të parë.
- 5) Përftimet sipas pikave 3 dhe 4 të këtij neni nuk mund të mblidhen për shkak se tejkalohet kohëzgjatja prej 2 vitesh kalendarike.

Neni 8

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 191, Datë 31.05.2011

“Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e prodhimit dhe tregtimit të bukës në qytetin e Vlorës”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Servete Gruda Anëtar
- Koço Broka Anëtar
- Rezana Konomi Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 31.05.2011, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Shqyrtimi i Raportit të hetimit paraprak “Në tregun e prodhimit dhe tregtimit të bukës në qytetin e Vlorës”;

Baza ligjore: Neni 24, shkronja d, neni 26 dhe neni 43, pika 1 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si dhe neni 12 i Rregullores “Për funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:

- Raportit të hetimit paraprak “Në tregun e prodhimit dhe tregtimit të bukës në qytetin e Vlorës”, të paraqitur nga Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës;
- Relacionin e Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës Nr.108 Prot., datë 13.05.2011,

VËREN SE:

I. PROCEDURA E NDJEKUR

- 1– Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës, duke marrë shkas, nga prononcimet në median vizive dhe të shkruar të datës 25.03.2011 në lidhje me rritjen e çmimit të bukës në Qytetin e Vlorës, në datë 28.03.2011 bazuar në nenin 28, germa a) të Ligjit nr. 9121, dt 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” të ndryshuar, me nismën e tij, realizoi

- një monitorim në qytetin e Vlorës për të parë nëse kjo rritje çmimi kishte ardhur si rezultat i një marrëveshje të ndaluar midis operatorëve që operojnë në këtë treg.
- 2– Nga monitorimi i realizuar u konstatua se rritja e çmimit të bukës në qytetin e Vlorës ka ardhur në mënyrë të menjëhershme, pas një mbledhje të rreth 42 prodhuesve dhe tregtuesve të bukës në qytetin e Vlorës ku është rënë dakord se: që nga data 23.03.2011 çmimi i bukës 900 gr do të jetë 120 lek dhe çmimi i bukës 450 gr do të jetë 60 lek.
 - 3– Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të kërkesës së Sekretarit të Përgjithshëm si dhe duke marrë shkas nga gjetjet e evidentuara në Informacionin e përgatitur nga Grupi i Punës, bazuar në nenin 42, pika 1 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar) me anë të Vendimit Nr. 184, datë 07.04.2011 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prodhimit dhe tregtimit të bukës në qytetin e Vlorës”, vendosi hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prodhimit dhe tregtimit të bukës në qytetin e Vlorës për ekzistencës ose jo të një marrëveshje të ndaluar dhe efektet e saj në tregun përkatës.
 - 4– Komisioni i Konkurrencës bazuar në nenin 44, pika 1 dhe 2 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar) për shkak të dëmit që mund t’i shkaktohet konsumatorëve të qytetit të Vlorës nga sjellja anti-konkurrese e prodhuesve dhe tregtuesve të bukës, me anë të Vendimit Nr 185, datë 07.04.2011 vendosi marrjen e masave të përkohshme për ndalimin e marrëveshjes në tregun e prodhimit dhe tregtimit të bukës në qytetin e Vlorës. Sipas këtij vendimi pjesëmarrësit në marrëveshjen e ndaluar për rritjen dhe fiksimin e çmimit të bukës në qytetin e Vlorës, duhet t’i japin fund menjëherë sjelljes së bashkërenduar për fiksimin e çmimit të bukës.
 - 5– Në vazhdim të procedurës, Sekretari i Përgjithshëm i Autoritetit të Konkurrencës, në bazë të nenit 29 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, nenit 22 të Rregullores “Për funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës”, si dhe të Vendimit Nr. 184, datë 07.04.2011 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prodhimit dhe tregtimit të bukës në qytetin e Vlorës”, me anë të Urdhrit Nr. 30/1, datë 11.04.2011 “Për ngritjen e Grupit të Punës mbi hapjen e procedurave të hetimit paraprak në tregun e prodhimit dhe tregtimit të bukës në qytetin e Vlorës, ngriti grupin e punës përgjegjës për ndjekjen procedurave të këtij hetimi.
 - 6– Grupi i Punës në zbatim të procedurave dhe të Vendimit Nr.185, datë 07.04.2011 “Për marrjen e masave të përkohshme për ndalimin e marrëveshjes në tregun e prodhimit dhe tregtimit të bukës në qytetin e Vlorës” me anë të shkresës Nr 184, datë 12.04.2011 bëri të mundur njoftimin e ndërmarrjeve pjesëmarrëse në marrëveshje në lidhje me vendimin e mësipërm
 - 7– Për mbledhjen e provave dhe të dhënave të nevojshme në lidhje me hetimin, bazuar në nenin 34 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, Grupi i Punës ka kërkuar të dhëna dhe informacion me anë të shkresës Nr. 153, Dt 28.03.2010 “Kërkesë për informacion” drejtuar Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Vlorë.
 - 8– Në përgjigje të kësaj shkrese Drejtoria Rajonale e Tatimeve Vlorë ka dërguar informacionin e kërkuar me anë të shkresës Nr 153/3 datë 28.04.2011
 - 9– Në bazë të nenit 35 dhe 36 të Ligjit Nr. 9121, dt 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe autorizimit të Komisionit të Konkurrencës Nr. 184/1, datë 07.04.2011 “Autorizim”, Grupi i Punës gjatë periudhës së hetimit kreu inspektime në ndërmarrjet pjesëmarrëse në tregun përkatës. Qëllimi i inspektimeve ishte grumbullimi i provave dhe të dhënave të nevojshme në funksion të hetimit paraprak në tregun e prodhimit dhe tregtimit të bukës në qytetin e Vlorës.

- 10– Grupi i punës kreu inspektime pranë furrave të bukës nga datat 11-14 Prill 2011. Gjatë inspektimeve u siguruan kuponë tatimore në lidhje me tregtimin e bukës 900 gr dhe 450 gr, si dhe u mbajtën procesverbale për ato subjekte të cilat nuk kishin zbatuar as edhe një ditë kushtet e marrëveshjes, pavarësisht se figuronin në listën e pjesëmarrësve në mbledhjen e datës 21.03.2011. Duhet sqaruar se Grupi i Punës gjatë inspektimeve është informuar se lista e administruar gjatë inspektimit të datës 28.03.2011 përfshin emrat e furrtarëve që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në qytetin e Vlorës dhe jo emrat e personave pjesëmarrës në marrëveshje (thënia e mësipërme është konfirmuar nga disa prej pjesëmarrësve në marrëveshje).
- 11– Nga inspektimet e kryera rezultoi se një pjesë e furrave të bukës që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në qytetin e Vlorës dhe që figurojnë në listën e pjesëtarëve në marrëveshje nuk janë të regjistruar pranë organeve tatimore dhe për këtë arsye nuk u arrit të siguroheshin kupona tatimore. Për sa më sipër Grupi i Punës njoftoi Drejtorinë Rajonale të Tatimeve Vlorë.

II. TREGU PËRKATËS

- 12– Tregu përkatës përfshin produktet dhe shërbimet që vlerësohen si të zëvendësueshme nga konsumatorët ose klientët e tjerë, për sa u përket karakteristikave, çmimit dhe funksionit të tyre dhe që ofrohen ose kërkohen nga ndërmarrjet në një zonë gjeografike me kushte të njëjta konkurrence, zonë kjo e cila veçohet nga zonat e tjera kufizuese.
- 13– Përkufizimi i tregut përkatës përfshin dy dimensione:
- 1) Tregun e produktit
 - 2) Tregun gjeografik

II.1 Tregu i produktit

- 14– Tregu përkatës i produktit është prodhimi dhe tregtimi i bukës masive 900 gram dhe bukës masive 450 gram në qytetin e Vlorës. Në analizë nuk janë marrë llojet e tjera të bukës pasi në marrëveshjen e gjetur nga inspektorët, kufizimi i konkurrencës, në këtë rast fiksimi i çmimit, ka ndodhur vetëm për dy llojet e bukës të përmendura më sipër.

II.2 Tregu gjeografik

- 15– Tregu përkatës gjeografik është qyteti i Vlorës duke qenë se të gjitha palët e përfshira në marrëveshje operojnë në këtë qytet.

III. NDËRMARRJET NËN HETIM

- 16– Grupi i Punës gjatë inspektimeve në terren fillimisht kreu identifikimin e prodhuesve të bukës në qytetin e Vlorës, duke ju referuar “Listës emërore të furrave të bukës Vlorë”, të administruar nga grupi i punës gjatë inspektimit të kryer në qytetin e Vlorës në datë 28.03.2011. Referuar kësaj liste, rezultojnë 42 prodhues buke të listuar në të, vendndodhja e secilit prej tyre në qytetin e Vlorës, si dhe numrat e telefonit për shumicën prej tyre.

- 17– Gjatë inspektimeve në terren, si dhe nga lista e subjekteve që ushtrojnë veprimtarinë e prodhimit dhe shitjes së bukës në qytetin e Vlorës, të vënë në dispozicion nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Vlorë, rezulton se 6 (gjashte) prej prodhuesve të bukës në qytetin e Vlorës, të cilët e kanë emrin në “Listën” e mësipërme nuk janë të regjistruar pranë organeve tatimore.
- 18– Nga verifikimet në terren nuk janë gjetur 4 (katër) subjekte, të cilët e kanë emrin në “Listë” (edhe pas kontaktimeve në numrat e telefonit që gjenden në listë, si dhe nga bashkëpunimi me inspektorët e Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Vlorë apo duke pyetur prodhues të tjerë buke në qytetin e Vlorës), si dhe emrat e tyre nuk figurojnë të regjistruar pranë organeve tatimore.
- 19– Gjithashtu, referuar listës, rezultojnë 2 (dy) persona emrat e të cilëve janë përsëritur, përkatësisht:
1. Numri 37 Erjon Arunaj, i cili është i njëjti person me atë me numër 27;
 2. Numri 39 Esat Cakaj, i cili është i njëjti person me atë me numër 30.
- 20– Prodhuesit e bukës, të cilët rezultojnë të regjistruar pranë organeve tatimore dhe që gjithashtu rezultojnë në listën e administruar gjatë inspektimit paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Tabela Nr 1: Subjektet nën hetim

Nr	Firmat që prodhojnë bukë	Të rregjistruara në Tatime
1	Spiro Koci	Nipti K86503203E,
2	Bexhet Selmanaj	Nipti K37227201E
3	Esat Cakaj Nipti	Nipti K96708202F
4	Agron Hamzaraj	Nipti K86610201D
5	Tomorr Ngucaj	Nipti K56803204S
6	Fidan Osmanalla	Nipti K76910202T
7	Paolo SHPK (Spiro Baba)	Nipti K46605210T
8	Mirvjen Shehaj	Nipti L06912207R
9	Arnaldo Baba	Nipti L06311204Q
10	Adelina Rucaj	Nipti L06902209G
11	ARBRI SHPK (Qemal Katia)	Nipti K36410201P
12	Kleanthi Rapushi	Nipti K76904202M
13	Gentian Berberi	Nipti L06627205V
14	Agim Skënderaj	Nipti K36218225M
15	Myslymi shpk (Fatos Myslymi)	Nipti K36410209K
16	Fation Aliu	Nipti K86708208G
17	Feriz Osmanollaj	Nipti K67108201B
18	Adhurim Metaj	Nipti L16510204S

19	Viron Qarri	Nipti K67302204J
20	Ngucaj sh.p.k	Nipti K36410202A
21	Niko Nini	Nipti K77417202S
22	Dilaver Mehilli	Nipti K36528213Q
23	Arben Meminaj	Nipti K86318203E
24	Maringlen Rushiti	Nipti K46426202M
25	Alza sh.p.k	Nipti K46822202E
26	Algert Metani	Nipti K96506204F
27	Engjell Meminaj	Nipti K36419226Ë
28	Shpendi Ymeraj	Nipti K66709206Q
29	Dashamir Haruni	Nipti L07107201O
30	Erjon Haruni	Nipti K76904209W

IV. VLERËSIMI I SJELLJES SË NDËRMARRJEVE NË TREG

- 21– Grupi i Punës, gjatë inspektimeve dhe verifikimeve të kryera pranë prodhuesve të bukës të qytetit të Vlorës më datë 11-14 Prill 2011, administroi kuponat tatimore të shitjes së produktit bukë 900 gr dhe bukë 450 gr, pranë 30 subjekteve të identifikuara sipas listës së administruar gjatë inspektimit të datës 28.03.2011.
- 22– Më poshtë po paraqesim ndërmarrjet të cilat janë në listën e administruar gjatë inspektimit dhe të regjistruara pranë organeve tatimore, si dhe çmimet e aplikuar nga këto ndërmarrje për bukën 900 gr dhe bukën 450 gr, sipas kuponave tatimore apo deklaratave të administruara mbi çmimin e tregtimit të bukës nga subjektet që nuk dispononin kasë fiskale, por rezultonin të regjistruar pranë organeve tatimore:
1. Spiro Koci Nipti K86503203E, nga kuponi tatimor i lëshuar në datë 11.04.2011 rezulton se ky subjekt e tregton bukën masive me peshë 900 gr me çmimin prej 120 lekë dhe bukën 450 gr me çmimin 60 lekë;
 2. Ngucaj sh.p.k Nipti K36410202A, nga kuponi tatimor i lëshuar në datë 13.04.2011, rezulton se ky subjekt e tregton bukën masive me peshë 900 gr me çmimin prej 100 lekë dhe bukën 450 gr me çmimin 50 lekë;
 3. Bexhet Selmanaj Nipti K37227201E, nga kuponi tatimor I lëshuar në datë 11.04.2011 rezulton që buka masive shitet 120 L dhe 60 L
 4. Esat Cakaj Nipti K96708202F nga kuponi tatimor i lëshuar në datë 11.04.2011 rezulton se ky subjekt e tregton bukën masive me peshë 900 gr me çmimin prej 120 lekë dhe bukën 450 gr me çmimin 60 lekë;
 5. Agron Hamzaraj Nipti K86610201D, nga kuponi tatimor i lëshuar në datë 11.04.2011 rezulton se ky subjekt e tregton bukën masive me peshë 900 gr me çmimin prej 100 lekë dhe bukën 450 gr me çmimin 50 lekë por në procesverbalin e datës 28.03.2011 ka deklaruar se nga data 23.03.2011 ka aplikuar çmimet 120 lekë për bukën 900 gr dhe 60 lekë për bukën 450gr;
 6. Niko Nini Nipti K77417202S nga kuponi tatimor i lëshuar në datë 11.04.2011 rezulton se ky subjekt e tregton bukën masive me peshë 900 gr me çmimin prej 100 lekë dhe bukën 450 gr me çmimin 50lekë;

7. Tomorr Ngucaj Nipti K56803204S nga kuponi tatimor i lëshuar në datë 11.04.2011 rezulton se ky subjekt e tregton bukën masive me peshë 900 gr me çmimin prej 120 lekë dhe bukën 450 gr me çmimin 60 lekë;
8. Fidan Osmanallaj Nipti K76910202T nga kuponi tatimor i lëshuar në datë 11.04.2011 rezulton se ky subjekt e tregton bukën masive me peshë 900 gr me çmimin prej 120 lekë dhe bukën 450 gr me çmimin 60 lekë;
9. Furrë buke “Paolo” SHPK (Spiro Baba) Nipti K46605210T nga kuponi tatimor lëshuar në datë 11.04.2011 rezulton se ky subjekt e tregton bukën masive me peshë 900 gr me çmimin prej 120 lekë dhe bukën 450 gr me çmimin 60 lekë;
10. Mirvjen Shehaj Nipti L06912207R nga kuponi tatimor i lëshuar në datë 14.04.2011 rezulton se ky subjekt e tregton bukën masive me peshë 900 gr me çmimin prej 120 lekë dhe bukën 450 gr me çmimin 60 lekë;
11. Arnaldo Baba Nipti L06311204Q nga kuponi tatimor i lëshuar në datë 11.04.2011 rezulton se ky subjekt e tregton bukën masive me peshë 900 gr me çmimin prej 120 lekë dhe bukën 450 gr me çmimin 60 lekë;
12. EuroForno (Adelina Rucaj) Nipti L06902209G nga kuponi tatimor i lëshuar në datë 11.04.2011 rezulton se ky subjekt e tregton bukën masive me peshë 900 gr me çmimin prej 120 lekë dhe bukën 450 gr me çmimin 60 lekë;
13. Arbri sh.p.k (Qemal Katia)Nipti K36410201P nga kuponi tatimor i lëshuar në datë 11.04.2011 rezulton se ky subjekt e tregton bukën masive me peshë 900 gr me çmimin prej 120 lekë dhe bukën 450 gr me çmimin 60 lekë;
14. “Fabiola DM” SHPK (Dilaver Mëhilli) Nipti K36528213Q sipas deklaratës së datës 11.04.2011 rezulton se ky subjekt e tregton bukën masive me peshë 900 gr me çmimin prej 100 lekë dhe bukën 450 gr me çmimin 50 lekë, pasi nuk kishte kasë fiskale;
15. Kleanthi Rapushi Nipti K76904202M nga kuponi tatimor i lëshuar në datë 11.04.2011 rezulton se ky subjekt e tregton bukën masive me peshë 900 gr me çmimin prej 120 lekë dhe bukën 450 gr me çmimin 60 lekë;
16. Gentian Berberi Nipti L06627205V nga kuponi tatimor i lëshuar në datë 12.04.2011 rezulton se ky subjekt e tregton bukën masive me peshë 900 gr me çmimin prej 120 lekë dhe bukën 450 gr me çmimin 60 lekë;
17. Arben Meminaj Nipti K86318203E, nga kuponi tatimor i lëshuar në datë 12.04.2011 rezulton se ky subjekt e tregton bukën masive me peshë 900 gr me çmimin prej 100 lekë dhe bukën 450 gr me çmimin 50 lekë;
18. Agim Skënderaj Nipti K36218225M, sipas deklaratës së datës 12.04.2011 rezulton se ky subjekt e tregton bukën masive me peshë 900 gr me çmimin prej 120 lekë dhe bukën 450 gr me çmimin 60 lekë;
19. Myslymi sh.p.k (Fatos Myslymi) Nipti K36410209K, nga kuponi tatimor i lëshuar në datë 12.04.2011 rezulton se ky subjekt e tregton bukën masive me peshë 900 gr me çmimin prej 120 lekë dhe bukën 450 gr me çmimin 60 lekë;
20. Rushiti sh.p.k (Maringlen Rushiti) Nipti K46426202M, nga kuponi tatimor i lëshuar në datë 12.04.2011 rezulton se ky subjekt e tregton bukën masive me peshë 900 gr me çmimin prej 80 lekë dhe bukën 450 gr me çmimin 50 lekë;
21. Fation Aliu Nipti K86708208G, nga kuponi tatimor i lëshuar në datë 11.04.2011 rezulton se ky subjekt e tregton bukën masive me peshë 900 gr me çmimin prej 120 lekë dhe bukën 450 gr me çmimin 60 lekë;
22. Alza sh.p.k Nipti K46822202E, nga kuponi tatimor I lëshuar në datë 14.04.2011 rezulton se ky subjekt e tregton bukën masive me peshë 900 gr me çmimin prej 100 lekë dhe bukën 450 gr me çmimin 40 lekë;

23. Feriz Osmanallaj Nipti K67108201B, sipas deklaratës 26.04.2011 rezulton se ky subjekt e tregton bukën masive me peshë 900 gr me çmimin prej 120 lekë dhe bukën 450 gr me çmimin 60 lekë;
24. Adhurim Metaj Nipti L16510204S sipas procesverbalit të mbajtur në datë 14.04.2011 rezultoi se ky subjekt e tregton bukën masive me peshë 900 gr me çmimin prej 120 lekë dhe bukën 450 gr me çmimin 60 lekë;
25. Viron Qarri Nipti K67302204J, nga kuponi tatimor i lëshuar në datë 14.04.2011 rezulton se ky subjekt e tregton bukën masive me peshë 900 gr me çmimin prej 110 lekë dhe bukën 450 gr me çmimin 50 lekë ndërsa nga procesverbali i mbajtur në datë 14.04.2011 ka deklaruar se deri në datën e lëshimit të Vendimit të KK ‘Për marrjen e masave të përkohshme’ ka aplikuar çmimi 120 lekë për bukën 900 gr dhe 60 lekë për bukën 450 gr;
26. Algert Metani Nipti K96506204F, nga kuponi tatimor i lëshuar në datë 14.04.2011 rezulton se ky subjekt e tregton bukën masive me peshë 900 gr me çmimin prej 110 lekë dhe bukën 450 gr me çmimin 55 lekë;
27. Blevim sh.p.k (Engjell Meminaj), Nipti K36419226Ë nga kuponi tatimor i lëshuar në datë 14.04.2011 rezulton se ky subjekt e tregton bukën masive me peshë 900 gr me çmimin prej 100 lekë dhe bukën 450 gr me çmimin 50 lekë;
28. Shpendi Ymeraj Nipti K66709206Q, sipas deklaratës së datës 14.04.2011 rezulton se ky subjekt e tregton bukën masive me peshë 900 gr me çmimin prej 100 lekë dhe bukën 450 gr me çmimin 50 lekë;
29. Dashamir Haruni Nipti L07107201O, në datë 11.04.2011 rezulton që buka masive shitet 120 L dhe 60 L. Aktualisht aktiviteti i tij figuron i mbyllur.
30. Erjon Haruni Nipti K76904209 W, sipas deklaratës së datës 27.04.2011 dhe kuponave tatimor rezulton se buka masive 900 gr shitet me 110 lekë dhe buka masive 460 gr shitet 50 lekë.

V. ANALIZA E KONKURRENCËS

- 23– Indicio e procedurave hetimore ishte një njoftim publik për rritjen e menjëhershme të çmimit të produktit bukë masive në qytetin e Vlorës, e cila në kuptim të ligjit nr. 9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës” i ndryshuar është një marrëveshje e ndaluar “per se” që kufizon konkurrencën në tregun përkatës. Nga informacioni i administruar gjatë procedurës së hetimit paraprak, rezulton se prodhuesit e bukës në qytetin e Vlorës janë mbledhur më datë 21.03.2011 gjë e cila vërtetohet nga procesverbalet e mbajtura më datë 28.03.2011 nga Grupi i Punës
- 24– Në këtë mbledhje të disa prej prodhuesve dhe ofruesve të produktit përkatës ku është tentuar të përfshihen të gjithë konkurrentët në qytetin e Vlorës është vendosur rritja e menjëhershme e çmimit të bukës masive duke sjellë si argument rritjen e çmimit të lëndës së parë, karburantit, energjisë elektrike, ambalazhit etj...
- 25– Në këtë mbledhje prodhuesit e bukës të qytetit të Vlorës vendosën të rrisnin çmimin e bukës masive 900 gr në 120 lekë dhe të bukës masive 450 gr në 60 lekë, duke filluar nga data 23.03.2011. Gjithashtu pas mbledhjes në furrat e bukës të qytetit të Vlorës është shpërndarë njoftimi i mëposhtëm:

“Shoqata e furrave të bukës Vlorë vendosi në datën 21.03.2011 që buka në datën 23.03.2011 të ketë këtë çmimin 900 gr = 120 lek dhe 450 gr = 60 lek”.

- 26– Referuar sa më sipër, rezulton se prodhuesit e bukës kanë fiksuar çmimin e shitjes së produktit bukë masive 900 gr në 120 lekë dhe bukë masive 450 gr në 60 lekë.
- 27– Në bazë të nenit 4, pika 1, gërma (a), të Ligjit 9121, datë 23.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, kjo sjellje mund të përbëjë kufizim apo shtrembërim të konkurrencës në treg, duke caktuar në mënyrë të drejtpërdrejtë çmimet e shitjes së bukës.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të nenit 24, shkronja d) dhe nenit 43, pika 1, të Ligjit Nr .9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si dhe në nenin 12 dhe nenin 21, pika 4, të Rregullores “Për funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës”, me propozim të Sekretariatit,

V E N D O S I:

- I. Hapjen e hetimit të thelluar në tregun e prodhimit dhe tregtimit të bukës 900 gr dhe 450 gr në qytetin e Vlorës, për ndërmarrjet që kanë zbatuar marrëveshjen për fiksimin e çmimit si vijon:
- | | | |
|-----|-------------------|------------------|
| 1. | Spiro Koci | Nipti K86503203E |
| 2. | Bexhet Selmanaj | Nipti K37227201E |
| 3. | Esat Cakaj | Nipti K96708202F |
| 4. | Agron Hamzaraj | Nipti K86610201D |
| 5. | Tomorr Ngucaj | Nipti K56803204S |
| 6. | Fidan Osmanallaj | Nipti K76910202T |
| 7. | Paolo SHPK | Nipti K46605210T |
| 8. | Mirvjen Shehaj | Nipti L06912207R |
| 9. | Arnaldo Baba | Nipti L06311204Q |
| 10. | Adelina Rucaj | Nipti L06902209G |
| 11. | Arbri sh.p.k | Nipti K36410201P |
| 12. | Kleanthi Rapushi | Nipti K76904202M |
| 13. | Gentian Berberi | Nipti L06627205V |
| 14. | Agim Skënderaj | Nipti K36218225M |
| 15. | Myslymi sh.p.k | Nipti K36410209K |
| 16. | Fation Aliu | Nipti K86708208G |
| 17. | Feriz Osmanallaj | Nipti K67108201B |
| 18. | Adhurim Metaj | Nipti L16510204S |
| 19. | Viron Qarri | Nipti K67302204J |
| 20. | Ngucaj sh.p.k | Nipti K36410202A |
| 21. | Niko Nini | Nipti K77417202S |
| 22. | Dilaver Mehilli | Nipti K36528213Q |
| 23. | Arben Meminaj | Nipti K86318203E |
| 24. | Maringlen Rushiti | Nipti K46426202M |
| 25. | Alza sh.p.k | Nipti K46822202E |

- | | | |
|-----|-----------------|------------------|
| 26. | Algert Metani | Nipti K96506204F |
| 27. | Engjell Meminaj | Nipti K36419226W |
| 28. | Shpendi Ymeraj | Nipti K66709206Q |
| 29. | Dashamir Haruni | Nipti L07107201O |
| 30. | Erjon Haruni | Nipti K76904209W |

- II. Hetimi i thelluar të përfshijë periudhën kohore nga 23.03.2011 deri në 14.04.2011.
- III. Përcaktimin e hapave të kryerjes së hetimit të thelluar si vijon:
- Inspektime në ndërmarrjet nën hetim;
 - Mbledhja e informacioneve të nevojshme dhe plotësuese;
 - Përpunimi i të dhënave dhe vlerësimi i informacionit të mbledhur;
 - Hartimi i Raportit përfundimtar të hetimit të thelluar brenda datës 30 Qershor 2011;
 - Organizimi i seancës dëgjimore.
- IV. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të përfshira në këtë hetim;

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete Gruda
()
Anëtar

Koço Broka
()
Anëtar

Rezana Konomi
()
Anëtar

Lindita Milo (Lati)

K R Y E T A R

MENDIMI I PAKICËS

Lidhur me Vendimin e Komisionit të Konkurrencës Nr.191, Datë 30.05.2011 “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e rodhimit dhe tregëtimit të bukës në qytetin e Vlorës” kam mbajtur qëndrim kundra, me arësytimin e mëposhtëm :

- I- Nuk kam aprovuar dhe nuk aprovoj “Raport i hetimit paraprak në tregun e prodhimit dhe tregëtimit të bukës në Qytetin e Vlorës” të datës 13/5/2011, por dhe veprimtarinë e Grupit të punës, për mungesën saktësie, objektiviteti, dhe një hetim të paanshmëm që mund të garantojë rivendosjen e konkurrencës së lirë, efektive por dhe të ndershme. Përmes këtij raporti dhe kësaj veprimtarie, nuk është mundur t’i jepet përgjigje problematikës së këtij tregu, të evidentuara dhe në dy rastet paraardhëse kur nga Autoriteti i Konkurrencës është hetur tregu i bukës në qytetin e Fierit dhe atë të Korçës dhe sidomos kërkesës së shoqatës të prodhuesve të bukës të qytetit të Fierit, ku i është kërkuar në mënyrë eksplicite, Autoritetit të Konkurrencës në tërësi dhe Komisionit të Konkurrencës në veçanti, ndihmesa për rivendosjen e konkurrencës së lirë, efektive dhe të ndershme, që dëmtohet nga praktikatat e evazionit fiskal.

” Shoqata e Prodhuesve të Bukës” Apollonia” Fier, pasi i kishte kërkuar ndihmesë zyres së Tatim -Taksave në Fier “Kërkohet ndihma Juaj për kufizimin e evazionit Fiskal në prodhimin e shitjen e bukës” i a drejtoj këtë kërkesë dhe Autoritetit të Konkurrencës. Personalisht shqetësimin e kësaj kërkesë e quaj të drejtë, por ndërkohë shmangjen e kësaj kërkesë gjatë hetimeve kryera nga grupet e punës të sekretariatit nuk e quaj të drejtë. Unë e konsideroj dhe e vlerësoj këtë praktikë hetimore të gabuar që nuk mundëson rivendosjen e konkurrencës në treg. Dua të evedentoj se forma kryesore e shtrëmbërimit të konkurrencës në Shqipëri është ajo nëpërmjet evazionit fiskal.

Ky aspekt është shmangur gjatë hetimit paraprak dhe /ose Raportin e hetimit paraprak në tregun e prodhimit dhe tregëtimit të bukës në Qytetin e Vlorës. Nga tërësia e subjekteve nën hetim është mundësuar të sigurohen kupona tatimore po thuaj se për shumicën e subjekteve dhe bilance 10 bilance fiskale. Sipas kuponave tatimore, që ndodhen në dosjen hetimore, rezultojnë se ka subjekte që kanë prerë kuponin e parë tatimor në ora 15.40. Ka subjekte që kanë prerë, 30 kupona e të tjerë ndoshta më shumë. Por kjo situatë nuk paraqitet në Raportin Hetimor. E njëjta gjë mund të thuhet për pasqyrat financiare të subjekteve nën hetim. Nga tërësia e subjekteve në dosje hetimore janë siguruar pasqyrat financiare (Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve dhe bilanci) vetëm për 10 subjekte, nga një numër i paqartë subjektësh që jepen në Raport. Sipas këtyre bilanceve, xhiroja ditore e konvertuar në një bukë 100 lek rezultojnë, të jete sipas rendit të subjekteve për të cilët është siguruar bilanc, subjekti nr 1-38 copë bukë; 2-176; 3-165; 4-63; 5-87; 6-67; 7-52; 8-17; 9-91; 10-96. Pra gjithsej për këto 10 subjekte 852 cope bukë. Sipas kësaj rezultojnë se gjatë një dite në Qytetin e Vlorës prodhohen rreth 3400-3500 bukë në ditë.

Kur komisioni kërkon që grupi i punës të pasqyrojë volumin e tregut të bukës nën hetim në qytetin e Vlorës, përgjigja shmanget. Nisur nga sa më sipër, bazuar në cilësinë e Raportit Hetimor të paraqitur nga Grupi i punës i jam përmbajtur dhe i përmbahem mendimit se hapi i parë duhet të ndërmerret nga Sekretariati ishte rishtrujta e raportit hetimor mbi bazën e gjithë informacionin që ndodhet në dosjen hetimore. Në kushtet e kundërshtimit të kësaj paraqitje të plotë dhe objektive kam propozuar:

- I. Sekretari i përgjithshëm të anultoj grupin e punës ekzistues për hetimin paraprak, duke e zëvendësuar atë me një grup tjetër pune “ Për hapjen e procedurës së hetimit

paraprak në tregun e prodhimit dhe tregtimit të bukës në qytetin e Vlorës”, duke mundësuar e siguruar një hetim objektiv dhe pasqyrim të plotë dhe të paanshëm të gjithë subjekteve. nën hetim, në Raportet dhe draft vendimarrjen përkatse”

- II. Në kuadrin e avokatisë, dhe rastit konkret, të bëhet një shpjegim i plotë dhe i qartë, mbi rolin e shoqatave të ndryshme, duke shpjeguar se çfarë është e ndaluar për to nga ligji, bazën e përvojës dhe trajnimeve të fituara, Kjo të realizohet në një televizion kombëtar dhe në një nga televizionet e qytetit të Vlorës.
- II. Në këtë situatë ka dy lista të subjekteve nën hetim, një të paraqitur nga Grupi i Punës me 19 subjekte, dhe një nga Komisioni i Konkurrencës.

Në këto rrethana nuk jam dakort dhe kam shprehur edhe votën kundra pjesës së ddispozitivit të Vendimit Nr 191, Datë 31.05.2011”Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e prodhimit dhe tregtimit të bukës në qytetin e Vlorës” me këtë përmbajtje: “

- IV. Hapjen e hetimit të thelluar në tregun e prodhimit dhe tregtimit të bukës 900 gr dhe 450 gr në qytetin e Vlorës, për ndërmarrjet që kanë qënë pjesëmarrës në takimin ku është rënë dakort për fiksimin e cmimit në tregun përkatës si vijon:

1.	Spiro Koci	Nipti K86503203E
2.	Bexhet Selmanaj	Nipti K37227201E
3.	Esat Cakaj	Nipti K96708202F
4.	Agron Hamzaraj	Nipti K86610201D
5.	Tomorr Ngucaj	Nipti K56803204S
6.	Fidan Osmanallaj	Nipti K76910202T
7.	Paolo SHPK	Nipti K46605210T
8.	Mirvjen Shehaj	Nipti L06912207R
9.	Arnaldo Baba	Nipti L06311204Q
10.	Adelina Rucaj	Nipti L06902209G
11.	Arbri sh.p.k	Nipti K36410201P
12.	Kleanthi Rapushi	Nipti K76904202M
13.	Gentian Berberi	Nipti L06627205V
14.	Agim Skënderaj	Nipti K36218225M
15.	Myslymi sh.p.k	Nipti K36410209K
16.	Fation Aliu	Nipti K86708208G
17.	Feriz Osmanallaj	Nipti K67108201B
18.	Adhurim Metaj	Nipti L16510204S
19.	Viron Qarri	Nipti K67302204J
20.	Ngucaj sh.p.k	Nipti K36410202A
21.	Niko Nini	Nipti K77417202S
22.	Dilaver Mehilli	Nipti K36528213Q
23.	Arben Meminaj	Nipti K86318203E
24.	Maringlen Rushiti	Nipti K46426202M
25.	Alza sh.p.k	Nipti K46822202E
26.	Algert Metani	Nipti K96506204F

27	Engjell Meminaj	Nipti K36419226Ë
28	Shpendi Ymeraj	Nipti K66709206Q
29	Dashamir Haruni	Nipti L07107201O
30	Erjon Haruni	Nipti K76904209Ë

- V. Hapjen e hetimit të thelluar në tregun e prodhimit dhe tregtimit të bukës 900 gr dhe 450 gr në qytetin e Vlorës, për personat që kanë qënë pjesëmarrës në takimin ku është rënë dakort për fiksimin e cmimit në tregun përkatës por nuk janë të regjistruar në organet tatimore si vijon:
- 1 Lulo Myslymi
 - 2 Agace Myslymi
 - 3 Gentian Hamzaraj
 - 4 Gjergji Simoni
 - 5 Migen Kozmai
- VI. Hetimi i thelluar të përfshijë periudhën kohore nga 23.03.2011 deri në 14.04.2011.
- VII. Përcaktimin e hapave të kryerjes së hetimit të thelluar si vijon:
- a. Inspektime në ndërmarrjet nën hetim;
 - b. Mbledhja e informacioneve të nevojshme dhe plotësuese;
 - c. Përpunimi i të dhënave dhe vlerësimi i informacionit të mbledhur;
 - d. Hartimi i Raportit përfundimtar të hetimit të thelluar brenda datës 30 Qershor 2011; »

Kjo me argumentin se brenda një institucioni nuk mund të ketë dy lista subjektsh nën hetim. Ndërkohë edhe periudha hetimore dhe hapat e kryerjes së hetimit në trajtën si janë në depozitiv dhe mangësive të Raportit Paraprak, nuk garantojnë rivendosjen e konkurrencës në treg përfshirë shmngjen dhe eliminimin e shtrembërimeve të saj nga evazioni fiskal, për të cilat janë në dijeni organizma shtetërore, përfshi organet tatimore apo Autoriteti i Konkurrencës. Hetimi nga Autoriteti i Konkurrencës, për shtrmbërimin e konkurrencës duhet të jetë integral. Vetëm në këtë mënyrë, mund te rivendoset konkurrenca në tregun e shitjes së bukës, dhe të rritet efikasiteti i Autoritetit të Konkurrencës, duke mundësuar rivendosjen e konkurrencës në tregun e bukës, përfshirë ato që kërkojnë shatatat e prodhuesve të bukës, ndihmesen për eliminimin edhe të shtrëmbërimeve të konkurrencës që vijnë nga evazioni fiskal

KOMISIONER NE KOMISIONIN E KONKURRENCËS

Koço BROKA

(_____)

Anëtar



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 192, Datë 21.06.2011

“Për mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të orizit”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Servete Gruda Anëtar
- Koço Broka Anëtar
- Rezana Konomi Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 14.06.2011, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Shqyrtimi i Raportit të Hetimit Paraprak “Në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të orizit”;

Baza ligjore: Neni 24, shkronja d, neni 26 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të Raportit të Hetimit Paraprak “Në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të orizit”, të paraqitur nga Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës dhe relacionin e Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës,

VËREN SE:

I. PROCEDURA E NDJEKUR

- 1– Duke marrë shkas nga gjetjet e konstatuara në raportin “Monitorimi i tregut të importit të sheqerit dhe orizit për periudhën janar 2009 – gusht 2010”, bazuar në nenin 42, pika 1 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” (i ndryshuar) me anë të Vendimit Nr. 155, datë 28.10.2010, Komisioni i Konkurrencës vendosi “Për miratimin e hapjes së procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të orizit”. Ky vendim është ndryshuar me Vendimin Nr. 172, datë 17.01.2011 dhe Vendim Nr. 180, datë 29.03.2011 dhe ka si objekt vlerësimin e kushteve të tregut nëse ka kufizime të konkurrencës së lirë dhe efektive.

- 2- Bazuar në nenet 33 dhe 34 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, Autoriteti i Konkurrencës ka administruar informacionin e nevojshëm nga ndërmarrjet aktive në tregun përkatës dhe institucionet publike si Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, QKR, INSTAT etj.

II. PERIUDHA HETIMORE DHE NDËRMARRJET NËN HETIM

- 1- Referuar Vendimit Nr. 155, datë 28.10.2010 “Për miratimin e hapjes së procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të orizit”, të ndryshuar, hetimi paraprak përfshin periudhën kohore nga Janari 2008 deri më 31 Dhjetor 2010.
- 2- Në bazë të nenit 35 dhe 36 të Ligjit Nr. 9121, dt 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” dhe autorizimit të Komisionit të Konkurrencës Nr. 419, datë 08.11.2010 “Autorizim”, Grupi i Punës gjatë periudhës së hetimit kreu inspektime në disa ndërmarrje pjesëmarrëse në tregun përkatës. Grupi i punës kreu inspektime vetëm në 4 ndërmarrjet më të mëdha të cilat zotërojnë më shumë se 5 % të tregut. Qëllimi i inspektimeve ishte grumbullimi i fakteve dhe të dhënave të nevojshme në funksion të hetimit paraprak në tregun e Importit dhe tregtimit me shumicë të orizit.

Këto ndërmarrje janë:

Teuta sh.p.k

Ndërmarrja Teuta sh.p.k me numër NIPT J61821505J, adresë Lagjia 15, Rruga ‘A Goga’ ish Fabrika e makaronave, Spital, Durrës.

Ferra & Co sh.p.k

Ndërmarrja Ferra & Co me numër NIPT J 61805508Ë, adresë Lagjia 14, Rruga ‘Tirana’, Shkozë, Durrës

Sprint sh.p.k

Ndërmarrja Sprint sh.p.k me numër NIPT K31519045J, adresë Rruga ‘Siri Kodra’, Tiranë

Sucralba sh.p.k dhe Oerti sh.p.k

Ndërmarrja Sucralba me numër NIPT J91328501A, adresë Lagjia 17, Rruga ‘Dalip Peza’ Nr 12, Durrës. Ndërsa ndërmarrja Oerti sh.p.k me numër NIPT J61818569Ë, adresë ‘Ish bobinazhi’, Durrës . Në qershor të vitit 2009 ndërmarrja Sucralba është bashkuar me përthithje me ndërmarrjen Oerti.

III. ANALIZA E KONKURRENCËS

III.1 TREGU PËRKATËS

- 3- Në zbatim të Udhëzimit për përcaktimin e tregut përkatës, grupi i punës përcaktoi dy dimensionet e tregut përkatës:
- 1) Tregun e produkteve
 - 2) Tregun gjeografik

Tregu përkatës i produktit

- 4- Tregu përkatës i produktit është tregu i importit dhe tregtimit me shumicë të orizit për përdorim masiv.
- 5- Në analizë, produkti oriz nuk është ndarë në oriz kokërr gjatë, kokërr mesëm kokërr rumbullakët, sepse qëllimi i përdorimit të këtij produkti është i njëjtë dhe gjithashtu

këto tre lloje produkti janë plotësisht të zëvendësueshëm si nga ana e kërkesës ashtu edhe nga ana e ofertës. Këto tre lloje orizi kanë cilësi dhe çmime thuajse të njëjta. Në analizë është përjashtuar orizi i cilësisë së lartë i llojeve të ndryshme sepse nuk është i zëvendësueshëm për shkak të nivelit të lartë të çmimit.

Tregu përkatës gjeografik

- 6- Tregu përkatës gjeografik është territori i Republikës së Shqipërisë sepse ndërmarrjet tregtojnë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

III.2 STRUKTURA E TREGUT

- 7- Në tregun e importit të orizit operojnë mbi 30 ndërmarrje të cilat importojnë dhe tregtojnë me shumicë. Në këtë hetim janë marrë në analizë vetëm 4 prej tyre të cilat zënë, së bashku, rreth 61% të tregut.

Tabela Nr 1: Pjesët e tregut

	Ndërmarrjet	Viti 2010	Viti 2009	Viti 2008
		Pjesa e tregut	Pjesa e tregut	Pjesa e tregut
1	TEUTA E.B	31,7%	34,7%	34,7%
2	FERRA & CO	14,3%	8,1%	1,3%
3	SPRINT	9,8%	8,8%	8,1%
4	SUCRALBA	7,1%	5,6%	0,0%
5	VAKO-TREG	6,0%	3,6%	1,4%
6	ELENA SHPK	4,5%	3,6%	7,7%
7	BEEM	3,5%	1,0%	0,0%
8	IMPULS	3,6%		
9	EMEDO COMPANY	1,9%	0,5%	0,0%
10	ITALIA GRIFOOD	1,5%	0,5%	0,0%
11	MARZI PAN	1,4%	2,5%	5,8%
12	SHENA GJ	2,0%	0,0%	0,0%
13	HENRI-IMPEKS -SHPK	1,3%	0,0%	0,0%
14	ELLEDII -SHPK	1,2%	0,0%	0,0%
15	EQEREM - 934 - SHPK	1,2%	0,7%	0,0%
16	GAZMENT ZENELI	1,0%	0,7%	0,0%
17	LIBOHOVA	0,8%	0,5%	0,8%
18	HODAJ	1,9%		
19	VAJRA BIMORE	0,7%		
20	DANINA -SHPK	0,7%	0,0%	0,0%
22	MIRNA ENTERPRISES	0,6%	5,1%	0,0%
23	TRANZO SHPK	0,0%		0,9%
24	OERTI	0,0%	7,7%	27,2%
25	HARI LENA	0,0%		0,6%
26	CRYSTAL	0,0%	3,5%	4,0%
27	ANONIME KAKAVIJE	0,0%		0,6%
28	ALFA-3	0,0%		1,7%
29	"ERIONI-H"	0,0%	8,0%	1,0%
30	Te tjera	3,3%	5,0%	4,3%
	Totali	100,0%	100,0%	100,0%

Burimi: Të dhënat e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, shkresa Nr. 348/1, dt 15.09.2010

- 8- Nga tabelat e mësipërme mund të thuhet se tregu i orizit është një treg me dinamikë të lartë, ka shume hyrje dhe dalje të firmave nga tregu.

- 9- Indeksi i përqëndrimit në tregun e importit të orizit ka ardhur në ulje nga viti në vit. Në vitin 2008 tregu i importit të orizit ka qenë i përqëndruar. Në vitin 2009 dhe 2010 indeksi i përqëndrimit është ulur ndjeshëm.

Tabela Nr 2: Treguesit e përqëndrimit

Viti	2008	2009	2010
HHI	2141,3	1572,57	1471,7
Tregu	Shumë i përqëndruar	Mesatarisht i përqëndruar	Mesatarisht i përqëndruar

- 10- Për vitin 2010 tregu i orizit është mesatarisht i përqëndruar. Ulja e indeksit të përqëndrimit tregon që tregu është hapur për konkurrencën dhe është rritur numri i operatorëve në këtë treg. Ndërmarrja që ka ulur fuqinë e tregut është kryesisht ndërmarrja Teuta e cila ka humbur pjesë tregu në vitin 2010, ndërsa ndërmarrjet Ferra & Co, Sprint dhe Sucralba kanë fituar pjesë tregu nga viti në vit. Shkalla e përqëndrimit e moderuar (1417) tregon se ndërmarrjet nuk kanë fuqi tregu.

III.3 KUFIZIMET E MUNDSHME TË KONKURRENCËS

- 11- Analiza e kufizimit të mundshëm të konkurrencës në tregun përkatës është mbështetur në dy pistat kryesore që përcakton Ligji Nr.9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, marrëveshjet potenciale të ndaluara dhe abuzimin e mundshëm me pozitën dominuese (nisur nga pjesët e tregut, barrierat e hyrjes në treg dhe faktorë të tjerë).

III.3.1 Abuzimi i mundshëm me pozitën dominuese

1) Pjesët e tregut

- 12- Bazuar në kriterin e pjesës së tregut, në tregun e importit dhe shitjes me shumicë neni 8 pika a të Ligjit Nr.9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” asnjë ndërmarrje nuk zotëron pozitë dominuese në tregun përkatës.

2) Pengesat e hyrjes në treg

- 13- Në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të orizit mund të marrë pjesë çdo subjekt i regjistruar sipas legjislacionin në fuqi. Për të qenë operator i këtij tregu nuk ka nevojë për investime të mëdha fillestare. Sipas operatorëve të këtij tregu nuk ka asnjë pengesë për të importuar dhe tregtuar oriz, mjafton që një individë të blejë oriz me thasë dhe mund ta shesë atë. Gjithashtu nuk ka barriera ligjore dhe administrative për të hyrë në tregun e orizit.
- 14- Pra, si konkluzion mund të themi se hyrja është e lire, nuk ka barriera për të qenë pjesë e tregut të importit dhe tregtimit me shumicë të orizit.

3) Konkurrenca potenciale

- 15- Duke qenë se hyrja është e lire, firma të reja kanë hyrë dhe mund të hyjnë në treg të cilat kanë rritur sasinë totale të furnizimit, rritje kjo që mund të çojë në uljen e çmimit. Kërcënimi i konkurrencës potenciale është i lartë për firmat ekzistuese meqenëse barrierat hyrëse janë të ulta.

4) Rrjeti i shpërndarjes

- 16- Bazuar në informacionin e mbledhur nga ndërmarrjet nën hetim rezulton se ndërmarrjet realizojnë shpërndarjen e produktit oriz në të gjithë territorin e Shqipërisë nëpërmjet rrjetit të tyre shpërndarjes.

5) Karakteristika të tjera

- 17- Në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të orizit transparenca është në nivele të larta. Të gjithë operatorët e interesuar mund të blejnë oriz në tregjet ndërkombëtare dhe mund të disponojnë të gjithë informacionin e nevojshëm për të qenë aktiv me shitje në treg.
- 18- Si konkluzion, mund të themi se nisur nga pjesët e tregut, pengesat e hyrjes në treg, fuqia ekonomike financiare e ndërmarrjes, rrjeti i shpërndarjes dhe karakteristika të tjera të tregut, asnjë nga ndërmarrjet nuk ka përmbushur kriteret e nenit 8 duke mos zotëruar pozitë dominuese në tregun përkatës. Pra mund të themi që nuk jemi para rastit të një abuzimi të mundshëm me pozitën dominuese, sipas parashikimeve të nenit 9 të Ligjit Nr 9121, date 28.07.2003, "Për Mbrotjtjen e Konkurrencës", i ndryshuar).


III.3.2 Mundësia e bashkërendimit të sjelljes

Sjellja në lidhje me çmimin

- 19- Për të parë nëse ndërmarrjet që operojnë në tregun e tregtimit me shumicë të orizit vendosin direkt apo indirekt çmime fikse të shitjes janë krahasuar çmimet mesatare të shitjes me shumicë. Nga analiza duket qartë se ndërmarrjet nuk kanë çmime të njëjta dhe nuk kanë të njëjtin trend të ndryshimit të çmimit. Gjithashtu është bërë krahasimi i ndryshimit të çmimeve të periudhës pasardhëse me periudhën paraardhëse dhe nuk vihen re të njëjtat trende të ndryshimit të çmimeve.

Burimi: Të dhëna të ardhura nga ndërmarrjet pranë AK e të përpunuar nga grupi i punës.

- 20- Nga krahasimi i çmimeve të shitjes me shumicë nuk vihen re të njëjtat trende të ndryshimit midis ndërmarrjeve.



- 21- Në vitin 2008 ka patur një rritje prej rreth 216% të çmimit ndërkombëtar të orizit çka është reflektuar dhe në çmimin e importit, shitjes me shumicë dhe pakicë të orizit në tregun shqiptar.

Ndarja e tregjeve dhe burimeve të furnizimit

- 22- Nga analiza në vite e ndërmarrjeve rezulton se ndërmarrjet të cilat operojnë në tregun e importit të orizit nuk kanë blerje të përbashkëta, pjesët e tregut janë dinamike ka hyrje te reja dhe nuk ka kuota ndarje tregu ndërmjet konkurrentëve. Gjithashtu nga inspektimi dhe nga kontrolli i librave të shitjes nuk rezultuan që ka ndarje furnizimesh për klientë të veçantë.
- 23- Gjatë inspektimeve të kryera si dhe nga analiza e konkurrencës për sjelljet e ndërmarrjeve në treg nuk u gjetën evidenca direkte dhe indirekte të bashkëpunimit, si fiksimit direkt dhe indirekt të çmimeve të shitjes, kufizime apo kontroll i ofertës, ndarje të tregjeve dhe burimeve të furnizimit.
- 24- Nisur nga sjelljet e ndërmarrjeve në treg, nga analiza e çmimeve të shitjes, ndarja e tregjeve dhe burimet e furnizimit nuk ka evidenca të ekzistencës së një marrëveshje të ndaluar qoftë dhe në formën e një praktike të bashkërenduar midis ndërmarrjeve në tregun përkatës.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të nenit 24, shkronja d) dhe nenit 26, të Ligjit Nr .9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si dhe në nenin 12 dhe nenin 21, pika 4, të Rregullores “Për funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës”, me propozim të Sekretariatit,

VENDOSI:

- I. Mbylljen e Procedurës së Hetimit të Paraprak në Tregun e Importit dhe Tregtimit me Shumicë të Orizit pasi nuk janë gjetur shenja të kufizimit të konkurrencës, në bazë të nenit 4 dhe 9 të Ligjit Nr.9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”
 - II. Ngarkohet Sekretariati të vazhdojë monitorimin e tregut në zbatim të nenit 28, germa a e Ligjit “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”.
 - III. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të përfshira në këtë hetim;
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete Gruda
()
Anëtar

Koço Broka
()
Anëtar

Rezana Konomi
()
Anëtar

Lindita Milo (Lati)

K R Y E T A R



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 193, Datë 21.06.2011

**“Për mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit,
 prodhimit dhe tregtimit me shumicë të vajit vegjetal”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Servete Gruda Anëtar
- Koço Broka Anëtar
- Rezana Konomi Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 14.06.2011, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Shqyrtimin e raportit të hetimit paraprak në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të vajit vegjetal;

Baza ligjore: Ligji Nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, neni 24, shkronja d, dhe neni 26.
 Ligji Nr. 8485 datë 11. 11. 1999 “Kodi i procedurave administrative”.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të raportit “Mbi hetimin paraprak në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të vajit vegjetal” të paraqitur nga Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës, dhe relacionit përkatës të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës,

VËREN SE:

I. PROCEDURA E NDJEKUR

1. Bazuar në nenin 28 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, (të ndryshuar) Sektori i Analizës dhe Studimeve pranë Sekretariatit të Autoritetit të Konkurrencës, kreu një monitorim në tregun e importit të vajit ushqimor gjate periudhes janar 2009-gusht 2010. Nga monitorimi i tregut të importit të vajit ushqimor, rezultoi se ky treg është shumë i përqendruar.
2. Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të kërkesës së Sekretarit të Përgjithshëm dhe raportit të monitorimit të tregut të importit të vajit ushqimor, në zbatim të nenit

42, pika 1, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (të ndryshuar) me anë të Vendimit Nr. 156, datë 28.10.2010 “Për miratimin e hapjes së procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të vajit vegjetal”, ndryshuar me Vendimet e Komisionit të Konkurrencës nr. 173, datë 17.01.2011 dhe nr. 182, datë 29.03.2011, vendosi të miratojë hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të vajit vegjetal, për të parë nëse ka kufizime të konkurrencës.

3. Grupi i punës në zbatim të vendimit të mësipërm të Sekretarit të Përgjithshëm, Ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, ndoqi procedurat përkatëse për realizimin e hetimit.
4. Për analizen e konkurrencës në tregun përkatës bazuar në nenet 33 dhe 34 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, Autoriteti i Konkurrencës ka mbledhur të dhënat dhe informacionin e nevojshëm nga ndërmarrjet në tregjet përkatëse dhe institucionet publike si Drejtoria e Përgjithshme e doganave, QKR, INSTAT, MBUMK.

II. PERIUDHA E HETIMIT DHE NDERMARRJET NEN HETIM

5. Referuar Vendimit Nr. 156, datë 28.10.2010 “Për miratimin e hapjes së procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të vajit vegjetal”, të ndryshuar, hetimi paraprak përfshin periudhën kohore nga Janari 2008 deri më 31 Dhjetor 2010.
6. Ndërmarrjet nën hetim të cilat operojnë në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të vajit vegjetal janë
 - **Në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të vajit vegjetal operojnë këto ndërmarrje:**
 - 1) Ndërmarrja “**ERBIRON**”, regjistruar si person juridik me Vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë, Nr. 15478, datë 22.07.1996, me NIPT J62001012B, me seli në: Bërxull-Domje, Autostrada Tirane-Durrës Km.5, Tiranë.
 - 2) Ndërmarrja “**E & B**”, regjistruar si person juridik me Vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë, Nr. 32956, datë 15.02.2005, me NIPT K51705007E, me seli në: Tiranë – Prush.
 - 3) Ndërmarrja “**ELLEDII**”, regjistruar si person juridik pranë QKR-së më datë 15.12.2009, me NIPT K97415003G, me seli në: Lagjja: “Manush Alimani”, Rruga: “Ali Kelmendi”, Tek Ish Parku Komunal; Shkodër.
 - 4) Ndërmarrja “**FERRA & CO**”, regjistruar si person juridik me Vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë, Nr. 12582, datë 25.10.1995, me NIPT J61805508E, me seli në: Lagjja 14, Rruga Tirana, Përballë ish Plastikës, Shkozet, Durrës.
 - 5) Ndërmarrja “**BOMIRA**”, regjistruar si person juridik me Vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë, Nr. 21093, datë 23.03.1999, me NIPT K02701016D, me seli në: Ura Vajguore, Berat.
 - 6) Ndërmarrja “**CRYSTAL**”, regjistruar si person juridik me Vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë, Nr. 16299, datë 13.11.1996, me NIPT J62904353F, me seli në: L. 29 Nëntori, Autostrad-Metalurgjik, Elbasan.

- 7) Ndërmarrja “**DANINA**”, regjistruar si person juridik pranë QKR-së më datë 19/03/2009, me NIPT K92719204A, me seli në: Lagja “29 Nëntori”, Magazina pranë Fabrikës Crystal, Autostrada Metalurgji, Elbasan.
 - 8) Në tregun e importit operojnë edhe një numër i madh ndërmarrjesh të tjera, ku pjesa më e madhe e të cilave, së bashku, zënë një përqindje shumë të vogël të këtij tregu.
- **Në tregun e prodhimit dhe shitjes me shumicë të vajit vegjetal operojnë këto ndërmarrje:**
 - 9) Ndërmarrja “**OLIM**”, regjistruar si person juridik me Vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë, Nr. 20592, datë 18.01.1999, me NIPT J91327005U, me seli në: Gjokaj, Tiranë, Autostrada TR-DR.
 - 10) Ndërmarrja “**VAJRA BIMORE**”, regjistruar si person juridik me Vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë, Nr. 12663, datë 30.10.1995, me NIPT J82916436O, me seli në: Fier.

III. VLERESIMI I KONKURRENCËS NE TREG

III.1 Përcaktimi i Tregut Përkatës

7. Në zbatim të Udhëzimit për përcaktimin e tregut përkatës, grupi i punës përcaktoi dy dimensionet e tregut përkatës:
 - 1) Tregun e produkteve
 - 2) Tregun gjeografik
8. Kërkesat për vaj në tregun shqiptar sigurohen nga prodhimi vendas dhe nga importi. Vaji që sigurohet nga importi mund të jetë vaj i përpunuar dhe vaj i papërpunuar. Për prodhimin e vajit në vend, si lëndë e parë shërben vaji i papërpunuar që importohet. Në treg hidhet për shitje si vaji vegjetal i importuar ashtu dhe vaji vegjetal i prodhuar në vend.
9. Vaji i përpunuar që importohet është i llojeve të ndryshme si: vaj luledielli, vaj kikiriku, vaj ulliri, vaj misri, vaj soje, vaj industrial, vaj ëmbëlsirash, etj. Vaji vegjetal përfshin: vaj luledielli, vaj kikiriku dhe vaj misri, etj (me përjashtim të vajit të ullirit)¹. Për sa i përket zëvendësueshmërisë nga ana e kërkesës, për nga përdorimi, vaji i lulediellit dhe vaji i kikirikut kanë përdorim më të gjerë në familje si për gatim, skuqje dhe sallatë. Vaji industrial dhe vaji i ëmbëlsirave janë përjashtuar nga tregu përkatës, sepse i pari përdoret për pajisje pune, ndërsa i dyti përdoret në punishtet e ëmbëlsirave, pra të dy këto lloje vajrash nuk kanë përdorim familjar. Vaji i sojës dhe vaji i misrit përdoren për gatim dhe kanë vlera të larta ushqyese, por për shkak të çmimit më të lartë, nuk përfshihet në tregun përkatës (megjithëse janë lloje të vajit vegjetal). Nga ana e ofertës produktet janë të zëvendësueshme, sepse ndërmarrjet importuese janë të lira të zgjedhin llojin e vajit që duan të importojnë.
10. Tregu përkatës i produktit përfshin:
 - ***Tregun e importit të vajit vegjetal***
 - ***Tregun e prodhimit të vajit vegjetal***
 - ***Tregun e shitjes me shumicë të vajit vegjetal***

Në tregun e importit dhe të shitjes me shumicë të vajit vegjetal operojnë shumë ndërmarrje, ndërsa në tregun e prodhimit operojnë vetëm dy ndërmarrje.

¹ Nr. 604, datë 17.11.2000 “Për Etiketimin e Produkteve Ushqimore”

11. Tregu përkatës gjeografik është territori i Republikës së Shqipërisë sepse ndërmarrjet tregtojnë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë

III.2 Struktura e ndërmarrjeve në treg²

12. *Në tregun e importit të vajit vegjetal* operojnë një numër i madh ndërmarrjesh, ku ndërmarrja me pjesë më të madhe ka pësuar rënie nga 38% në 32.5%; pas saj vijnë dy ndërmarrje me pjesë të konsiderueshme në treg; rreth 6 ndërmarrje të tjera që kanë një pjesë tregu më të madhe se 1%, dhe shumë ndërmarrje të tjera të vogla që kanë një pjesë tregu nën 1%. Në këtë treg ka hyrje-dalje të ndërmarrjeve dhe rritje të pjesës së tregut të ndërmarrjeve të vogla. Nga analiza e të dhënave të DPD mbi importet e vajit vegjetal rezulton se: ekziston një numër i madh vendesh nga të cilat importohet vaji vegjetal, gjë që tregon edhe për shumëllojshmërinë e markave të produktit në treg; dhe se nuk kanë rezultuar blerje të përbashkëta të ndërmarrjeve për ndarjen e kostove.

Tabela1. Pjesët e tregut sipas ndërmarrjeve importuese të vajit vegjetal 2008-2010.

Ndërmarrja	Viti 2008	Viti 2009	Viti 2010
	Pjesa e tregut	Pjesa e tregut	Pjesa e tregut
ERBIRON	37.92%	32.45%	32.41%
DANINA			15.51%
CRYSTAL	25.17%	24.70%	14.09%
BOMIRA	14.54%	25.52%	13.87%
E & B	0.39%	2.08%	4.80%
ERIONI-H / ELLEDII	0.36%		4.04%
FERRA & CO	4.98%	0.35%	3.34%
DESINA BALLKAN-SHPK	1.05%	3.05%	2.95%
F.M.SH.			1.21%
"BARDULLA"	0.75%	0.29%	0.98%
KRIKET	1.77%	3.36%	0.47%
GUSTO 2008 SHPK	1.03%	1.91%	0.42%
OLIM	6.79%	0.49%	0.10%
Të tjera*	5.24%	5.81%	5.80%
TOTALI	100.00%	100.00%	100.00%

* Tek të tjera përfshihen ndërmarrjet me pjesë tregu < 1%, përkatësisht 70 ndërmarrje për vitin 2008, 49 për vitin 2009 dhe 42 për vitin 2010.

Burimi: DPD dhe përpunimet e grupit të punës

13. Treguesit e përqendrimit kanë rënë nga viti në vit duke kaluar në një treg mesatarisht të përqendruar në vitin 2010 (HHI=1746.62), si rezultat i rënies së pjesës së tregut të ndërmarrjeve kryesore. Edhe treguesit CR3 dhe CR4 paraqesin rënie gjatë vitit 2010. Nuk ka barriera ligjore dhe ekonomike për të hyrë në këtë treg. Liria e hyrjes dhe daljes së ndërmarrjeve në tregun e importit të vajit vegjetal si dhe ndryshimet në pjesët e tregut në vite, tregojnë që në këtë treg ka konkurrencë.

² Llogaritjet e pjesëve të tregut janë bërë mbi volumin në litër të importit, prodhimit dhe shitjes me shumicë të vajit vegjetal.

14. **Ne tregun e prodhimit të vajit vegjetal** operojnë vetëm dy ndërmarrje, Olim dhe Vajra Bimore. Këto ndërmarrje importojnë vajin e papërpunuar, e përpunojnë dhe e hedhin në tregun e shitjes me shumicë. Treguesit e përqendrimit janë shume të lartë për vetë faktin se janë vetëm 2 ndërmarrje prodhuese. Ndërmarrjet gjatë viteve 2008-2009 kanë ruajtur pjesët e tregut (Olim 52% dhe Vajra Bimore 48%), ndërsa gjatë vitit 2010 ndërmarrja Olim ka rritur pjesën e tregut me 5%. Nga analiza e të dhënave të DPD ka rezultuar se ndërmarrjet nuk kanë bërë blerje të përbashkëta për produktin e ndërmjetëm.

Tabela 2. Pjesët e tregut sipas ndërmarrjeve prodhuese të vajit vegjetal 2008-2010.

Ndërmarrja	Viti 2008	Viti 2009	Viti 2010
	Pjesa e tregut	Pjesa e tregut	Pjesa e tregut
Olim	52%	52%	57%
Vajra Bimore	48%	48%	43%
Total	100%	100%	100%

Burimi: Të dhënat e sjella nga ndërmarrjet dhe përpunimet e grupit të punës.

15. **Tregu i shitjes me shumicë** përbëhet nga ndërmarrjet që importojnë dhe ato që prodhojnë vaj vegjetal. Shkalla e përqendrimit në këtë treg ka rënë duke kaluar në nivelet e një tregu mesatarisht të përqendruar në 1657. Gjithashtu edhe treguesit CR3, CR4 dhe CR5 kanë pësuar rënie krahasuar me vitin 2008. Shkalla e moderuar përqendrimit, tregon që tregu është i hapur për konkurrencë. Në tregun e shitjes me shumicë, nuk ka ndarje të mëdha të tregut që janë mbajtur për një kohë të gjatë, por pjesët e tregut kanë ndryshuar nga viti në vit.

Tabela 3. Pjesët e tregut sipas ndërmarrjeve të shitjes me shumicë të vajit vegjetal 2008-2010.

Nr.	Ndërmarrja	Viti 2008	Viti 2009	Viti 2010
		Pjesa e tregut	Pjesa e tregut	Pjesa e tregut
1	Olim	17.3%	23.3%	24.8%
2	Vajra Bimore	20.6%	13.9%	19.1%
3	Erbiron	26.8%	20.5%	17.7%
4	Crystal	16.6%	14.9%	13.6%
5	Bomira	12.0%	15.8%	12.5%
6	E&B	0.1%	1.4%	2.8%
7	ERIONI-H & ELLEDII	0.2%	0.0%	2.1%
8	DESINA BALLKAN-SHPK	0.7%	1.8%	1.6%
9	Ferra&Co	0.0%	1.6%	1.1%
10	F.M.SH.	0.0%	0.0%	0.6%
11	"BARDULLA"	0.5%	0.2%	0.5%
12	KRIKET	1.2%	2.0%	0.2%
13	GUSTO 2008	0.7%	1.1%	0.2%
14	Te tjera	3.4%	3.5%	3.1%
	Totali	100.0%	100.0%	100.0%

Burimi: Të dhënat e sjella nga ndërmarrjet dhe DPD si dhe përpunimet e grupit të punës

16. Në tregun e shitjes me shumicë ndërmarrjet dalin në treg me një shumëllojshmëri markash si: Ndërmarrja Olim me markën “Olim”; Ndërmarrja Vajra Bimore me markën “Fiol”; Ndërmarrja Erbiron me markën “Floriol”; Ndërmarrja Crystal me markën “Crystal”; Ndërmarrja Bomira me markën “Bomira”; Ndërmarrja E&B me markën “Elite”; Ndërmarrja Elledii me markën “Iskon”; Ndërmarrja Ferra&Co me markën “Bimal” etj. Ekzistenca e shumëllojshmërisë së markave bën që të ketë mundësi më të mëdha zgjedhjeje për konsumatorët.

III.3 Kufizimet e mundshme të konkurrencës

17. Analiza e kufizimit të mundshëm të konkurrencës në tregjet përkatëse është mbështetur në dy shtyllat kryesore që përcakton Ligji Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, marrëveshjet potenciale të ndaluara dhe abuzimin e mundshëm me pozitën dominuese.

III.3.1 Abuzimi i mundshëm me pozitën dominuese

Pjesët e tregut

18. Sipas strukturës së tregut të importit dhe shitjes me shumicë, nuk ka ndarje të mëdha të tregut, të cilat janë mbajtur për një kohë të gjatë, por pjesët e tregut kanë qenë dinamike. Ndërmarrjet importuese të vajit vegjetal shërbejnë si fuqi kundërvepruese, ndaj ndërmarrjeve prodhuese në rast të forcimit të fuqisë së tyre në treg. Bazuar në këtë kriter në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të vajit vegjetal asnjë ndërmarrje nuk zotëron pozitë dominuese në tregun përkatës.

Pengesat e hyrjes në treg

19. Për ushtrimin e veprimtarisë së importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të vajit vegjetal nuk ka barriera ligjore. Megjithëse në tregun e prodhimit të vajit vegjetal ka barriera ekonomike, në tregun e importit hyrja është e lirë, gjë që bën të mundur parandalimin e ushtrimit të fuqisë së tregut nga ndërmarrjet prodhuese. Në këto kushte sipas këtij kriteri nuk gjendemi përpara një pozite dominuese të ndonjë ndërmarrje në treg.

Konkurrenca potenciale

20. Duke qenë se hyrja është e lire firma të reja kanë hyrë dhe mund të hyjnë në treg të cilat kanë rritur sasinë totale të furnizimit, rritje kjo që mund të çojë në uljen e çmimit. Kërcënimi i konkurrencës potenciale është i lartë për firmat ekzistuese kur barrierat hyrëse janë të ulta.

Rrjeti i shpërndarjes

21. Ndërmarrjet e importit, prodhimit dhe shitjes me shumicë të vajit vegjetal kanë një rrjet filialesh në shume qytete të vendit, ato gjithashtu kanë makinat e tyre të cilët konkurrojnë midis tyre në të gjithë zonën gjeografike.
22. Duke vlerësuar pjesët e tregut, pengesat e hyrjes në treg, rrjetin e shpërndarjes dhe konkurrencën potenciale, asnjë nga ndërmarrjet nuk përmbush kriteret e nenit 8, duke mos zotëruar pozitë dominuese në tregun e shitjes me shumicë. Në këto kushte nuk jemi para rastit të një abuzimi të mundshëm me pozitën dominuese.


III.3.2 Mundësi bashkëndimi të sjelljes

23. Nga analiza e sjelljes së ndërmarrjeve në tregun e importit dhe shitjes me shumicë, rezulton një shkallë e moderuar përqendrimi. Shkalla e ulët e përqendrimit tregon se ndërmarrjet nuk kanë fuqi tregu për të shkaktuar efekte negative. Megjithatë tregu nuk ka fuqi për të shkaktuar kufizime Autoriteti i Konkurrencës ka analizuar nëse kjo fuqi tregu vjen si rezultat i koordinimit të sjelljeve të ndërmarrjeve në tregun e importit dhe shitjes me shumicë.

Sjellja në lidhje me çmimin

24. Nga krahasimi i çmimeve mesatare mujore për të gjitha ndërmarrjet rezulton se nuk ka çmime të fiksuara, nuk ka skema të vendosjes së çmimeve nga njëra ndërmarrje tek tjetra, si dhe nga krahasimi i çmimeve mesatare nga muaji pasardhës me muajin paraardhës nuk vihen re të njëjtat indekse të ndryshimit të çmimeve midis ndërmarrjeve. Pra ndërmarrjet veprojnë të pavarura në vendosjen e çmimeve.
25. Nga krahasimi i ritmeve të ndryshimit të çmimeve mesatare të shitjes me shumicë ndaj çmimeve mesatare të doganës për ndërmarrjet importuese të vajit nuk vihen re të njëjtat indekse të ndryshimit të çmimit në të njëjtën kohë dhe në të njëjtën masë për të gjitha ndërmarrjet, pra nuk ka vendosje indirekte të çmimeve të shitjes me shumicë.
26. Çmimet e shitjes me shumicë kanë reflektuar ndryshimet e çmimeve në tregun e importit dhe tregjet ndërkombëtare, sipas grafikut të mëposhtëm³

Grafiku 1. Trendi i ndryshimit të çmimit ndërkombëtar, doganës, shitjes me shumicë dhe shitjes me pakicë për periudhën 2008-2010



³ Burimi: *International commodity prices* <http://www.fao.org/es/esc/prices/PricesServlet.jsp?lang=en> te dhëna të sjella nga doganat, ndërmarrjet, Instat përpunuar nga Grupi i punës

27. Sipas grafikut rezulton se, çmimet e shitjes me shumicë dhe pakicë janë rezultat i rritjes së çmimeve në tregun e importit dhe tregjet ndërkombëtare. Rritja e çmimit në muajin Dhjetor 2010 në krahasim me muajin Qershor 2010 (kur filloi rritja) ka qene: çmimi i doganës është rritur 35.3%; Çmimi i shumicës⁴ është rritur 36.6%, çmimi i shitjes me pakicë 29.7% dhe çmimi në tregun ndërkombëtar 52.6%.
28. Arsyet e rritjes të çmimeve botërore janë: rritja e popullsisë botërore, të ardhura në rritje në ekonomitë në zhvillim, uljet e ofertës si rezultat i përdorimit të farërave të luledielli si bime energjetike në prodhimin e vajrave biofuel dhe biodiesel, anomalitë e motit (thatësira dhe përmbytje), dominimi nga një numër i vogël i vendeve dhe i përqendrimit në pak ndërmarrje brenda këtyre vendeve, rritja e prodhimit në lloje të tjera vajrash si përgjigje ndaj problemeve shëndetësore në vendet e zhvilluara⁵, kufizimet e vendosura nga disa vende kryesore eksportuese, si p.sh Ukraina⁶, rritja e kostos së prodhimit si rezultat i rritjes së çmimeve të energjisë, naftës etj.

Ndarja e tregjeve dhe burimeve të furnizimit

29. Nga analiza në vite e ndërmarrjeve rezulton se ndërmarrjet të cilat operojnë në tregun e importit të vajit vegjetal dhe vajit të papërpunuar nuk bëjnë blerje të përbashkëta, pjesët e tregut janë dinamike ka hyrje të reja dhe nuk ka kuota ndarje tregu ndërmjet konkurrentëve, gjithashtu nga inspektimi dhe nga kontrolli i librave të shitjes nuk rezultuan që ka ndarje furnizimesh për klientë të veçantë. Ndërmarrjet importuese dhe prodhuese kanë rritur nga viti në vit sasinë e vajit vegjetal të ofruar në treg (importi dhe prodhimi), pra në treg nuk ka mungesë oferte.
30. Gjatë inspektimeve të kryera si dhe nga analiza e konkurrencës për sjelljet e ndërmarrjeve në treg nuk u siguruan evidenca direkte dhe indirekte të bashkëpunimit, si fiksime direkt dhe indirekt të çmimeve të shitjes, kufizime apo kontroll i ofertës, ndarje të tregjeve dhe burimeve të furnizimit.

Nisur nga sjelljet e ndërmarrjeve në treg si vendosja e çmimeve, kufizimi i ofertës, ndarja e tregjeve dhe burimeve të furnizimit, asnjë nga ndërmarrjet nuk përmbush kriteret e nenit 4, duke mos evidentuar një marrëveshje e ndaluar apo një praktikë e bashkërenduar midis ndërmarrjeve në tregun përkatës.

31. Bazuar sa më sipër nga hetimi paraprak në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të vajit vegjetal, rezulton se nuk janë gjetur shenja të kufizimit, shtrembërimit apo pengimit të konkurrencës në këto tregje.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të nenit 24, shkronja d) të Ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

⁴ Në këto çmime ka ndikuar dhe ndryshimi i akcizës (akcize ambalazhi 1 mijë dol/ton; vete 3-4 leke për shishe)

⁵ http://ec.europa.eu/agriculture/analysis/tradepol/eworldmarkets/outlook/2010_2019_en.pdf

⁶ Në dhjetor 2010 është marrë vendim nga Ministri i Bujqësisë së Ukrainës si vendi kryesor importues i vajit të papërpunuar për të kufizuar sasinë e eksportit me qëllim rregullimin e tregut vendas. http://www.fao.org/fileadmin/templates/est/COMM_MARKETS_MONITORING/Oilcrops/Images/March_2011/MPPU_Mar11.pdf

VENDOSI:

- I.* Mbyllet e procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të vajit vegjetal”, pasi nuk janë gjetur shenja te kufizimit të konkurrencës, në bazë të nenit 4 dhe 9 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës.
- II.* Ngarkohet Sekretariati për monitorimin e tregut.
- III.* Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të përfshira në këtë vendim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete Gruda

(_____)

Anëtar

Koço Broka

(_____)

Anëtar

Rezana Konomi

(_____)

Anëtar

Lindita Milo (Lati)

K R Y E T A R



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS

VENDIM

Nr. 194, Datë 04.07.2011

“Për mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të sheqerit”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Servete Gruda Anëtar
- Koço Broka Anëtar
- Rezana Konomi Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 27.06.2011, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Shqyrtimin e raportit të hetimit paraprak në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të sheqerit;

Baza ligjore: Ligji Nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, neni 24, shkronja d, dhe neni 26.
Ligji Nr. 8485 datë 11. 11. 1999 “Kodi i procedurave administrative”.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të Raportit “Mbi hetimin paraprak në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të sheqerit” të paraqitur nga Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës, dhe Relacionit përkatës të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës,

VËREN SE:

I. PROCEDURA E NDJEKUR

1. Komisioni i Konkurrencës, me vendimin Nr. 157, datë 28.10.2010, të ndryshuar me vendimet 171 dhe 181, ka vendosur hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të sheqerit”.
2. Për administrimit të të dhënave të nevojshme në lidhje me hetimin, bazuar në nenet 33 dhe 34 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, Autoriteti i Konkurrencës ka administruar të dhënat dhe informacionin e nevojshëm nga

ndërmarrjet ne tregjet përkatëse dhe institucionet publike si Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, QKR, INSTAT, MBUMK.

II. PERIUDHA E HETIMIT DHE NDERMARRJET NEN HETIM

3. Referuar Vendimit Nr. 157, datë 28.10.2010 “Për Miratimin e Hapjes së Procedurës së Hetimit Paraprak në Tregun e Importit dhe Tregtimit me Shumicë të Sheqerit”, të ndryshuar, hetimi paraprak përfshin periudhën kohore nga Janari 2008 deri më 31 Dhjetor 2010.
4. Ndërmarrjet kryesore që ushtrojnë veprimtarinë në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të sheqerit janë:
 - a- Ndërmarrja “FERRA & CO” SHPK, person juridik shqiptar, me NIPT J61805508, me seli në Adresën: Lagjja 14, Rruga Tirana, përballë ish Plastikes, Shkozet, Durrës;
 - b- Ndërmarrja “SUCRALBA” SHPK, person juridik shqiptar, me NIPT J91328501A, me seli në Adresën: Lagjja 17, Rruga “Dalip Peza”, nr.12, Durrës;
 - c- Ndërmarrja “TEUTA DURRËS” SHPK, person juridik shqiptar, me NIPT J61821505J, me seli në Adresën: Lagjja 15, Rruga “A. Goga”, Durrës;
 - d- Ndërmarrja “MIKUKA” SHPK, person juridik shqiptar, me NIPT K78020705I, me seli në Adresën: Kastarat, Hot, Shkodër;
 - e- Ndërmarrja “ERIONI-H” SHPK, person juridik shqiptar, me NIPT K56523001E, me seli në Adresën: Rruga “A. Kelmendi”, nr.78, Shkodër;
 - f- Ndërmarrja “AMULI” SHPK, person juridik shqiptar, me NIPT K58507706K, me seli në Adresën: Koplik, Shkodër;
 - g- Ndërmarrja “SIDI” SHPK, person juridik shqiptar, me NIPT K27730710Q, me seli në Adresën: Koplik, Shkodër;
 - h- Ndërmarrja “MALËSORI” SHPK, person juridik shqiptar, me NIPT K88128702F, me seli në Adresën: Kastrat, Hot, Hani i Hotit, Shkodër
 - i- Ndërmarrja “EUROMAX” SHPK, person juridik shqiptar, me NIPT K51325801A, me seli në Adresën: QTU, Autostrada Tiranë-Durrës, KM 7, Kashar, Tiranë

III. VLERËSIMI I KONKURRENCËS NË TREG

III.1 Përcaktimi i Tregut Përkatës

5. Në zbatim të Udhëzimit për përcaktimin e tregut përkatës, është përcaktuar tregu përkatës i këtij hetimi në dy dimensionet e tij, përkatësisht:
 - 1) Tregun e produktit;
 - 2) Tregun gjeografik

III.1.1 Tregu përkatës i produktit

- a- Për shkak të kostos së përpunimit (ambalazhimit) të sheqerit për secilën nga kategoritë, në rastin e shitjes me shumicë përballemi me tre nëntregje: Sheqeri me thasë, sheqeri me paketim 1 kilogram;
 - b- Sheqeri me bustinë.
6. Në import tregu i sheqerit përbehet vetëm nga importi me thasë.

III.1.2 Tregu Gjeografik

7. Tregu gjeografik përfshin Republikën e Shqipërisë pasi ndërmarrjet nën hetim e kryejnë aktivitetin në këtë territor.

II. ANALIZA E TREGUT

VI.1 Fuqia e Tregut

8. Nga përpunimi i të dhënave të siguruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe për periudhën Janar 2008- Dhjetor 2010, rezulton se gjatë kësaj periudhe kemi dy ndërmarrje të cilat dominojnë tregun e importit të sheqerit. Nga Tabela Nr.1, më poshtë, konstatohet se ndërmarrja “Ferra & Co” SHPK ka rritur pjesën e tregut nga viti 2008 në 2009 dhe për vitin 2010. Ndërsa ndërmarrja tjetër që zë një pjesë të konsiderueshme në këtë treg, “Sucralba” SHPK, rezulton të ketë një humbje në pjesët e tregut të importit të sheqerit në vite duke e reflektuar këtë rënie nga viti 2008 në vitin 2010. Përsa i përket ndërmarrjeve të tjera (6 ndërmarrje), të cilat kanë një pjesë secila më të ulët se 5% dhe në total pjesa që zënë ato nga viti 2008 në vitin 2010 vjen në rritje nga 6.87% në 16.46%.

Tab.1	2008	2009	2010
	Pjesa e tregut 2008	Pjesa e tregut 2009	Pjesa e tregut 2010
FERRA&CO	41,93%	54,27%	58,03%
SUCRALBA	51,19%	33,20%	25,51%
Te tjera	6,87%	12,53%	16,46%
Totali	100,00%	100,00%	100,00%

Burimi: DPD, Shkresa 248/1, Datë 15.09.2010 Shkresa 71/1. Datë 08.02.2011

9. Rritja e pjesës së tregut për ndërmarrjet e vogla tregon se në këtë treg konkurrenca është në rritje ndërsa marrja¹ e një pjese të tregut të ndërmarrjes SUCRALBA SHPK nga ndërmarrja FERRA&CO SHPK, tregon se mungojnë shenjat e bashkëpunimit midis tyre.
10. Indeksi i Përqendrimit (HHI) në këtë treg ka ardhur duke rënë (nga 4076 në 3986). Megjithatë tregu mbetet ende shume i përqendruar. Ndërmarrjet më të vogla kanë rritur pjesën e tyre të importit në vite.

I. Barrierat Ligjore

11. Në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë nuk ka barriera ligjore, pra nuk ka ndonjë kufizim apo barrierë administrative të parashikuar nga legjislacioni shqiptar për hyrjen në treg të operatorëve të rinj që të veprojnë në tregun e sheqerit për tregtimin me pakicë apo me shumicë.

II. Barrierat Ekonomike

12. Nga analiza e treguesve financiare, këto dy ndërmarrje kanë një xhiro vjetore të konsiderueshme dhe një rrjet shpërndarje në të gjithë vendin. Të dy këto ndërmarrjet kanë pësuar rritje në shifrën e shitjeve neto gjatë viteve 2008-2009, ndërsa në vitin 2010 ndërmarrja Sucralba rezulton me një rënie të shifrës së shitjeve neto krahasuar me vitin 2009. Kjo fuqi ekonomiko - financiare e ndërmarrjeve ekzistuese në treg,

¹ Gjatë vitit 2009-2010 ndërmarrja Ferra&CO ka marrë një pjesë të tregut të ndërmarrjes Sucralba Shpk, ndërsa kanë rritur pjesën edhe ndërmarrjet e tjera të vogla në treg.

përben një barrierë për ndërmarrjet e reja edhe për vetë faktin se deri në vitin 2009 tregtia me kontenierë nuk ka qenë e mundur për t'u realizuar dhe për operatorët e vegjël në treg kërkohej angazhim i kapitaleve të mëdha financiare për të realizuar importe nga vendet e Amerikës Latine apo Azisë.

III. Rrjeti i shpërndarjes

13. Dy ndërmarrjet kryesore, FERRA & CO SHPK dhe SUCRALBA SHPK, kanë një rrjet shpërndarje në të gjithë vendin me filiale dhe njëkohësisht realizojnë shpërndarje edhe me anë të makinave.
14. Për sa i përket ndërmarrjeve të vogla importuese ato operojnë vetëm në zonat gjeografike në të cilat ndodhet edhe selia e tyre, duke mos patur një rrjet të mirëfilltë shpërndarje si edhe kryesisht në mungesë të kapaciteteve përpunuese të sheqerit.

IV. Homogjeniteti

15. Produkti sheqer është homogjen dhe mundësia për një diversifikim të cilësive dhe përdorimi i markës mbetet relativisht i vështirë për të nxitur një konkurrencë në këtë drejtim. Në këto kushte rritet qëndrueshmëria e firmave të mëdha në treg për sa i përket kërkesës e cila në vite duket se ka një stabilitet relativ.

V. Konkurrenca potenciale

16. Konkurrenca potenciale në tregun e importit dhe tregtimit të sheqerit është në rritje dhe një fakt i tillë konstatohet edhe nga pjesa në rritje e importeve të këtij produkti nga ana e ndërmarrjeve të vogla. Rritja e konkurrencës potenciale ka ardhur edhe për shkak të mundësive të reja që ofron importi në rrugë detare me kontenierë duke ulur në këtë mënyrë kostot e transportit.

VI. Fuqia kundërvepruese e blerësve

17. Blerësit më kryesorë të dy kompanive "SUCRALBA" SHPK dhe "FERRA&CO" SHPK janë njësitë e vogla të shitjes në të gjithë vendin, të cilët kanë një fuqi të ulët kundërvepruese, duke patur parasysh faktin se këto dy ndërmarrje kanë një rrjet të ndërtuar mirë dhe ofrojnë edhe produkte të tjera veç atij sheqer.

VII. Ndarja e tregjeve dhe burimeve të furnizimit

18. Nga analiza në vite e pjesëve të tregut të ndërmarrjeve rezulton se nuk ka blerje të përbashkëta, pjesët e tregut janë dinamike, konkurrentët e vegjël kanë rritur pjesët e tyre dhe nuk ka kuota në ndarje tregu ndërmjet konkurrentëve, gjithashtu nga inspektimi dhe nga kontrolli i librave të shitjes nuk rezultuan që ka ndarje furnizimesh për klientë të veçantë.
19. Gjatë inspektimeve të kryera si dhe nga analiza e konkurrencës për sjelljet e ndërmarrjeve në treg nuk u gjetën evidenca direkte dhe indirekte të bashkëpunimit, si fiksimit direkt dhe indirekt të çmimeve të shitjes, kufizime apo kontroll i ofertës, ndarje të tregjeve dhe burimeve të furnizimit.
20. Nëse i referohemi çmimeve² dhe sasive që këto ndërmarrje tregtojnë gjatë kësaj periudhe, konstatohet se ato operojnë të pavarura nga klientët dhe konsumatorët e tyre si edhe nga njëra-tjetra.
21. Referuar analizës së mësipërme, duke patur parasysh, pjesët e tregut për vitet 2008, 2009, 2010, barrierat ligjore, fuqinë ekonomiko-financiare, rrjetin e shpërndarjes,


² Shiko Graf Nr 3 dhe Nr 4.

ekonomitë e shkallës, homogjenitetin e produktit, fuqinë kundërvepruese të blerësve dhe bazuar në pikën 5, të nenit 3 dhe nenin 8 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, konkludojmë se: ndërmarrja “FERRA&CO” SHPK dhe ndërmarrja “SUCRALBA” SHPK zotërojnë pozitë dominuese kolektive në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të produktit sheqer për periudhën hetimore, pasi zotërojnë fuqi ekonomike, e cila ju jep mundësinë të jenë të pavarura kundrejt veprimeve të pjesëmarrësve të tjerë në treg, si konkurrentët, klientët dhe konsumatorët.

III. ANALIZA E KONKURRENCËS

- Ndërmarrja “FERRA&CO” SHPK

22. Në grafikun e mëposhtëm jepen çmimet e tregtimit të sheqerit nga ndërmarrja “FERRA&CO” SHPK, gjatë periudhës Janar 2008- Dhjetor 2010. Grafiku paraqet diferencat midis çmimit të sheqerit të zhdoganuar³ në doganë, plus detyrime doganore⁴, me çmimet e sheqerit që ndërmarrja shet sipas tre gupeve, sheqer me thasë, sheqer i paketuar dhe sheqer me bustinë.



BURIMI: Shkresat Nr. 443/3 datë 07.12.2010,

23. Nga grafiku shohim se ka një korelacion midis trendit të çmimeve të importit të sheqerit në bursa. Në këtë grafik ku reflektohen çmimet e zhdoganimit të sheqerit për periudhën hetimore, në të cilën përfshihen taksat doganore, por është e përjashtuar TVSH-ja, konstatohet se, kryesisht kemi një reflektim të këtyre çmimeve ndërkombëtare në çmimet që ndërmarrja “FERRA&CO” SHPK vendos në treg.

- Ndërmarrja “SUCRALBA” SHPK


24. Në grafikun e mëposhtëm jepen çmimet CIF⁵ me detyrime doganore të ndërmarrjes “SUCRALBA” SHPK dhe çmimet e tregtimit të kësaj ndërmarrje për tre produktet e saj,

³ Grafiku paraqet çmimet e faturave doganore që firma ka deklaruar përpara rreferencave që përdoren nga ana e doganave.

⁴ Në produktin sheqer taksa doganore është 10% e çmimit të referencës dhe prej muajit Korrik 2010 paguhet edhe akcizë për ambalazhin plastik.

⁵ Në grafik paraqitet çmimi I faturës doganore që firma deklaroi përpara referencave që përdoren nga ana e Autoritetit Doganor.

përkatësisht: sheqer me thasë, sheqer i paketuar 1 Kg dhe sheqer me bustinë. Nga grafiku i mësipërm konstatohet se nuk ka një lidhje të vazhdueshme midis çmimit të importit dhe atij të shitjes së produkteve nga ana e ndërmarrjes “SUCRALBA” SHP. Kjo ndërmarrje rezulton që të ketë disa periudha mujore që nuk importon dhe nga ana tjetër shitja në treg është e vazhdueshme.




Burimi: Shkresat Nr. 471/1 datë 09.12.2010, Nr.30/2 datë 10/02/2011

V.2 Krahasimi i çmimeve të tregtimit të sheqerit për ndërmarrjen Ferra&Co SHPK dhe Sucralba SHPK

V.2.1 Krahasimi i çmimit të tregtimit të Sheqerit me Thasë

25. Në Grafikun e mëposhtëm, pasqyrohen çmimet mesatare mujore të shitjes me shumicë të produktit sheqer me thasë për ndërmarrjet “SUCRALBA” SHPK dhe “FERRA&CO” SHPK për periudhën Janar 2008 – Dhjetor 2010.




Burimi shkresat Nr 443/3 datë 07/12/2010, Nr 471/1 datë 09/12/2010, Nr.30/2 datë 10/02/2011

26. Nga grafiku, gjithashtu rezulton se deri në fund të vitit 2008, çmimi për produktin sheqer me thasë i ndërmarrjes “SUCRALBA” SHPK është në shumicën e periudhës më i lartë se ai i ndërmarrjes “FERRA&CO” SHPK, ndërsa për periudhën tjetër që paraqitet në grafik çmimet e ndërmarrjes “FERRA&CO” SHPK janë më të larta se ato të ndërmarrjes “SUCRALBA” SHPK.

V.2.2 Krahasimi i çmimit të tregtimit të Sheqerit me Paketim 1 Kg


27. Në grafikun e mëposhtëm shihen çmimet e shitjes me shumicë të Sheqerit të Paketuar 1 Kg, për ndërmarrjet “SUCRALBA” SHPK dhe “FERRA&CO” SHPK. Paraqitja grafike e të dhënave jep një pamje ku çmimet midis dy kompanive kanë diferenca të ndryshme gjatë periudhës hetimore. Nga ana tjetër duket qartë se çmimet midis dy kompanive nuk ndjekin të njëjtin trend në periudha mujore, duke treguar se politika e vendosjes së çmimeve është e pavarur.



Burimi: Shkresa Nr 443/3 datë 07/12/2010, Shkresa Nr 471/1 datë 09/12/2010, Nr.30/2 datë 10/02/2011.

V.2.3 Krahasimi i çmimit të tregtimit të Sheqerit me Bustinë

28. Nga grafiku i mëposhtëm konstatohet se ka një diferencë të vazhdueshme të çmimeve midis ndërmarrjes “FERRA&CO” SHPK dhe ndërmarrjes “SUCRALBA” SHPK për gjatë gjithë periudhës hetimore. Në çmimin e sheqerit me bustinë thuajse për gjithë periudhën hetimore çmimet mesatare mujore të shitjes së sheqerit me bustinë nga ana e ndërmarrjes “SUCRALBA” SHPK janë më të ulëta se ato të ndërmarrjes “FERRA&CO” SHPK, por trendet e tyre edhe me këtë diferencë janë të ndryshme.



Burimi: Shkresat Nr 443/3 datë 07/12/2010, Shkresa Nr 471/1 datë 09/12/2010, Nr.30/2 datë 10/02/2011.

V.3 ANALIZA E KOSTOS


- **Analiza e Kostos për produktin sheqer të ndërmarrjes “FERRA & CO” SHPK**
29. Nga analiza e kostos⁶ për ndërmarrjen “FERRA&CO” SHPK, për vitet 2008, 2009, 2010, shohim se normat e fitimit bruto në vite janë përkatësisht, 7.21%, 4.24% dhe – 4.85%. Për dy vitet 2008-2009 ndërmarrja “FERRA&CO” SHPK ka një norma fitimi pozitiv ndërsa për vitin 2010 norma e fitimit për produktin sheqer para taksave është negative. Normat e fitimit të ndërmarrjes “FERRA&CO” SHPK për vitet 2008-2009 për produktin sheqer janë brenda normalitetit nëse krahasohen me produktet e tjera që këto ndërmarrje shesin për të cilat nuk kanë pozitë dominuese, duke mos dhënë indicio për norma të larta fitimi që janë dukuri zakonisht të ndërmarrjeve me pozitë dominuese. Ndërsa për vitin 2010, norma negative e fitimit para taksave ka ardhur kryesisht për shkak të një sasive të madhe sheqeri të blerë në fundin e vitit 2010 me një çmim të lartë, i cili ndikon edhe në rezultatin përfundimtar të analizës së kostos vjetore për këtë produkt.
- **Analiza e Kostos për produktin sheqer të ndërmarrjes “SUCRALBA” SHPK**
30. Nga analiza e kostos për ndërmarrjen “SUCRALBA” SHPK, për vitin 2008 ka një normë fitimi pozitiv prej 9.8% para taksave, ndërsa për vitet 2009⁷-2010 analiza e kostos së realizuar nxjerr një normë fitimi negative. Nga këto të dhëna të nxjerra nga analiza del se për këtë periudhë ndërmarrja “SUCRALBA” SHPK rezulton me norma fitimi brenda normalitetit, ndërsa normat negative të fitimit veçanërisht për vitin 2010 vijnë kryesisht për shkak të rritjes së shpejtë që ka patur çmimi i sheqerit në bursat ndërkombëtare dhe një ndjekje me një kohë vonesë në tregun e brendshëm. Kjo vonesë në kohë bën që edhe çmimet e blerjes së produktit sheqer bashkë me kostot të jenë më të larta se çmimi i shitjes në bazë vjetore.

V.4 KRAHASIMI I ÇMIMEVE TË TREGTIMIT TË SHEQERIT ME BURSËN

31. Nga Grafikon e mëposhtëm, paraqiten çmimi i Bursës dhe çmimi i tregtimit të sheqerit të paketuar 1kg i aplikuar nga ndërmarrjet “FERRA&CO” SHPK dhe “SUCRALBA” SHPK. Nga Grafiku konkludohet se ndërmarrja “FERRA&CO” SHPK ruan një korrelacion më të fortë midis çmimeve të aplikuara në bursë dhe çmimit të sheqerit të paketuar që ajo tregon në vend, nëse e krahasojmë me ndërmarrjen tjetër “SUCRALBA” SHPK. Kjo e fundit ka një ndjekje në një korrelacion më të ulët me çmimet ndërkombëtare të sheqerit

⁶ Nga rivlesimi tatimor i kryer nga ana e Organeve tatimore për ndërmarrjen Ferra&CO në vitet 2008-2009-Janar-Korrik 2010 nuk janë bërë rivlerësime për sa i përket çmimeve të shitjes së sheqerit me të cilat shet kjo ndërmarrje.

⁷ Për muajin Dhjetor të vitit 2009 është realizuar një rivlerësim tatimor nga ana e organeve tatimore për ndërmarrjen Sucralba Sh.p.k pasi sipas akteve të konstatimit nga ana e tatimeve çmimi I aplikuar për produktin sheqer nga ndërmarrja ka qenë 73lek/Kg ndërsa ka deklaruar një çmim prej 58 lek/kg.



Burimi: IndexMundi, Shkresa Nr. 167/1 Prot, datë 13.04.2011, Shkresa Nr 167/2 Prot, datë 21.04.2011, Shkresat Nr. 443/3 datë 07.12.2010, Shkresat Nr. 471/1 datë 09.12.2010, Shkresa Nr.30/2 Prot datë 10/02/2011.

V.5 ANALIZA E ÇMIMEVE TË TREGTIMIT TË SHEQERIT ME PAKICË

32. Për të realizuar edhe një analizë çmimesh që reflekton zhvillimet edhe në tregun e rrjedhës së poshtme, pra atë të pakicës, janë marrë në analizë disa nga rrjetet e mëdha të supermarketeve në vend, të cilët kanë si furnitorë kryesorë dy ndërmarrjet me pozitë dominuese, “SUCRALBA” SHPK dhe “FERRA&CO” SHPK.

V.5.1 EUROMAX

33. Referuar të dhënave të paraqitura nga ndërmarrja Euromax SHPK, për çmimet e aplikuara nga ana kësaj ndërmarrje në blerjen e sheqerit, nga ndërmarrjet “SUCRALBA” SHPK dhe “FERRA&CO” SHPK, konstatojmë se këto 2 (dy) ndërmarrje konkurrojnë në çmimet e shitjes së sheqerit të paketuar në rrjetin e marketeve Euromax dhe nuk paraqesin një sjellje të bashkërenduar referuar çmimeve të blerjeve dhe të shitjeve që aplikon ndërmarrja Euromax.


V.5.2 MERCATOR

34. Referuar të dhënave të paraqitura nga ndërmarrja MERCATOR SHPK, për çmimet e aplikuara nga ana kësaj ndërmarrje në blerjen e sheqerit, nga ndërmarrjet “SUCRALBA” SHPK dhe “FERRA&CO” SHPK, konstatojmë se këto 2 (dy) ndërmarrje, me përjashtim të disa muajve gjatë të cilëve kanë aplikuar çmime të njëjta ndaj kësaj ndërmarrje, konkurrojnë në çmimet e shitjes së sheqerit të paketuar në rrjetin e marketeve MERCATOR dhe nuk paraqesin një sjellje të bashkërenduar referuar çmimeve të blerjeve dhe të shitjeve që aplikon ndërmarrja MERCATOR.

V.5.3 INSTAT

35. Në grafikun e mëposhtëm, shohim se kemi një ndjekje të fortë midis çmimeve të shitjes së ndërmarrjes “FERRA&CO” SHPK dhe çmimeve të shitjes me pakicë të dhëna nga ana e INSTAT për produktin sheqer. Grafiku i shitjes me pakicë të çmimeve të sheqerit të INSTAT reflekton edhe trendin e çmimeve CIF. Edhe nga

ana e ndërmarrjes “SUCRALBA” SHPK, çmimi i shitjes së sheqerit të paketuar reflekton lëvizjet në tregun ndërkombëtar, por korrelacioni mbetet më i ulët.



Burimi: Shkresa Nr 344/2 date 16/09/2010, S.A.S, Nr 443/3 datë 07/12/2010, Nr 471/1 datë 09/12/2010, Nr.30/2 datë 10/02/2011, Shkresa Nr 161/2 Prot, datë 18.4.2011

V.6 ANALIZA E SJELLJES SË NDËRMARRJEVE ME POZITË DOMINUESE TË PËRBASHKËT

36. Analiza e konkurrencës është mbështetur në parashikimet e nenit 9 të Ligjit “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”. Një nga format e abuzimit me pozitën dominuese janë çmimet e padrejta⁸. Për këtë janë analizuar kostot e produktit sheqer për kilogramë për dy ndërmarrjet kryesore. Diferenca e kostos për njësi/kg të sheqerit për ndërmarrjen “FERRA&CO” SHPK për vitet 2008,2009,2010 tregon për norma të fitimit bruto përkatësisht, 7.21%, 4.24% dhe – 4.85%. Ndërsa për ndërmarrjen “SUCRALBA” SHPK, në vitin 2008 ka një normë fitimi pozitiv prej 9.8% para taksave, ndërsa për vitet 2009⁹-2010 analiza e kostos së realizuar nxjerr një normë fitimi negative e cila mund të shihet edhe në Graf Nr 5. Gjithashtu janë krahasuar edhe çmimet e këtyre ndërmarrjeve me çmimet e ndërmarrjeve të tjera. Kështu psh, në rastin e çmimeve të sheqerit të vendosura nga ndërmarrja Teuta e cila për vitet 2009-2010, i ka përkatësisht pjesët e tregut 1.17% dhe 2.25%, çmimet e sheqerit të deklaruara nga Euromax kjo ndërmarrje i ka më të larta se FERRA&CO dhe SUCRALBA për vitet 2008 dhe 2009, ndërsa për vitin 2010, çmimi mesatar vjetor i sheqerit që Euromax ka deklaruar për ndërmarrjen Teuta është më i lartë se ai i ndërmarrjes SUCRALBA SHPK dhe më i ulët se ai i ndërmarrjes FERRA&CO SHPK.

⁸ Në çështjen United Brands, Komisioni Evropian është shprehur se një çmim është abuziv nëse (1) diferenca midis çmimit dhe kostos marxhinale është e tepruar, (2) çmimi është i padrejtë nëse krahasohet me çmimet e tjera dhe rezulton diferenca të ndjeshme.

⁹ Për muajin Dhjetor të vitit 2009 është realizuar një rivlerësim tatimor nga ana e organeve tatimore për ndërmarrjen Sucralba Sh.p.k pasi sipas akteve të konstatimit nga ana e tatimeve çmimi i aplikuar për produktin sheqer nga ndërmarrja ka qe në 73lek/Kg ndërsa ka deklaruar një çmim prej 58 lek/kg.

37. Referuar analizës së mësipërme, arrijmë në përfundimin se ndërmarrjet me pozitë dominuese kolektive në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të produktit sheqer, FERRA&CO SHPK dhe SUCRALBA SHPK nuk aplikojnë çmime ekseseve apo të padrejta, në kuptim të nenit 9, pika 1 dhe 2 të Ligjit 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, për klientët dhe konsumatorët përfundimtar.
38. Referuar evidencave të mbledhura gjatë procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të sheqerit, si dhe sjelljes së ndërmarrjeve të cilat ushtrojnë veprimtari në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të sheqerit, lidhur me vendosjen e çmimeve, kufizimit të ofertës, ndarja e tregjeve dhe burimeve të furnizimit, arrijmë në përfundimin se midis ndërmarrjeve që ushtrojnë veprimtari në këtë treg, gjatë periudhës hetimore, nuk janë gjetur evidenca të marrëveshjeve të ndaluar apo praktikave të bashkërenduar, e cila mund të kufizojë, shtrembërojë apo pengojë konkurrencën sipas nenit 4 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.
39. Gjithashtu, referuar evidencave të mbledhura gjatë procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të sheqerit, si dhe analizës së sjelljes gjatë periudhës hetimore të 2 (dy) ndërmarrjeve me pozitë dominuese kolektive në këtë treg, përkatësisht: “FERRA&CO” SHPK dhe “SUCRALBA” SHPK, lidhur me ecurinë e çmimeve të tregtimit nga këto 2 (dy) ndërmarrje, krahasimi i çmimeve të tregtimit të sheqerit dhe analizës së kostos, arrijmë në përfundimin se nuk ka elementë që të bëjnë të dyshosh që këto 2 (dy) ndërmarrje kanë shkelur ligjin Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të nenit 24, shkronja d) të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Mbyllet e procedurës së Hetimit Paraprak në Tregun e Importit dhe Tregtimit me Shumicë të Sheqerit, pasi nuk ka shenja të kufizimit të konkurrencës, në bazë të nenit 4 dhe 9 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”.
2. Ngarkohet Sekretariati të vazhdojë monitorimin e tregut në zbatim të nenit 28, germa a, e Ligjit ‘Për Mbrojtjen e Konkurrencës”.
3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të përfshira në këtë hetim;

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete Gruda
()
Anëtar

Koço Broka
()
Anëtar

Rezana Konomi
()
Anëtar

Lindita Milo (Lati)

K R Y E T A R



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS**

VENDIM

Nr. 195, Datë 22.07.2011

“Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të 55.9 % të të drejtave të votës dhe 53.71 % të kapitalit themeltar nga shoqëria Volkswagen Aktiengesellschaft tek shoqëria MAN SE”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Servete Gruda Anëtar
- Koço Broka Anëtar
- Rezana Konomi Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 22.07.2011, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të 55.9% të të drejtave të votës dhe 53.71 % të kapitalit themeltar nga shoqëria Volkswagen Aktiengesellschaft tek shoqëria MAN SE;

Baza ligjore: Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, neni 24, shkronja d, neni 2, nenet 10-12, dhe 16, në veçanti Kreu III “Përqendrimet e ndërmarrjeve” nenet 53-64, Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit dhe mundësinë për njoftim të thjeshtuar” dhe Formulari “Për njoftimin e përqendrimit”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të raportit mbi njoftimin e përqendrimit Volkswagen Aktiengesellschaft /MAN SE, dhe relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm,

VËREN SE:

1. Transaksioni dhe përqendrimi

Transaksioni është realizuar nëpërmjet “Ofertës së detyrueshme të Volkswagen për aksionerët e MAN me qëllimin për të fituar të gjitha aksionet e zakonshme të mbajtësit pa vlerë nominale që mbartin të drejta vote dhe aksionet me përparësi të mbajtësit pa vlerë

nominale dhe pa të drejta vote” e publikuar më datë 31 Maj 2011 dhe e vlefshme deri më 29 Qershor 2011.

Pas përfundimit të periudhës së pranimit të ofertës më 29 Qershor, shoqëria MAN ka pranuar ofertën dhe si rezultat shoqëria Volkswagen do të fitojë 55.9 % të të drejtave të votës dhe 53.71 % të kapitalit themeltar në shoqërinë MAN duke përfutur kështu kontrollin në këtë të fundit.

Pas plotësimit të informacionit të plotë, më date 14 Korrik 2011, Autoriteti i Konkurrencës ka konfirmuar palës njoftuese plotësinë e njoftimit po më datë 14 Korrik 2011.

Transaksioni i realizuar ndërmjet palëve pjesëmarrëse në kuptim të nenit 10/1/b të Ligjit, është ndryshim kontrolli në formën ndryshimit të pronësisë. Gjithashtu përqendrimi njoftuar përmbush edhe kushtet e nenit 12 të Ligjit përse i përket xhirove (neni 12/1) dhe është njoftuar brenda afatit të parashikuar (neni 12/2).

2. Palët në transaksion

- **Volkswagen Aktiengesellschaft** në cilësinë e **blerësit**, është një shoqëri me ofertë publike, e themeluar dhe që funksionon sipas legjislacionit gjerman, me seli në adresën: 38440 Wolfsburg, Berliner Ring 2, Gjermani. Shoqëria është aktive në mbarë botën në aktivitetin e zhvillimit, prodhimit, shitjes dhe shpërndarjes së makinave, mjeteve të lehta tregtare, kamionëve, autobusëve, mjeteve të udhëtarëve, shasive të autobusëve, secili duke përfshirë edhe pjesët e këmbimit dhe aksesoret, si dhe motorëve të naftës.

Në Shqipëri, Volkswagen është aktiv nëpërmjet shoqërisë së kontrolluar Porsche Albania Sh.p.k

- **MAN SE**, në cilësinë e **shitësit** është një shoqëri me ofertë publike e themeluar dhe që funksionon në bazë të legjislacionit gjerman me seli në adresën: Ungererstrasse 69, 80805 Munich, Gjermani. MAN është aktive në tregun e prodhimit të mjeteve tregtarë, motorë dhe pajisje inxhinierike mekanike, kamionë furnizimi, autobusë, motorë naftë si dhe makineri turbo

3. Përshkrimi i transaksionit

Transaksioni realizohet nëpërmjet aktit të “Ofertës së detyrueshme të Volkswagen për aksionerët e MAN me qëllimin për të fituar të gjitha aksionet e zakonshme të mbajtësit pa vlerë nominale që mbartin të drejta vote dhe aksionet me përparësi të mbajtësit pa vlerë nominale dhe pa të drejta vote” e publikuar më datë 31 Maj 2011 dhe e vlefshme deri më 29 Qershor 2011, në përputhje me “Aktin Gjerman për Fitimin dhe marrjen nën Kontroll të Titujve”.

Pas përfundimit të periudhës së pranimit të ofertës më 29 Qershor, shoqëria MAN ka pranuar ofertën dhe si rezultat Volkswagen do të fitojë 55.9 % të të drejtave të votës dhe 53.71 % të kapitalit themeltar në MAN SE.

Ky transaksioni i cili sjell ndryshime në cilësinë e kontrollit mbi një bazë të vazhdueshme afat gjatë, në kuptim të nenit 10/1/b dhe 10/2 të Ligjit, është përqendrim.

4. Xhiro për vitin 2010

Xhiro totale e palëve pjesëmarrëse në përqendrim në tregun ndërkombëtar për vitin 2010 është afërsisht XXXX miliard Lek:

- Xhiro e Grupit Volkswagen– XXX milion EUR = XXX miliard Lek.

- Xhiro e MAN – XXX milion EUR = XXX miliard Lek.

Referuar seksionit 3.3.2 të formularit të njoftimit të përqendrimit, xhiro e realizuar nga:

- Grupi Volkswagen në Shqipëri për vitin 2010 është XX milion EUR ose XXX miliard Lek, ndërkohë,
- MAN SE ka realizuar shitje me vlerë XXX milion EUR ose rreth XXX milion Lek.

Palët në transaksion plotësojnë kriteret e xhiros së përcaktuar në nenin 12, pika 1 të Ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”, dhe si rrjedhojë ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

5. ANALIZA E KONKURRENCËS

5.1. TREGU PËRKATËS

Referuar nenit 3, pika 7, të Ligjit, përcaktimi “treg përkatës”, përfshin dy komponentë:

- a) tregu i produktit, dhe
- b) tregu gjeografik.

5.1.a Tregu i produktit:

Referuar Udhëzimit të Komisionit të Konkurrencës, Nr.76, datë 07.04.2008 , “Për përcaktimin e tregut përkatës”, si dhe mbështetur në veprimtarinë e palëve:

Në tregun ndërkombëtar, biznesi kryesor i Volkswagen AG është prodhimi i makinave të pasagjerëve dhe mjeteve të lehta tregtare, ndërsa MAN është kryesisht aktiv në zhvillimin, prodhimin dhe shitjen e kamionëve me peshë të rëndë dhe të mesme nga 7.5 – 50 ton, si dhe të autobusëve, shasive dhe pajisjeve inxhinierike mekanike. Aktivitetet e grupit Volkswagen në prodhimin dhe shpërndarjen e kamionëve, autobusave dhe shasive për autobusë aktualisht janë të përqendruara në shoqërinë finale kontrolluese Scania, e cila prodhon në disa fabrika në Europë dhe në Amerikën Latine. Veç aktiviteteteve të mësipërme grupi Volkswagen është prezent dhe në tregun e shërbimeve financiare dhe atë të sigurimeve. Të dy palët pjesëmarrëse në transaksion janë prezent në tregun e mjeteve tregtare në Shqipëri. Ndërsa MAN shet kamionë të tonazhit të rëndë në Shqipëri, aktivitetet e VW në Shqipëri kufizohen në shitjen e mjeteve të lehta tregtare.

5.1.b Tregu përkatës gjeografik:

Ky treg përfshin hapësirën ku tregtohen produktet apo shërbimet e ofruara të përcaktuara në tregun e produktit.

Për analizimin dhe vlerësimin e efekteve që do të shkaktojë ky transaksion në tregun përkatës të produktit, treg përkatës gjeografik është konsideruar Tregu kombëtar.

5.2 Struktura e tregut para dhe pas përqendrimit dhe vlerësimi i konkurrencës

Dy shoqëritë pjesëmarrëse në këtë transaksion operojnë në dy segmente të ndryshëm të tregut të kamionëve duke ofruar produkte të ndryshëm për nga madhësia, forma dhe funksioni. Si rrjedhojë, mund të themi se nuk kemi mbivendosje të veprimtarive

ekonomike të palëve në Shqipëri, dhe as tregje të prekur nga ky transaksion. Realizimi i këtij transaksioni nuk pritet të ketë ndonjë ndikim në tregun e brendshëm, në strukturën e tregut të kamionëve në Shqipëri apo në pozicionin e shoqërive të tjera të cilat ushtrojnë aktivitetin e tyre ekonomik në këtë treg. Tregu ngelet i hapur dhe pa barriera hyrëse për ndërmarrjet e reja dhe për ndërmarrjet ekzistuese të cilat mund të synojnë zgjerimin e aktivitetit ekonomik të tyre.

Përqendrimi i realizuar nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

PËR KËTO ARSYE:

Në bazë të nenit 24, shkronja d, dhe nenit 56 pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”:

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfundimit të 55.9 % të të drejtave të votës dhe 53.71 % të kapitalit themeltar nga shoqëria Volkswagen Aktiengesellschaft tek shoqëria MAN SE.

2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete Gruda

(_____)

Anëtar

Koço Broka

(_____)

Anëtar

Rezana Konomi

(_____)

Anëtar

Lindita Milo (Lati)

K R Y E T A R



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 196, Datë 29.07.2011

“Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun shërbimit të ngarkim-shkarkim të gazit të lëngshëm në Portin “Porto Romano”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Servete Gruda Anëtar
- Koço Broka Anëtar
- Rezana Konomi Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 29.07.2011, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun shërbimit të ngarkim-shkarkim të gazit të lëngshëm në portin “Porto Romano.

Baza ligjore: Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, nenet, 9, 24 dhe neni 44.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm dhe relacionit të Grupit të Punës mbi kufizimet e konkurrencës në tregun e shërbimit të ngarkim-shkarkimit dhe depozitimit të gazit të lëngshëm,

VËREN SE:

Porti “Porto Romano” i është dhënë me koncesion nga Shteti Shqiptar, ndërmarrjes “Romano Port” SHA, me anë të Ligjit nr.9298, datë 28.10.2004, Për ratifikimin e “Marrëveshjes së Koncesionit, të formës “BOT” (ndërtim, shfrytëzim, transferim), për ndërtimin dhe shfrytëzimin e pontilit të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre në zonën bregdetare të Porto-Romanos, Durrës”. Me anë të kësaj marrëveshje, kjo ndërmarrje kishte marrë përsipër që brenda afateve të parashikuara në marrëveshje (31.05.2009) të ndërtonte dhe të shfrytëzonte pontilin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre, si dhe të infrastrukturës së nevojshme portale, në funksion të depozitave bregdetare që do të ndërtohen në zonën bregdetare të Porto Romanos.

Referuar pikës 4 të kësaj Marrëveshje Koncesioni, Koncesionari detyrohet të respektojë të drejtën e barazisë për shoqëritë që do të kryejnë shërbime nëpërmjet këtij objekti, duke respektuar legjislacionin në fuqi në këtë fushë dhe ky koncesion do të jetë e vetmja veprimtari që ka të drejtë të kryejë koncesionari, sipas objektit të kësaj Marrëveshjeje. Sipas këtij neni Koncesionari nuk do të lejojë përdorimin e portit për subjekte të palicencuara për importin e lëndëve djegëse, përveç rasteve kur kjo është një kërkesë eksplicite e OSHA.

Në vendimin nr. 162, datë 14.12.2010 “Për mbylljen e hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjeve “LA PETROLIFERA ITALO ALBANESE” SHA, “ROMANO PORT” SHA dhe “INTER GAZ” SHA” për abuzimin me pozitën dominuese në tregun e shërbimit të ngarkim-shkarkimit dhe depozitimit të gazit të lëngshëm në rrugë detare”, pika 25, “*“Romano Port” sh.a dhe “Inter Gaz” sh.a gjatë periudhës objekt hetimi kanë pozitë dominuese në tregun e shërbimit të ngarkim-shkarkimit dhe të depozitimit të GLN-së në rrugë detare*”.

“Mare Oil” SHA ka paraqitur një ankesë pranë Autoritetit të Konkurrencës me numër protokollit 326 të datës 26.07.2011 me anë të së cilës ka pretenduar se “Romano Port” SHA nuk e lejon të kryejë shkarkimin e anijes me gaz të lëngshëm në Porto Romano, që nga data 22.07.2011, dhe kërkon nga Autoriteti i Konkurrencës që të ndërhyjë në tregun e brendshëm të Gazit të Lëngëzuar të Naftës (GLN), për shkak të praktikave monopoliste që po ndiqeshin në këtë treg nga “Porto Romano” SHA.

Me anë të ankeses, “Mare Oil” SHA pretendon se ka ndërtuar një pikë për depozitimin e Gazit të Lëngshëm të Naftës në zonën bregdetare të Porto Romanos në qytetin bregdetar të Durrësit. Më pas ajo vetë ka nisur procedurat për të futur anijen e parë me gaz të lëngshëm për t’a përpunuar me qëllime tregtimi në tregun e brendshëm.

Ankimuesi pretendon se me anë të agjencisë spedicionere ka kryer pagesat përkatëse, dhe ka mundësuar zhdoganimin, por nuk i ofrohet shërbimi nga Romano Port, Sh.A pasi sipas ankimesit aksioneri kryesor me më shumë se 98 % të aksioneve të porto Romano ka konflikt interesi pasi zotëron 50 % të aksioneve të shoqërisë Intergas (e vetmja që deri më tani ka patur depozita të gazit të lëngshëm LNG në Porto Romano) dhe 100 për qind të aksioneve të shoqëria importuese e gazit të lëngshëm A&V gas. Këto deklarime vërtetohen edhe nga të dhënat e QKR të datës 28 korrik 2011 të dërguara pranë Autoritetit të Konkurrencës me faks nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (METE).

Procedura e ndjekur

Në zbatim të neneve 28, 29 të ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”, Sekretari i Përgjithshëm i Autoritetit të Konkurrencës me Urdhrin Nr. 61 datë 27.07.2011, ka ngritur Grupin e Punës për verifikimin e ankesës së ndërmarrjes “Mare–Oil SHA

Me date 27.07.2011 u dëgjua ankuesi për pretendimet e tija dhe ju kërkua që të plotësonte formularin e ankesës në bazë të nenit 26/2 të rregullores për funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës.

Ndërmarrja së bashku me plotësimin e formularit dorëzoi dhe dokumente të tjera që pretendonte se mbështesnin ankesën e bërë si me poshtë:

1. Shkresa Nr. 54 Prot datë 23.07.2011 e Porto Romano SHA; (Ku ndërmarrja Romano Port e njofton ndërmarrjen Mare Oil për plotësim dokumentacioni);

2. Vendim për leje dhe Shesh Ndërtimi Nr. 7 datë 30.07.2010 për subjektin “Mare Oil” SHA e KRRT së Komunës Katund i Ri;
3. Akt Miratimi Projekt Teknologjik Nr. 38 Prot datë 11.07.2011 e IQT;
4. Procesverbal kolaudimi i datës 20.07.2011;
5. Formulari Nr. 4 i Leje Ndërtimi e KRRT Komuna Katund i Ri e datës 01.11.2010;
6. Akt Teknik Nr. 95 datë 15.06.2011 nga sektori i PMNZSH;
7. Vërtetim Teknik lëshuar nga IQT me Nr. 359 Prot datë 12.07.2011;
8. Vërtetim nga Komuna Katund i Ri e datës 24.07.2011; (Me ane te se cilit vertetohet se ndermarrja Mare Oil ka depozituar dokumentacionin per leje shfrytzimi)
9. Leje akostimi për shkarkim datë 24.07.2011

Ne formularin e ankeses ndermarrja Mare –Oil ankohet per shkelje te nenit 9 te Ligjit “Per Mbrojtjen e Konkurrencës”, duke kerkuar zhblokimin e situates dhe vendosjen e pozitave te barabarta në treg.

Për verifikimin e ankesës ne vend më datë 27.07.2011, Grupi i Punës u paraqit pranë ambienteve të “Romano Port SHA” dhe pati takime me përfaqësuesit e saj për të sqaruar rastin.

Vlerësimi ligjor

Ndërmarrja “Mare Oil” SHA është subjekt tregtar dhe vepron në tregun e Përpunimi, transporti me shumice e pakice i naftës e nënprodukteve te saj. Ajo është regjistruar pranë QKR me Nr. K21922802I NIPTI. Ndërmarrja Mare Oil sh.a ka ndërtuar një depozite për GLN, për të cilën nuk i është dhënë akoma leja e shfrytëzimit vërtetuar kjo sipas shkresës së datës 24.07.2011 të Komunës katund i ri Durrës. Bazuar ne Raportin e monitorimit te importit dhe tregtimit me shumice kjo kompani ka ulur pjesën e tregut nga 17% ne vitin 2008 ne 7.3% ne vitin 2010 dhe 7.5% ne dymujorin e pare 2011.

Ndërmarrja “Romano Port” SHA ka per objekt ndertim, shfrytëzim porti, shkarkim e analiza te lëndëve djegëse, ruajtje objekti, përdorim mjete detare etj. Kjo ndermarrje ka filluar veprimtarinë e saj të ngarkim shkarkimit në prill të 2009. me nr K51625501O. Sipas QKR. Aksioneri kryesor ka 99.84% te aksioneve.

Nga monitorimi i kryer në Porto Romano rezulton se janë ndërtuar 5 depozita për GLN me kapacitet 10 000 m3 në pronësi të ndërmarrjes “INTER GAZ” SHA, njëri prej aksionarëve të së cilës me 50% te aksioneve është njëkohësisht edhe aksionari me 99.84% te aksioneve të ndërmarrjes “Romano Port” sha. Njekohsisht ne tregun e shitjes me shumice dhe pakicë operon ndërmarrja A&V-Gas sh.a me Nipt K92223503O me aksioner 100% te kësaj ndermarrje ku eshte dhe aksioneri kryesor i ndërmarrjes “Romano Port” SHA dhe me 50% te aksioneve te ndërmarrjes Inter Gaz sh.a. Bazuar ne raportin e monitorimit ndërmarrja Av & Gas ka rritur pjesën e tregut nga 0% ne vitin 2008 ne 4% ne vitin 2009 ne 37% ne vitin 2010 dhe 38.5% ne dymujorin e pare 2011.

Porti “Porto Romano” i është dhënë me koncesion nga shteti Shqiptar, ndërmarrjes “Romano Port” SHA, me anë të Ligjit nr.9298, datë 28.10.2004, Për ratifikimin e “Marrëveshjes së Koncesionit, të formës “BOT” (ndërtim, shfrytëzim, transferim), për ndërtimin dhe shfrytëzimin e pontilit të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre në zonën bregdetare të Porto-Romanos, Durrës”. Me anë të kësaj marrëveshjeve, kjo ndërmarrje kishte marrë përsipër që brenda afateve të parashikuara në marrëveshje (31.05.2009) të ndërtonte dhe të shfrytëzonte pontilin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre, si dhe

të infrastrukturës së nevojshme portale, në funksion të depozitave bregdetare që do të ndërtohen në zonën bregdetare të Porto Romanos.

Referuar pikës 4 të kësaj Marrëveshje Koncesioni, Koncesionari detyrohet të respektojë të drejtën e barazisë për shoqëritë që do të kryejnë shërbime nëpërmjet këtij objekti, duke respektuar legjislacionin në fuqi në këtë fushë dhe ky koncesion do të jetë e vetmja veprimtari që ka të drejtë të kryejë koncesionari, sipas objektit të kësaj Marrëveshjeje.

Porti “Porto Romano”, është kategorizuar si “Port i hapur për trafik ndërkombëtar”, me Vendimin e këshillit të Ministrave nr. 306, datë 25.03.2009 dhe që nga ky moment mund të fillonte të ushtronte veprimtarinë e tij, në përputhje dhe me marrëveshjen e Koncesionit.

Me Vendimin Nr. 4 datë 27. 04.2009 të OSHA është miratuar Rregullorja e Funksionimit të Portit të Përpunimit të Lëndëve Djegëse për Shoqërinë Romano Port SHA

- Qëllimi i kësaj rregulloreje është organizimi i të gjithë veprimtarisë juridike administrative tregtare për funksionimin e Portit “ROMANO PORT” si një port i hapur për trafik ndërkombëtar detar. (Neni 1)
- Kjo rregullore zbatohet në Portin e Hidrokarbureve të Romano Port SHA ndaj të gjitha anijeve që transportojnë naftë, gaz dhe nënprodukte të tyre etj.

Pritësi i mallit që sjell produktet e naftës, përpara fillimit të procesit të shkarkimit, duhet të paraqesë dokumentacionin përkatës tek autoritetet e Portit si më poshtë.

- Dokumentacionin e Lëshuar nga Autoritetet Doganore që lejojnë përpunimin e anijes;
- Dokumentacionin e lëshuar nga Laboratori i Kontrollit të Cilësisë për cilësinë e produkteve që do të përpunohen;
- Dokumentacionin nga Autoritetet mjedisore për plotësimin e kërkesave mjedisore;
- Dokumentacionin për pagesën e shërbimit që kryen Porti.

Ndërkohë që nga njoftimi dhe deri në ardhjen e anijes, bëhet rakordimi ndërmjet pritësit të mallit dhe Portit të Hidrokarbureve “Romano Port” për gatishmërinë e instalimeve dhe gjithë infrastrukturës së Portit për Kryerjen e Proceseve të shkarkimit të Produkteve të Naftës. Me mbërritjen e anijes në radë pas përfundimit të veprimeve me autoritetet përkatëse dhe përfundimit të procedurave doganore, Drejtoria e Portit lëshon lejen për akostim.

Pra, referuar dhe akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, Porto Romano SHA ka të drejtë që të kërkojë vetëm dokumentacionet e sipërpërmendura dhe të merret me sigurinë e anijeve dhe jo dokumenta të tjerë për të cilat Porto Romano sh. a. pretendon për të justifikuar refuzimin e saj për të mos lejuar shkarkimin e anijes së “Mare Oil’ sh. a.

Megjithatë, kjo ndërmarrje ka siguruar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm nga insitucionet përkatëse që garantojnë sigurinë teknike të depozitave dhe lidhjes me impjantin e shkarkimit. (Akt Teknik Nr. 95 datë 15.06.2011 nga sektori i PMNZSH; Vërtetim Teknik lëshuar nga IQT me Nr. 359 Prot datë 12.07.2011).

Komisioni i Konkurrencës duke patur parasysh

- informacionin për aktivitetet e ndërmarrjes “Romano Port” sh.a. dhe të pjesëve që kjo shoqëri zë në këtë treg dhe të lidhjeve aksionere në tregun e lidhur dhe në tregun e shitjes me shumicë dhe pakice
- kuadrin ligjor dhe institucional mbi bazën e të cilit janë dhënë lejet dhe miratimet përkatëse për ngritjen dhe përdorimin e depozitave bregdetare për naftën gazin

dhe nënproduktet e tyre,

- marrëveshjen e koncensionit të formës BOT si dhe shtojcat e kësaj marrëveshjeje
- Letrën e Ministrit të METE me nr, prot t. 28-07-2011 me sqarimet dhe referencat ligjore dhe shkresore, përkatëse, për kompetencat.
- moslejimin e shkarkimit në portin “Porto Romano” të anijes me GLN të sjellë nga shoqëria “Mare Oil”,

Si konkluzion, në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga marrëveshja e Koncensionit (miratuar me ligjin nr. 9298, neni 4) për trajtim të barabartë dhe duke ju referuar akteve ligjore dhe nënligjore mbi bazën e të cilave rregullohet marrëdhënia mes pritësit të mallit dhe ndërmarrjes “Porto Romano” sh.A, Komisioni i Konkurrencës shpreh se mund ketë shkelje të nenit 9, të Ligjit 9121 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 42, pika 1, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të miratojë hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e ngarkimit dhe shkarkimit të GNL në tregun gjeografik Porto Romano, Durrës.
2. Periudha e hetimit do të jetë nga 1 janari 2009 deri 29 korrik 2011.
3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për ndjekjen e procedurave hetimore të parashikuara në Ligj dhe aktet nënligjore, si dhe përgatitjen e raportit të hetimit paraprak jo më vonë se data 15.09.2011

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete Gruda

(_____)

Anëtar

Koço Broka

(_____)

Anëtar

Rezana Konomi

(_____)

Anëtar

Lindita Milo (Lati)

K R Y E T A R



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 197, Datë 29.07.2011

“Për marrjen e masave të përkohshme për rivendosjen e konkurrencës në tregun shërbimit të ngarkim-shkarkimit dhe depozitimit të gazit të lëngshëm në portin “Porto Romano”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Servete Gruda Anëtar
- Koço Broka Anëtar
- Rezana Konomi Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 29.07.2011, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Marrja e masave të përkohshme për rivendosjen e konkurrencës në tregun e shërbimit të ngarkim-shkarkimit të gazit të lëngshëm në tregun gjeografik “Porto Romano”.

Baza ligjore: Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, nenet, 9, 24 dhe neni 44.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm dhe relacionit të Grupit të Punës mbi kufizimet e konkurrencës në tregun e shërbimit të ngarkim-shkarkimit dhe depozitimit të gazit të lëngshëm,

VËREN SE:

Porti “Porto Romano” i është dhënë me koncesion nga Shteti Shqiptar ndërmarrjes “Romano Port” SHA, me anë të Ligjit nr.9298, datë 28.10.2004, Për ratifikimin e “Marrëveshjes së Koncesionit, të formës “BOT” (ndërtim, shfrytëzim, transferim), për ndërtimin dhe shfrytëzimin e pontilit të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre në zonën bregdetare të Porto-Romanos, Durrës”. Me anë të kësaj marrëveshje, kjo ndërmarrje kishte marrë përsipër që brenda afateve të parashikuara në marrëveshje (31.05.2009) të ndërtonte dhe të shfrytëzonte pontilin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre, si dhe

të infrastrukturës së nevojshme portale, në funksion të depozitave bregdetare që do të ndërtohen në zonën bregdetare të Porto Romanos.

Referuar pikës 4 të kësaj marrëveshje koncesioni, koncesionari detyrohet të respektojë të drejtën e barazisë për shoqëritë që do të kryejnë shërbime nëpërmjet këtij objekti, duke respektuar legjislacionin në fuqi në këtë fushë dhe ky koncesion do të jetë e vetmja veprimtari që ka të drejtë të kryejë koncesionari, sipas objektit të kësaj marrëveshjeje. Sipas këtij neni koncesionari nuk do të lejojë përdorimin e portit për subjekte të palicencuara për importin e lëndëve djegëse, përveç rasteve kur kjo është një kërkesë eksplicite e OSHA.

Në vendimin nr. 162, datë 14.12.2010 “Për mbylljen e hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjeve “LA PETROLIFERA ITALO ALBANESE” SHA, “ROMANO PORT” SHA dhe “INTER GAZ” SHA” për abuzimin me pozitën dominuese në tregun e shërbimit të ngarkim-shkarkimit dhe depozitimit të gazit të lëngshëm në rrugë detare”, pika 25, “*“Romano Port” SHA dhe “Inter Gaz” SHA gjatë periudhës objekt hetimi kanë pozitë dominuese në tregun e shërbimit të ngarkim-shkarkimit dhe të depozitimit të GLN-së në rrugë detare”*”.

“Mare Oil” SHA ka paraqitur një ankesë pranë Autoritetit të Konkurrencës me numër protokollit 326 të datës 26.07.2011 me anë të së cilës ka pretenduar se “Romano Port” SHA nuk e lejon të kryejë shkarkimin e anijes me gaz të lëngshëm në Porto Romano, që nga data 22.07.2011, dhe kërkon nga Autoriteti i Konkurrencës që të ndërhyjë në tregun e brendshëm të Gazit të Lëngëzuar të Naftës (GLN), për shkak të praktikave monopoliste që po ndiqeshin në këtë treg nga “Porto Romano” SHA.

Me anë të ankeses, “Mare Oil” SHA pretendon se ka ndërtuar një pikë për depozitim të Gazit të Lëngëzuar të Naftës në zonën bregdetare të Porto Romanos në qytetin bregdetar të Durrësit. Më pas ajo vetë ka nisur procedurat për të futur anijen e parë me gaz të lëngshëm për t’u përpunuar me qëllime tregtimi në tregun e brendshëm.

Ankimuesi pretendon se me anë të agjencisë spedicionere ka kryer pagesat përkatëse, dhe ka mundësuar zhdoganimin, por nuk i ofrohet shërbimi nga Romano Port ShA pasi sipas ankimuesit aksioneri kryesor me më shumë se 98 % të aksioneve të Porto Romano ka konflikt interesi pasi zotëron 50 % të aksioneve të shoqërisë Intergas (e vetmja që deri tani ka patur depozita të gazit të lëngshëm GLN në Porto Romano) dhe 100 % të aksioneve të shoqëria importuese e gazit të lëngshëm A&V gas. Këto deklarime vërtetohen edhe nga të dhënat e QKR të datës 28 korrik 2011 të dërguara pranë Autoritetit të Konkurrencës me faks nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës(METE).

Procedura e ndjekur

Në zbatim të neneve 28, 29 të Ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”, Sekretari i Përgjithshëm i Autoritetit të Konkurrencës me Urdhrin Nr. 61 datë 27.07.2011, ka ngritur Grupin e Punës për verifikimin e ankesës së ndërmarrjes “Mare Oil » SHA

Me date 27.07.2011 u dëgjua ankuesi për pretendimet e tij dhe ju kërkua që të plotësonte formularin e ankesës në bazë të nenit 26/2 të Rregullores për funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës.

Ndërmarrja së bashku me plotësimin e formularit dorëzoi dhe dokumente të tjera që pretendonte se mbështesnin ankesën e bërë si me poshtë:

1. Shkresa Nr. 54 Prot datë 23.07.2011 e Porto Romano SHA; (Ku ndermarrja Romano Port e njofton ndermarrjen Mare Oil per plotesim dokumentacioni) ;
2. Vendim për leje dhe shesh ndërtimi Nr. 7 datë 30.07.2010 për subjektin “Mare Oil” SHA e KRRT së Komunës Katund i Ri;
3. Akt miratimi projekt teknologjik Nr. 38 Prot datë 11.07.2011 e IQT;
4. Procesverbal kolaudimi i datës 20.07.2011;
5. Formulari Nr. 4 i leje ndërtimi e KRRT Komuna Katund i Ri e datës 01.11.2010;
6. Akt teknik Nr. 95 datë 15.06.2011 nga sektori i PMNZSH;
7. Vërtetim teknik lëshuar nga IQT me Nr. 359 Prot datë 12.07.2011;
8. Vërtetim nga Komuna Katund i Ri e datës 24.07.2011; (Me ane te te cilit vertetohet se ndermarrja Mare Oil ka depozituar dokumentacionin per leje shfrytëzimi)
9. Leje akostimi për shkarkim datë 24.07.2011

Ne formularin e ankeses ndermarrja Mare Oil ankohet per shkelje te nenit 9 te Ligjit “Per mbrojtjen e konkurrencës”, duke kerkuar zhbllokimin e situates dhe vendosjen e pozitive te barabarta në treg.

Për verifikimin e ankesës ne vend më datë 27.07.2011, Grupi i Punës u paraqit pranë ambienteve të “Romano Port SHA” dhe pati takime me përfaqësuesit e saj për të sqaruar rastin.

Vlerësimi ligjor

Ndërmarrja “Mare Oil” SHA është subjekt tregtar dhe vepron në tregun e përpunimit, transportit me shumice e pakice te naftës e nënprodukteve te saj. Ajo është regjistruar pranë QKR me Nr. K21922802I NIPTI. Ndërmarrja Mare Oil SHA ka ndërtuar një depozite për GLN, për të cilën nuk i është dhënë akoma leja e shfrytëzimit vërtetuar kjo sipas shkresës së datës 24.07.2011 të Komunës Katund i Ri, Durrës. Bazuar ne raportin e monitorimit te importit dhe tregtimit me shumice, kjo kompani ka ulur pjesën e tregut nga 17% ne vitin 2008 ne 7.3% ne vitin 2010 dhe 7.5% ne dymujorin e pare 2011.

Ndërmarrja “Romano Port” SHA ka per objekt ndertim, shfrytëzim porti, shkarkim e analiza te lëndëve djegëse, ruajtje objekti, përdorim mjete detare etj. Kjo ndermarrje ka filluar veprimtarinë e saj të ngarkim shkarkimit në prill të 2009. me nr K51625501O. Sipas QKR. aksioneri kryesor ka 99.84% te aksioneve.

Nga monitorimi i kryer në Porto Romano rezulton se janë ndërtuar 5 depozita për GLN me kapacitet 10 000 m3 në pronësi të ndërmarrjes “INTER GAZ” SHA, njëri prej aksionarëve të së cilës me 50% te aksioneve është njëkohësisht edhe aksionari me 99.84% te aksioneve të ndërmarrjes “Romano Port” SHA. Njekohësisht ne tregun e shitjes me shumice dhe pakicë operon ndërmarrja A&V Gas SHA me Nipt K92223503O me aksioner 100% te kësaj ndermarrje ku eshte dhe aksioneri kryesor i ndërmarrjes “Romano Port” SHA dhe me 50% te aksioneve te ndërmarrjes Inter Gaz SHA. Bazuar ne raportin e monitorimit ndërmarrja A&V Gas ka rritur pjesën e tregut nga 0% ne vitin 2008 ne 4% ne vitin 2009 ne 37% ne vitin 2010 dhe 38.5% ne dymujorin e pare 2011.

Porti “Porto Romano” i është dhënë me koncesion nga Shteti Shqiptar ndërmarrjes “Romano Port” SHA, me anë të Ligjit nr.9298, datë 28.10.2004, Për ratifikimin e “Marrëveshjes së Koncesionit, të formës “BOT” (ndërtim, shfrytëzim, transferim), për ndërtimin dhe shfrytëzimin e pontilit të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre në zonën bregdetare të Porto-Romanos, Durrës”. Me anë të kësaj marrëveshje kjo ndërmarrje kishte marrë përsipër që brenda afateve të parashikuara në marrëveshje (31.05.2009) të ndërtonte dhe të shfrytëzonte pontilin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre, si dhe të infrastrukturës së nevojshme portale, në funksion të depozitave bregdetare që do të ndërtohen në zonën bregdetare të Porto Romanos.

Referuar pikës 4 të kësaj marrëveshje koncesioni, koncesionari detyrohet të respektojë të drejtën e barazisë për shoqëritë që do të kryejnë shërbime nëpërmjet këtij objekti, duke respektuar legjislacionin në fuqi në këtë fushe dhe ky koncesion do të jetë e vetmja veprimtari që ka të drejtë të kryejë koncesionari, sipas objektit të kësaj marrëveshjeje.

Porti “Porto Romano” është kategorizuar si “Port i hapur për trafik ndërkombëtar”, me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 306, datë 25.03.2009 dhe që nga ky moment mund të fillonte të ushtronte veprimtarinë e tij, në përputhje dhe me marrëveshjen e koncesionit.

Me Vendimin Nr. 4 datë 27. 04.2009 të OSHA është miratuar « Rregullorja e funksionimit të portit të përpunimit të lëndëve djegëse » për Shoqërinë Romano Port SHA

- Qëllimi i kësaj rregulloreje është organizimi i të gjithë veprimtarisë juridike administrative tregtare për funksionimin e Portit “ROMANO PORT” si një port i hapur për trafik ndërkombëtar detar. (Neni 1)
- Kjo rregullore zbatohet në portin e hidrokarbureve të Romano Port SHA ndaj të gjitha anijeve që transportojnë naftë, gaz dhe nënprodukte të tyre etj.

Pritësi i mallit që sjell produktet e naftës, përpara fillimit të procesit të shkarkimit, duhet të paraqesë dokumentacionin përkatës tek autoritetet e portit si më poshtë.

- Dokumentacionin e lëshuar nga autoritetet doganore që lejojnë përpunimin e anijes;
- Dokumentacionin e lëshuar nga laboratorit i kontrollit të cilësisë për cilësinë e produkteve që do të përpunohen;
- Dokumentacionin nga autoritetet mjedisore për plotësimin e kërkesave mjedisore;
- Dokumentacionin për pagesën e shërbimit që kryen porti.

Ndërkohë që nga njoftimi dhe deri në ardhjen e anijes, bëhet rakordimi ndërmjet pritësit të mallit dhe portit të hidrokarbureve “Romano Port” për gatishmërinë e instalimeve dhe gjithë infrastrukturës së portit për kryerjen e proceseve të shkarkimit të produkteve të naftës. Me mbërritjen e anijes në radë pas përfundimit të veprimeve me autoritetet përkatëse dhe përfundimit të procedurave doganore, drejtoria e portit lëshon lejen për akostim.

Pra, referuar dhe akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, Porto Romano SHA ka të drejtë që të kërkojë vetëm dokumentacionet e sipërpërmendura dhe të merret me sigurinë e anijeve dhe jo dokumenta të tjerë për të cilat Porto Romano SHA. pretendon për të justifikuar refuzimin e saj për të mos lejuar shkarkimin e anijes së “Mare Oil’ SHA.

Megjithatë, kjo ndërmarrje ka siguruar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm nga insitucionet përkatëse që garantojnë sigurinë teknike të depozitave dhe lidhjes me impiantin

e shkarkimit. (Akt Teknik Nr. 95 datë 15.06.2011 nga sektori i PMNZSH; vërtetim teknik lëshuar nga IQT me Nr. 359 Prot datë 12.07.2011).

Komisioni i Konkurrencës duke patur parasysht

- informacionin për aktivitetet e ndërmarrjes “Romano Port” SHA. dhe të pjesëve që kjo shoqëri zë në këtë treg dhe të lidhjeve aksionere në tregun e lidhur dhe në tregun e shitjes me shumice dhe pakice
- kuadrin ligjor dhe institucional mbi bazën e të cilit janë dhënë lejet dhe miratimet përkatëse për ngritjen dhe përdorimin e depozitave bregdetare për naftën gazin dhe nënproduktet e tyre,
- marrëveshjen e koncensionit të formës BOT si dhe shtojcat e kësaj marrëveshjeje
- Letrën e Ministrit të METE me nr, prot t. 28-07-2011 me sqarimet dhe referencat ligjore dhe shkresore, përkatëse, për kompetencat.
- moslejimin e shkarkimit në portin “Porto Romano” të anijes me GLN të sjellë nga shoqëria “Mare Oil”,

Si konkluzion, në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga marrëveshja e koncensionit (miratuar me ligjin nr. 9298, neni 4) për trajtim të barabartë dhe duke ju referuar akteve ligjore dhe nënligjore mbi bazën e të cilave rregullohet marrëdhënia mes pritësit të mallit dhe ndërmarrjes “Porto Romano” SHA, Komisioni i Konkurrencës shprehet se mund të ndodhemi përballë një situatë urgjence, për shkak të rrezikut të kryerjes së një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm për konkurrencën, duke parë dhe mundësinë e shkeljes së nenit 9, të Ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, germa f, nenin 44 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

Marrjen e masës së përkohshme si vijon :

“Porto Romano” SHA të bëjë të mundur përpunimin e anijes me GLN të sjellë nga ndërmarrja “MARE OIL” SHA në mënyrë të menjehershme dhe jo me vonë se 5 ditë nga njoftimi i këtij vendimi”

1. Masat e përkohshme merren për një periudhë kohore deri në përfundim të hetimeve.
2. Në rast të moszbatimit të vendimit për masa të përkohshme të cituara në pikën 1 të këtij vendimi, ndëshkohet me gjobë deri në 10 % të xhiros vjetore për shkelje të rëndë të konkurrencës në zbatim të nenit 74, pika 1, germa b e ligjit nr. 9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.
3. Në rast të moszbatimit të masave të përkohshme brenda afateve të përcaktuara në këtë vendim, Komisioni i Konkurrencës mund të vendosë gjoba periodike deri në 5 % të xhiros mesatare ditore, deri sa shoqëria “ROMANO PORT” SHA të veprojë në përputhje me vendimin për masat e përkohshme.

4. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Autoritetit të Konkurrencës për njoftimin e vendimit shoqërisë “ROMANO PORT” SHA

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete Gruda

(_____)

Anëtar

Koço Broka

(_____)

Anëtar

Rezana Konomi

(_____)

Anëtar

Lindita Milo (Lati)

K R Y E T A R

Tiranë më 01.08.2011

MENDIMI I PAKICËS

Lidhur me Vendimin e Komisionit të Konkurrencës Nr.197, Datë 29.07.2011 “Për marrjen e masave të përkohshme për rivendosjen e konkurrencës në tregun shërbimit të ngarkim-shkarkimit dhe depozitimit të gazit të lëngshëm në Portin”Porto Romano” kam mbajtur qëndrim kundra... Këtë qëndrimin e mbështes dhe e argumentoj me arsyetimin e mëposhtëm:

Duke vlerësuar shqetësimin e firmës “Mare Oil”e cila ka paraqitur një ankesë me anë të shkresës së saj Nr. 61/1 datë 26.07.2011, protokolluar pranë Autoritetit të Konkurrencës me Nr. 326 të datës 26.07.2011 me anë të së cilës ka pretenduar se “Romano Port” SHA nuk e lejon të kryejë shkarkimin e anijes me gaz të lëngshëm në Porto Roman, që nga data 22.07.2011, dhe kërkon nga Autoriteti i Konkurrencës që të ndërhyjë në tregun e brendshëm të gazit të lëngëzuar të naftës (GLN), për shkak të praktikave monopoliste që ndiqeshin në këtë treg, kam mbështetur dhe kam nxitur ndërhyrjen e shpejtë të Autoritetit për shqyrtimin e kësaj ankese.

Mbështetur në Raportin e Grupit të Punës të ngritur për shqyrtimin e kësaj ankese, informacionin plotësues të prezantuar dhe propozimeve të tij, mbështetur mbi faktet dhe provat e mbledhura në terren dhe të vena në dispozicion, kam qenë dhe jam dakord me propozimin dhe Vendimin e Komisionit të Konkurrencës Nr 196 datë 29/07/2011”Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e shërbimit të ngarkim shkarkimit të gazit të lëngshëm në portin “Porto Romano” . Pra jam plotësisht dakord për shqyrtimin sa më të shpejtë të ankesës së ndërmarrjes “Mare Oil”, duke ndjekur procedurat përkatëse, përfshi informacionin e siguruar nga ndërmarrja “Porto Romano”.

Sipas informacionit të siguruar nga Grupi i Punës, ndërmarrja “Porto Romano” kërkon garanci se ndoshta ndodh ndonjë shpërthim, në kushtet kur ndërmarrja “Mare Oil” nuk ka leje shfrytëzimi të depozitës së saj të gazit. Kjo për arsye se me anë të marrëveshjes koncesionare “Romano Port” SHA përgjigjet për mirëmbajtjen dhe sigurinë teknike të portit.

Mbështetur në shqyrtimi i dokumentacionit të siguruar në dosjen përkatëse, sqarimet e grupit të punës, dyzimin e qëndrimeve brendapërbrenda sekretariatit lidhur me propozimin për marrjen e masave të përkohshme, mungesën e dëgjimit të drejtpërdrejtë nga ana e Komisionit të Konkurrencës, të pretendimeve të ndërmarrjes “Porto Romano” SHA për mos përpunimin e anijes me GLN të ndërmarrjes “Mare Oil” në depozitën e saj nuk krijova bindjen se jemi para një Vendimi të Komisionit të Konkurrencës për të vendosur përpunimin e menjëhershëm të anijes me GLN të sjellë nga ndërmarrja “Mare Oil” në depozitën e saj te re.

Prandaj çmoj që për përmbajtjen e vendimit të jap votën kundër.

KOMISIONI I KONKURRENCËS**Koço BROKA**

(_____)

Anëtar



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 198, Datë 25.08.2011

“Për marrjen e masave të përkohshme për rivendosjen e konkurrencës në tregun shërbimit të ngarkim-shkarkimit dhe depozitimit të gazit të lëngshëm në portin “Porto Romano”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Servete Gruda Anëtar
- Koço Broka Anëtar
- Rezana Konomi Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 25.08.2011, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Marrja e masave të përkohshme për rivendosjen e konkurrencës në tregun e shërbimit të ngarkim-shkarkimit të gazit të lëngshëm në tregun gjeografik “Porto Romano”.

Baza ligjore: Neni 9, neni 24, shkronja d, neni 26 dhe neni 44 pika 1 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:

- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës,

VËREN SE:

Pranë Autoritetit të Konkurrencës, ndërmarrja “Prima Gas Albania” SHA ka paraqitur një ankesë me Nr. PGA–AK0811, datë 12.08.2011, protokolluar pranë Autoritetit të Konkurrencës me Nr. Prot 355, datë 12.08.2011 si dhe ka plotësuar formularin e ankesës i cili është protokolluar pranë Autoritetit të Konkurrencës me Nr. Prot 355/1, datë 12.08.2011.

Me anë të ankesës, “Prima Gas Albania” SHA pretendon se ka përfunduar investimin për ndërtimin e depozitave bregdetare të gazit të lëngshëm me kapacitet 3600 m³ në zonën e

Porto-Romanos, Durrës, për të cilat është pajisur me autorizim nga Ministria e Ekonomisë Tregtisë dhe Energjetikës (METE) me nr . 26, datë 03.05.2010. Për objektin në fjalë, kjo ndërmarrje pretendon se disponon Lejen e sheshit të ndërtimit të miratuar nga K.RR.T e Komunës Katund i Ri me vendim Nr.8 datë 27.08.2010, Lejen e Mjedisit , Aktin Teknik nga Sektori i PMNZSH, Akt Miratimet e Projekteve Teknologjike nga IQT etj.

Shoqëria ka kryer të gjitha testimet dhe kolaudimet përkatëse nga shoqëria “E.C.I.T” Sh.p.k e autorizuar nga IQT si dhe inspektorët e IQT, si për depozitat dhe për tubacionet që lidhin depozitat me tubacionet kryesore të portit të hidrokarbureve “Romano Port”, duke përfutur edhe Vërtetimin Teknik Nr. 358, datë 12.07.2011, lëshuar nga IQT.

Ndërmarrja “Prima Gas Albania” SHA pretendon se për arsye tërësisht abuzive nga ana e ndërmarrjes “Romano Port” SHA e cila është koncesionaria e portit, nuk lejohet shkarkimi i anijes me emrin “LPG/C SEAGAS GOVERNOR”, e ngarkuar me 1500 ton GLN e ardhur pranë portit “Romano Port” në emër të ndërmarrjes “Prima Gas Albania” SHA, pavarësisht se nga kjo e fundit janë realizuar të gjitha procedurat përkatëse të kërkuara nga “Rregullorja Funktionale e Portit” Nr. 4, datë 27.04.2009, si dhe të Ligjit Nr. 9298, dt 28.10.2004.

Ndërmarrja “Prima Gas Albania” SHA ankohet për shkelje të nenit 9 të Ligjit Nr. 9121, dt 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, abuzim me pozitën dominuese nga ana e ndërmarrjes “Romano Port” SHA dhe për të gjitha këto arsye , kërkon marrjen e masave urgjente përpara se të shkaktohen dëme të pa riparueshme në treg dhe ndaj ndërmarrjes “Prima Gas Albania” SHA.

Procedura e ndjekur

Për verifikimin në vend të kësaj ankese më datë 23.08.2011 u realizua një takim në ambientet e ndërmarrjes “Romano Port” SHA me Z. Piro BARE administrator dhe ortak me 99,84 % të aksioneve të kësaj shoqërie. Qëllimi i këtij takimi ishte marrja e shpjegime lidhur me refuzimin e kësaj ndërmarrje për të shkarkuar anijen me GLN të sjellë nga ndërmarrja “Prima Gas Albania” SHA. Gjatë këtij takimi u mbajt dhe Procesverbali përkatës.

Në shpjegimet e dhëna nga Administratori i ndërmarrjes “Romano Port” sha, pretendon se arsyeja kryesore për mos shkarkimin e anijes është mosparaqitja nga ana e ndërmarrjes “Prima Gas Albania” SHA e dokumentacionit të kërkuar me anë të shkresës Nr.EXT Prot., datë 08.08.2011.

Z. Bare deklaron se bazuar në ligjin për koncesionin, ndërmarrja “Romano Port” SHA, ka detyrimin ligjor që të operojë vetëm me shoqëritë e licencuara dhe të kualifikuara për kryerjen e këtij aktiviteti.

Më datë 24.08.2011, u dëgjua ankimuesi, i cili deklaroi se anija me GLN ka mbërritur më datë 12.08.2011 dhe ka marre leje nga dogana dhe Inspektorati Qendror Teknik (IQT) dhe ka kryer pagesën e detyrimeve, por nuk është lejuar të kryejë shkarkimi nga shoqëria “Romano Port” SHA, megjithëse e ka lajmëruar këtë ndërmarrje për mbërritjen e anijës që më datë 08.08.2011 me anë të e-mail. Nga ndërmarrja “Romano Port” Sha i janë kërkuar dokumentacione shtesë. Përfaqësuesi i ndërmarrjes “Prima Gas Albania” SHA na vuri në dispozicion të gjithë letërkëmbimin me ndërmarrjen “Romano Port” SHA, si dhe dokumentacionin përkatës lidhur me depozitat, si vijon:

- 1– Autorizim Nr. 26, datë 03. 05. 2011 lëshuar nga METE;
- 2– Leje mjedisore për aktivitetin e depozitimit, tregtimit të gazit të lëngshëm, për në Adresën: Porto Romano, lëshuar nga QKL;
- 3– Leje Tregtimit Nr. 153, datë 15.11.2006, lëshuar nga METE me afat 10 vjeçar;
- 4– Formular 3/1, Lidhja e Objektivit me Infrastrukturën Inxhinierike, për depozita bregdetare në Porto Romano;
- 5– Akt – Teknik Ne. 120, datë 10.08.2011, lëshuar nga Sektori i PMNZSH;
- 6– Certifikatë Regjistrimi, me adresë dytësore në Porto Romano, Durrës, lëshuar nga QKR-ja;
- 7– Vendim Nr. 8, datë 27.08.2010, i KRRT-së së Komunës Katundi i Ri Durrës;
- 8– Vërtetim Teknik Nr. 358, datë 12.07.2011, Për respektimin e normave teknike në depozitat e tregtimit të GLN-së, lëshuar nga IQT;
- 9– Formulari Nr. 4, lëshuar nga KRRT së Komunës katund i Ri, datë 01.11.2010;
- 10– Leje shfrytëzimi, datë 12.08.2011, lëshuar nga Komuna Katund i Ri, për Objektivin: Depozita bregdetare- Estakada e Jashtme;

Gjithashtu, përfaqësuesi i ndërmarrjes “Prima Gas Albania” SHA, deklaroi se i ka dërguar dhe dy letra të tjera ndërmarrjes “Romano Port” SHA, përkatësisht në data 15.08.2011 dhe më datë 17.08.2011 (me e-mail), ku i është kërkuar zbatimi i vendimit 5537/6Prot., datë 12.08.2011 i OSHA-së, për shkarkimin e anijes së sjellë nga kjo ndërmarrje, por nuk ka marrë asnjë përgjigje nga ndërmarrja “Romano Port” SHA.

Pra, nga data e mbërritjes së anijes pranë portit “Romano Port” SHA më datë 12.08.2011 dhe deri më 24.08.2011 anija nuk është shkarkuar dhe sipas përfaqësuesit të Ankuesit, dëmi ekonomik i shkaktuar është 14 000 USD në ditë dhe dëmi deri tani është rreth 140 000 USD.

Vlerësim ligjor

Ndërmarrja “Prima Gas Albania” SHA, është subjekt tregtar dhe vepron në tregun e përpunimit, transportit me shumice e pakice të naftës e nënprodukteve të saj. Ndërmarrja “Prima Gas Albania” SHA ka ndërtuar një depozitë bregdetare për depozitimin e GLN, në zonën e Porto Romanos, me kapacitet 3 600 m³.

Porti “Porto Romano” i është dhënë me koncesion nga Shteti Shqiptar ndërmarrjes “Romano Port” SHA, me anë të Ligjit nr. 9298, datë 28.10.2004, Për ratifikimin e “Marrëveshjes së Koncesionit, të formës “BOT” (ndërtim, shfrytëzim, transferim), për ndërtimin dhe shfrytëzimin e pontilit të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre në zonën bregdetare të Porto-Romanos, Durrës”. Me anë të kësaj marrëveshje kjo ndërmarrje kishte marrë përsipër që brenda afateve të parashikuara në marrëveshje (31.05.2009) të ndërtonte dhe të shfrytëzonte pontilin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre, si dhe të infrastrukturës së nevojshme portale, në funksion të depozitave bregdetare që do të ndërtohen në zonën bregdetare të Porto Romanos.

Referuar pikës 4 të kësaj marrëveshje koncesioni, koncesionari detyrohet të respektojë të drejtën e barazisë për shoqëritë që do të kryejnë shërbime nëpërmjet këtij objekti, duke respektuar legjislacionin në fuqi në këtë fushë dhe ky koncesion do të jetë e vetmja veprimtari që ka të drejtë të kryejë koncesionari, sipas objektivit të kësaj marrëveshjeje.

Porti “Porto Romano” është kategorizuar si “Port i hapur për trafik ndërkombëtar”, me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 306, datë 25.03.2009 dhe që nga ky moment mund të fillonte të ushtronte veprimtarinë e tij, në përputhje dhe me marrëveshjen e koncesionit.

Me Vendimin Nr. 4 datë 27. 04.2009 të OSHA është miratuar « Rregullorja e funksionimit të portit të përpunimit të lëndëve djegëse » për Shoqërinë “Romano Port” SHA:

- Qëllimi i kësaj rregulloreje është organizimi i të gjithë veprimtarisë juridike administrative tregtare për funksionimin e Portit “ROMANO PORT” si një port i hapur për trafik ndërkombëtar detar (Neni 1);
- Kjo rregullore zbatohet në portin e hidrokarbureve të Romano Port SHA ndaj të gjitha anijeve që transportojnë naftë, gaz dhe nënprodukte të tyre etj.

Pritësi i mallit që sjell produktet e naftës, përpara fillimit të procesit të shkarkimit, duhet të paraqesë dokumentacionin përkatës tek autoritetet e portit si më poshtë:

- Dokumentacionin e lëshuar nga autoritetet doganore që lejojnë përpunimin e anijes;
- Dokumentacionin e lëshuar nga laboratorit i kontrollit të cilësisë për cilësinë e produkteve që do të përpunohen;
- Dokumentacionin nga autoritetet mjedisore për plotësimin e kërkesave mjedisore;
- Dokumentacionin për pagesën e shërbimit që kryen porti.

Ndërkohë që nga njoftimi dhe deri në ardhjen e anijes, bëhet rakordimi ndërmjet pritësit të mallit dhe portit të hidrokarbureve “Romano Port” për gatishmërinë e instalimeve dhe gjithë infrastrukturës së portit për kryerjen e proceseve të shkarkimit të produkteve të naftës. Me mbërritjen e anijes në radë pas përfundimit të veprimeve me autoritetet përkatëse dhe përfundimit të procedurave doganore, drejtoria e portit lëshon lejen për akostim.

Pra, referuar dhe akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, Porto Romano SHA ka të drejtë që të kërkojë vetëm dokumentacionet e sipërpërmendura dhe të merret me sigurinë e anijeve dhe jo dokumenta të tjerë për të cilat Porto Romano SHA pretendon për të justifikuar refuzimin e saj për të mos lejuar shkarkimin e anijes së “Prima Gas Albania” SHA.

Megjithatë, kjo ndërmarrje ka siguruar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm nga institucionet përkatëse që garantojnë sigurinë teknike të depozitave dhe lidhjes me impiantin e shkarkimit. (Akt Teknik Nr. 120 datë 10.08.2011 nga sektori i PMNZSH; vërtetim teknik lëshuar nga IQT me Nr. 358 Prot datë 12.07.2011).

Konkluzione

Duke pasur parasysh se:

- Komisioni i Konkurrencës me Vendimi Nr. 196, datë 29.07.2011, “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun shërbimit të ngarkim-shkarkim të gazit të lëngshëm në Portin “Porto Romano” ka vendosur hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e shërbimit të ngarkim-shkarkim të gazit të lëngshëm në Portin “Porto Romano”;
- Komisioni i Konkurrencës me Vendimin Nr. 197, datë 29.07.2011, “Për marrjen e masave të përkohshme për rivendosjen e konkurrencës në tregun shërbimit të ngarkim-shkarkimit dhe depozitimit të gazit të lëngshëm në portin “Porto Romano”,

- ka marrë masa të përkohshme ndaj ndërmarrjes “Romano Port” SHA;
- OSHA-ja me Vendimin Nr. 5537/6, datë 12.08.2011, ka vendosur ti kërkojë ndërmarrjes “Romano Port” SHA, të bëjë përpunimin e të gjitha anijeve të sjella nga shoqëritë që kanë në pronësi ose në përdorim depozita bregdetare në zonën e Porto Romanos, përfshirë ndërmarrjet që disponojnë depozita për GLN, si dhe të bashkërendojë veprimtarinë e saj me Autoritetin e Konkurrencës dhe institucionet e tjera të shtetit shqiptar, për të garantuar një treg të hapur dhe konkurrues në aktivitetin e transportimit dhe tregtimit të naftës gazit dhe nënprodukteve të tyre.
 - Marrëveshjen e koncesionit të formës BOT, si dhe shtojcat e kësaj marrëveshje;
 - Moslejimin e shkarkimit në Portin “Porto Romano” të anijes të sjellë nga ndërmarrja “Prima Gas Albania” SHA;
 - Refuzimi i ndërmarrjes “Romano Port” SHA për të shkarkuar anijen me GLN të sjellë nga ndërmarrja “Prima Gas Albania” SHA, mund t’i shkaktojë dëm të rëndë ekonomik kësaj të fundit, si dhe mund të përbëjë shkelje të nenit 9 të ligjit “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”.
 - Refuzimin e përsëritur të ndërmarrjes “Romano Port” Sha. për shkarkimin e anijeve të disa shoqërive që veprojnë në sektorin e tregtimit të gazit të lëngshëm.

Komisioni i Konkurrencës konstaton se jemi përpara rrezikut të kryerjes së një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm për konkurrencën, ku ka mundësi të ketë shkelje të nenit 9 të Ligjit “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të nenit 9, nenit 24, germa (d), nenit 26 dhe nenit 44, pika 1 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”,

V E N D O S I:

1. Marrjen e masës së përkohshme si vijon: *“Porto Romano” SHA të bëjë të mundur përpunimin e anijes me GLN të sjellë nga ndërmarrja “Prima Gas Albania” SHA në mënyrë të menjëhershme dhe jo me vonë se 5 (pesë) ditë nga njoftimi i këtij vendimi”.*
2. Te garantojë zbatimin e menjehershëm të detyrimit ligjor që ka shoqëria “Romano Port”SHA për të bere të mundur shkarkimin e anijeve të shoqërive të tjera që veprojnë në sektorin e tregtimit të GLN-se, me qëllim hapjen e tregut dhe sigurimin e konkurrencës së lire.
3. Në rast të moszbatimit të vendimit për masa të përkohshme të cituara në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi, ndeshkohet me gjobe deri në 10% të xhiros vjetore për shkelje të rënde të konkurrencës në zbatim të neneve 74, pika 1, germa (b) e Ligjit nr. 9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.
4. Për moszbatimin e masave të përkohshme brenda afateve të përcaktuara në këtë vendim, Komisioni i Konkurrencës mund të vendosë gjoba periodike për çdo ditë vonese deri në 5 % të xhiros mesatare ditore, në zbatim të nenit 76, pika 1, germa b.

5. Masat e perkohshme merren per nje periudhe kohore deri ne perfundim te hetimeve.
6. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Autoritetit të Konkurrencës për njoftimin e vendimit shoqërisë “ROMANO PORT” SHA

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete Gruda

()

Anëtar

Koço Broka

()

Anëtar

Rezana Konomi

()

Anëtar

Lindita Milo (Lati)

K R Y E T A R

MENDIMI I PAKICËS

Lidhur me Vendimin e Komisionit të Konkurrencës Nr.198, Datë 25.08.2011 “Për marrjen e masave të përkohshme për rivendosjen e konkurrencës në tregun shërbimit të ngarkim-shkarkimit dhe depozitimit të gazit të lëngshëm në Portin”Porto Romano” kam mbajtur qëndrim kundra. Këtë qëndrimin e mbështes dhe e argumentoj me arsyetimin e mëposhtëm:

Mbas ankesës së firmës “Mare Oil” edhe firma “Prima Gaz Albania” SHA ka paraqitur një ankesë me Nr. PGA –AK0811, datë 12.08.2011, protokolluar pranë Autoritetit të Konkurrencës me Nr. Protokolli, datë 12.08.2011 si dhe ka plotësuar formularin e ankesës, i cili është protokolluar pranë Autoritetit të Konkurrencës me Nr . Prt 355/1 datë 12.08.201, me anë të së cilës ka pretenduar se “Romano Port” SHA nuk e lejon të kryejë shkarkimin e anijes me gaz të lëngshëm në depozitën bregdetare të gazit të lëngshëm , të ndërtuar nga ana e saj, duke renditur dhe dokumentacionin i cili është pasqyruar edhe në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës. Duke u njohur me këtë shqetësim që në datën 12.08.2011, ushtrova gjithë ndikimin dhe angazhzhimin tim, për shqyrtimin sa më shpejt të këtij shqetësimi nga ana e Komisionit të Konkurrencës

Mbështetur në Raportin e Grupit të Punës të ngritur për shqyrtimin e kësaj ankese, jam plotësisht dakort, që edhe shqetësimi i kësaj firme, argumentat dhe informacioni i saj, të bëhen pjesë e Vendimit Nr 196 të Komisionit të Konkurrencës “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun shërbimit të ngarkim-shkarkim të gazit të lëngshëm në Portin “Porto Romano” Kjo edhe për faktin se disa muaj pas fillimit të veprimtarisë së portit « Porto Romano » sidomos gjatë vitit 2010, është reduktuar ndjeshëm pjesa që ka pasur kjo firmë në tregun e gazit të lëngshëm gatshëm. Kjo e shqetësime të tjera të bëjnë të dyshosh se në këtë treg ka shkelje të mundshme të konkurrencës në treg. Kryerja e një hetimi, të shpejtë, cilësor, objektiv e të paanshëm, brenda afateve të parashikuara në vendimin përkatës të Komisionit të Konkurrencës, ka pasur dhe ka gjithë mbështetjen aktive time.

Ndërkohë për shqyrtimin objektiv dhe të paanshëm të kësaj ankese, kërkova që brenda ditës së nesërme, para marrjes së vendimit të Komisionit të dëgjohej drejtpërdrejt nga ana e Komisionit edhe ndërmarrja “Romano Port SHA” Por kjo kërkesë nuk u morr në konsideratë.

Duke u njohur me pretendimet e ndërmarrjes “Romano Port” të ndodhura në dosjen hetimore për çështjen e Vendimit Nr 197 të Komisionit të Konkurrencës se “Shoqwrria “Romano Port” kërkon të bëjë të njour se në asnjë rast nuk do të lejojë kryerje të veprimeve në kundërshtim me kërkesat e ligjit e që mund të sjellin pasoja të rënda për aktivitetin e shoqerisë, të operatoreve të tjerë ekonomikë në zonën e Porto Romano dhe Banorëve të kësaj zone”, dhe se Dokumenti Lejë Shfrytëzimi për depozitat e gazit të lëngshëm në Porto Romano-Durrës, i është kërkuar edhe firmave të tjera si “Inter Gaz” SHA që operojnë dhe kanë depozita në Porto Romano

Prandaj çmoj që për përmbajtjen e vendimit të jap votën kundër.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Koço BROKA

(_____)

Anëtar



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS

VENDIM

Nr. 199, Datë 15.09.2011

Mbi

Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet blerjes së 75%+1 aksione të shoqërisë Intersig Sh.a nga shoqëria Vienna Insurance Group AG

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Servete Gruda Anëtar
- Koço Broka Anëtar
- Rezana Konomi Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 15.09.2011, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet blerjes së 75%+1 aksione të shoqërisë Intersig Sh.a nga shoqëria Vienna Insurance Group AG.

Baza ligjore: Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, neni 24, shkronja d, nenet 10-12 dhe neni 59, në veçanti Kreu III “Përqendrimet e Ndërmarrjeve” nenet 53-56, 58, Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i Plotë “Për njoftimin e Përqendrimit”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të raportit mbi njoftimin e përqendrimit Vienna Insurance Group AG – Intersig Sh.a dhe relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm,

VËREN SE:

1. Transaksioni dhe përqendrimi

Transaksioni i shitblerjes së 75%+1 aksion të shoqërisë Intersig Sh.a, nga shoqëria Vienna Insurance Group AG, është realizuar nëpërmjet ‘Kontratë Shitje Aksionesh’ të datës 24 Gusht 2011, e nënshkruar nga palët Vienna Insurance Group AG dhe Intersig Sh.a.

Shoqëria Vienna Insurance Group AG me anë të kësaj Kontrate merr në zotërim 75%+1 të aksioneve me të drejtë vote të shoqërisë Intersig Sh.a dhe përfton kështu kontrollin në këtë të fundit nëpërmjet shit-blerjes së aksioneve.

Transaksioni i realizuar ndërmjet palëve pjesëmarrëse në kuptim të nenit 10/1/b të Ligjit, është ndryshim kontrolli në formën ndryshimit të pronësisë dhe hyrjes së një aksioneri të ri kontrollues. Gjithashtu përqendrimi njoftuar përmbush edhe kushtet e nenit 12 të Ligjit përsa i përket xhirove(neni 12/1) dhe është njoftuar brenda afatit të parashikuar(neni 12/2).

2. Palët në transaksion

Vienna Insurance Group AG, një shoqëri aksionare, e themeluar dhe që ushtron aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin e Republikës së Austrisë, me seli në Vienë, Austri, në cilësinë e **Blerësit** të pjesës prej 75% +1 të kapitalit aksionar të shoqërisë Intersig Sh.a. Në Shqipëri shoqëria është prezent që prej një viti me anë të shoqërisë Sigma Vienna Insurance Group Sh.a, ku ajo zotëron 87% +1 aksion në kapitalit themeltar me të drejtë vote. Aksionet e shoqërisë janë të listuara ne bursën e Vjenës.

- **Intersig Sh.a**, është një shoqëri aksionere pa ofertë publike themeluar dhe që funksionon në përputhje me Ligjin Nr. 9267, datë 29.07.2004 “Mbi aktivitetin e sigurimit, risigurimit dhe brokerimit në Shqipëri”, në cilësinë e **Shitësit**. Shoqëria ushtron veprimtarinë e saj në fushën e sigurimit dhe risigurimit të jo-jetës kryesisht në fushën e sigurimit për automjetet, shëndetin, pronësinë etj., gjithashtu ajo mund të kryejë çdo veprimtari ndihmëse ose të ushtrojë çdo aktivitet tjetër i cili konsiderohet i dobishëm ose i nevojshëm për arritjen e qëllimit të shoqërisë.

3. Përshkrimi i transaksionit

Transaksioni i përqendrimit është realizuar në bazë të “Kontratë Shitje Aksionesh” të datës 24 Gusht 2011, me qëllim transferimin e pjesës prej 75% +1 aksione të kapitalit aksionar të shoqërisë Intersig Sh.a tek shoqëria Vienna Insurance Group AG.

Transaksioni konsiston në përfitim e kontrollit të drejtpërdrejtë nëpërmjet blerjes së 75%+1 të aksioneve me të drejtë vote nga Blerësi tek Shitësi. Blerësi do jetë aksioneri kryesor në shoqërinë Intersig Sh.a duke përfutuar pronësinë e aksioneve të lira nga çdo barrë dhe bashkë me të gjitha të drejtat, titujt dhe interesat që lidhen apo rrjedhin nga aksionet e shitura. Transaksioni do të përfundojë me përmbushjen e kushteve nga palët.

4. Xhiro për vitin 2010

- Xhiro totale në **tregun ndërkombëtar** është **x xxx miliard Lekë**:
 - o **Vienna Insurance Group**: x xxx xxx xxx Euro¹ = x xxx xxx xxx xxx Lekë
- Xhiro totale në **tregun e brendshëm**: është **x xxx xxx xxx Lekë**:
 - o **Interalbanian Sha**: xxx xxx xxx Lekë
 - o **Sigma Sha**: xxx xxx xxx Lekë
 - o **Intersig Sha**: xxx xxx xxx Lekë

¹ Sipas kursit zyrtar të Bankës së Shqipërisë për vitin 2010, 1 euro= 140 lek. Burimi:Raporti Statistikor

Palët në transaksion plotësojnë kriteret e xhiros të përcaktuara në nenin 12, pika 1 të ligjit “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” dhe si rrjedhojë, ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

5. ANALIZA E KONKURRENCËS

5.1. TREGU PËRKATËS

Referuar nenit 3, pika 7, të Ligjit, përcaktimi “treg përkatës”, përfshin dy komponentë:

- a) tregu i produktit, dhe
- b) tregu gjeografik.

5.1.a Tregu i produktit:

Referuar Ligjit të gjitha shërbimet e ofruara apo përftuara nga konsumatorët në tregun përkatës, nga palët në këtë transaksion janë konsideruar produkte (kryeja e sigurimit të dëmeve në përputhje me lejen për ushtrim aktiviteti), sipas përcaktimit të licensave të lëshuara nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (Komisioni i Mbikëqyrjes së Sigurimeve):

- a. Sigurimi i aksidenteve dhe shëndetit;
- b. Sigurimet motorrike
- c. Sigurimi i avionëve, anijeve, marinës dhe transportit
- d. Sigurimi nga zjarri dhe dëmtime të tjera në pronë
- e. Sigurimi i Përgjegjësive
- f. Sigurimi i Kreditit dhe Garancive

5.1.b. Tregu gjeografik:

Ky treg përfshin hapësirën ku tregtohen produktet apo shërbimet e ofruara të përcaktuara në tregun e produktit.

Por, duke qënë se pasojat e veprimtarisë së palëve do të ndihen direkt në tregun e brendshëm, në vlerësimin e këtij përqendrimi, tregu përkatës gjeografik në këtë këndvështrim, (për nga qëllimi), është konsideruar **Tregu kombëtar**.

5.2. Struktura e tregut para përqendrimit.

Vienna Insurance Group është aktualisht prezent në tregun shqiptar pasi zotëron paketa kontrolluese të aksioneve në shoqëritë Sigma sha dhe Interalbani sh.

Tregu i prekur i përqendrimit është tregu shqiptar i sigurimeve të jo jetës ku të dyja shoqëritë pjesëmarrëse në transaksion janë prezent para përqendrimit. Për këtë arsye janë studiuar me kujdes pjesët e kombinuara të tregut dhe shkallës së përqendrimit, pasi përftuesi i kontrollit do të zotërojë kontrollin e tre shoqërive që ofrojnë shërbimin e sigurimit të jo jetës në tregun e brendshëm.

Në tre nëntregjet e prekura pjesët e përbashkëta të tregut për të tre shoqëritë e kontrolluara nga VIG (Sigma , Interalbani, Intersig) janë respektivisht : për sigurimet motorrike 38.55%, për sigurimin e pasurisë 32.95% dhe për sigurimin e shëndetit 35.43%.

5.3. Struktura e tregut pas përqendrimit

Transaksioni i shitblerjes së aksioneve të Intersig sha nga shoqëria Vienna Insurance Group nuk ndryshon strukturën e tregut shqiptar të sigurimeve. Shoqëritë do të vazhdojnë të veprojnë veçmas, edhe pse aksioneri kryesor ka paketën kontrolluese të shoqërive Sigma, Interalbanian si dhe Intersig.

Tregu i sigurimeve është mesatarisht i përqendruar në sigurimet motorike dhe shumë i përqendruar në sigurimet e pasurisë dhe shëndetit.

Indeksi i përqendrimit të tregut (HHI) vazhdon të mbetet shumë i përqendruar për sigurimin e shëndetit dhe sigurimin e pasurisë, si dhe ka një rritje të indeksit të përqendrimit në sigurimet motorike ku tregu mbetet shumë i përqendruar.

Pjesa e kombinuar e tregut në sigurimin e jo jetës pas përqendrimit për shoqëritë e kontrolluara nga VIG (Sigma , Interalbanian, Intersig) është 36.74%

Indeksi i përqendrimit të tregut (HHI) vazhdon të mbetet shumë i përqendruar për sigurimin e shëndetit dhe sigurimin e pasurisë, si dhe ka një rritje të indeksit të përqendrimit në sigurimet motorike ku tregu nga mesatarisht i përqendruar bëhet shumë i përqendruar.

Megjithëse rritet përqendrimi i tregut, asnjëra nga shoqëritë e sigurimit nuk zotëron pozitë dominuese individuale dhe pjesët e përafërta të tregut mes dy grupeve të mëdha të njohura ndërkombëtarisht të sigurimeve pritet të sjellin një dominim të tregut nga dy konkurrentët kryesorë dhe për këtë arsye ky treg do të mbahet nën monitorim nga ana e Autoritetit të Konkurrencës.

6. Vlerësimi i konkurrencës pas përqendrimit

- 6.1 Tregu i sigurimeve është një treg i rregulluar me dinamikë të lartë zhvillimi që karakterizohet nga ndryshime të shpeshta në paketën kontrolluese të ndërmarrjeve prezente, kryesisht nga shoqëri sigurimesh nga vendet evropiane.
- 6.2 Indeksi i përqendrimit të tregut të sigurimeve të jo jetës HHI para përqendrimit është 2075, pra tregu është shumë i përqendruar dhe pas përqendrimit indeksi HHI është 2570, pra tregu mbetet shumë i përqendruar.
- 6.3 Në rastin e përqendrimit VIG-Intersig sh.a pjesët e kombinuara të tregut janë më pak se 40 për qind dhe konkurrenti kryesor në treg edhe pas realizimit të këtij përqendrimi mbetet Sigal sh.a. Sigal Sh.A si konkurrenti kryesor i dy ndërmarrjeve të kontrolluara nga VIG ka më shumë se 40 përqind në dy nëntregje (sigurimi i pasurisë dhe sigurimi i shëndetit) dhe ka pjesë të përafërta tregu me pjesën e kombinuar Sigma-Interalbanian në nëntregun e sigurimit të shëndetit.
- 6.4 Me eksperiencën e saj shumëvjeçare grupi VIG synon të rrisë efikasitetin ekonomik dhe prioritetin e saj është të integrojë shoqërinë e kontrolluar në grup në mënyrë që të implementojë procedurat, standartet dhe know-how të grupit të cilat do të pasqyrohen në mirëqenien e konsumatorëve duke rritur cilësinë e shërbimeve. Mundësitë e biznesit dhe potenciali i zhvillimit të shfrytëzuar në mënyrë të qëndrueshme nga VIG ishin dhe vazhdojnë të jenë të bazuara në rritjen dinamike që ndodh në Evropën Qendrore dhe Lindore. Arsyeja kryesore e kësaj rritje dinamike është nevoja masive për të arritur kushtet e mbulimit të sigurimit dhe ruajtjen e standartit të jetesës në rritje.

- 6.5 Vienna Insurance Group është e prirur të fokusohet në vendet me potencial të rritjes ekonomike dhe vlerëson tregjet e mundshme nëpërmjet blerjes së një shoqërie sigurimi (zakonisht e vogël) për të pasur një njohje të mirë të tregut, barrierat e tij të kryerjes si dhe ndalime të tjera ligjore ose të faktit.
- 6.6 Pas realizimit të përqendrimit VIG-Intersig, kompania lider në treg Sigal e cila kontrollohet nga një tjetër shoqëri ndërkombëtare sigurimesh si Uniqua Group Austria do të sfidohet nga një konkurrent i fortë si Vienna International Group duke krijuar një konkurrencë bipolare në tregun e sigurimit.

Si konkluzion, përqendrimi i realizuar nuk shfaq shenja të kufizimit në mënyrë të ndjeshme të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese për shkak të përqendrimit ndërmjet shoqërive Vienna Insurance Group AG dhe Intersig Sh.a

PËR KËTO ARSYE

Në bazë të nenit 24, shkronja d, dhe nenit 56 pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”:

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet shitblerjes së 75%+1 aksione të shoqërisë Intersig Sh.a, nga shoqëria Vienna Insurance Group AG.
2. Të monitorojë tregun e sigurimeve për sigurimin e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg.
3. Ngarkohet Sekretari i përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete Gruda

(_____)

Anëtar

Koço Broka

(_____)

Anëtar

Rezana Konomi

(_____)

Anëtar

Lindita Milo (Lati)

K R Y E T A R



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS**

VENDIM

Nr. 200, Datë 15.09.2011

Mbi

Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet shit-blerjes së 100% të kuotave të shoqërisë Hagggar Cigarette & Tobacco Factory Ltd., nga shoqëria Japan Tobacco Group

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Servete Gruda Anëtar
- Koço Broka Anëtar
- Rezana Konomi Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 15.09.2011, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet shit-blerjes së 100% të kuotave aksioneve të shoqërisë Hagggar Cigarette & Tobacco Factory Ltd., nga shoqëria Japan Tobacco International Holding B.V.

Baza ligjore: Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, neni 24, shkronja d, neni 2, nenet 10 dhe 12, në veçanti Kreu III “Përqendrimet e Ndërmarrjeve” nenet 53-64, Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit dhe mundësinë për njoftim të thjeshtuar” dhe Formulari i Thjeshtuar “Për njoftimin e Përqendrimit”

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të raportit mbi njoftimin e përqendrimit Japan Tobacco Group / Hagggar Cigarette & Tobacco Factory Ltd, dhe relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm,

VËREN SE:

1. Transaksioni dhe përqendrimi

Transaksioni i shitblerjes së 100 % të kuotave të Hagggar Cigarette & Tobacco Factory Ltd. (Sudani i Veriut) Hagggar Cigarette & Tobacco Factory Ltd. (Sudani i Jugut) nga Japan

Tobacco Group, në bazë të ‘Marrëveshjes për Shitje Aksionesh’ e lidhur më datë 27 Korrik 2011, ndërmjet palëve Hagggar Holding Ltd, z. Mohammed Khalil Osman Mahmud dhe z. Taha Ali Bashir Garalla (të cilët veprojnë sëbashku si shitësit) dhe Loras Holding Bv, JT International Holding B.V (të cilët veprojnë si blerësi) me qëllim përfitim i kontrollit të Hagggar Cigarette & Tobacco Factory Ltd. (Sudani i Veriut) Hagggar Cigarette & Tobacco Factory Ltd. (Sudani i Jugut).

Ky transaksion që ndodh jashtë Shqipërisë, është njoftuar në Autoritetin e Konkurrencës në zbatim të nenit 2 të Ligjit, pasi shoqëria JT Group ka pasur shitje për vitin 2010 në Shqipëri, nëpërmjet shoqërisë distributore të saj Primall Sh.p.k .

Transaksioni i realizuar ndërmjet palëve pjesëmarrëse në kuptim të nenit 10/1/b të Ligjit, është ndryshim kontrolli në formën ndryshimit të pronësisë. Gjithashtu përqendrimi njoftuar përmbush edhe kushtet e nenit 12 të Ligjit përsa i përket xhirove (neni 12/1) dhe është njoftuar brenda afatit të parashikuar (neni 12/2).

2. Palët në transaksion

- Japan Tobacco Group, (JT) në cilësinë e blerësit, me seli në Japoni, kryen aktivitet në fushën e prodhimit dhe shitjes së cigareve të prodhuara nëpërmjet makinerive (MMC). JT Group ka pasur shitje për vitin 2010 në Shqipëri, nëpërmjet shoqërisë distributore të saj Primall Sh.p.k.
- Hagggar Cigarette & Tobacco Factory Ltd., (HTCF) në cilësinë e shitësit, me seli në Republikën e Sudanit, dhe të Sudanit të Jugut. HTCF ushtron veprimtarinë në prodhimin, importimin dhe shitjen e produkteve të duhanit vetëm në Sudan dhe në Sudanin e Jugut.

3. Xhiro për vitin 2010

- Xhiro totale në tregun ndërkombëtar është **XXX miliard Lekë:**

o **Japan Tobacco Group (JT International Holding BV dhe Loras Holding BV):**
XXX miliard Euro¹ = XXX Lekë

o **Hagggar Cigarette & Tobacco Factory Ltd.:**
XXXmiliard Euro = XXXX Lekë

- Xhiro totale në tregun e brendshëm: është **XXX miliard Lekë:**

o **JT (nëpërmjet distributorit Primall shpk) :** XXX milion Euro = XXX Lekë

4. ANALIZA E KONKURRENCËS

4.1. TREGU PËRKATËS

Referuar nenit 3, pika 7, të Ligjit, përcaktimi “treg përkatës”, përfshin dy komponentë:

- a) tregu i produktit, dhe
- b) tregu gjeografik.

¹ Sipas kursit zyrtar të Bankës së Shqipërisë për vitin 2010, 1 euro= 140 lek. Burimi:Raporti Statistikor

4.1.a Tregu i produktit:

Referuar Udhëzimit të Komisionit të Konkurrencës, Nr.76, datë 07.04.2008 , “Për përcaktimin e tregut përkatës”, si dhe mbështetur në veprimtarinë e palëve, tregu përkatës i produktit: tregtimi i cigareve MMC të prodhuara nëpërmjet makinerive dhe të produkteve të tjera të duhanit.

Në Shqipëri: vetëm shoqëria Japan Tobacco Group është e pranishme në tregtimin e produktiteve MMC nëpërmjet distributorit Primall Shpk.

Tregu gjeografik: Territorri i Republikës së Shqipërisë, pra **Tregu i Brendshëm**.

5. Vlerësimi i konkurrencës

Transaksioni nuk ka asnjë efekt në tregun shqiptar. Meqënëse JTI nuk është aktive në Sudan dhe HCTF nuk është aktive në Shqipëri, nuk ka mbivendosje të aktiviteteve të palëve.

Nuk ka ndonjë marrëveshje vertikale midis JTI dhe shoqërive target, ndaj transaksioni nuk do të ketë ndonjë impakt mbi konkurrencën në tregun shqiptar të cigareve MMC.

PËR KËTO ARSYE

Në bazë të nenit 24, shkronja d, dhe nenit 56 pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”:

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin përqendrimit të realizuar nëpërmjet shit-blerjes së 100% të kuotave të shoqërisë Hagggar Cigarette & Tobacco Factory Ltd., nga shoqëria Japan Tobacco Group”
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete Gruda

()

Anëtar

Koço Broka

()

Anëtar

Rezana Konomi

()

Anëtar

Lindita Milo (Lati)

K R Y E T A R



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS

VENDIM

Nr. 201, Datë 20.09.2011

“Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar tregun e shërbimit të ngarkim – shkarkimit të gazit të lëngshëm të naftës në rrugë detare ndaj ndërmarrjes “Romano Port” SHA”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Servete Gruda Anëtar
- Koço Broka Anëtar
- Rezana Konomi Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 20.09.2011, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Shqyrtimi i Raportit të Hetimit Paraprak “Në tregun e shërbimit të ngarkim shkarkimit të gazit të lëngshëm në portin “Porto Romano”

Baza ligjore: Neni 24, shkronja “d”, neni 26 dhe neni 43, pika 1 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si dhe neni 12 i Rregullores “Për funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të: Raportit të Hetimit Paraprak “Në tregun e shërbimit të ngarkim shkarkimit të gazit të lëngshëm në portin “Porto Romano”/Durrës dhe relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm,

VËREN SE:

I. PROCEDURA E NDJEKUR

1. Pranë Autoritetit të Konkurrencës ndërmarrja “Mare Oil” SHA paraqiti një ankesë me Nr. 61/1 Prot datë 26.07.2011, protokolluar pranë Autoritetit të Konkurrencës me Nr. 326 Prot datë 26.07.2011. Me anë të kësaj ankese, kjo ndërmarrje pretendonte se “Romano Port” SHA nuk po lejonte shkarkimin e anijes me GLN, për shkak të plotësimit të dokumentacionit. Për vlerësimin e kësaj ankese, Sekretariati, në zbatim të procedurave hetimore, në datën 27.07.2011, zhvilloi takime me përfaqësuesit e ndërmarrjes “Mare Oil” SHA dhe “Romano Port” SHA.

2. Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 42 të Ligjit Nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, me anë të Vendimit Nr. 196 datë 29.07.2011 ka miratuar hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e ngarkimit dhe shkarkimit të gazit të lëngshëm të naftës (GLN) në tregun gjeografik Porto Romano, Durrës, për të parë nëse ka elementë të kufizimit të konkurrencës.
3. Komisioni i Konkurrencës, duke e vlerësuar se moslejimi i shkarkimit të anijes së subjektit pritës “Mare Oil” SHA nga ana e “Romano Port” SHA mund të përbente një rrezik të kryerjes së një dëmi me pasoja të rënda e të pariparueshme për konkurrencën, me Vendimin Nr. 197 datë 29.07.2011 vendosi, me shumicë votash, të marrë masën e përkohshme. Nëpërmjet këtij vendimi është urdhëruar ndërmarrja “Romano Port” SHA të bëjë të mundur përpunimin e anijes me GLN të sjellë nga ndërmarrja “Mare Oil” SHA në mënyrë të menjëhershme dhe jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga marrja e njoftimit të këtij vendimi.
4. Ndërmarrja “Prima Gas Albania” SHA me anë të shkresës së saj Nr. PGA–AK0811, datë 12.08.2011, protokolluar pranë Autoritetit të Konkurrencës me Nr. Prot 355, datë 12.08.2011, ankohej se nga ana e “Romano Port” SHA, nuk po lejohej përpunimi i anijes së sjellë me GLN nga ana e saj, pasi i kërkonin edhe dokumenta të tjera shtesë.
5. Pas kryerjes së procedurave përkatëse nga Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës, Komisioni i Konkurrencës, pasi u njoh me këtë ankesë, me Vendimin Nr. 198, datë 25.08.2011 vendosi, me shumicë votash, të marrë masën e përkohshme duke urdhëruar ndërmarrjen “Romano Port” SHA të bëjë të mundur përpunimin e anijes me GLN të sjellë nga ndërmarrja “Prima Gas Albania” SHA.
6. Në bazë të Ligjit Nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, Grupi i Punës gjatë periudhës së hetimit paraprak ka kryer inspektime në ndërmarrjet “Romano Port” SHA, “Prima Gas Albania” SHA si dhe ka zhvilluar takime pranë Autoritetit të Konkurrencës me ndërmarrjen “Mare Oil” SHA dhe “Prima Gas Albania” SHA.

II. TREGU PËRKATËS

Tregu përkatës përcaktohet në dy dimensionet:

1. Tregu përkatës i produktit
2. Tregu përkatës gjeografik

II.1 Tregu i Shërbimit

7. Tregu i shërbimit të ngarkim-shkarkimit të gazit të lëngshëm të naftës (GLN) në rrugë detare ofrohet për depozitat e dedikuara në zonën e Porto Romano nga ndërmarrja “Romano Port” SHA.
8. Procesi i ngarkim-shkarkimit në rrugë detare ofrohet në dy porte: Porto Romano, Durrës dhe porti Vlora 1, Vlorë. Ky proces nuk mund të realizohet pa procesin e depozitimit të produktit në depozitat e lidhura me impiantet e ngarkim shkarkimit. Por kushtet dhe konditat në të cilat ofrohet ky shërbim në zonën e Porto Romanos nga ndërmarrja “Romano Port” SHA, janë specifike.

Zëvendësueshmëria nga ana e kërkesës

9. Në zonën gjeografike të Porto Romanos, ndërmarrjet që operojnë në tregun e importit dhe të tregëtimit me shumicë të GLN-së kanë të drejtën të ndërtojnë depoziat në pronësi të tyre. Këto ndërmarrje mund të realizojnë procesin e ngarkim-shkarkimit nëpërmjet shoqërisë “Romano port” SHA, që është i vetmi subjekt që mund ta ofrojë shërbimin e ngarkim- shkarkimit të GLN-së. Kjo e drejtë eskuzive është garantuar nga marrëveshja koncesionare, e përkatësisht Ligjit Nr. 9298 datë 28.10.2004 “Për ratifikimin e marrëveshjes së koncesionit të formës “BOT” (ndërtim, shfrytëzim, transferim) për ndërtimin dhe shfrytëzimin e pontilit të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre në zonën bregdetare të Porto Romano/Durrës” (i ndryshuar).

Zëvendësueshmëria nga ana e ofertës

10. Ndërmarrja “Romano Port” SHA për shkak të eskuzivitetit nuk mund që të ketë konkurrentë në ofrimin e shërbimit. Në kontratën koncesionare ndërmarrjes “Romano Port” SHA i është dhënë eskuziviteti për shërbimin e ngarkim-shkarkimit të naftës dhe nënprodukteve të saj në zonën e Porto Romanos, duke bllokuar në këtë mënyrë hyrjet e reja në tregun përkatës, për aq kohë sa kjo kontratë do të jetë në fuqi.

II.2 Tregu Gjeografik

11. Tregu gjeografik përfshin territorin e Portit “Romano Port” në zonën e Porto Romanos, Durrës.

Tregu përkatës i shërbimit, është tregu i ngarkim-shkarkimit të gazit të lëngshëm në rrugë detare në zonën gjeografike të Porto Romanos, Durrës.

III. Vlerësimi i pozitës dominuese

12. Në bazë të pikës 5 të nenit 3 të Ligjit Nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, pozitë dominuese është ajo fuqi ekonomike e mbajtur nga një ose më shumë ndërmarrje, që i jep atyre mundësinë për të penguar konkurrencën efektive në treg, duke i bërë ato të afta të veprojnë përsa i takon ofertës ose kërkesës, në mënyrë të pavarur nga pjesëmarrësit e tjerë në treg, si konkurrentët, klientët ose konsumatorët.
13. Bazuar në kushtet dhe konditat specifike të ofrimit të shërbimit të ngarkim- shkarkimit të GLN-së në Porto Romano, si dhe referuar pjesëve në tregun përkatës dhe barrierave ligjore dhe ekonomike që ekzistojnë në treg, konkurrencës potenciale, sipas nenit 8 të Ligjit Nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, rezulton se ndërmarrja “Romano Port” SHA ka pozitë dominuese në tregun e shërbimit të ngarkim – shkarkimit të gazit të lëngshëm në rrugë detare, në portin Porto Romano.

IV. SHENJAT E KUFIZIMIT TË KONKURRENCËS

IV.1 Sjelljet e evidentuara gjatë periudhës objekt hetimi

14. Zotërimi i pozitës dominuese të ndërmarrjes “Romano Port” SHA i jep asaj një detyrim të veçantë që të ketë patjetër parasysh rregullat e konkurrencës në treg.

15. Gjatë periudhës objekt hetimi, nga ana e ndërmarrjes “Romano Port” SHA konstatohet kufizimi i tregtimit të produktit të subjektit pritës/pritësit të mallit “Mare Oil” SHA që operon në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të GLN, duke i refuzuar shkarkimin e anijes me GLN të kësaj të fundit gjatë muajit korrik 2011 me pretendimin për paraqitjen e disa dokumentave shtesë.
16. Ndërmarrja “Mare Oil” SHA paraqiti gjatë muajit korrik 2011 një ankesë, me anë të së cilës parashtronte se, ndërmarrja “Romano Port” SHA, për të bërë të mundur depozitimin e GLN të sjellë me anije nga ana e saj (“Mare Oil” sha), duhej të paraqiste disa dokumenta shtesë të cilat ishin:
 - Leje shfrytëzimi për stacionin e depozitimit të gazit të lëngshëm për Shoqërinë “Mare Oil” SHA;
 - Vërtetim teknik për konformitetin e linjave të transportit të lëndëve djegëse dhe depozitave të lëshuara nga IQT;
 - Licencën e ushtrimit të aktivitetit;
 - Akt kolaudimin e stacion depozitimit.
17. Sipas nenit 4 të marrëveshjes koncesionare, “Romano Port” SHA detyrohet të respektojë të drejtën e barazisë për shoqëritë që do të kryejnë shërbime nëpërmjet objektit që i është dhënë me koncesion, duke respektuar legjislacionin në fuqi në ato kushte kur kjo ndërmarrje do të kryejë vetëm këtë lloj veprimtarie sipas objektit të marrëveshjes, që është shkarkimi i naftës dhe nënprodukteve të tyre.
18. Komisioni i Konkurrencës, me Vendimin Nr. 197 datë 29.07.2011, duke parë që sjellja e ndërmarrjes “Romano Port” SHA mund të sillte pasoja të pariparueshme e të rënda për konkurrencën, vendosi ta urdhërojë atë të bëjë të mundur shkarkimin e anijes së sjellë nga “Mare Oil” SHA gjatë muajit korrik 2011.

IV.2 Sjelljet e evidentuara gjatë muajit gusht 2011

19. Autoriteti i Konkurrencës gjatë muajit gusht 2011 konstatoi disa sjellje të dyshuara si antikonkurrese të kryera nga “Romano Port” SHA, në kuptim të nenit 9 të ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës. Më konkretisht:
 - 1) Kufizimit të konkurrencës në treg nëpërmjet refuzimit të shkarkimit e anijeve me GLN të ndërmarrjeve Mare Oil dhe Primagas, me pretendimin për paraqitjen e disa dokumentave shtesë;
 - 2) Vendosja e kushtit për lidhjen e kontratave tip “Sipërmarrje për kryerje shërbimesh” ndaj dy subjekteve që operojnë në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të GLN, “Prima Gas Albania” SHA dhe “Mare Oil” SHA, duke i detyruar ato të pranojnë detyrime shtesë në mënyrë që të bëhet i mundur shkarkimin e anijeve të ardhura në muajin gusht 2011 e më pas nga këto dy subjekte.
20. Si konkluzion, nga vlerësimi i sjelljes së ndërmarrjes “Romano Port” SHA në tregun e ngarkim shkarkimit të GLN-së në rrugë detare, ndaj ndërmarrjeve “Mare Oil” SHA dhe “Prima Gas Albania” SHA, mund të ketë kufizuar konkurrencën nëpërmjet abuzimit me pozitën e saj dominuese në tregun përkatës.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, germa d, dhe nenit 43 pika 1 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si dhe nenit 12 dhe nenin 21 pika 4 të Rregullores “Për funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës”

VENDOSI:

- I. Fillimin e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e shërbimit të ngarkim shkarkimit të gazit të lëngshëm të naftës në rrugë detare ndaj ndërmarrjes “Romano Port” SHA, subjekt tatimpagues me Nr. K51625501O NIPTI, me objekt ekzistencën ose jo të abuzimit të me pozitën dominuese, në tregun përkatës;
- II. Periudha e hetimit do të jetë 1 Janar 2009-15 Shtator 2011.
- III. Afati i përfundimit të kësaj procedure hetimore caktohet data 5 dhjetor 2011.
- IV. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e ndërmarrjes “Romano Port” SHA.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete Gruda

()

Anëtar

Koço Broka

()

Anëtar

Rezana Konomi

()

Anëtar

Lindita Milo (Lati)

K R Y E T A R

MENDIMI I PAKICËS

Lidhur me Vendimin e Komisionit të Konkurrencës Nr.201, datë 20/09/2011”Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar tregun e shërbimit të ngarkim- shkarkimit të gazit të lëngshëm të naftës në rrugë detare ndaj ndërmarrjes Romano Port” SHA” kam mbajtur qëndrim kundra, me arsyetimin e mëposhtëm:

- I- Unë kam qenë plotësisht dakord me vendimin Nr.196, datë 29.07.2011 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e shërbimit të ngarkim shkarkimit të gazit të lëngshëm në Portin “Porto Romano”. Por ndërkohë nuk aprovoj në përgjithësi “Raportin e Hetimit Paraprak në Tregun e Ngarkim Shkarkimit “Romano Port” dhe rekomandim e tij për të kaluar në hetim të thelluar, menjëherë, për “Fillimin e Procedurës së Hetimit të Thelluar ndaj Ndërmarrjes “Romano Port” SHA me adresë në Porto Romano/Durrës 500 m në veri të hidrovorit, subjekt tatim pagues me Nr. K5162550110, për abuzim të mundshëm me pozitën dominuese, sipas nenit 9 të ligjit 9121, datë 28.07.2003 ”Për Mbrojtjen e Konkurrencës. Periudha e hetimit do të jetë 1 Janar 2011-15 Shtator 2011.”

Për rrjedhojë nuk aprovoj as Vendimin e Komisionit të Konkurrencës, Nr. 201, datë 20/09/2011 ”Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar tregun e shërbimit të ngarkim-shkarkimit të gazit të lëngshëm të naftës në rrugë detare ndaj ndërmarrjes Romano Port” SHA”, që është në thelb ai i grupit të punës, megjithëse ka pranuar pjesërisht sugjerimin e bërë nga ana ime, për ndryshimin e periudhës hetimore, duke e shtrire atë edhe ne vitet para vitit 2011. Në këto rrethana jap votën kundra ndaj Vendimit të Komisionit të Konkurrencës Nr 201, datë 20/09/2011.

- II- Arsyet përse nuk miratoj në përgjithësi “Raportin e Hetimit Paraprak në Tregun e Ngarkim Shkarkimit “Romano Port” dhe kërkova plotësimin dhe rishkrimin e tij, para se të kalohet në hapjen e hetimit të thelluar.

- II.1 Vendimi Nr 196, datë 29/07/2011 i Komisionit të Konkurrencës “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e shërbimit të ngarkim shkarkimit të gazit të lëngshëm në Portin ”Porto Romano” në dispozitiv, ka parashikuar “Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për ndjekjen e procedurave hetimore të parashikuara në ligj dhe aktet ligjore, si dhe përgatitjen e raportit të hetimit paraprak jo më vonë se data 15.09.2011”. Ky vendim i Komisionit të Konkurrencës, nuk ishte apriori, por ishte mbështetur: a) në vetë sugjerimin e grupit të punës se mund ta realizonte hetimin dhe të përgatiste raportin jo më vonë se data 15.09.2011; dhe b) në frymën e Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr 197 datë 29/07/2011 “Për marrjen e masave të Përkohshme për rivendosjen e konkurrencës në tregun e shërbimit të ngarkim – shkarkimit dhe depozitimin e gazit të lëngshëm në Portin “Porto Romano”, që në dispozitivin e vet parashikonte: 1.“Marrjen e masës së përkohshme si vijon:”Porto Romano” SHA të bëjë të mundur përpunimin e anijes me GLN të sjellë nga ndërmarrja “Mare Oil” SHA në mënyrë të menjëhershme dhe jo më vonë se 5 ditë nga njoftimi i këtij vendimi”. Siç dihet unë nuk kam qenë dakord me këtë vendim, i cili është i shprehur më parë.

Por për çudi Urdhri i Sekretares së Përgjithshme të Autoritetit të Konkurrencës, për ngritjen e Grupit të Punës dhe zbatimin e VKK Nr 196, datë 29.07.2011, me nr Prot. 217, është i datës 22.082011. Është e tepërt të thuhet se nga periudha e marrjes së Vendimit të KK, datë 29.07.2011, deri në 22 Gusht 2011, ka kaluar gjysma e periudhës hetimore që ishte parashikuar deri në 15 Shtator 2011. Për hir të provave

dhe fakteve, në datë 15/08/2011, nga Institucioni i Autoritetit të Konkurrencës, ka patur një shkresë në funksion edhe të hetimit paraprak drejtuar QKR-së. Është e tepërt të thuhet se nga rrjedha e hetimit paraprak, me një vonesë të tillë, është një mungesë serioziteti ndaj firmave nën hetim, por dhe ndaj vetë Komisionit të Konkurrencës, si Organ Kolegjial, një shpërfillje ndaj këtij të fundit. Ndërkohë duke përgjysmuar subjektivisht periudhën hetimore, nga rreth 50 ditë kalendarike në rreth 25 ditë kalendarike, nuk mund të mos ketë pasoja negative në cilësinë e hetimit paraprak, duke shmangur ose duke dobësuar me dashje apo pa dashje elementët e një hetimi objektiv e të paanshëm dhe duke rritur në të njëjtën kohë dozat e subjektivitetit. Nëse pjekja e bukës, kërkon X kohë, por ne fakt bukëpjekësi e le vetëm për X/2 e kohës, është e pritshme nga kushdo që buka do të mbetet pa pjekur ose do të digjet nga nxehtësia me e larte e furrës. Kjo ka ndodhur dhe me hetimin dhe Raportin e hetimit paraprak

II.2 Doza e subjektiviteti, buron dhe shprehet midis të tjerash edhe në mospjesëmarrjen e anëtarëve të grupit të punës, në takimet konsultuese/trajnimet e bëra nga ekspertet e huaj hungarezë, por edhe italiane kur është trajtuar në mënyrë të posaçme edhe çështja e hetimit paraprak në Tregun e Shërbimit të Ngarkim Shkarkimit të GLN-se në Portin “Porto Romano”, apo raste të përafërta me të, në funksion të këtij rasti. Takimet e veçanta konsultuese, të realizuara në fakt, nga anëtarë të veçantë të grupit, pas vërejtjeve të bëra, nuk mund të pakësojnë dozat e subjektivitetit dhe nuk i shërbejnë arritjes të një konsensusi real për një hetim objektiv e të paanshëm që i shërben jo thjesht vendosjes së gjobës por shëndoshjes reale të tregut.

Kujtoj se në këto trajnime u shtjelluan çështje të tilla: si ajo e ndarjes së qartë midis funksioneve rregullatore dhe operacionale:

“distinction between regulatory and operational functions:

On one hand the institutions (central, regional and local governments) in charge of planning, on the other hand the companies providing the services. European Union is heading for a “regulated market” based on a clear-cut separation of the regulatory function of the institutions and the operation of the services” (për të shmangur debatin se përkthimi ose shqipërimi është apo nuk është i saktë, e kam citur të plotë lektoren Letizia Razzitti, nga Autoriteti Italian i Konkurrencës”

Është e drejtë e kujtdo të mos mbajë parasysh sugjerimin në fjalë të e trajnueses, ose ta perceptojë sipas mënyrës së vet, por ndërkohë është e patolerueshme mospjesëmarrja në trajnime të tilla kur harxhohen jo pak fonde për ngritjen e kualifikimit dhe kompetencave profesionale të stafit të Autoriteti të Konkurrencës. Dhe kjo bëhet në mënyrë të përsëritur.

E njëjta gjë mund të thuhet edhe për aspekte të tjera të shtjelluara gjatë trajnimit, si integrimi i sektorit etj.

“4. modal integration: according to legislative decree no. 422/97, modal integration must be taken into account at all levels: by regional governments in developing and approving plans and programmes and in identifying minimum services; by local governments in handing over the services to transport companies; and by operators in providing public transport services and in participating in the bidding procedures.

3. “mandatory” transformation of the companies into corporations: in order to open the market to competition, legislative decree no. 422/97, as amended by legislative decree no. 400/99, has imposed on regional and local governments the obligation to transform the special companies and consortiums into corporations » .

Natyrisht unë nuk kam mendimin se rekomandimet e znj Letizia Razzitti janë të detyrueshme për t'u zbatuar nga stafi i Autoritetit Shqiptar të Konkurrencës, por përftimi i përvojës nga stafi dhe rastet e Autoritetit Italian të Konkurrencës, shtjellimi i tyre në seminare e debate të lira ku marrin pjesë gjithë njerëzit që trajtojnë këto çështje ndihmon potencialisht në rritjen e cilësisë së hetimeve dhe raporteve hetimore dhe për rrjedhojë të vendimmarrjes së Komisionit të Konkurrencës, ashtu si mospjesëmarrja në trajnime përforcon qëndrimet subjektive e subjektiviste .

II-3 Kufizimi i kohës hetimore, vonimi i dërgimit të shkresave nga ana e grupit të punës, është shoqëruar edhe nga mungesa e përgjigjeve të plota në kohë nga subjekte të ndryshme që i është drejtuar grupi hetimor. Siç evidentohen në faqen 12 pika 53 e Raportit, nga "Ndërmarrja Romano Port, Kapiteneria Durrës dhe Komuna Katund i Ri nuk ka ardhur informacioni i Kërkuar deri në këtë fazë, duke mos sqaruar për Komisionin se janë pajisur apo jo ndërmarrjet si Mare Oil dhe Primagaz, me lejen e shfrytëzimit, apo dhe për çështje të tjera. Siç dihet komisioni është njohur se ndërmarrja "Inter Gaz", e cila ka depozita bregdetare në Porto Romano, është pajisur me leje shfrytëzimi që në datën 24.12.2008, pra disa muaj para se të fillonte nga puna vetë porti Porto Romano. Ky informacion i referuar si provë është jo vetëm i nevojshëm por edhe i domosdoshëm për të gjykuar si Komisioner në se i është bërë trajtim i veçantë diskriminues Mare Oil dhe Prima Gaz, në raport me firmat e tjera që kanë depozita bregdetare gazi në Porto Romano.

II-4. Në seancën dëgjimore të Komisionit me ndërmarrjen Mareoil në datë 25.08.2011, është kërkuar

1. Sa ka qenë kostoja e plote e ndërtimit depozitës së gazit deri në vënien në shfrytëzim dhe volumi i saj (të ndërtuar nga vetë Mare Oil) ?
2. Sa ka qenë kostoja e shkarkimit gazit (paguar Portit, vetëm për procesin e shkarkimit, psh. të një anije, mbështetur në një rast konkret, në rastin kur është bërë në një depozitë të tretë apo në depozitën e re tuaj). Të specifikohet kostoja gjithsej dhe kostoja për ton për x Ton, tarifa e shkarkimit të miratuar nga OSSH dhe tarifa e zbatuar nga Romano Port, dhe tarifatat e tjera që paguhen konkretisht (siç mund të jenë tarifa e rrezikut nga zjarri etj).
3. Sa ka qenë kostoja e depozitimit të një anije në depozitat të tretëve në Porto Romano. Si është kontrata me ndërmarrjen që ka depozita, javore, apo për periudhën sa do të ngarkohet dhe shkarkohet depozita, mujore apo vjetore ?

E njëjta gjë për në shkarkim depozitim në Vlorë.

1. Pra Sa ka qenë kostoja e shkarkimit të një anije (paguar Portit vetëm për procesin e shkarkimit), dhe për depozitim tek të tretet në Vlorë, shpenzimet e shkarkimit gjithsej për një anije me x Ton, tarifatat e shkarkimit dhe tarifatat e tjera që përdoren ndaj portit Vlorë. Është kërkuar të sqarohen sa janë tarifatat e shpallura nga Porti, në Romano Port dhe në Vlorë
2. Sa ka qenë kostoja e depozitimit të anijes në depozitat e tretëve në Vlorë. Sa ka qenë kostoja gjithsej. Si ka qenë kontrata, javore, për periudhën e ngarkim-shkarkimit

Për të qenë të krahasueshme të dhënat duhen gjithsej, të shoqëruara me volumin e gazit të shkarkuar, për të llogaritur dhe koston për njësi në çdo rast.

Këto të dhëna nuk janë sjellë nga ndërmarrja Mareoil, (e njëjta gjë kërkohet dhe për Prima Gaz) megjithëse ju kërkuan, por sigurimi i këtij informacioni nuk është realizuar as nga Grupi i Punës, që ka realizuar hetimin paraprak dhe ka përgatitur hetimin përkatës.

II-5. Ne Raportin e hetimit paraprak ne sythin Tregu i Produktit /Shërbimit dhe nënsythen

- Parimi i monopolistit hipotetik,
- Zëvendësimi ne anën e kërkesës
- Zëvendësimi ne anën e ofertës, ka një stërzgjatje, për gjëra të njohura dhe të pranuar pa qartësuar siç duhet tregun përkatës.(përcaktimi i qartë i këtij tregu për edhe thelbin e çështjes) Kjo stërzgjatje është në të gjithë pjesën por unë po ndalem vetëm në pikën 89-90

Ne piken 89, pohohet se “Ndërmarrjet që kanë depozitat e tyre ne Porto Romano, nëse kërkojnë të shkarkojnë anijet me GLN-ne ne portin Vlora 1, duhet që të kenë marrëveshje me ndërmarrjen Kalaja SHA, e cila ka me qira depozitat e vetme te GLN-se ne Portin Vlora 1. Edhe ne se supozojmë se ne te gjitha rastet që këto kompani do të kërkonin të shkarkonin ne këtë port, do të gjenin gatishmërinë e ndërmarrjes Kalaja SHA, për t’i ofruar me nën qira depozitat, kostoja për të cilat ne rastet që është realizuar ky proces rezulton të jete xxxx mijë USD. Ne se ky proces do të realizohet ne Porto Romano, për ndërmarrjet që kanë depozita ne këtë Port, Intergaz , Mare Oil dhe Prima Gaz do të paguajnë mesatarisht xxxx mijë USD. Pra ne rastin se ndërmarrjet që kanë depozita ne Porto Romano do të kërkonin që të realizonin shkarkim depozitimin ne Portin Vlora 1, përballen me një çmim 1000% më të lartë.”.

Ndërsa ne piken 90 “Pra, ne rastin e shërbimit e ngarkim shkarkimit për depozitat e GLN-se te ndërtuara ne zonën e Porto-Romanos, i vetmi subjekt që mund të ofroje këtë shërbim është ndërmarrja Porto Romano SHA. Duke u bazuar ne shembullin e monopolistit hipotetik, nëse kjo ndërmarrje do të rriste tarifën (footnot 13- Tarifat për shërbimin e ngarkim shkarkimit e GLN-se ne Porto Romano janë përcaktuar nga OSHA) e shërbimit te ngarkim shkarkimit për GLN- ne atëherë për asnjë nivel te çmimit te rritur ndërmarrjet që kanë depozita ne zonën e Porto Romanos nuk mund të kenë një mundësi të dytë për të zëvendësuar shërbimin (çmimi që paguhet ne Vlore është 1000 % me i larte sipas Testit SSNIP produkti është zëvendësues ne nivelin e çmimit 5-10 %. Pra jemi ne rastin kur një shërbim ofrohet vetëm nga një ndërmarrje për depozitat ne Porto Romano, dhe ndërmarrja Romano Port SHA është monopolist ne ofrimin e shërbimit te ngarkimit – shkarkimit për depozitat e ndërtuara ne Porto Romano. Për shkak te ekskluzivitetit që i vjen kësaj ndërmarrje nga kontrata koncesionare, pozicioni i monopolit te ndërmarrjes Porto Romano SHA nuk cenohet nga hyrjet e reja.”. Dhe me tej, Konkludohet në pikën 93: Edhe ne rastin ofertës dalim ne konkluzion se ndërmarrja Romano Port SHA për shkak te ekskluzivitetit nuk mund të ketë konkurrentë ne ofrimin e shërbimit. Ne kontratën koncesionare Romano Port SHA i është ekskluziviteti për shërbimin e ngarkim shkarkimit te naftës dhe nënprodukteve te saj ne zonën e Porto Romanos, duke bllokuar ne këtë mënyre hyrjet e reja ne këtë treg përkatës.

Për Komisionin e Konkurrencës është bere e qarte se: Tregu i shërbimit te ngarkim-shkarkimit te Gazit te Lëngshëm te Naftës, ne rruge detare realizohet nga Porti Vlora 1 dhe Porti Porto Romano, por ne vend që kjo te pohohet drejtpërdrejt, këtë duhet ta marrësh vesh nëpërmjet fjalisë së parë të pikës 88, ku thuhet : Alternativa e vetme përjashto Porto Romano, në të cilin realizohet shkarkimi dhe depozitimi i GLN-së që prej vitit 2009 ne rruge detare , është Porti Vlora 1.

Por ne vend të jepen referimet përkatëse ligjore, për të qartësuar se si vendosen çmimet apo tarifatat e ngarkimit shkarkimit në portin, Vlora 1, që në tërësi dihet se janë të lira të vendosen nga koncesionari, duke pohuar tarifatat e ngarkimit shkarkimit të GLN-se në Porto Romano janë të përcaktuara nga OSHA, nuk jepet informacioni përkatës të cilin e kemi trajtuar në pikën II-5. Përveç kësaj nuk analizohet pasojat e qëndrimit të OSHA-s për vendosjen e tarifave ndryshe në portin Vlora 1 nga ai në Porto Romano, se çfarë pasoja kanë si për vetë Portet por edhe për operatorët e tregimit me shumicë të gazit, se çfarë pasoja ka në vetë konkurrencën në tregun e shërbimit të ngarkimit –shkarkimit të GLN-se, por edhe në tregun e shitjes me shumicë dhe pakicë të GLN-se.

Nëse sigurohet informacioni i plotë, në treguesit fizikë të përmendur më sipër dhe për treguesit vlerore të porteve, por edhe të tregut të importit dhe shkarkimit me shumicë të gazit, dhe tregun me pakicë, dhe jepen në raportin përkatës të hetimit paraprak, mund të qartësohen edhe problemet e realizimit të konkurrencës ose praktikave antikonkurrese si rezultat i sjelljes së operatorëve të caktuar, apo i ndërhyrjes së aktorëve shtetërorë, përfshi OSHA-n, apo vetë Autoritetin e Konkurrencës, por edhe probleme të tjera që kanë të bëjnë me efikasitetin e shërbimit të ngarkimit shkarkimit, por dhe në tërësi të tregut me shumicë dhe pakicë të tregut të GLN-se, dhe ndikimin e tyre tek konsumatorët. E them këtë se, sipas Ligjit 9298, datë 28.10.2004, analiza e vetëshlyerjes së investimeve në portin Porto Romano është bërë duke krahasuar shpenzimet e investimeve me të ardhurat nga shitja, dhe jo të ardhurat neto operative apo fitimin, apo treguesin EBITDA. Po kjo përjashtohet në Raportin e hetimit paraprak. Dhe ky është një gabim i madh profesional, që ka vullën e OSHA-s dhe është kthyer edhe në ligj, duke sjelle pasojat të gabuara jo vetëm për firmat individuale, por edhe për funksionimin e tregut të ngarkimit shkarkimit të GLN-së por edhe atë të tregut me shumicë dhe pakicë të tregut të tij.

Po kështu përjashtohet Analiza e Vendimit Nr 111, datë 26.1.2011 "Për një ndryshim në vendimin Nr 486, datë 25.7.2007 të Këshillit të Ministrave" "Për ndërprerjen e Veprimtarisë së Përpunimit të anijeve, që transportojnë naftë, gaz dhe nënprodukte të tyre, në portet e Durrësit dhe Shëngjinit ndryshuar."

Në Raport nuk thuhet asnjë fjalë se moskalimi i këtij akti në Autoritetin e Konkurrencës bie ndesh me ligjin "Për mbrojtjen e Konkurrencës". Nuk behet analiza e nevojshme nëse ky akt bie ndesh me Ligjin nr 9298, datë 28.10.2004. Mos dërgimi i draft ligjit përkatës për vlerësim ligjor nga ana e Autoritetit të Konkurrencës, është një shkelje e ligjit "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", dhe për gjykimin tim duhet shqyrtuar, nga Autoriteti i Konkurrencës. Kjo behet imperative, edhe për faktin se Raporti i Hetimit Paraprak, pretendon siç kemi cituar më lart në pikën 90 "pozicioni i monopolit të ndërmarrjes Porto Romano SHA nuk cenohet nga hyrjet e reja."

Nëse tregu shqiptar i importit të naftës dhe gazit është i tillë sa nuk justifikon ekonomikisht ngritjen e më shumë se dy porteve, ekskluziviteti i tyre, i cili është shumë i qartë dhe nuk ka nevojë për t'u vërtetuar në vetvete, nëpërmjet monopolistit hipotetik, por se çfarë efekte ka në efikasitetin e tregut dhe tek çmimi përfundimtar i gazit apo naftës tek konsumatori përfundimtar. Po kështu nëse një importues gazi nuk ka depozitën të veta ai duhet të paguajë edhe tarifatat e ngarkimit shkarkimit edhe atë të depozitimit jo vetëm në Vlorë por edhe në Durrës.

Kjo e bën imperative sigurimin e informacionit për të gjykuar dhe këtë duhet ta bënte dhe duhet ta bëjë edhe Raporti i Hetimit Paraprak.

"Sentenca në fund të pikës 89" Pra në rastin se ndërmarrjet që kanë depozitën në Porto Romano do të kërkonin që të realizonin shkarkim depozitimin në Portin Vlora 1, përballen

me një çmim 1000% me te larte” është ne thelb e vërtete edhe për depozitat bregdetare ne Vlore, por edhe për ato ne Romano Port. Por ndryshe nga porti “Porto Romano”, porti Vlora 1, ishte paraparë në kontratën e koncesionarit të ishte i hapur për të gjithë importuesit e gazit dhe jo vetëm për një. Tani që kanë dalë të dhënat ekonomike –finaciare të vitit 2010, mund të shihen qartë dhe efektet negative që ka patur Kontrata midis Petroliferes dhe firmës Kalaja për vetë firmën Petrolifera, që ka të drejtën ekskluzive për Vlora 1, duke kufizuar artificialisht përdorimin e këtij porti dhe nga operatorë të tjerë të tregtimit të gazit.

Për me tepër, kjo vërtetohet nga Kontrata për dhënie me qira të depozitave të GLN-së me kapacitet 4000 m³ midis “Inter –Gaz “sh.a dhe Mare Oil sh.a.-Porto Romano, Durrës 2010, vlefta e së cilës, sipas kësaj kontrate, është: “Vlera e qirasë për të 2 (dy) depozitat, sipas kohëzgjatjes se përcaktuar në pikën 5 të kësaj Kontrate, është USD\$ xxxxxx, TVSH-ja është përfshirë në vlerën e qirasë.

Kjo do të thotë se vlera e Kontratës për një depozitë 2000 m³, është xxxxx mijë dollarë. Ndërsa kur firma Mare Oil, ka preferuar ta shkarkoje anijen LPG/C Syn Mira, ka rënë dakord ta depozitoje në portin Vlora 1, tek ndërmarrja Kalaja, me një vlere prej xxxxx, për nja kapacitet prej 2062.949 kg, ose 2063 ton. Ne këto kushte del e nevojshme për t’u përdorur e njëjta njësi matje se sa kg, përmban 1m³.

II-6 Në Raportin Hetimor, shmanget analiza e efekteve të sjelljes së OSHA-së në tregun e ngarkim shkarkimit në përcaktimin dhe rregullimin e tarifave të ngarkimit shkarkimit duke i përcaktuar për një operator dhe duke i lënë të lira në një operator tjetër. OSHA-s aktuale i duhet të rregullojë gabimet profesionale të OSHA-së që ka përgatitur marrëveshjen koncesionare në Porto Romano. Nëse sipas ligjit Nr 9298, date 28.10.2004, të ardhurat nga shitja ishin parashikuar 204 milion lekë, në fakt gjatë vitit të parë të plote kalendarik 2010, niveli i shitjeve neto ishte 291.1 milion leke dhe se bashku me të ardhurat e tjera nga veprimtaria e shfrytëzimit prej 73.6 milion lek, janë 364.7 milion leke ose rreth 180 % e nivelit te parashikuar.

Mbështetur në Ligjin Nr 9298, date 28.10.2004, i cili është i publikua, kushdo mund te mësoje në pjesën që bën fjalë për Plan biznesin për ndërtimin dhe vënien në funksionim te terminalit ne gjirin e Porto Romanos, Durrës, se “Shfrytëzimi i këtij objekti parashikohet të fillojë menjëherë për shkak të nevojës imediate për këtë investim, duke dhënë të ardhura që me fillimin e punës së tij se në një vit parashikohej që në këtë pontil të shkarkoheshin rreth 600 mije ton lende djegëse të lëngët dhe rreth 200 mije ton lende djegëse te gaztë. Më tej është parashikuar:

Të ardhurat rezultojnë si më poshtë:

Naftë e importuar 350000 ton/vitx280lek/ton=98 milion leke Benzine e importuar 100000 ton/vitx560lek/ton=56 milion leke Vajgur avionësh 30000 ton/vitx560 lek/ton=16.8 milion leke Gaz i lëngshëm 60000 ton /vitx560 lek/ton=33.6 milion leke Totali i te ardhurave në një vit 204.4 milion lek

Në këto kushte, kur në vitin e parë të ardhurat janë realizuar ndjeshëm shumë më tepër, nga sa janë parashikuar te ardhura në Plan biznes, për të gjykuar mbi abuzimin e mundshëm të pozitës dominuese del e nevojshme se ç’pjesë e shtesës të të ardhurave nga shitja ka rezultuar nga rritja e volumit dhe se çfarë pjese ka rezultuar nga rritja e volumit të xhiros, si në tërësi por për GLN në veçanti? Sipas Ligjit nr 9298, datë 28.10.2004 ishte parashikuar si angazhimi se: ”Te respektojë të drejtën e barazisë për shoqëritë që do të kryejnë shërbime nëpërmjet këtij objekti, duke respektuar legjislacionin në fuqi, në këtë

fushë”, por edhe se: “Tarifat që do të përdoren do të jenë ato që përdoren sot në Portin e Durrësit me tendencë ulje”. Pra çështja e barazisë ruajtjes së konkurrencës se lirë dhe efektive është paraparë dhe e lidhur ngushtë me çështjen e eficiencës dhe anasjelltas, dhe jo në mënyrë të simplifikuar integrim sektorial = shkelje të barazisë së ofrimit të shërbimit. Ashtu siç e parashikon edhe ligji për mbrojtjen e Konkurrencës, që lejon dhe presupozon ekonominë e shkallës, por nuk lejon dhe dënon abuzimin me pozitën dominuese.

Kjo (sigurimi i eficiencës, ulja e tarifave të shërbimit) sipas Ligjit nr 9298, do të mundësohej edhe nga integrimi sektorial se: “Kapitali dhe mjetet financiare të kësaj shoqërie janë rezultat i bashkimit të shoqërisë ”Inter Gaz” sh.a, Rira, që operojnë në tregun e gazit dhe të naftës, si dhe shoqërisë së ndërtimit “Edil” etj..., që operojnë në fushën e ndërtimit”. Për më tepër ky integrim shihet si garanci për realizimin në të njëjtën kohë të dy angazhimeve të mësipërme, ruajtjen e barazisë në treg për shërbimin e dhënë dhe uljen e kostos së shërbimit ”Aktiviteti në rritje të vazhdueshme i këtyre kompanive në fushat përkatëse, ka krijuar likuiditete dhe kapitale të fuqishme që kapërcejnë vlerën e investimit të parashikuar”-shih Ligjin nr 9298. Pra çështja që Romano Port ka një integrim vertikal, është e konfirmuar se dhe në Raport nuk ka vend për t’u thelluar gjatë, ajo ka qenë e qartë që në krijimin e vet por dhe gjatë funksionimit. Duke u konfirmuar siç e kërkon çdo analize konkurrence, kryesorja është të zbulohet, në se ky integrim që ish konsideruar si një avantazh për ndërtimin e Portit, është shndërruar apo jo në një abuzim dominancë, qoftë në fazën e ndërtimit dhe sidomos të vënies në përdorim të tij.

Kjo kërkon që Raporti i hetimit paraprak të sigurojë dhe prezantojë një informacion, të qartë dhe të mjaftueshëm se si janë realizuar kërkesat e Ligjit nr 9298, lidhur me rritjen e kapacitetit të anijeve që mund të përpunohen në Portin “Port Romano”, shpejtësia e përpunimit –shkarkimit të anijeve, të gazit të lëngshëm dhe të karburanteve të tjera. Rritja e produktivitetit në tregun e ngarkim shkarkimit, e ndikuar edhe nga rritja e përqendrimit, pa abuzim të dominancës, me sigurim të konkurrencës së lirë dhe efektive, është një element i nevojshëm dhe i domosdoshëm për uljen e çmimeve në tregun e ngarkim shkarkimit të gazit të lëngshëm , por edhe në çmimin e tij tek konsumatori përfundimtar. Fakti që sipas bilancit të Ndërmarrjes Romano Port SH.A që mbi 4/5 e të gjithë aktiveve, janë detyrime të ndërmarrjes “Romano Port”, e bën të nevojshme të merret informacion si nga vete ndërmarrjet që janë të lidhura me hetimin në tregun e ngarkim shkarkimit të gazit të lëngshëm, përfshirë ndërmarrjet që kanë ndërtuar Portet, në këtë treg, por edhe depozitat si dhe nga OSHA dhe nga Bankat ku është marrë kredi. Është e njohur se ndryshimi i mënyrës së financimit të investimit ka efekte të ndjeshme në koston e produktit dhe për rrjedhojë në tarifat e shërbimit. Kjo ishte dhe mbetet e nevojshme dhe e domosdoshme për disa arsye: a) konkurrenca nuk është qëllim në vetvete, por garanci dhe mjet edhe për rritjen e eficiencës (kjo është paraparë dhe në Politiken Kombëtare të Konkurrencës), sipas së cilës, nëpërmjet saj mund të jepet një kontribut sinjifikativ për përmirësimin e treguesve makroekonomike të tillë si niveli i çmimeve, punësimi dhe rritja ekonomike, b) Për të shmangur çdo element negativ në rregullimin e koncesioneve në këtë fushë por dhe në fusha të tjera, ku duke garantuar në kontratat koncesionare me këtë ose atë çmim (mjaft më të lartë se sa aktual- sidomos në fushën e energjetikes) mund të ketë pasoja të mëdha negative, jo vetëm për koncesionaret e veçantë, por për gjithë ekonominë në tërësi. c) Rritja e raportit të detyrimeve ndaj kapitalit të vet, nga ndërmarrjet, vështirësitë e moskthimit të kredive edhe si rezultat i mosllogaritjes të saktë të biznesit për vetëshlyerjen e investimeve, por edhe mbështetja e bashkëpunimit të tyre me bankat, jo aq në një biznesplan real, por kryesisht në kolateralin,

përben një nga problemet më të mprehta dhe sfidat kryesore të ekonomisë sonë. Këtu nuk mund të mos mbahet parasysh se gjithçka që ka realizuar Porto Romano, është bërë edhe me bekimin e OSHA-s në vite, edhe nëpërmjet akteve ligjore, përfshi edhe ligjet. Ja pse analiza e grupit të punës që në fazën e hetimit paraprak nuk duhet të simplifikohet dhe të shihet tepër ngushtë, dhe t'ia presë këmbët vetes duke u kufizuar nëpërmjet objektit të hetimit të thelluar. Institucioni i Autoritet të Konkurrencës, si institucion i pavarur dhe profesional, duke analizuar këtë problematike në ndërmarrjen Romano Port, mund të hedhe drite dhe japë kontributin e vet për trajtimin në thellësi të problemeve me të cilat ndeshet tregu i ngarkim -shkarkimit të GLN-së, duke marrë pjesë indirekt ose direkt në përballimin e sfidave dhe problemeve me të cilat ndeshet ekonomia në tërësi por edhe bizneset në veçanti, në stadin e tanishëm të zhvillimeve globale.

II-7 Është e vërtetë që Vendimi nr 196 i Komisionit të Konkurrencës, parashikonte që periudha hetimore të fillonte nga Janari 2011 deri në Korrik 2011. Por të dhënat e Tabelës Nr.1 të faqes Nr.21 të Raportit të Hetimit Paraprak, duke pasqyruar një informacion mbi zhvillimin e tregut të importit të gazit të lëngshëm, duke filluar nga vitit 2008, e me pas 2009, 2010, 2011, hedhin drite mbi zhvillime të ndryshme në këtë treg. Ndër këto zhvillime të bie në sy, se një ndër firmat që është ankuar për abuzim të pozitës dominuese, nga ndërmarrja “Romano Port” SHA, ka patur luhatje jo të vogla si në uljen, por edhe në rritjen e volumit të importit të gazit të lëngshëm, në sasi por edhe në peshën specifike që ka zënë dhe zë në tregun e importit të gazit të lëngshëm. Dhe me konkretisht, nëse në vitin 2008, importi i gazit të lëngshëm nga kjo ndërmarrje ka qenë, xxxxx ton, në vitin 2009 u rrit në xxxxx tonë, për të rënë në xxx tonë, e deri tek xxx tonë për periudhën Janar - Korrik 2011. Ky ndryshim i volumit të importit nga kjo shoqëri, është shoqëruar me ndryshimin e peshës që zë kjo shoqëri në strukturën e tregut të importit të GLN të matur në tregues fizike, nga xx.x % në vitin 2008 në xx.x % në vitin 2009, në x.x % në vitin 2010 dhe x.x % në vitin 2011. Mbështetur në kontratën e realizuar midis kësaj ndërmarrje dhe ndërmarrjes InterGaz, për përdorimin e depozitave të GLN në Porto Romano nga dhe sidomos në të dhënat faktike për shkarkimin e anijeve të GLN-së në këtë Port, flasin se kjo rritje e volumit është mbështetur dhe nxitur edhe në sajë të vënies në përdorim të Portit Porto Romano në pranverën e vitit 2009. Kjo e bën imperative, që edhe periudha hetimore në hetimin e thelluar të ndryshojë, duke qenë i tillë që të sigurojë analizën e thelluar të konkurrencës përfshirë dhe këto periudha, pra periudha hetimore të jetë 1 Janar 2008 -15 Shtator 2011.

II-8 Në pikën 76, faqe 16, të Raportit të Hetimit Paraprak, evidentohet se “Grupi i punës ka konstatuar se në faqen zyrtare të internetit “Romano Port” SHA ka vendosur një njoftim të datës 29.08.2011, me anën e të cilit Romano Port SHA i kërkon operatoreve që kërkojnë të marrin shërbimin e transportimit të hidrokarbureve në zonën e Porto Romanos, që të paraqiten pranë administratës së Portit për të nënshkruar kontratën tip ndërmjet operatorit dhe “Romano Port” SHA Lidhur me këtë ka rrjedhur edhe çështja se kush ka përparësi nga pikëpamja juridike, një kod siç është Kodi Civil, apo një ligj specifik, siç është ai që rregullon legjislacionin në tregun e gazit të lëngshëm.

Në kushtet kur siç u deklaruar edhe në mbledhjen e Komisionit: “Grupi i punës është i mendimit që zbatohet ligji specifik për Romano Port SHA, përkundrejt Kodit Civil. Gjithsesi ky është një vlerësim paraprak i joni”, personalisht mendoj se Komisioni duhet të ketë një qëndrim të qartë mbi këtë çështje, ashtu siç u trajtua edhe në këtë mbledhje. Në këtë kuadër, vetë Raporti hetimor, por për rrjedhojë edhe draft vendimi i Grupit të

punës duhej të ishte i qartë, se në fakt ligji “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” nuk atakon apriori lirinë ekonomike të ndërmarrjeve, e për rrjedhojë të drejtën e tyre për të hartuar kontratat tip. Për me tepër liria ekonomike e sipërmarrjes, jo vetëm që presupozohet por edhe mbrohet gjate veprimtarisë për mbrojtjen e konkurrencës. Analiza e Komisionit të Konkurrencës e për rrjedhojë edhe e Autoritetit të Konkurrencës, konsiston e duhet të konsistojë në faktin se në kuadrin e kësaj të drejte, a ka dukuri që nëpërmjet kontratës tip realizohen abuzime të pozitës dominuese. Pra qartësimi i çështjeve të mësipërme dhe rishikimi i Raportit të Hetimit paraprak, nuk është një qëllim në vetvete, por një mjet i nevojshëm dhe i domosdoshëm për të përcaktuar më qartë vete objektivat dhe fushën e analizës së konkurrencës në fazën e hetimit të thelluar. Nëse ato nuk riparohen që në këtë fazë, më pas mund të thuhet se këto ose ato çështje janë objekt i një hetimi tjetër dhe jo për sa është hapur hetimi i thelluar.

Për të gjitha vërejtjet e dhëna më sipër, nuk e kam miratuar Raportin e Hetimit Paraprak, pasi kërkoj kthimin e këtij Raporti për plotësim nga Grupi i Punës sipas vërejtjeve të dhëna, dhe rrjedhimisht, për këto arsye, jap votën kundër Vendimit të Komisionit të Konkurrencës Nr.201, datë 20.09.2011.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Koço BROKA

(_____)

Anëtar



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS

VENDIM

Nr. 202, Datë 26.09.2011

“Për gjorbitjen e ndërmarrjeve pjesëmarrëse në marrëveshjen e ndaluar në tregun e prodhimit dhe tregtimit të bukës në qytetin e Vlorës, si dhe dhënien e disa rekomandimeve për drejtorinë e përgjithshme të tatimeve”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Servete Gruda Anëtar
- Koço Broka Anëtar
- Rezana Konomi Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 26.09.2011, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Shqyrtimi i raportit të hetimit të thelluar “Në tregun e prodhimit dhe tregtimit të bukës në qytetin e Vlorës”;

Baza ligjore: - Neni 24, shkronja d); neni 26; neni 4, pika 1; neni 70, pika 2, neni 74 pika 1, shkronja a) dhe (b), si dhe neni 75, pika 1, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”;
 - Ligji Nr. 8485, datë 11. 11. 1999 “Kodi i procedurave administrative”.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:

- Raportit të hetimit të thelluar “Në tregun e prodhimit dhe tregtimit të bukës në qytetin e Vlorës”, të paraqitur nga Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës, si dhe relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës.
- Pretendimeve të palëve nën hetim në seancën dëgjimore të zhvilluar në ambjentet e Autoritetit të Konkurrencës me datë 19.07.2011,

VËREN SE:

I. PROCEDURA E NDJEKUR

- 1– Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës, duke marrë shkas nga prononcimet në median vizive dhe të shkruar¹ në lidhje me rritjen e çmimit të bukës në qytetin e

¹ Kronike televizive ne Top-Chanel dhe artikulli “Një bukë arrin cmimin prej 120 lekësh”, gazeta PANORAMA online dt. 25.03.2011

Vlorës, bazuar në nenin 28, germa a) të Ligjit nr. 9121, dt 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” i ndryshuar, me nismën e tij, realizoi një monitorim në qytetin e Vlorës për të parë nëse kjo rritje çmimi kishte ardhur si rezultat i një marrëveshje të ndaluar midis operatorëve që operojnë në këtë treg.

- 2– Nga monitorimi i realizuar u konstatua se rritja e çmimit të bukës në qytetin e Vlorës ka ardhur në mënyrë të menjëhershme, pas një mbledhje të rreth 41 prodhuesve dhe tregtuesve të bukës në qytetin e Vlorës, ku është rënë dakord se: që nga data 23.03.2011 çmimi i bukës 900 gr do të jetë 120 lekë dhe çmimi i bukës 450 gr do të jetë 60 lekë.
- 3– Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të kërkesës së Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe duke marrë shkas nga gjetjet e evidentuara në informacionin e përgatitur nga Grupi i Punës, bazuar në nenin 42, pika 1 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar), me anë të Vendimit Nr. 184, datë 07.04.2011 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prodhimit dhe tregtimit të bukës në qytetin e Vlorës”, vendosi: *Të miratojë hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prodhimit dhe tregtimit të bukës në qytetin e Vlorës për ekzistencës ose jo të një marrëveshje të ndaluar dhe efektet e saj në tregun përkatës.*
- 4– Komisioni i Konkurrencës bazuar në nenin 44, pika 1 dhe 2 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar), për shkak të dëmit që mund t’i shkaktohet konsumatorëve të qytetit të Vlorës nga sjellja anti-konkurrese e prodhuesve dhe tregtuesve të bukës, me anë të Vendimit Nr 185, datë 07.04.2011 “Për marrjen e masave të përkohshme për ndalimin e marrëveshjes në tregun e prodhimit dhe tregtimit të bukës në qytetin e Vlorës”, vendosi marrjen e masave të përkohshme. Sipas këtij vendimi: “Pjesëmarrësit në marrëveshjen e ndaluar për rritjen dhe fiksimin e çmimit të bukës në qytetin e Vlorës, duhet t’i japin fund menjëherë sjelljes së bashkërenduar për fiksimin e çmimit të bukës.”.
- 5– Ndërkohë, Komisioni i Konkurrencës me anë të Vendimit Nr 191, datë 31.05.2011 “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e prodhimit dhe tregtimit të bukës në qytetin e Vlorës” vendosi hapjen e hetimit të thelluar në këtë treg, i cili përfshinte periudhën kohore nga 23.02.2011 deri në 14.04.2011.
- 6– Për mbledhjen e provave dhe të dhënave të nevojshme në lidhje me hetimin, bazuar në nenin 34 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, Grupi i Punës, gjatë procedurës së hetimit paraprak dhe atij të thelluar, ka kërkuar të dhëna dhe informacion me anë të shkresave²:
 - Nr. 153, Dt 28.03.2011 “Kërkesë për informacion” drejtuar Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Vlorë.
 - Nr 231, Dt 03.06.2011 “Kërkesë për informacion” drejtuar Bashkisë Vlorë.
 - Nr 241, Dt 03.06.2011 “Kërkesë për informacion” drejtuar Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Vlorë.
- 7– Në përgjigje të këtyre shkresave Drejtoria Rajonale e Tatimeve Vlorë ka dërguar informacionin e kërkuar me anë të shkresës Nr 153/3 datë 28.04.2011, ndërsa Bashkia Vlorë ka dërguar informacionin e kërkuar me anë të shkresës Nr 210/2 datë 21.06.2011.
- 8– Në bazë të nenit 35 dhe 36 të Ligjit Nr. 9121, dt 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe autorizimit të Komisionit të Konkurrencës Nr. 184/1, datë

² Numrat e protokollit të shkresave i përkasin protokollit të Autoritetit të Konkurrencës

07.04.2011 “Autorizim”, Grupi i Punës gjatë periudhës së hetimit kreu inspektime³ në ndërmarrjet pjesëmarrëse në tregun përkatës. Qëllimi i inspektimeve ishte grumbullimi i provave dhe të dhënave të nevojshme në funksion të hetimit paraprak në tregun e prodhimit dhe tregtimit të bukës në qytetin e Vlorës.

- 9– Gjatë procedurës së hetimit paraprak dhe të thelluar grupi i punës ka realizuar inspektime pranë furrave të bukës si më poshtë vijon:
- Në datat 11-14 Prill 2011, ku u siguruan kupona tatimorë në lidhje me tregtimin e bukës 900 gr dhe 450 gr, si dhe u mbajtën procesverbale ‘Për marrje shpjegimesh për fakte dhe dokumente që lidhen me objektin dhe qëllim e hetimit’
 - Në datat 26-27 Prill 2011, ku u mbajtën procesverbale ‘Për marrje shpjegimesh për fakte dhe dokumente që lidhen me objektin dhe qëllim e hetimit’
 - Në datat 9-10 Qershor 2011, ku u mbajtën procesverbale ‘Për marrje shpjegimesh për fakte dhe dokumente që lidhen me objektin dhe qëllim e hetimit’.

II. TREGU PËRKATËS

- 10– Tregu përkatës përfshin produktet dhe shërbimet që vlerësohen si të zëvendësueshme nga konsumatorët ose klientët e tjerë, për sa u përket karakteristikave, çmimit dhe funksionit të tyre dhe që ofrohen ose kërkohen nga ndërmarrjet në një zonë gjeografike me kushte të njëjta konkurrence, zonë kjo e cila veçohet nga zonat e tjera kufizuese.
- 11– Përkufizimi i tregut përkatës përfshin dy dimensione:
- 1) Tregun e produktit
 - 2) Tregun gjeografik

II.1 Tregu i produktit

- 12– Tregu përkatës i produktit është prodhimi dhe tregtimi i bukës masive 900 gram dhe bukës masive 450 gram në qytetin e Vlorës. Në analizë nuk janë marrë llojet e tjera të bukës pasi në marrëveshjen e gjetur nga inspektorët, kufizimi i konkurrencës, në këtë rast fiksimi i çmimit, ka ndodhur vetëm për dy llojet e bukës të përmendura më sipër.

II.2 Tregu gjeografik

- 13– Tregu përkatës gjeografik është qyteti i Vlorës duke qenë se të gjitha palët e përfshira në marrëveshje operojnë në këtë qytet.

III. NDËRMARRJET NËN HETIM

- 14– Gjatë inspektimeve në terren fillimisht u krye identifikimi i prodhuesve të bukës në qytetin e Vlorës, duke ju referuar “Listës emërore të furrave të bukës Vlorë”, të administruar gjatë Monitorimit në Qytetin e Vlorës në datë 28.03.2011. Duhet theksuar se lista e administruar përfshin emrat e furrtarëve që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në qytetin e Vlorës dhe jo emrat e personave pjesëmarrës në mbledhje.

³ Inspektimet janë të evidentuara me procesverbal, të cilat ndodhen në dosjet e Grupit të Punës.

15– Komisioni i Konkurrencës me anë të Vendimit Nr 191, datë 31.05.2011 ka vendosur hapjen e hetimit të thelluar për ndërmarrjet e mëposhtme:

1.	Spiro Koci	Nipti K86503203E
2.	Bexhet Selmanaj	Nipti K37227201E
3.	Esat Cakaj	Nipti K96708202F
4.	Agron Hamzaraj	Nipti K86610201D
5.	Tomorr Ngucaj	Nipti K56803204S
6.	Fidan Osmanallaj	Nipti K76910202T
7.	Paolo SHPK	Nipti K46605210T
8.	Mirvjen Shehaj	Nipti L06912207R
9.	Arnaldo Baba	Nipti L06311204Q
10.	Adelina Rucaj	Nipti L06902209G
11.	Arbri sh.p.k	Nipti K36410201P
12.	Kleanthi Rapushi	Nipti K76904202M
13.	Gentian Berberi	Nipti L06627205V
14.	Agim Skënderaj	Nipti K36218225M
15.	Myslymi sh.p.k	Nipti K36410209K
16.	Fation Aliu	Nipti K86708208G
17.	Feriz Osmanallaj	Nipti K67108201B
18.	Adhurim Metaj	Nipti L16510204S
19.	Viron Qarri	Nipti K67302204J
20.	Ngucaj sh.p.k	Nipti K36410202A
21.	Niko Nini	Nipti K77417202S
22.	Dilaver Mehilli	Nipti K36528213Q
23.	Arben Meminaj	Nipti K86318203E
24.	Maringlen Rushiti	Nipti K46426202M
25.	Alza sh.p.k	Nipti K46822202E
26.	Algert Metani	Nipti K96506204F
27.	Engjell Meminaj	Nipti K36419226Ë
28.	Shpendi Ymeraj	Nipti K66709206Q
29.	Dashmir Haruni	Nipti L07107201O
30.	Erjon Haruni	Nipti K76904209Ë

16– Gjithashtu Komisioni i Konkurrencës me anë të vendimit Nr 191, datë 31.05.2011 vendosi hapjen e hetimit të thelluar për personat të cilët ushtrojnë veprimtarinë e tyre në tregun e prodhimit dhe tregtimit të bukës në qytetin e Vlorës por nuk janë të regjistruar në organet tatimore si vijon:

31. Lulo Myslymi
32. Agace Myslymi
33. Gentian Hamzaraj
34. Gjergji Simoni
35. Migen Kozmai

- 17– Në datat 9 dhe 10 Qershor 2011, grupi i punës realizoi inspektime pranë subjekteve të cilat rezultojn në pa regjistruara pranë organeve tatimore. Nga inspektimi rezultoi se :
- Subjekti me emër Lulo Myslymi (emri i vërtet Myslym Myslymi), sipas procesverbalit të mbajtur në datë 10.06.2011 ‘Për marrje shpjegimesh për fakte dhe dokumente që lidhen me objektin dhe qëllimin e hetimit’, rezulton i regjistruar si degë e shoqërisë ‘Myslymi’ sh.p.k me NIPT K36410209K me adresë dytësore Lagjia Isa Boletini, Rr Sadik Zotaj, godinë 1 katëshe përball me shkollën Ismail Qemali. Data e lëshimit të certifikatës të kësaj dege është 25.03.2009. Gjithashtu rezulton se në datë 03.03.2011 subjekti në fjalë ka lidhur një kontratë me shoqërinë CKV Noki Albania sh.p.k për pajisjen me kasë fiskale. Pajisje të cilën, sipas deklaratave të tij, është përdorur për rreth 20 ditë pas instalimit dhe me pas për probleme teknike nuk është përdorur më.
 - Subjekti me emër Agace Myslymi (emri i vërtet Elmaz Myslymi), sipas procesverbalit të mbajtur në datë 09.06.2011 ‘Për marrje shpjegimesh për fakte dhe dokumente që lidhen me objektin dhe qëllimin e hetimit’, rezulton i regjistruar si degë e shoqërisë ‘Myslymi’ sh.p.k me NIPT K36410209K me adresë dytësore Lagjia “28 Nëntori”, pranë Kishës Katolike, Vlorë. Data e lëshimit të certifikatës të kësaj dege është 29.05.2006. Gjithashtu rezulton se në datë 03.03.2011 subjekti në fjalë ka lidhur një kontratë me shoqërinë CKV Noki Albania sh.p.k për pajisjen me kasë fiskale. Sipas deklaratës së tij rezulton se kasa fiskale nuk është përdorur asnjëherë sepse nuk është instaluar.
 - Subjekti me emër Gentian Hamzarai, sipas procesverbalit të mbajtur në datë 10.06.2011 ‘Për marrje shpjegimesh për fakte dhe dokumente që lidhen me objektin dhe qëllimin e hetimit’, rezulton i regjistruar në datë 15.04.2011 si person fizik në emër të Floreta Xhyheri, me NIPT L16615201A, me adresë: Lagjia “15 Tetori”, godinë 2 katëshe pranë spitalit Vlorë. Lidhur me kasën fiskale deklaroi se ka aplikuar por nuk është pajisur ende.
 - Subjekti me emër Gjergji Simoni, sipas procesverbalit të mbajtur në datë 09.06.2011 ‘Për marrje shpjegimesh për fakte dhe dokumente që lidhen me objektin dhe qëllimin e hetimit’, rezulton i regjistruar në datë 08.06.2011, si person fizik me numër NIPT L16808201Q, me adresë: Lagjia “Pavarësia”, Pallati i ri afër Albano e Romina, kati I, Vlorë. Në datë 08.06.2011 ky subjekt ka blerë kasën fiskale pranë shoqërisë CKV Noki Albania sh.p.k, të cilën nuk e ka vënë ende në punë.
 - Subjekt me emër Migen Kozmai, sipas shkresës të Bashkisë Vlorë me numër 210/2, datë 21.06.2011, rezulton i regjistruar pranë drejtorisë së taksave dhe tarifave vendore pranë kësaj Bashkie, me numër NIPT K67001202R. Por ka aplikuar për mbyllje të aktivitetit pranë QKR.

IV. VLERËSIMI I SJELLJES SË NDËRMARRJEVE NË TREG

- 18– Në inspektimin e kryer në datë 28.03.2011 u informuam se disa nga prodhuesit e bukës në qytetin e Vlorës (kryesisht ata prodhues të cilët vinin nga emigracioni) u mbledhën për të krijuar shoqatën e prodhuesve dhe tregtuesve të bukës në qytetin e Vlorës. Sipas deklaratave të prodhuesve të bukës, për këtë mbledhje u njoftuan 41 veta por jo të gjithë ishin të pranishëm. Gjithsesi dhe ata persona të cilët nuk ishin të pranishëm në mbledhje morën dijeni për atë çka u vendos.
- 19– Në mbledhjen e datës 21.03.2011 u vendos që buka do të rritej me 20 Lek si dhe u hartua vendimi i mëposhtëm i cili u shpërnda në të gjitha furrat e bukës që operojnë në qytetin e Vlorës:

Shoqata e Furrave te Bukes

Vlore

**Vendosi ne daten 21.03.2011 qe
buka ne daten 23.03.2011 te
kete cmimin**

900 gr = 1200 lek

450 gr = 600 lek

Faksimile e njoftimit të shpërndarë për ndryshimin e çmimit të bukës

20– Lidhur me sjelljen e ndërmarrjeve në treg, u analizuan çmimet e tregtimit të bukës 900 gr dhe 450 gr, për të verifikuar zbatimin e marrëveshjes, si dhe zbatimin e Vendimit Nr 185 të Komisionit të Konkurrencës ‘Për marrjen e masave të përkohshme’. Nga kuponat tatimore si dhe deklaratave të prodhuesve të bukës, në lidhje me çmimin e tregtimit të bukës, rezultojnë se:

1. Spiro Koci Nipti K86503203E, nga kuponi tatimor i lëshuar në datë 11.04.2011 rezultojnë se ky subjekt e tregton bukën masive me peshë 900 gr me çmimin prej 120 lekë dhe bukën 450 gr me çmimin 60 lekë;
2. Ngucaj sh.p.k Nipti K36410202A, nga kuponi tatimor i lëshuar në datë 13.04.2011, rezultojnë se ky subjekt e tregton bukën masive me peshë 900 gr me çmimin prej 100 lekë dhe bukën 450 gr me çmimin 50 lekë;
3. Bexhet Selmanaj Nipti K37227201E, nga kuponi tatimor I lëshuar në datë 11.04.2011 rezultojnë që buka masive shitet 120 L dhe 60 L
4. Esat Cakaj Nipti K96708202F nga kuponi tatimor i lëshuar në datë 11.04.2011 rezultojnë se ky subjekt e tregton bukën masive me peshë 900 gr me çmimin prej 120 lekë dhe bukën 450 gr me çmimin 60 lekë;
5. Agron Hamzaraj Nipti K86610201D, nga kuponi tatimor i lëshuar në datë 11.04.2011 rezultojnë se ky subjekt e tregton bukën masive me peshë 900 gr me çmimin prej 100 lekë dhe bukën 450 gr me çmimin 50 lekë, por në procesverbalin e datës 28.03.2011 ka deklaruar se nga data 23.03.2011 ka aplikuar çmimet 120 lekë për bukën 900 gr dhe 60 lekë për bukën 450gr;
6. Niko Nini Nipti K77417202S nga kuponi tatimor i lëshuar në datë 11.04.2011 rezultojnë se ky subjekt e tregton bukën masive me peshë 900 gr me çmimin prej 100 lekë dhe bukën 450 gr me çmimin 50lekë;
7. Tomorr Ngucaj Nipti K56803204S nga kuponi tatimor i lëshuar në datë 11.04.2011 rezultojnë se ky subjekt e tregton bukën masive me peshë 900 gr me çmimin prej 120 lekë dhe bukën 450 gr me çmimin 60 lekë;
8. Prodhime Brumi Era (Fidan Osmanallai) Nipti K76910202T nga kuponi tatimor i lëshuar në datë 11.04.2011 rezultojnë se ky subjekt e tregton bukën masive me peshë 900 gr me çmimin prej 120 lekë dhe bukën 450 gr me çmimin 60 lekë;

9. Furrë buke Paolo (Spiro Baba) Nipti K46605210T nga kuponi tatimor lëshuar në datë 11.04.2011 rezulton se ky subjekt e tregton bukën masive me peshë 900 gr me çmimin prej 120 lekë dhe bukën 450 gr me çmimin 60 lekë;
10. Mirvjen Shehaj Nipti L06912207R nga kuponi tatimor i lëshuar në datë 14.04.2011 rezulton se ky subjekt e tregton bukën masive me peshë 900 gr me çmimin prej 120 lekë dhe bukën 450 gr me çmimin 60 lekë;
11. Arnaldo Baba Nipti L06311204Q nga kuponi tatimor i lëshuar në datë 11.04.2011 rezulton se ky subjekt e tregton bukën masive me peshë 900 gr me çmimin prej 120 lekë dhe bukën 450 gr me çmimin 60 lekë;
12. EuroForno (Adelina Rucaj)Nipti L06902209G nga kuponi tatimor i lëshuar në datë 11.04.2011 rezulton se ky subjekt e tregton bukën masive me peshë 900 gr me çmimin prej 120 lekë dhe bukën 450 gr me çmimin 60 lekë;
13. Arbri sh.p.k (Qemal Katia)Nipti K36410201P nga kuponi tatimor i lëshuar në datë 11.04.2011 rezulton se ky subjekt e tregton bukën masive me peshë 900 gr me çmimin prej 120 lekë dhe bukën 450 gr me çmimin 60 lekë;
14. Fabiola DM (Dilaver Mehilli) Nipti K36528213Q sipas deklaratës së datës 11.04.2011 rezulton se ky subjekt e tregton bukën masive me peshë 900 gr me çmimin prej 100 lekë dhe bukën 450 gr me çmimin 50 lekë pasi nuk kishte kasë fiskale;
15. Kleanthi Rapushi Nipti K76904202M nga kuponi tatimor i lëshuar në datë 11.04.2011 rezulton se ky subjekt e tregton bukën masive me peshë 900 gr me çmimin prej 120 lekë dhe bukën 450 gr me çmimin 60 lekë;
16. Gentian Berberi Nipti L06627205V nga kuponi tatimor i lëshuar në datë 12.04.2011 rezulton se ky subjekt e tregton bukën masive me peshë 900 gr me çmimin prej 120 lekë dhe bukën 450 gr me çmimin 60 lekë;
17. Arben Meminaj Nipti K86318203E, nga kuponi tatimor i lëshuar në datë 12.04.2011 rezulton se ky subjekt e tregton bukën masive me peshë 900 gr me çmimin prej 100 lekë dhe bukën 450 gr me çmimin 50 lekë;
18. Agim Skënderaj Nipti K36218225M, sipas deklaratës së datës 12.04.2011 rezulton se ky subjekt e tregton bukën masive me peshë 900 gr me çmimin prej 120 lekë dhe bukën 450 gr me çmimin 60 lekë;
19. Myslymi sh.p.k (Fatos Myslymi) Nipti K36410209K, nga kuponi tatimor i lëshuar në datë 12.04.2011, rezulton se ky subjekt e tregton bukën masive me peshë 900 gr me çmimin prej 120 lekë dhe bukën 450 gr me çmimin 60 lekë. Gjithashtu ky subjekt ka edhe 2 degë të tjera ku prodhohet dhe tregtohet bukë, përkatësisht:
20. *Lulo Myslymi (Myslym Myslymi), bazuar në procesverbalin e datës 10.06.2011, deklaroi se gjatë tre muajve të fundit ka tregtuar bukën 900 gr për 100 Lek dhe bukën 450 gr për 50 Lek*
21. *Agace Myslymi (Elmaz Myslymi), bazuar në procesverbalin e datës 09.06.2011, deklaroi se ka tregtuar bukën 900 gr për 120 Lek dhe bukën 450 gr për 60 Lek.*

Duhet sqaruar se këto dy degë të ndërmarrjes 'Myslymi' sh.p.k de jure janë pjesë e kësaj ndërmarrjeje, pavarësisht se de facto ato operojnë si ndërmarrje të ndara. Prandaj këto do të trajtohen si një ndërmarrje e vetme nën emrin e 'Myslymi' sh.p.k.

22. Rushiti sh.p.k (Maringlen Rushiti) Nipti K46426202M, nga kuponi tatimor i lëshuar në datë 12.04.2011 rezulton se ky subjekt e tregton bukën masive me peshë 900 gr me çmimin prej 80 lekë dhe bukën 450 gr me çmimin 50 lekë;
 23. Fation Aliu Nipti K86708208G, nga kuponi tatimor i lëshuar në datë 11.04.2011 rezulton se ky subjekt e tregton bukën masive me peshë 900 gr me çmimin prej 120 lekë dhe bukën 450 gr me çmimin 60 lekë;
 24. Alza sh.p.k Nipti K46822202E, nga kuponi tatimor I lëshuar në datë 14.04.2011 rezulton se ky subjekt e tregton bukën masive me peshë 900 gr me çmimin prej 100 lekë dhe bukën 450 gr me çmimin 40 lekë;
 25. Feriz Osmanollaj Nipti K67108201B, sipas deklaratës 26.04.2011 rezulton se ky subjekt e tregton bukën masive me peshë 900 gr me çmimin prej 120 lekë dhe bukën 450 gr me çmimin 60 lekë;
 26. Adhurim Metaj Nipti L16510204S sipas procesverbalit të mbajtur në datë 14.04.2011 rezultoi se ky subjekt e tregton bukën masive me peshë 900 gr me çmimin prej 120 lekë dhe bukën 450 gr me çmimin 60 lekë;
 27. Viron Qarri Nipti K67302204J, nga kuponi tatimor i lëshuar në datë 14.04.2011 rezulton se ky subjekt e tregton bukën masive me peshë 900 gr me çmimin prej 110 lekë dhe bukën 450 gr me çmimin 50 lekë ndërsa nga procesverbali i mbajtur në datë 14.04.2011 ka deklaruar se deri në datën e lëshimit të v endimit të KK 'Për marrjen e masave të përkohshme' ka aplikuar çmimi 120 lekë për bukën 900 gr dhe 60 lekë për bukën 450 gr;
 28. Algert Metani Nipti K96506204F, nga kuponi tatimor i lëshuar në datë 14.04.2011 rezulton se ky subjekt e tregton bukën masive me peshë 900 gr me çmimin prej 110 lekë dhe bukën 450 gr me çmimin 55 lekë;
 29. Blevim sh.p.k (Engjell Meminaj), Nipti K36419226Ë nga kuponi tatimor i lëshuar në datë 14.04.2011 rezulton se ky subjekt e tregton bukën masive me peshë 900 gr me çmimin prej 100 lekë dhe bukën 450 gr me çmimin 50 lekë;
 30. Shpendi Ymeraj Nipti K66709206Q, sipas deklaratës së datës 14.04.2011 rezulton se ky subjekt e tregton bukën masive me peshë 900 gr me çmimin prej 100 lekë dhe bukën 450 gr me çmimin 50 lekë;
 31. Dashamir Haruni Nipti L07107201O, në datë 11.04.2011 rezulton që buka masive shitet 120 L dhe 60 L. Aktualisht aktiviteti i tij figuron i mbyllur.
 32. Erjon Haruni Nipti K76904209 Ë, sipas deklaratës së datës 27.04.2011 dhe kuponave tatimor rezulton se buka masive 900 gr shitet me 110 lekë dhe buka masive 460 gr shitet 50 lekë.
 33. Gentian Hamzaraj, sipas deklaratës së datës 10.06.2011 rezulton se çmimi i tregtimit të bukës masive 900 gr ka qenë 110 Lek dhe bukës 450 gr 50 Lek
 34. Gjergji Simoni, sipas deklaratës së datës 09.06.2011 së datës rezulton se çmimi i tregtimit të bukës masive 900 gr ka qenë 120 lek dhe 450 gr 60 Lek.
 35. Migen Kozmai ka aplikuar pranë QKR për mbylljen e aktivitetit.
- 21– Nga sa më sipër rezulton se 20 nga 35 ndërmarrje kanë aplikuar çmimin e vendosur në mbledhjen e datës 21.03.2011, sjellje e cila bie në kundërshtim me nenin 4 pika 1, gërma (a), të Ligjit 9121, datë 23.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”.

22– Informacioni i mësipërm paraqitet në formë të përmbledhur në tabelën e mëposhtme:

Nr	Firmat që prodhojne bukë	Nr NIPT	Data/ora e kuponit	Nr.Kuponi	Cmimi
1	Spiro Koci	K86503203E	11.04.2011 09:49	3	120/60
2	Bexhet Selmanaj	K37227201E	11.04.2011 10:12	96	120/60
3	Esat Cakaj Nipti	K96708202F	11/04/11 11:45	67	120/60
4	Agron Hamzaraj	K86610201D	11/04/2011 12:09	6	100/50
5	Tomorr Ngucaj	K56803204S	11/04/2011 12:06	26	120/60
6	Fidan Osmanalla	K76910202T	11/04/2011 13:29	60	120/60
7	Spiro Baba	K46605210T	11/04/2011 12:46	26	120/60
8	Mirvjen Shehaj	L06912207R	14/04/2011 13:25	8	120/60
9	Arnaldo Baba	L06311204Q	11/04/2011 15:21	32	100/50
10	Adelina Rucaj	L06902209G	11/04/2011 16:08	11	120/60
11	Qemal Katia	K36410201P	11/04/2011 15:55	55	120/60
12	Kleanthi Rapushi	K76904202M	11/04/2011 17:26	40	120/60
13	Gentian Berberi	L06627205V	12/04/2011 9:56	20	120/60
14	Agim Skënderaj	K36218225M	Deklaratë datë 12.04.2011		120/60
15	Fatos Myslymi	K36410209K	12/04/2011 10:11	5	120/60
16	Fation Aliu	K86708208G	11/04/2011 16:02:00 MD	4	120/60
17	Feriz Osmanollaj	K67108201B	Deklaratë, datë 26.04.2011		120/60
18	Adhurim Metaj	L16510204S	Deklaratë , datë 14.04.2011		120/60
19	Viron Qarri	K67302204J	14/04/2011 10:35	105	110/50
20	Ngucaj sh.p.k	K36410202A	13.04.2011 17:40	14	100/50
21	Niko Nini	K77417202S	11/04/2011 12:18	6	100/50
22	Dilaver Mehilli	K36528213Q	Deklaratë, datë 11.04.2011		100/50
23	Arben Meminaj	K86318203E	12/04/2011 10:16	38	100/50
24	Maringlen Rushiti	K46426202M	12/04/2011 11:41	3	100/80
25	Alza sh.p.k	K46822202E	14/04/2011 10:50	41	100/40
26	Algert Metani	K96506204F	14/04/2011 11:19	22	110/50
27	Engjell Meminaj	K36419226w	14/04/2011 12:38	11	100/50
28	Shpendi Ymeraj	K66709206Q	Deklaratë, datë 14.04.2011		100/50
29	Dashmir Haruni	L07107201O	Rezulton l mbyllur		
30	Erjon Haruni	K76904209w	Deklaratë, datë 27.04.2011		110/50
31	Myslym Myslymi (Lulo)	K36410209K	Deklaratë, datë 10/06/11		100/50
32	Elmaz Myslymi (Agace)	K36410209K	Deklaratë, datë 09/06/11		120/60
33	Floreta Xhyheri (Gentian Hamzaraj)	L16615201A	Deklaratë, datë 09/06/11		110/50
34	Gjergji Simoni	L16808201Q	Deklaratë, datë 09/06/11		120/60
35	Migen Kozmai		Ka aplikuar për mbyllje		

23– Sipas tabelës së mësipërme del qartë se shumë subjekte nuk deklarojnë saktë shitjet e kryera, duke mos lëshuar kuponin tatimor për të gjitha shitjet. Referuar kuponave tatimorë, vihet re se disa subjekte në orët e mbasdites kanë lëshuar kupona me kërkesën e inspektorëve të Autoritetit të Konkurrencës vetëm 4, 6, 8 apo 11 kupona

tatimore, çka tregon qartë shkallën e lartë të informalitetit. Gjtitashtu kjo sjelljë përbën konkurrencë të pandershme ndaj prodhuesve të bukës që i deklarojnë saktë të gjitha shitjet e kryera, si dhe deformon analizën e konkurrencës së këtij tregu.

- 24– Një tjetër problem që vërehet është dhe mungesa e kasave fiskale në disa prej njësive të tregëtimit të bukës. Në mungesë të kasave për të vërtetuar çmimin e tregëtimit të bukës, Inspektorët e Autoritetit kanë mbajtur deklarata pranë këtyre njësive dhe vetëm pas ndërhyrjes së Autoritetit të Konkurrencës janë regjistruar disa biznese në organet tatimore.
- 25– Mungesa e kasave fiskale në disa njësi tregtare si dhe moslëshimi i kuponave tatimorë për të gjitha shitjen në disa njësi të tjera tregtimi, tregon shkallën e lartë të informalitetit në këtë treg, si dhe përbën konkurrencë të pandershme për njësitë tregtare të cilat deklarojnë plotësisht shitjet e kryera.

V. Analiza e konkurrencës

- 26– Sipas njoftimit në media të Shoqatës së Prodhuesve të Bukës të Qytetit të Vlorës, deklaratave të prodhuesve të bukës, rezulton se disa nga prodhuesit e bukës në qytetin e Vlorës janë mbledhur më datë 21.03.2011, për të formuar Shoqatën e Furrave të Bukës Vlorës. Në këtë datë, ata kanë vendosur që duke filluar nga data 23.03.2011, çmimi i tregëtimit të bukës masive 900 gr të jetë 120 lekë dhe çmimi i tregëtimit të bukës masive 450 gr të jetë 60 lekë. Më pas në shumicën e pikave të tregëtimit të bukës në qytetin e Vlorës është shpërndarë njoftimi i mëposhtëm:

“Shoqata e furrave të bukës Vlorë vendosi në datën 21.03.2011 që buka në datën 23.03.2011 të ketë këtë çmimin 900 gr = 120 lek dhe 450 gr = 60 lek”.

- 27– Gjatë inspektimeve të kryera, grupi i punës është informuar se Shoqata e Furrave të Bukës Vlorë, nuk është themeluar apo regjistruar pranë Regjistratit të Organizatave Jofitimprurëse pranë Gjykatës së rrethit Gjyqësor Tiranë, sipas legjislacionit në fuqi, si dhe përpjekja e bërë më datë 21.03.2011, për krijimin e kësaj Shoqate nuk është finalizuar.
- 28– Nga verifikimi i çmimit të tregëtimit të bukës masive 900 gr dhe 450 gr, me anë të kuponave tatimore ose deklaratave të dhëna nga ndërmarrjet nën hetim, rezulton se 20 prodhues buke në qytetin e Vlorës kanë aplikuar çmimin 120 lekë dhe 60 lekë, sipas vendimit të marrë më mbledhjen e datës 21.03.2011.
- 29– Referuar sa më sipër, prodhuesit e bukës kanë caktuar në mënyrë të drejtpërdrejtë çmimin e shitjes së produktit bukë masive 900 gr në 120 lekë dhe bukë masive 450 gr në 60 lekë. Kjo rritje e çmimit nga 100 lekë në 120 lekë (pra rritje e çmimit me 20%) konsiderohet me pasoja negative për konsumatorin përfundimtar.
- 30– *Në bazë të nenit 4, pika 1, gërma (a), të Ligjit 9121, datë 23.07.2003, “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, kjo sjellje përbën kufizim të konkurrencës në treg, duke caktuar në mënyrë të drejtpërdrejtë çmimet e shitjes së bukës.*

VI. Zbatimi i Vendimit të Komisionit të Konkurrencës Nr. 185, datë 07.04.2011

- 31– Vendimi i Komisionit të Konkurrencës Nr.185, datë 07.04.2011 “Për marrjen e masave të përkohshme për ndalimin e marrëveshjes në tregun e prodhimit dhe të tregëtimit të bukës në qytetin e Vlorës”, u është njoftuar prodhuesve dhe tregtuesve të bukës në Qytetin e Vlorës në datë 13.04.2011.

- 32– Për të verifikuar zbatimin e këtij vendimi grupi i punës kreu inspektime në datat 26 dhe 27 prill 2011, pranë prodhuesve të bukës duke administruar kuponat tatimor dhe deklarata nga subjekte të cilat kishin rritur çmimin e bukës nga data 23.04.2011. Nga informacioni i mbledhur rezultoi se subjektet e mëposhtme:
- 1– Bexhet Selmanaj Nipti K37227201E, nga procesverbali i datës 26.04.2011 dhe nga kuponi tatimor Nr 10 dhe 11, të datës 26.04.2011 rezultoi se vazhdon të tregtojë me çmimin 120 Lekë dhe 60 lekë;
 - 2– Esat Cakaj Nipti K96708202F, nga procesverbali i datës 26.04.2011 dhe nga kuponi tatimor Nr 87 dhe 88, të datës 26.04.2011 rezultoi se vazhdon të tregtojë me çmimin 120 Lekë dhe 60 lekë;
 - 3– Myslymi sh.p.k Nipti K36410209K, nga procesverbali i datës 26.04.2011 dhe nga kuponi tatimor Nr 21 dhe 22, të datës 26.04.2011 rezultoi se vazhdon të tregtojë me çmimin 120 Lekë dhe 60 lekë;
 - 4– Agim Skënderaj Nipti K36218225M, nga procesverbali i datës 26.04.2011 rezultoi se vazhdon të tregtojë me çmimin 120 Lekë dhe 60 lekë.
- 33– Pra 4 (katër) ndërmarrjet e mësipërme kanë vazhduar të tregtojnë me të njëjtat çmime si më parë, pra bukën 900 gr e kanë tregtuar me 120 lekë dhe bukën 450 gr e kanë tregtuar me 60 lekë, duke mos zbatuar vendimin e Komisionit të Konkurrencës Nr 185, datë 07.04.2011 ‘Për marrjen e masave të përkohshme’, sjellje e cila në bazë të nenit 74, pika 1 gërma (b) të ligjit Nr 9121, datë 28.07.2003 ‘Për mbrojtjen e konkurrencës’ përbën shkelje të rëndë.
- 34– Ndërsa ndërmarrjet e tjera kanë reflektuar vendimin e Komisionit të Konkurrencës duke rritur peshën e bukës masive ose duke ulur çmimin e tregtimit të bukës.

VII. Vlerësimi i shkeljes

- 35– Komisioni i Konkurrencës vlerëson se marrëveshja për rritjen dhe fiksimin e çmimit të tregtimit të bukës masive, e realizuar nga ndërmarrjet nën hetim që operojnë në tregun e prodhimit dhe tregtimit të bukës në qytetin e Vlorës, përbën një shkelje të rëndë të Ligjit “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, pasi kjo marrëveshje kufizon konkurrencën në këtë treg.
- 36– Komisioni i Konkurrencës në vlerësimin e shkeljes së Ligjit merr parasysh edhe disa rrethana lehtësuese si: (i) kohëzgjatja e shkurtër e shkeljes, (ii) bashkëpunimi i palëve nën hetim me Autoritetin e Konkurrencës gjatë gjithë procedurës, (iii) reagimi i menjëhershëm nga subjektet duke ulur çmimin e tregtimit të bukës masive pas vendimit të Komisionit të Konkurrencës për marrjen e masave të përkohshme, (iv) shkalla e lartë e informalitetit që shprehet në ekzistencën e bizneseve të pa licencuara dhe mos raportimin e saktë të faturave tatimore, (v) mungesa e bilanceve për 12 nga 20 subjekte nën hetim (edhe pas kërkesës për informacion drejtuar Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Vlorë të përsëritur disa herë nga ana jonë).
- 37– Advokacia e konkurrencës është një nga synimet kryesore të Autoritetit të Konkurrencës dhe kërkon bashkëveprimin e një sërë institucionesh që me veprimet apo mosveprimet e tyre ndikojnë në konkurrencën mes lojtarëve të tregut. Në këto kushte përdorimi i instrumentit të avokatisë nëpërmjet procedurave hetimore, organizimit të seancës dëgjimore dhe vendimit për masa të përkohshme, së bashku me vendosjen e masave ndëshkuese mundësojnë zbatimin e plotë të ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës” me qëllimin final sigurimin e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të nenit 4, pika 1, germa (a), nenit 24, shkronja d), nenit 45, pika 1, nenit 70, pika 2, nenit 74, pika 1, germa “a” dhe “b”, si dhe nenit 80 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

- I. Mbylljen e hetimit të thelluar në tregun e prodhimit dhe tregtimit të bukës 900 gr dhe 450 gr në qytetin e Vlorës;
- II. Të gjobisë në shumën 10 000 (dhjetëmijë) lekë, ndërmarrjet që kanë zbatuar marrëveshjen për fiksimin e çmimit si vijon:
 1. Spiro Koci Nipti K86503203E
 2. Bexhet Selmanaj Nipti K37227201E
 3. Esat Cakaj Nipti K96708202F
 4. Agron Hamzaraj Nipti K86610201D
 5. Tomorr Ngucaj Nipti K56803204S
 6. Fidan Osmanallai Nipti K76910202T
 7. Shoqëria Paolo Nipti K46605210T
 8. Mirvjen Shehaj Nipti L06912207R
 9. Arnaldo Baba Nipti L06311204Q
 10. Adelina Rucaj Nipti L06902209G
 11. Arbri sh.p.k Nipti K36410201P
 12. Kleanthi Rapushi Nipti K76904202M
 13. Gentian Berberi Nipti L06627205V
 14. Agim Skënderaj Nipti K36218225M
 15. Myslymi sh.p.k Nipti K36410209K
 16. Fation Aliu Nipti K86708208G
 17. Feriz Osmanallaj Nipti K67108201B
 18. Adhurim Metaj Nipti L16510204S
 19. Viron Qarri Nipti K67302204J
 20. Gjergji Simoni Nipti L16808201Q
- III. Të gjobisë në shumën 10 000 (dhjetëmijë) lekë, ndërmarrjet që nuk kanë zbatuar Vendimin e Komisionit të Konkurrencës Nr.185, datë 07.04.2011, “Për marrjen e masave të përkohshme për ndalimin e marrëveshjes në tregun e prodhimit dhe tregtimit të bukës në qytetin e Vlorës”, si vijon:
 1. Bexhet Selmanaj Nipti K37227201E
 2. Esat Cakaj Nipti K96708202F
 3. Myslymi sh.p.k Nipti K36410209K
 4. Agim Skënderaj Nipti K36218225M

- IV. I rekomandohet Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve të evidentojë shkallën e lartë të informalitetit dhe përdorimin e kasave fiskale tek subjektet që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në prodhimin dhe tregtimin e bukës në qytetin e Vlorës;
- V. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe për komunikimin e tij ndërmarrjeve të mësipërme, si dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURENCËS

Servete Gruda
()
Anëtar

Koço Broka
()
Anëtar

Rezana Konomi
()
Anëtar

Lindita Milo (Lati)

K R Y E T A R



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 203, Datë 08.11.2011

Për miratimin e Rregullores “Për marrëveshjet me rëndësi të vogël”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Servete Gruda Anëtar
- Koço Broka Anëtar
- Rezana Konomi Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 08. 11 .2011, dhe në mbështetje të nenit 24 germa dh) dhe nenit 7 të Ligjit nr 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Miratimin e rregullores “Për marrëveshjet me rëndësi të vogël” në zbatim të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar);

Baza ligjore: Neni 24, germa dh) dhe neni 7 i Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar);
 Rregullorja “Për marrëveshjet me rëndësi të vogël” miratuar me Vendimin Nr. 121, datë 10.09.2009 të Komisionit të Konkurrencës, ndryshuar me Vendimin nr 164, datë 14.12.2010 të Komisionit të Konkurrencës.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të Projekt-Rregullores “Për marrëveshjet me rëndësi të vogël”,

VENDOSI:

1. Të miratojë Rregulloren “Për marrëveshjet me rëndësi të vogël”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Rregullorja “Për marrëveshjet me rëndësi të vogël” miratuar me vendimin nr 121, datë 10.09.2009 të Komisionit të Konkurrencës, ndryshuar me Vendimin nr 164, datë 14.12.2010 të Komisionit të Konkurrencës, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURENCËS

Servete Gruda
()
Anëtar

Koço Broka
()
Anëtar

Rezana Konomi
()
Anëtar

Lindita Milo (Lati)

K R Y E T A R

RREGULLORE
“PËR MARRËVESHJET ME RËNDËSI TË VOGËL ”

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i kushteve që duhet të përmbushin marrëveshjet me rëndësi të vogël, si dhe i kufizimeve që këto marrëveshje nuk duhet të përmbajnë, në mënyrë që të përjashtohen nga ndalimi në zbatim të nenit 7 të Ligjit nr 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”(i ndryshuar)”.

Neni 2

Përkufizime

Në kuptim të kësaj rregulloreje:

1. “Ndërmarrje” është çdo person fizik ose juridik, privat ose publik, që kryen veprimtari ekonomike. Si ndërmarrje konsiderohen edhe organet e administratës qendrore dhe vendore, entet ose institucionet publike kur kryejnë veprimtari ekonomike.
2. “Ndërmarrje të lidhura” janë ato ndërmarrje të cilat direkt ose indirekt:
 - kanë fuqinë të ushtrojnë më tepër sesa gjysmën e të drejtave të votës;
 - kanë fuqinë të caktojë më tepër sesa gjysmën e anëtarëve të bordit mbikëqyrës, bordit menaxherial ose përfaqësuesit ligjor të ndërmarrjes; ose
 - kanë fuqinë të menaxhojë veprimtarinë e ndërmarrjes.
3. Shitjet aktive, janë ato që synojnë të sigurojnë klientët të cilët janë pjesë e një territor ekskluziv shpërndarjeje ose bëjnë pjesë në një grup klientësh ekskluziv.
4. Shitje pasive, janë shitjet e kryera për plotësimin e kërkesave të klientëve individualë, duke ofruar shpërndarjen e produkteve të këta klientë.

Neni 3

Rregulla të përgjithshme

1. Neni 4 i Ligjit ndalon marrëveshjet ndërmjet ndërmarrjeve të cilat mund të kenë si objekt ose pasojë pengimin, kufizimin ose shtrembërimin e konkurrencës në treg.
2. Marrëveshjet ndërmjet ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, në shumë pak raste mund të ndikojnë në konkurrencën në treg.
3. Autoriteti, për marrëveshjet që plotësojnë kriteret e kësaj rregulloreje, nuk fillon procedurat hetimore.

4. Kjo rregullore gjithashtu aplikohet për vendimet e bashkimeve të ndërmarrjeve dhe për praktikatat bashkërenduese.

KREU II

Marrëveshjet me rëndësi të vogël

Neni 4

Kuptimi i marrëveshjeve me rëndësi të vogël

1. Konsiderohen si marrëveshje që nuk kufizojnë ndjeshëm konkurrencën në kuptim të nenit 4 të Ligjit :
 - a. Marrëveshjet e lidhura ndërmjet ndërmarrjeve, të cilat janë konkurrentë aktualë ose potencialë, kur totali i pjesës së tregut të palëve në marrëveshje nuk tejkalon 10% në secilin prej tregjeve përkatëse të ndikuar nga marrëveshja (marrëveshje ndërmjet konkurrentëve).
 - b. Marrëveshjet e lidhura ndërmjet ndërmarrjeve ,të cilat nuk janë konkurrentë aktualë ose potencialë, kur pjesa e tregut e secilës palë në marrëveshje nuk tejkalon 15% të secilit nga tregjet përkatëse të ndikuar nga marrëveshja (marrëveshje ndërmjet jo-konkurrentëve).

Në rast pamundësie të klasifikimit të marrëveshjes si marrëveshje ndërmjet konkurrentëve ose jo-konkurrentëve, atëherë është i zbatueshëm kriteri i pjesës së tregut prej 10 për qind.

2. Kur konkurrenca në tregun përkatës, kufizohet nga efekti kumulativ i një marrëveshjeje për shitjen e produkteve të ofruara nga ndërmarrje të ndryshme, pjesa e tregut sipas pikës 1 të këtij neni reduktohet në 5%, si për marrëveshjet ndërmjet konkurrentëve ashtu edhe për marrëveshjet ndërmjet jo-konkurrentëve.
3. Marrëveshjet nuk kufizojnë konkurrencën nëse gjatë dy viteve të njëpasnjëshme kalendarikë, pjesët e tregut të palëve në marrëveshje (sipas pikës 1 dhe 2 të këtij neni) nuk tejkalojnë 2%.
4. Për të llogaritur pjesën e tregut është e nevojshme të përcaktohet tregu përkatës bazuar në udhëzimin “Për përcaktimin e tregut përkatës”. Pjesët e tregut duhet të llogariten mbi bazën e vlerës së shitjeve ose kur është e përshtatshme të vlerës së blerjeve. N.q.s të dhënat në vlerë nuk janë të disponueshme përdoren vlerësimet bazuar në informacionet e tjera të vlefshme të tregut.

Neni 5

Kufizimet e rënda të konkurrencës në marrëveshjet midis konkurrentëve

1. Neni 4 i kësaj rregulloreje, nuk zbatohet për marrëveshjet që përmbajnë kufizime të rënda të konkurrencës në marrëveshjet midis konkurrentëve.
2. Kufizime të rënda të konkurrencës në marrëveshjet midis konkurrentëve janë ato të cilat direkt ose indirekt, veçmas ose të kombinuar me faktorë të tjerë nën kontrollin e palëve kanë për objekt:

- a) Fiksimin e çmimeve kur shiten produkte tek palët e treta;
- b) Kufizimin e prodhimit ose të shitjeve;
- c) Ndarjen e tregjeve ose ndarjen e konsumatorëve.

Neni 6

Kufizime të rënda të konkurrencës në marrëveshjet midis jo-konkurrentëve

1. Neni 4 i kësaj rregulloreje, nuk zbatohet për marrëveshjet që përmbajnë kufizime të rënda të konkurrencës në marrëveshjet midis jo-konkurrentëve.
2. Kufizime të rënda të konkurrencës në marrëveshjet midis jo-konkurrentëve janë ato të cilat direkt ose indirekt, veçmas ose të kombinuar me faktorë të tjerë të cilat kanë për objekt:
 - a) Kufizimin e shpërndarësit për të përcaktuar çmimin e tij të shitjes;
 - b) Kufizimin e territorit ose të klientëve, ku shpërndarësi mundet të shesë produkte;
 - c) Kufizimin e shitjeve aktive ose pasive, tek konsumatorin përfundimtar, nga pjesëmarrësit e sistemit përzgjedhës të shpërndarjes, që operojnë në nivelin e shitjes me pakicë;
 - d) Kufizimin midis ofruesit të pjesëve përbërëse të një produkti për shitjen e tyre vetëm tek blerësi, i cili i përdor këto elementë për të prodhuar produktin përfundimtar. Nëpërmjet kësaj marrëveshjeje, kufizohet mundësia e ofruesit për t'i shitur këto pjesë përbërëse direkt tek konsumatori përfundimtar ose te riparuesit.
3. Nuk konsiderohen kufizime sipas pikës 2 të këtij neni rastet e mëposhtme:
 - (i) Shitjet aktive në territore ekskluzive ose tek një grup klientësh ekskluziv;
 - (ii) Shitjet tek klientët përfundimtar nga shpërndarësi që operon në tregun e shitjes me shumicë,
 - (iii) Shitjet tek shpërndarësit e paautorizuar nga pjesëmarrësit e sistemit përzgjedhës të shpërndarjes;
 - (iv) Shitja e pjesëve përbërëse të një produkti, që ofrohen me qëllim prodhimin e një produkti përfundimtar, nga shpërndarësi tek klientët, që mund ti përdornin ato për të prodhuar të njëjtin tip (lloj) të produkteve si ato të prodhuara nga ofruesi.

Neni 7

Kufizime të rënda të konkurrencës në marrëveshjet ndërmjet konkurrentëve në raste të veçanta

Neni 4 i kësaj rregulloreje, nuk zbatohet për marrëveshjet që përmbajnë kufizime të rënda të konkurrencës në marrëveshjet midis konkurrentëve. Në këto raste konkurrentët veprojnë, për qëllime të marrëveshjes, në nivele të ndryshme të zinxhirit të shpërndarjes së produktit dhe që lidhet me një nga kufizimet e rënda sipas nenit 5 dhe 6 të kësaj rregulloreje.

KREU III

Dispozita të tjera

Neni 8

Hyrja në fuqi

Rregullorja “Për marrëveshjet me rëndësi të vogël” , miratuar me vendimin nr 121, datë 10.09.2009 të Komisionit të Konkurrencës, ndryshuar me Vendimin nr 164, datë 14.12.2010 të Komisionit të Konkurrencës shfuqizohet.

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 204, Datë 14.11.2011

“Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e ofrimit të shërbimit të telefonisë fikse me anë të kartave me parapagesë”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Servete Gruda Anëtar
- Koço Broka Anëtar
- Rezana Konomi Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 14. 11.2011, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Raporti i monitorimit në tregun e ofrimit të shërbimit të telefonisë fikse me anë të kartave me parapagesë”;

Baza ligjore: Nenet: 24, (shkronja d); 26 dhe 42, (pika 1); të Ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si dhe neni 12 i Rregullores “Për funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:

- Raportit të monitorimit në “Tregun e ofrimit të shërbimit të telefonisë fikse me anë të kartave me parapagesë”, të paraqitur nga Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës;
- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës,

VËREN SE:

I. PROCEDURA E NDJEKUR

- (1). Në bazë të ankesës së ardhur pranë Autoritetit të Konkurrencës nga ndërmarrja “ALBAN-TIRANA NASCENDO AL” SHA, me Nr.240 Prot., datë 08.06.2011, Sekretari i Përgjithshëm i Autoritetit të Konkurrencës, me anë të Urdhrit Nr.54 Prot., datë 23.06.2011 ngriti Grupin e Punës “Për monitorimin e tregut të shërbimit të telefonisë fikse me parapagesë (kartat e parapaguara).

II. KUADRI LIGJOR RREGULLATOR

- (2). Komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë rregullohen me anë të Ligjit Nr.9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i cili si qëllim të tij, të përcaktuar në nenin 1 të tij, ka që nëpërmjet parimit të asnjësisë teknologjike të promovojë konkurrencën dhe infrastrukturë eficiente në komunikimet elektronike dhe të garantojë shërbimet e duhura dhe të përshtatshme në RSH.
- (3). Operatorët e Shërbimit të Kartave me Parapagesë (vijim-OSHKP), për të ushtruar veprimtarinë e tyre në ofrimin e shërbimeve elektronike, duhet të pajisen paraprakisht nga AKEP-i me një Autorizim të Përgjithshëm për të patur të drejtën e ofrimit të këtyre shërbimeve.
- (4). Këta operatorë, OSHKP, për të kryer veprimtarinë e tyre duhet të kenë patjetër akses dhe interkoneksion në rrjetin e ndërmarrjes ALBTELECOM SHA, duke marrë nga kjo ndërmarrje Origjinimin, Terminimin apo Tranzitimin e thirrjeve. Aksesit dhe interkoneksioni janë të rregulluar në Ligjin Nr.9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” dhe një ndër kompetencat e AKEP-it, e përcaktuar në nenin 8, pika (b) është rregullimi i aksesit dhe interkoneksionit midis rrjeteve të komunikimeve elektronike, në përputhje me përcaktimet e këtij ligji, akteve nënligjore në zbatim të tij, si dhe të sigurojë që sipërmarrësit të mos diskriminohen dhe të kenë mundësi të barabarta, kushte transparente, objektive dhe të ndershme.
- (5). AKEP, në zbatim të kompetencave të tij të përcaktuara në Ligj, ka hartuar Dokumentin “Analizë e Tregut të Telefonisë Fikse: Tregjet me pakicë të aksesit dhe thirrjeve telefonike nga vendndodhje fikse dhe tregjet me shumicë të terminimit, origjinimit dhe tranzitimit në rrjete fikse: Dokumenti Përfundimtar”, i cili është përgatitur pas kryerjes së këshillimit publik dhe përmban komentet e palëve të interesuara dhe qëndrimin e AKEP-it për komentet në përputhje me nenin 35 të Ligjit nr. 9918. Në zbatim të Analizës së mësipërme, duke vlerësuar dhe pozitën në tregjet përkatëse të sipërmarrësit ALBTELECOM SHA, Bordi Drejtues i AKEP-it, me Vendimin Nr.1348, datë 26. 07. 2010 Për “Përcaktimin e sipërmarrësit Altelecom Sh.a., me Fuqi të Ndjeshme në Treg dhe vendosjen e masave rregulluese në tregjet me pakicë të telefonisë fikse dhe tregjet me shumicë të interkoneksionit të telefonisë fikse” (Vendimi Nr. 1348), ka vendosur të përcaktojë sipërmarrësin Altelecom Sh.a., sipërmarrës me Fuqi të Ndjeshme në Treg (FNT) në disa tregje përkatëse për të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë përfshi: (i) *Tregun e terminimit të thirrjeve drejt numrave gjeografike në rrjetin fiks të Altelecom;* (ii) *Tregun përkatës të origjinimit të thirrjeve nga vendndodhje fikse.* (iii) *Tregun përkatës të tranzitimit të thirrjeve kombëtare në rrjet fiks.*
- (6). Pra, referuar Vendimit Nr. 1348, ndërmarrja ALBTELECOM SHA është shpallur FNT në tregjet e Terminimit të thirrjeve drejt numrave gjeografike në rrjetin fiks të ALBTELECOM, origjinimit të thirrjeve nga vendndodhje fikse dhe tranzitimit të thirrjeve kombëtare në rrjet fiks dhe për pasojë, ndër të tjera, ka dhe detyrimin për akses, interkoneksion, përdorimin e përbashkët të facilitetit dhe kontrollin e tarifave. Në këtë mënyrë, ndërmarrja ALBTELECOM SH.A., për terminimin, origjinimin dhe tranzitimin e thirrjeve në rrjetin ALBTELECOM, duhet t’u ofrojë palëve të treta akses dhe interkoneksion në rrjet dhe elementet e tij, si dhe do të ofrojë terminim të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare në nivel shumice, për t’u rishitur nga operatorët e autorizuar nga AKEP-i.

- (7). Referuar shkresës së AKEP-it Nr.1583 Prot., datë 06.10.2011, ky organ ka miratuar dokumentin “Orientimi në Kosto i Tarifave të Shërbimeve Celulare të Operatorëve me FNT” me Vendimin e Këshillit Drejtues Nr.1505, datë 10.02.2011, objekt i të cilit janë rregullimi i tarifave të shërbimit të origjinimit dhe terminimit të thirrjeve nga operatorët celularë.

III. PËRSHKRIMI SITUATËS NË TREGUN E KARTAVE TË PARAPAGUARA

Sipas të dhënave zyrtare të publikuara nga AKEP www.akep.gov.al, janë 21 shoqëri¹ tregtare (operatorë) të licencuara për ofrimin e shërbimit të telefonisë fikse me kartat e parapaguara (OSHKP). Këta operatorë, për të kryer veprimtarinë e tyre e kanë të domosdoshëm aksesin në rrjetin e ndërmarrjes ALBTELECOM SHA, pasi klientët e tyre duhet të kenë një numër telefoni fiks për të përdorur kartat me parapagesë të OSHKP.

Elementët kryesorë që nevojiten për të ofruar thirrje (shërbime) telefonike (fikse) me karta me parapagesë në nivel pakice janë origjinimi i thirrjes, tranzitimi i thirrjes midis centraleve tranzite dhe terminimi i thirrjes. Për të ofruar shërbime telefonike me pakicë një OSHKP mund t’i blejë këto elemente veç e veç ose së bashku, t’i prodhojë të gjitha vetë duke ndërtuar një rrjet gjithëpërfshirës, ose të blejë disa elemente dhe të prodhojë të tjerat.

- i. **Origjinimi i thirrjes** përfshin përcjelljen e thirrjes nga linja e përdoruesit fundor deri tek elementi tjetër i thirrjes (tranzitim apo terminim) në central lokal apo tranzit.
 - ii. **Tranzitimi** përcjell thirrjet telefonike nga centrali lokal deri në elementin e terminimit të thirrjes në central lokal apo tranzit. Tranzitimi përfshin të paktën një central tranzit.
 - iii. **Terminimi i thirrjes** përcjell thirrjen telefonike nga centrali lokal apo tranzit tek linja e përdoruesit fundor.
- (8). Ndërmarrja ALBTELECOM SHA zotëron 100% të tregut të aksesit (origjinim, terminim dhe tranzitim) për ofrimin e telefonisë fikse me Kartat e Parapaguara, çka do të thotë që kjo ndërmarrje ka pozitë dominuese në këtë treg.
- (9). Shërbimi i telefonisë fikse me karta të parapaguara kryhet nëpërmjet marrëveshjeve ndërlidhëse që operatorët, të cilët ofrojnë këtë shërbim lidhin me ndërmarrjen ALBTELECOM SHA. Ky i fundit zotëron lehtësirat e nevojshme për aksesin, terminimin, origjinimin dhe tranzitimin e thirrjeve, me anë të të cilave operatorët e tjerë të tregut kryejnë apo ofrojnë për klientët shërbimin e kartës me parapagesë.
- (10). Tarifat e shërbimit të origjinimit, terminimit dhe tranzitimit të thirrjeve për bartësit e thirrjeve nëpërmjet zgjedhjes/parazgjedhjes së bartësit dhe për ofruesit e shërbimeve me kartë të parapaguar, të ofruara nga ndërmarrja ALBTELECOM SHA, janë objekt kontrolli dhe rregullimi nga AKEP-i, i cili në Vendimin Nr.1348 ka rregulluar ato, duke vendosur tarifat maksimale të terminimit, origjinimit dhe tranzitimit të thirrjeve në rrjetin ALBTELECOM për periudhën deri më 21.08.2010 dhe për periudhën nga 01.09.2010. Këto tarifa, nga data 01.09.2010 kanë pësuar një rritje të ndjeshme, pasi referuar Analizës së AKEP, tarifat me shumicë të ALBTELECOM SHA (interkoneksioni) rezultojnë të jenë nën-koston e ofrimit eficient BULRAIC

¹ Aneksi Nr. Lista e shoqerive të licensuara për shërbimin e kartave të parapaguara në telefoninë fikse. Pse nuk kemi një informacion zyrtar nëse të gjitha shoqeritë e licensuara vazhdojnë aktivitetin.

(sipas rezultateve të modelit BULRAIC publikuar në faqen e internetit të AKEP), gjithashtu aplikimi i një tarife fikse për thirrje është i justifikuar nga kostot e vendosjes së thirrjes (set up) dhe karakteristikë në shumë vende të BE-së.

- (11). Sipas këtij Vendimi, për ofruesit e shërbimeve me kartë të parapaguar, tarifat e origjinimit, terminimit dhe tranzitimit të thirrjeve, aplikohen vlerat sipas segmentit përkatës dyfish në rrjetin Altelecom. Pra, një Operator i Shërbimeve të Kartave të Parapaguara (OSHKP) nëse merr nga ndërmarrja ALBTELECOM SHA shërbimin e origjinimit të thirrjes paguan 3.5 lekë/min pa TVSH (4.2 lekë/min me TVSH), për shërbimin e terminimit të thirrjes paguan 3.5 lekë/min pa TVSH (4.2 lekë/min me TVSH) dhe për shërbimin e tranzitimit të thirrjes paguan 2.5 lekë/min pa TVSH (3 lekë/min me TVSH), si dhe për çdo thirrje paguan 0.83 lekë/thirrje pa TVSH (0.996 lekë me TVSH).
- (12). Ndërmarrja ALBTELECOM SHA, përveç shërbimeve të tjera në fushën e komunikimeve elektronike, ka filluar dhe ushtrimin e veprimtarisë në ofrimin e shërbimit të kartave me parapagesë, duke hedhur në treg kartën ALBLUE, për të cilën ankohet dhe ndërmarrja “ALBAN-TIRANA NASCENDO AL” SHPK.
- (13). Referuar përgjigjes së ndërmarrjes ALBTELECOM SHA, Karta e Parapaguar ALBLUE ofrohet në treg me çmimin 500 lekë me TVSH dhe thirrjet telefonike kryhen me tarifën 5 lek/min. Brenda rrjetit të Altelecom dhe 7.5 lek/min ndaj operatorëve alternativë fikse.
- (14). Nga krahasimi i tarifave të përdorura vërehet se operatorët që ofrojnë shërbimin e telefonisë fikse me anë të kartave me parapagesë aplikojnë çmime të ndryshme drejt rrjeteve fikse dhe drejt rrjeteve celularë, si për thirrjet kombëtare edhe për thirrjet ndërkombëtare.
- (15). Nga krahasimi i tarifave që aplikohen nga ndërmarrja ALBTELECOM SHA me anë të Kartave me Parapagesë ALBLUE, me tarifën që aplikon ndërmarrja “ALBAN-TIRANA NASCENDO AL” SHPK me anë të Kartave me Parapagesë ALBAN TIRANA, konstatojmë se tarifën e Altelecom janë më të ulëta.

Komisioni i Konkurrencës, duke patur parasysh se:

1. Ndërmarrja ALBTELECOM SHA ushtron veprimtarinë e saj në dy nivele të tregjeve, përkatësisht në tregun me shumicë të origjinimit, terminimit dhe tranzitimit të thirrjeve në rrjetin Altelecom, ku kjo ndërmarrje është shpallur FNT nga AKEP-i dhe tarifën e saj janë të rregulluara, si dhe në tregun me pakicë, në atë të Ofrimit të Shërbimit të telefonisë fikse me anë të Kartave me Parapagesë, i cili është një treg i parregulluar.
2. Ndërmarrja ALBTELECOM SHA zotëron 100% të tregut të aksesit (origjinim, terminim dhe tranzitim) për ofrimin e telefonisë fikse me Kartat e Parapaguara, Aktualisht të gjithë OSHKP-të, për të kryer veprimtarinë e tyre në ofrimin e Kartave me Parapagesë duhet domosdoshmërisht të përdorin rrjetin e Altelecom për të kryer thirrjen, duke marrë nga Altelecom minimalisht shërbimin e origjinimit, tarifën e të cilit janë të rregulluara nga AKEP.
3. Aplikimi nga ana e ndërmarrjes ALBTELECOM SHA i çmimeve më të ulëta në nivelin e pakicës me anë të Kartës ALBLUE, se çmimet e aplikuar nga ndërmarrjet e tjera që ushtrojnë veprimtari në ofrimin e kartave me parapagesë, mund të çojë në vendosjen në një gjendje të vështirë ose në daljen nga tregu të këtyre të fundit.

Si konkluzion, kjo sjellje e ndërmarrjes ALBTELECOM SHA, në kuptim të nenit 9, pika 2, germa (a) të Ligjit Nr.9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, mund të përbëjë abuzim me pozitën dominuese të kësaj ndërmarrje në tregun ofrimit të shërbimit të telefonisë fikse me anë të Kartave me Parapagesë.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës në zbatim të nenit 42, pika 1 të ligjit nr. 9121 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, (i ndryshuar), dhe me synim identifikimin nëse kushtet e tregut sigurojnë konkurrencë të lirë dhe efektive,

VENDOSI:

- I. Të miratojë hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e ofrimit të shërbimit të telefonisë fikse me anë të kartave me parapagesë.
- II. Periudha e hetimit do të jetë nga Janar 2010 deri më Nentor 2011.
- III. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për ndjekjen e procedurave hetimore të parashikuara në Ligj dhe aktet nënligjore dhe përgatitjen e raportit të hetimit paraprak, jo më vonë se data 30 Janar 2012.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete Gruda

(_____)

Anëtar

Koço Broka

(_____)

Anëtar

Rezana Konomi

(_____)

Anëtar

Lindita Milo (Lati)

K R Y E T A R



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS

VENDIM

Nr. 205, Datë 14.11.2011

“Për një rekomandim për Ministrin e Arsimit dhe Shkencës për ndryshimin e udhëzimit nr. 36, dt. 9.9.2011 “Për një ndryshim në Udhëzimin nr. 25, dt. 20.07.2011” Për procedurat e pranimit dhe të regjistrimit në ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë në institucionet publike të arsimit të lartë”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Servete Gruda Anëtar
- Koço Broka Anëtar
- Rezana Konomi Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 14. 11.2011, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Vlerësimi i ankesës së Shoqatës Shqiptare të Bankave lidhur me ndryshimet në udhëzimin e Ministrisë të Arsimit për procedurat e pagesës për pranimin dhe rregjistrimin në ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë në institucionet publike të arsimit të lartë;

Baza ligjore: Neni 24, germa d) e f), neni 69 dhe neni 70, pika 2, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar (këtu e si vijon Ligji).

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:

- Relacionit të Grupit të Punës “Mbi shqyrtimin e ankesës së Shoqatës Shqiptare të Bankave lidhur me ndryshimet rregullatore të veprimeve me transfertat e thesarit”;
- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës,

VËREN SE:

- (1). Shoqata Shqiptare e Bankave, me anë të shkresës Nr. 35 Prot, datë 05.10.2011, ka paraqitur pranë Autoritetit të Konkurrencës një ankesë lidhur me përjashtimin e bankave nga tregu i shërbimit të pagesës për regjistrimin në institucionet publike të arsimit të lartë. Sipas ankimesit, bazuar në Udhëzimin e Ministrisë të Arsimit dhe

Shkencave nr. 36, dt. 9.9.2011 “Për një ndryshim në Udhëzimin nr. 25, dt. 20.07.2011 “Për procedurat e pranimit dhe të regjistrimit në ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë në institucionet publike të arsimit të lartë për vitin akademik 2011-2012”, të gjitha pagesat për sistemin e lartë arsimor në fakultete për këtë vit akademik është urdhëruar të kryhen vetëm nëpërmjet filialeve të Postës ndërkohë që më parë kryheshin nëpërmjet filialeve të bankave të nivelit të dytë.

- (2). Udhëzimi i sipërcituar ka dalë në zbatim të VKM nr. 241, dt. 31.03.2011, në bazë të Ligjit nr.8530, datë 23.9.1999 “Për shërbimin postar në Republikën e Shqipërisë”, (të ndryshuar), sipas të cilit i është dhënë Postës Shqiptare e drejta e kryerjes së: shërbimeve postare, shërbimeve financiare të cilat nuk bien në kundërshtim me legjislacionin aktual, si dhe shërbimeve të tjera, që janë në përputhje me veprimtarinë e kësaj poste, për institucionet e qeverisjes qendrore e vendore, institucionet e tjera publike, si dhe shoqëritë tregtare me kapital shtetëror. Në këtë mënyrë “Posta Shqiptare” sh.a do të jetë ofruesi i vetëm për shërbimet postare dhe shërbimet financiare që nuk bien në kundërshtim me legjislacionin aktual, si dhe ofrues i parë i shërbimeve të tjera që janë në përputhje me veprimtarinë e “Posta Shqiptare” sh.a., për llogari të institucioneve të lartpërmendura.
- (3). Ministri i Arsimit dhe Shkencës, bazuar në Ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, (sipas nenit 33 të të cilit ministri miraton, me udhëzim, kriteret dhe procedurat e pranimit në ciklin e parë të studimeve), ka miratuar Udhëzimin nr. 25, datë 20.07.2011 “Për procedurat e pranimit dhe të regjistrimit në ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë në institucionet publike të arsimit të lartë për vitin akademik 2011-2012”, udhëzim i cili është ndryshuar me Udhëzimin nr. 36, dt. 9.9.2011.
- (4). Problemi për të cilin ankohet Shoqata e Bankave ka lindur me miratimin e udhëzimit të Ministrit të Arsimit dhe Shkencave nr. 36, dt. 09.09.2011 “Për një ndryshim në Udhëzimin nr. 25, dt. 20.07.2011”, sipas të cilit të gjitha pagesat për sistemin e lartë arsimor në fakultete për këtë vit akademik është urdhëruar të kryhen nëpërmjet filialeve të Postës Shqiptare. Para këtij ndryshimi pagesat si më sipër kryeshin në një nga bankat e nivelit të dytë. Ky ndryshim është bërë bazuar në VKM nr. 241, dt. 31.03.2011, por ndryshe nga udhëzimi paraardhës që caktonte filialet e bankave për kryerjen e këtij shërbimi, udhëzimi nr. 36, date 09.09.2011 ka përcaktuar vetëm filialet e “Posta Shqiptare” sh.a për kryerjen e këtij shërbimi, duke përjashtuar filialet e bankave. Ky udhëzim ndryshe nga VKM nr.241 date 31.03.2011, e cila parashikon kryerjen e shërbimeve nëpërmjet “Posta Shqiptare” për shërbimet financiare që nuk bien në kundërshtim me legjislacionin aktual, kufizon mundësinë e perzgjedhjes së sportelit të shërbimit nga studentet .
- (5). Megjithëse ky shërbim financiar mund të kryet jo vetëm nga Posta Shqiptare, por edhe nga Bankat, udhëzimi i Ministrit të Arsimit dhe Shkencave nr. 36, dt. 9.9.2011 për një ndryshim në Udhëzimin nr. 25, dt. 20.07.2011, përcakton kryerjen e këtyre pagesave vetëm nëpërmjet filialeve të Postës Shqiptare, duke përbërë një kufizim për konkurrencën në tregun përkatës pasi këtë shërbim e ofronin dhe mund ta ofrojnë edhe bankat e nivelit të dytë sipas tarifave përkatëse.
- (6). Caktimi i një operatori të vetëm për kryerjen e shërbimit të pagimit të tarifave për regjistrimin e studentëve në një kohë që ky shërbim mund të ofrohet nga të gjithë bankat e nivelit të dytë përbën një kufizim të konkurrencës mes operatorëve për

ofrimin e këtij shërbimi në tregun përkatës duke kufizuar në këtë mënyrë lirinë e zgjedhjes së konsumatorëve.

- (7). Bazuar në nenin 69, pika 1, germa a të Ligjit “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, duhet të kishte marrë para miratimit vlerësimin e Autoritetit të Konkurrencës pasi sjell vendosjen e të drejtave ekskluzive për ndërmarrjen Posta Shqiptare sh.A.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, germa d) e f), nenin 70, pika 2, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, me propozim të Sekretariatit,

VENDOSI:

1. T’i rekomandojë Ministrit të Arsimit dhe Shkencave që të ndryshojë Udhëzimit nr. 36, dt. 9.9.2011 në mënyrë që të shmangë kufizimet për konkurrencën në tregun e shërbimeve financiare dhe të mundësojë që pagesat e rregjistrimit në ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë në institucionet publike të arsimit të lartë të kryhen si nëpërmjet filialeve të Postës Shqiptare ashtu edhe në filialet e bankave të nivelit të dytë.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e këtij vendimi Ministrit të Arsimit dhe Shkencave si dhe Shoqatës Shqiptare të Bankave.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete Gruda

(_____)

Anëtar

Koço Broka

(_____)

Anëtar

Rezana Konomi

(_____)

Anëtar

Lindita Milo (Lati)

K R Y E T A R



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 206, Datë 18.11.2011

Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet bashkimit me përthithje të Alpha Bank S.A dhe EFG Eurobank Ergasias S.A”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Servete Gruda Anëtar
- Koço Broka Anëtar
- Rezana Konomi Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 18. 11.2011, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet bashkimit me përthithje të Alpha Bank S.A dhe EFG Eurobank Ergasias S.A;

Baza ligjore: Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, neni 24, shkronja d, nenet 10-12, dhe neni 13, në veçanti Kreu III “Përqendrimet e ndërmarrjeve” nenet 53-56, 58, Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit ” dhe Formulari i thjeshtuar “Për njoftimin e përqendrimit”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të raportit mbi njoftimin e përqendrimit Alpha Bank S.A dhe EFG Eurobank Ergasias S.A dhe relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm,

VËREN SE:

1. Transaksioni dhe përqendrimi

Përqendrimi me objekt bashkimin me përthithje ndërmjet bankave greke Alpha Bank dhe Eurobank, realizohet me anë të ‘Marrëveshjes së implementimit’ të datës 29 Gusht 2011.

Transaksioni realizohet në formën e bashkimit me përthithje i cili në kuptim të nenit 10, pika 1, shkronja a) e Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” i ndryshuar (Ligji) është përqendrim, sjell ndryshim të kontrollit në ndërmarrjen target (Eurobank) nëpërmjet përftimit të kontrollit ekskluziv të saj nga Alpha Bank.

Transaksioni i realizuar ndërmjet palëve pjesëmarrëse në kuptim të nenit 10/1/a të Ligjit, është ndryshim kontrolli në formën e bashkimit me përrthithje. Gjithashtu përqendrimi i njoftuar përmbush edhe kushtet e nenit 12 të Ligjit përsa i përket xhirove (neni 12/1).

2. Palët në transaksion

- **Alpha Bank**, është një shoqëri e themeluar në 1879 dhe që funksionon në bazë të legjislacionit grek me seli në adresën: 40 Stadiou Str, Athinë, Greqi. Ajo është një nga bankat më të mëdha të Greqisë me më shumë se 900 degë. Grupi Alpha Bank është gjithashtu aktiv edhe në tregun ndërkombëtar të bankave me prezencë në Qipro, Rumani, Bullgari, Serbi, Ukrainë, Shqipëri, Maqedoni dhe Mbretëri e Bashkuar. Alpha Bank është prezente dhe për pasojë realizon xhiro në Shqipëri me anë të degës së saj **Alpha Bank – Albania** e cila ka filluar aktivitetin që prej vitit 1998.
- **Eurobank**, një bankë e themeluar dhe që funksionon në bazë të legjislacionit grek, me seli në adresën: 8 Othos Str. 10557, Athinë, Greqi. Ajo është një nga bankat kryesore në Greqi. Eurobank ofron shërbime bankare për individët, shërbime të vogla për bizneset e vogla dhe të mesme, bankë investimi, shërbime të tregut kapital, shërbime bankare private dhe menaxhim aktivesh.

3. Xhiro për vitin 2010

- Xhiro totale në **tregun ndërkombëtar** është XXX miliardë Lekë:
 - o **Alpha Bank** : XXX miliardë Euro¹ = XXX miliardë Lekë
 - o **Eurobank** : 6.1 miliardë Euro = XXX miliardë Lekë
- Xhiro totale në **tregun e brendshëm**: është XXX miliardë Lekë:
 - o **Alpha Bank Albania** : XXXX Lekë

Palët në transaksion plotësojnë kriteret e xhiros të përcaktuara në nenin 12, pika 1 e Ligjit.

4. ANALIZA E KONKURENCËS

TREGU PËRKATËS

Referuar nenit 3, pika 7, të Ligjit, përcaktimi “treg përkatës”, përfshin dy komponentë:

- I) tregu i produktit, dhe
 - II) tregu gjeografik.
- I) **Tregu i produktit**: Referuar Udhëzuesit “Për përcaktimin e tregut përkatës”, si dhe mbështetur në veprimtarinë e palëve, treg përkatës do konsiderohet ofrimi i shërbimeve bankare për individë (*retail banking*) dhe korporata (*corporate banking*).

Shërbime bankare për individë dhe korporata (Retail Banking dhe Corporate Banking)

1. Depozita dhe shërbime për llogaritë (llogari kursimi, llogari rrjedhëse etj)
2. Kreditim (kredi personale, kredi konsumi, overdraft , kredi për binzese etj)
3. Bono thesari

¹ Sipas kursit zyrtar të Bankës së Shqipërisë për vitin 2010, 1 euro= 140 lek. Burimi:Raporti Statistikor

II) *Tregu gjeografik:*

Alpha Bank Albania operon me 48 degë në të gjithë vendin dhe rreth 60 ATM.

Eurobank nuk është prezent në tregun Shqiptar, pra nuk ka ndonjë filial, degë apo shoqëri të lidhur apo aktiv (apo ndonjë formë tjetër akiviteti) në Shqipëri.

Për analizimin e këtij rasti *treg gjeografik* do të konsiderohet tregu kombëtar pra ***Tregu i Brendshëm***.

Struktura e Tregut (Tregu Bankar ne Shqipëri)

Në tregun shqiptar ushtrojnë veprimtarinë e tyre në total 16 banka të nivelit të dytë, me kapital të huaj kryesisht me origjinë nga Bashkimi Europian. Tregu karakterizohet nga ndryshime të shpejta përsa i takon shtrirjes gjeografike dhe ofrimit të produkteve të reja. Tendencat pozitive në zgjerimin e tregut bankar me degë dhe agjenci ka sjellë përmirësimin në mënyrë të dukshme të mbulimit dhe rritjes së cilësisë për produktet ekzistuese dhe atyre të reja.

Konkurrentët në tregun kombëtar

Referuar të dhënave të Bankës Qendrore, banka e cila rezulton të ketë mbulimin më të gjerë nëpërmjet degëve dhe agjencive të saj është Raiffeisen Bank me 103 degë, e ndjekur nga Banka Kombëtare Tregtare me 27 degë dhe 31 agjenci dhe Tirana Bank me 49 degë dhe 3 agjenci.

Alpha Bank ka 48 degë brenda vendit të shtrira në Koplik, Shkodër, Kukës, Lezhë, Laç, Peshkopi, Burrel, Fushë-Krujë, Tiranë, Durrës, Kavajë, Librazhd, Elbasan, Cërrik, Lushnje, Kuçovë, Urë-Vajgurore, Fier, Berat, Peqin, Ballsh, Vlorë, Pogradec, Korçë, Bilisht, Ersekë, Tepelenë, Përmet, Gjirokastër, Himarë, Sarandë.

Sipas klasifikimit bazuar mbi kriterin e madhësisë së aktiveve, **Alpha Bank** renditet në grupin **G2**, grupin e bankave të mesme.

Pas realizimit të përqendrimit struktura në tregun bankar nuk ndryshon, si rrjedhojë përqendrimi i tregut sipas depozitave, kredisë dhe bonove të thesarit mbetet i njëjtë.

Efienca e tregut

Pengesat në hyrje dhe dalje

Hyrja në tregun bankar rregullohet nëpërmjet ligjit “ Për Bankat në Republikën e Shqipërisë” dhe akteve nënligjore që nxirren në zbatim të këtij ligji. Autoriteti përgjegjës për mbikëqyrjen dhe licencimin e bankave është Banka e Shqipërisë.

Tregu është i hapur për konkurrencë, nuk ka barriera ndaj hyrjes së kapitalit të huaj dhe vendas, si dhe formës së organizimit të bankave (degë apo filial). Gjithashtu çelja e degëve dhe e çdo njësie tjetër bankare për ato banka që e kanë marrë licencën, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë është e lirë dhe nuk paraqitet nevoja për të marrë leje apo autorizim nga Banka e Shqipërisë, e cila zgjeron rrjetin e bankave, rrit konkurrencën dhe si pasojë rrit cilësinë e shërbimit të bankave. Nga ana tjetër edhe dalja nga tregu

nëpërmjet shpërndarjes apo likuidimit është e mundur me qëllim zhvendosjen e bankave jo eficiente nga tregu.

Pozicioni në treg pas përqendrimit

Transaksioni i bashkimit nuk sjell ndryshim të strukturës së tregut bankar në Shqipëri pasi, Eurobank nuk është prezent në Shqipëri me asnjë filial, degë, shoqëri të lidhur apo asete (apo ndonjë formë tjetër aktiviteti).

Këto sinergji pritet të arrihen si rezultat i kombinimit të produkteve, të optimizimit të platformës së shërbimit (retail), prokurimit dhe eliminimit të dublikimit të disa funksioneve qendrore si dhe të krijojnë bazat për forcimin e fitimeve vjetore të Alpha Eurobank dhe forcimit të brendshëm të kapitalit dhe likuiditeteve, të cilat në mënyrë indirekte do të pasqyrohen edhe në tregun e brendshëm

Vlerësimi i konkurrencës pas përqendrimit

1. Transaksioni realizohet në formën e bashkimit me përthithje i cili në kuptim të nenit 10, pika 1, shkronja a) e Ligjit është përqendrim, i cili sjell ndryshim të kontrollit në ndërmarrjen target (Eurobank) nëpërmjet përfutimit të kontrollit ekskluziv të saj nga Alpha Bank.
2. Transaksioni i bashkimit nuk sjell ndryshim të strukturës së tregut bankar në Shqipëri pasi, Eurobank nuk është prezent në Shqipëri me asnjë filial, degë, shoqëri të lidhur apo asete (apo ndonjë formë tjetër aktiviteti).
3. Pas realizimit të përqendrimit pjesët e tregut të Alpha-Eurobank nuk ndryshojnë, si rrjedhojë përqendrimi i tregut sipas depozitave, kredisë dhe bonove të thesarit mbetet i njëjtë.
4. Tregu është i hapur për konkurrencë, pa barriera hyrëse dhe karakterizohet nga ndryshime të shpejta përsa i takon shtrirjes gjeografike dhe ofrimit të produkteve të reja. Tendencat pozitive në zgjerimin e tregut bankar me degë dhe agjenci ka sjellë përmirësimin në mënyrë të dukshme të mbulimit dhe rritjes së cilësisë për produktet ekzistuese dhe atyre të reja.
5. I parë në këndvështrimin e eficientës së tregut, sinergjitë që do të arrihen si rezultat i kombinimit të produkteve, të optimizimit të platformës së shërbimit (retail), prokurimit dhe eliminimit të dublikimit të disa funksioneve qendrore në mënyrë indirekte pritet të pasqyrohen edhe në tregun e brendshëm.

Si konkluzion, përqendrimi i realizuar nuk shfaq shenja të kufizimit në mënyrë të ndjeshme të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese për shkak të përqendrimit ndërmjet shoqërive Alpha Bank S.A dhe EFG Eurobank Ergasias S.A

PËR KËTO ARSYE

Në bazë të nenit 24, shkronja d, dhe nenit 56 pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”:

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet bashkimit me përthithje të shoqërive Alpha Bank S.A dhe EFG Eurobank Ergasias S.A .
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete Gruda

()

Anëtar

Koço Broka

()

Anëtar

Rezana Konomi

()

Anëtar

Lindita Milo (Lati)

K R Y E T A R



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 207, Datë 05.12.2011

“Për miratimin e stemës zyrtare të Autoritetit të Konkurrencës”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Servete Gruda Anëtar
- Koço Broka Anëtar
- Rezana Konomi Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 05.12.2011, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Miratimin e stemës zyrtare të Autoritetit të Konkurrencës;

Baza ligjore: Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, neni 24, germa d.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VËREN SE:

Konkurrenca është një instrument i domosdoshëm për tregun, që sjell rritjen e mirëqenies ekonomike duke krijuar me shume mundësi zgjedhjeje për konsumatorët në një mjedis ekonomik ku ndërmarrjet mund të veprojnë lirisht për arritjen e objektivave të tyre. Për të pasur një ekonomi sa më efikase dhe sa më konkurruese, rol të rëndësishëm luan zbatimi i Ligjit të Konkurrencës dhe i Politikës së Konkurrencës.

Në Republikën e Shqipërisë mbrojtja e konkurrencës realizohet nëpërmjet Ligjit Nr. 9121 datë 28. 07. 2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar). Qëllimi i këtij Ligji është mbrojtja e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg, duke mbikëqyrur rregullat e sjelljes së ndërmarrjeve, si dhe duke përcaktuar institucionet përgjegjëse për mbrojtjen e konkurrencës.

Autoriteti i Konkurrencës, si një autoritet i pavarur në ushtrimin e detyrave të tij, në bazë të politikës kombëtare të konkurrencës, ka si një nga objektivat kryesore forcimin e kulturës së konkurrencës në mjedisin shqiptar. Realizimi i këtij objektivi është një ndër

instrumentat e rëndësishme për mbrojtjen dhe promovimin e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg. Në këtë kuadër, ndër të tjera, Autoriteti i Konkurrencës, kryen edhe aktivitete të ndryshme publike, botime etj.

Si pjesë e krijimit të imazhit si një institucion i pavarur është e nevojshme edhe miratimi i një steme të veçantë të Autoritetit të Konkurrencës e cila duhet të përdoret në të gjithë aktivitetet publike, botimet etj.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në Ligjin Nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, neni 24 d):

VENDOSI:

1. Miratimin e stemës zyrtare të Autoritetit të Konkurrencës, sipas modelit të bashkëlidhur.
2. Kjo stemë do të përdoret në ambientet e institucionit, aktivitetet publike, botimet dhe prezantimet nga i gjithë stafi i Autoritetit të Konkurrencës.
3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete Gruda
()
Anëtar

Koço Broka
()
Anëtar

Rezana Konomi
()
Anëtar

Lindita Milo (Lati)

K R Y E T A R

Stema Zyrtare e Autoritetit të Konkurrencës:





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS

VENDIM

Nr. 208, Datë 05.12.2011

“Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar ndërmjet shoqërive XLWorld Europe S.r.l dhe Xerox S.p.a me qëllim përfitim të shoqërive Eagle Connect Sh.p.k dhe Voice Star Sh.p.k”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Servete Gruda Anëtar
- Koço Broka Anëtar
- Rezana Konomi Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 05.12.2011, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Autorizimin e përqendrimit të realizuar ndërmjet shoqërive XLWorld Europe S.r.l dhe Xerox S.p.a me qëllim përfitim të shoqërive Eagle Connect Sh.p.k dhe Voice Star Sh.p.k;

Baza ligjore: Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, neni 24, shkronja d, nenet 10-12, dhe neni 13, në veçanti Kreu III “Përqendrimet e ndërmarrjeve” nenet 53-56, 58, Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit ” dhe Formulari i thjeshtuar “Për njoftimin e përqendrimit”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të raportit mbi njoftimin e përqendrimit XLWorld Europe S.r.l dhe Xerox S.p.a dhe relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm,

VËREN SE:

1. Transaksioni dhe përqendrimi

Përqendrimi realizohet me anë të ‘Marrëveshjes për blerjen e kuotave’ të datës 20 Shtator 2011 ndërmjet shoqërive Xerox S.p.a dhe XLWorld Europe S.r.l me qëllim transferimin e të gjitha kuotave të shoqërisë holding (XLW S.r.l) dhe në mënyrë indirekte të kuotave të shoqërive Eagle Connect Sh.p.k dhe Voice Star Sh.p.k.

Transaksioni realizohet në formën e përfimit të tërthortë të kontrollit, i cili në kuptim të nenit 10, pika 1, shkronja b) e Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” i ndryshuar (Ligji) është përqendrim, sjell ndryshim të kontrollit në ndërmarrjet target (Eagle Connect Sh.p.k, Voice Star Sh.p.k) nëpërmjet përfimit të kontrollit indirekt të tyre nga Xerox S.p.a.

Transaksioni i realizuar ndërmjet palëve pjesëmarrëse në kuptim të nenit 10/1/b të Ligjit, është ndryshim kontrolli në formën e përfimit të tërthortë të kontrollit. Gjithashtu përqendrimi i njoftuar përmbush edhe kushtet e nenit 12 të Ligjit përsa i përket xhirove (neni 12/1) si dhe është njoftuar brenda afatit kohor të përcaktuar në të (neni 12/2).

2. Palët në transaksion

- **Xerox Spa**, në cilësinë e Blerësit është një shoqëri e themeluar dhe që funksionon në bazë të legjislacionit italian që prej vitit 1961, me seli në Milano, Itali. Objekti i shoqërisë është shitja dhe dhënia me qira e pajisjeve të zyrave dhe sistemeve të printimit si dhe aksesorëve dhe sendeve të luajtshme si dhe ofrimi i shërbimeve përkatëse të mirëmbajtje.
- **XL World Europe Srl**, në cilësinë e Shitësit është një shoqëri që vepron në përputhje me legjislacionin Italian. Objekti i shoqërisë është kryerja e shërbimeve të *contact center*, futjen e të dhënave, sporti informatik dhe administrativ, kërkime tregu, marketing i drejtpërdrejtë si dhe prodhim dhe tregtim i software-ve, hardware-ve, sistemeve të telekomunikimit dhe furnizimin e shërbimeve përkatëse, konsulencë ndërmarrje në sektorin informatik.
- **Eagle Connect Shpk** në cilësinë e shoqërisë target me seli në Vlorë, ushtron veprimtarinë e saj kryesisht në aktivitetin e telemarketing-ut si edhe në shitjen dhe shkëmbimin, dhënien me qira administrimin e pasurive të paluajtshme në pronësi të saj ose të personave të tretë, enteve publike ose shtetërore.
- **Voice Star Shpk** në cilësinë e shoqërisë target me seli në Shkodër, ushtron veprimtarinë e saj kryesisht në aktivitetin e telemarketing-ut si edhe në shitjen dhe shkëmbimin, dhënien me qira administrimin e pasurive të paluajtshme në pronësi të saj ose të personave të tretë, enteve publike ose shtetërore.

3. Xhiro për vitin 2010

- Xhiro totale në tregun ndërkombëtar është **XXXXX Lekë**:
 - o **Xerox Spa** : XXXX Euro¹ = XXXX Lekë
 - o **XL World** : XXXX Euro = XXXX Lekë
- Xhiro totale në tregun e brendshëm: është **XXXX Lekë**:
 - o **Eagle Connect Shpk** : XXXX Lekë
 - o **Voice Star Shpk** : XXXX Lekë

Palët në transaksion plotësojnë kriteret e xhiros të përcaktuara në nenin 12, pika 1 të ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe si rrjedhojë, ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

¹ Sipas kursit zyrtar të Bankës së Shqipërisë për vitin 2010, 1 euro= 140 lek. Burimi:Raporti Statistikor

4. TREGU PËRKATËS

Referuar nenit 3, pika 7, të Ligjit, përcaktimi “treg përkatës”, përfshin dy komponentë:

- I). tregu i produktit, dhe
- II). tregu gjeografik.

I. Tregu i produktit:

Referuar Udhëzuesit “Për përcaktimin e tregut përkatës”, si dhe mbështetur në veprimtarinë e palëve, treg përkatës do konsiderohet shërbimi i telemarketingut.

Tregu përkatës i produktit:, Dhënien e shërbimeve shumëgjuhëshe të shërbimit të telemarketing - ut.

5. Vlerësimi i konkurrencës pas përqendrimit

Tregu shqiptar i telemarketingut është një treg relativisht i ri. Në këtë treg janë aktive 14 shoqëri. Pjesa më e madhe e këtyre shoqërive ofron shitje nëpërmjet telefonit dhe televizionit (telesales).

Gjatë viteve të fundit, tregu është karakterizuar nga zhvillime pozitive nisur nga rritja e numrit të ndërmarrjeve që operojnë në këtë treg. Tregu karakterizohet nga mungesa e barrierave domethënëse të hyrjes, duke qënë se kushti i vetëm për të hyrë në treg është teknologjia informatike dhe ajo e telekomunikacionit, e cila është gjerësisht e gjendur në tregun shqiptar.

Aktiviteti ekonomik i këtyre shoqërive është i përqendruar në qytetet kryesore të vendit si Tiranë, Durrës, Shkodër, Fier dhe Vlorë, ndërkohë që shërbimet e ofruara nga këto shoqëri janë të orientuara kryesisht ndaj klientëve me vendndodhje Italinë.

Përftimi i Voice Star Shpk dhe Eagle Connect Shpk nga Xerox S.p.a, konsiderohet si një transaksion në një sektor që po zgjerohet me ritme të shpejta, ku kompanitë kërkojnë konsolidimin e anës së ofertës për t’iu përgjigjur në mënyrën e duhur nevojave dhe kërkesave të blerësve të fuqishëm, të cilët kanë vendosur të transferojnë manaxhimin e marrëdhënieve me klientët tek shoqëritë e tjera.

Transaksioni nuk do të ketë efekte negative mbi konkurrencën apo konkurrentët në Shqipëri pasi Voice Star Shpk dhe Eagle Connect Shpk zotërohen nga e njëjta shoqëri dhe as blerësi apo shoqëria mëmë nuk janë aktive në tregun shqiptar.

Si rrjedhojë, transaksioni në fjalë nuk shkakton mbivendosje të aktivitetit të palëve në nivel horizontal dhe as forcim të pozicionit të shoqërive Eagle Connect dhe Voice Star në treg. Synimi kryesor i tij është rritja e kapaciteteve të Xerox në Europë dhe zgjerimi i shërbimeve të ofruara nga shoqëritë target nisur nga burimet financiare dhe ekspertiza teknologjike dhe operacionale e Xerox. Në këtë rast kemi të bëjmë thjesht me ndryshim kontrolli të shoqërive, i cili nuk sjell ndryshim të strukturës në tregun e produktit apo rritje të pjesës së kombinuar të tregut të shoqërive.

Voice Star Shpk dhe Eagle Connect Shpk edhe pas realizimit të përqendrimit do të hasin konkurrentë të fortë në treg si Albania Marketing Service, Studio Moderna dhe Intercom Data Service.

Si konkluzion, përqendrimi i realizuar nuk shfaq shenja të kufizimit në mënyrë të ndjeshme të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese për shkak të përqendrimit ndërmjet shoqërive XLWorld Europe S.r.l dhe Xerox S.p.a.

PËR KËTO ARSYE

Në bazë të nenit 24, shkronja d, dhe nenit 56 pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”:

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar ndërmjet shoqërive XLWorld Europe S.r.l dhe Xerox S.p.a me qëllim përftimin e shoqërive Eagle Connect Sh.p.k dhe Voice Star Sh.p.k.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete Gruda

(_____)

Anëtar

Koço Broka

(_____)

Anëtar

Rezana Konomi

(_____)

Anëtar

Lindita Milo (Lati)

K R Y E T A R



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS

VENDIM

Nr. 209, Datë 21.12.2011

Për miratimin e Udhëzuesit
“Mbi analizën e konkurrencës në procedurat për dhënien e koncesioneve”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Servete Gruda Anëtar
- Koço Broka Anëtar
- Rezana Konomi Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 21.12.2011, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Miratimi i Udhëzuesit “Mbi analizën e konkurrencës në procedurat për dhënien e koncesioneve”;

Baza ligjore: Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”
(i ndryshuar), neni 24, germa d) e dh), si dhe nenet 69 e 70.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të Projekt Udhëzuesit “Mbi analizën e konkurrencës në procedurat për dhënien e koncesioneve”,

VENDOSI:

1. Të miratojë Udhëzuesin “Mbi analizën e konkurrencës në procedurat për dhënien e koncesioneve”, sipas materialit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ky Udhëzues rekomandohet të zbatohet nga organet e administratës qendrore dhe vendore, në zbatim të detyrimit të percaktuar në nenin 69 dhe 70 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”
3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për dërgimin e këtij Udhëzuesi pranë organeve të administratës qendrore dhe vendore, enteve dhe institucioneve të tjera rregullatore.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete Gruda
()
Anëtar

Koço Broka
()
Anëtar

Rezana Konomi
()
Anëtar

Lindita Milo (Lati)

K R Y E T A R

Udhëzues

“Mbi analizën e konkurrencës në procedurat për dhënien e koncesioneve”

Mbështetur në nenin 24, shkronja d, si dhe nenet 69 dhe 70 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, për vlerësimin e legjislacionit nga këndvështrimi i konkurrencës, Autoriteti i Konkurrencës

I. Hyrje

Ky udhëzues ka për qëllim analizimin e koncesioneve parë nga këndvështrimi i konkurrencës. Kjo lloj analize mund të realizohet si për koncesionet ekzistuese (*ex post*) me qëllim për të propozuar përmirësime për koncesionet e ardhshme ashtu edhe përpara miratimit formal nga autoritetet kompetente publike të një koncesioni (*ex ante*).

Një koncesion është mbartës i një të drejte speciale dhe/ose ekskluzive për ushtrimin e veprimtarisë, të cilat në zbatim të Ligjit 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar), janë objekt vlerësimi nga Autoriteti i Konkurrencës.

Ligji bazë për koncesionet është Ligji nr. 9663, datë 18.12.2006 “Për Koncesionet”. Ky ligj përcakton kushtet, mënyrat, kriteret dhe procedurat e dhënies së koncesioneve në Republikën e Shqipërisë.

Zbatimi i këtij Ligji mund të përmirësohet duke synuar fuqizimin e parimeve të konkurrencës ndërmjet kompanive të mundshme të interesuara, ashtu si dhe rritjen e transparencës, dhe ky udhëzim synon të ndikoj në këtë aspekt.

Hartimi i koncesioneve dhe procedurave të dhënies së tyre janë në përgjithësi komplekse dhe ka shumë të ngjarë të çojnë në shtrembërime të konkurrencës në treg. Për këtë arsye, është e rëndësishme që organet (institucionet) përgjegjëse ti drejtohen Autoritetit të Konkurrencës në zbatim të kerkesave në nenet 69 dhe 70 të Ligjit Nr 9121, dt 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”.

Nëpërmjet rritjes së ndërgjegjësimit mbi aspektet e mundshme anti-konkurrese, kjo listë do të jetë udhërrëfyes për pjesën tjetër të administratës në kërkimin e këshillave të Autoritetit Shqipëtar të Konkurrencës dhe për mënyrën e eliminimit ose të paktën të reduktimit të ndikimeve të efekteve të anti-konkurrencës të koncesioneve të propozuara. Si pasojë, pavarësisht nge përmirësimi i “kimës së biznesit” dhe parandalimit/reduktimit të shtrembërimeve të tregut, procedurat e sipërpërmendura do të përfaqësojnë gjithashtu, në rastet kur zbatohen, një instrument të plotfuqishëm si për advokacinë e konkurrencës dhe rregullat e ndihmës shtetërore, ashtu edhe për forcimin e nivelit të bashkëpunimit administrative ndërmjet institucioneve.

Kjo listë është strukturuar në 5 seksione si vijon:

- I. Aspekte paraprake (tregu, përdorimi i koncesioneve, kohëzgjatja);
- II. Vlerësim ligjor paraprak;
- III. Analiza e aspekteve më të rëndësishme në lidhje me hartimin/konceptimin e koncesioneve;
- IV. Mënyrat e zgjedhura për dhënien e koncesioneve;
- V. Roli i AK në analizën e koncesioneve.

Çdo seksion, përfshin disa çështje kryesore dhe kur është e përshtatshme shënime shpjeguese.

II. Analiza e konkurrencës në procedurat për dhënien e koncesioneve

Gjatë analizës së konkurrencës në procedurat e dhënies së koncesioneve, organet përgjegjëse për hartimin dhe zhvillimin e këtyre procedurave si dhe Autoriteti i Konkurrencës duhet të marrin në konsiderat elementët e mëposhtëm:

II.1. Aspekte paraprake (tregu, përdorimi i koncesioneve, kohëzgjatja)

1. Tregu

Tregjet kryesore ku mund të miratohen koncesione mund të jenë:

- Në transport (sistemi hekurudhor, transportin hekurudhor, portet, aeroportet, rrugët, tunelet, urat, parkimet, transportin publik);
- në prodhimin dhe shpërndarjen e energjisë elektrike e të ngrohjes;
- në prodhimin, shpërndarjen dhe administrimin e ujit, në trajtimin, mbledhjen, shpërndarjen dhe administrimin e ujërave të zeza, ujitjen, drenazhimin, pastrimin e kanaleve e të digave;
- në grumbullimin, transportimin, përpunimin dhe administrimin e mbetjeve të ngurta;
- në telekomunikacion;
- në arsim dhe sport;
- në shëndetësi;
- në turizëm dhe kulturë;
- në infrastrukturën e burgjeve;
- në projektet e riciklimit, rehabilitimit të tokës dhe pyjeve, në parqet industriale, të strehimit, të ndërtesave qeveritare, të shërbimeve të mirëmbajtjes së teknologjisë së informacionit dhe infrastrukturës së bazës së të dhënave;
- në shpërndarjen e gazit natyror;
- në kontratat e administrimit apo në kryerjen e shërbimeve publike, përfshirë edhe ato të sektorëve të sipërpërmendur¹
- Të tjera²

2. Karakteristikat e tregut / sektorit

Një koncesion mund të jetë i dëmshëm për konkurrencën në sektori/tregu përkatës nëse kanë disa karakteristika që ndikojnë një kufizimin e konkurrencës së lirë dhe efektive.

Në këtë mënyrë duhet të analizohen kushte të tilla si:

- a) Pasja e një një situate të **monopolit natyror**.
- b) Pasja e **kushteve/situatave të veçanta strukturore** ku konkurrenca në treg nuk është e zbatueshme, (kufizohet, pengohet ose shtrembërohet).
- c) Pasja e **ekonomisë së shkallës** në tregun përkatës.
- d) Përcaktimi i **aseteve përkatëse** të cilat koncesionari do të marrë në **zotërim** dhe nëse **pronësia** mbi asetet përkatëse i mbetet shtetit si dhe **mënyra e përdorimit** të aseteve përkatëse.

¹ Këta sektorë i referohen atyre të përmendura në Ligjin shqiptar për koncesionet (neni 4 i Ligjit 9663, datë 18.12.2006).

² Nëse koncesionet në lidhje me sektorë të tjerë do të autorizohen nga Këshilli i Ministrave sipas propozimeve të Ministrit përgjegjës për ekonominë (shiko nenin. 4, par.2 të Ligjit “Për Koncesionet”).

- e) Përfitimi/pasja e **reputacionit** si një ofrues eficient i shërbimeve në sektorin në fjalë.
- f) Efektet e parashikuara të **përfitimeve për konsumatorët** në periudhat afatshkurtra/afatmesme/afatgjata (kosto më e ulët/ Më tepër risi/shpikje/Cilësi më të mirë të shërbimeve etj.)

3. Arsyeya e zgjedhjes së instrumentit të koncesionit

Në radhë të parë duhet të përcaktohet nëse veprimtaria përkatëse është një koncesion në kuptim të ligjit përkatës dhe jo një procedurë tjetër (autorizim administrativ, leje përdorimi etj.).

Gjithashtu duhen analizuar edhe arsyet se pse shteti i transferon këto funksione duke përdorur instrumentin e koncesionit dhe jo atë të privatizimit (ekzistenca e arsyeve ligjore apo politike?)

Në këtë vlerësim duhet të merret parasysh fakti /nëse veprimtaria e dhënë me koncesion është e rregulluar tashmë, duhet rregulluar apo i nënshtrohet konkurrencës së lirë. Nëse është e nevojshme që tregu të rregullohet duhet analizuar nëse regjimi rregullator duhet të krijohet në të njëjtë kohë me koncesionin apo jo.

Në rastet kur ka ekonomi domethënëse të shkallës në tregun përkatës, duhet të analizohet se në çfarë mase krijimi i më tepër koncesioneve do të ulte eficientësinë

4. Kohëzgjatja e koncesionit

Kohëzgjatja e koncesionit³ duhet të vendoset në mënyrë të tillë që të mos kufizojë konkurrencën e lirë përtej asaj që është kërkuar; që investimi është paguar dhe që ka një rikthim të arsyeshëm të kapitalit të investuar, ndërsa ka një risk të pandashëm në përdorimin nga koncesionari.

Koncesionet afatshkurtra mund të sugjerohen kur ka pasiguri në lidhje me zhvillimet e ardhshme të tregut. Një periudhë më e shkurtër zëvendëson barrën e pasigurisë mbi qeverinë në periudhën afatshkurtër, por do të rrisë sigurinë mbi konkurrencën për koncesionin vijues.

Nga ana tjetër, koncesionet rëndojnë problemin e nismave të pamjaftueshme për të kryer investime në prag të përfundimit të koncesionit, dhe rrisin koston e ofruesit, sepse ato ndodhin shumë shpesh.

Pavarësisht kësaj, Koncesionet afatshkurtra lejojnë një tenderim të shpeshtë konkurrues, i cili lehtëson hyrjen dhe siguron që çdo përfitim i konkurrencës në rritje reflekton në mënyrë të përshtatshme.

Për sa më sipër koncesionet duhet të jepen me një afat minimal i cili të garantojë ndërmarrjen e një nisme të duhur për koncesionarin që të kryejë një investim, përfshirë investimin në mirëmbajtje, gjatë dhe deri në fund të koncesionit në mënyrë që të gjendet një kompromis ndërmjet këtyre interesave.

³ Afatet e percaktuara në ligjin për koncesionet përcaktohen

II.2. Vlerësimi ligjor paraprak

Paraprakisht duhet bërë një analizë e plotë ligjore për të parë nëse koncesioni është në përputhje me legjislacionin shqiptar qoftë të sektorit përkatës ashtu edhe të ligjeve të tjera si ligji për mbrotjen e konkurrencës, ligji për ndihmën shtetërore etj.

Duke pasur parasysh faktin se Shqipëria ka shpallur si prioritet antërsimin e Shqipërisë me BE, duhet analizuar edhe fakti nëse koncesioni është në përputhje me *acquis communautaire* të BE-së apo detyrime të tjera ndërkombëtare në kuadrin e anëtarësimit në Organizatën Botërore të Tregtisë dhe marrëveshjeve të ndryshme të tregtisë së lirë.

II.3. Analiza e aspekteve më të rëndësishme të lidhur me konceptimin e koncesionit

7. Konkurrenca në lidhje me një koncesion duhet të mundësohet në dy momente:

1. **Sigurimi i konkurrencës ndërmjet kompanive të mundshme për përfitimin e kontratës së koncesionit.**
2. **Mbrojtja e Konkurrencës së lirë dhe efektive në treg pas dhënies së koncesionit.**

Në këtë mënyrë duhet analizuar nëse pas koncesionit do të ketë një strukturë tregu që merr në konsideratë dinamikën e konkurrencës, si në nivelin horizontal ashtu edhe në atë vertikal.

Në veçanti:

Në nivel horizontal, a është e mundur për më tepër se sa një koncesionar që të ushtrojë aktivitet në treg?⁴ Sektori në fjalë lejon të tilla “ndarje”? (si p.sh në telefoni e lëvizshme).

Në nivel vertikal, janë zbatuar ndarjet vertikale? Në veçanti, a ka marrë në konsideratë konceptuesi i koncesionit ndarjen e funksioneve të komponentëve të monopolit natyror nga fazat e tjera në të cilat konkurrenca është e mundshme?

Për shembull: Në tregun e furnizimit me energji elektrike, rrjeti i transmetimit të energjisë elektrike konsiderohet si një monopol natyror, por gjenerimi i energjisë elektrike nuk është i tillë. Një operator i të dy sistemeve mund të diskriminojë konkurrentët e tij në gjenerim nëpërmjet përdorimit të rrjetit, duke dëmtuar konkurrencën në tregun gjenerues.

Gjithashtu duhet analizuar edhe ekzistenca apo jo krijimi i të ashtuquajturave “ekonomi qëllimi”⁵

8. Krijimi i një regjimi rregullator për veprimtarinë e dhënë me koncesion.

Për reduktimin e pasigurive më të cilat përballen operatorët në treg, në disa tregje apo aktivitete të dhëna me koncesion duhet të krijohen struktura/agjenci të posacme rregullatore.

⁴ Nëse dy ose më shumë subjekte janë zëvendësues për njëri tjetrin atëherë do të ishte e këshillueshme që të zgjidhej një koncesionar i ndryshëm për ti ushtruar ato (Në rastin e porteve p.sh ose brenda të njëjtë port, konkurrenca mund të jetë e mundshme ndërmjet operatorëve në terminale të ndryshme).

⁵ 'Ekonomi qëllimi' kemi kur një firmë mund të ulë koston mesatare të dy ose më shumë produkteve. Për shembull: në një njëjtën kompani është përfshirë si përdorimi i portit dhe monopoli hekurudhor për ti shërbyer atij.

Elemente të mundshëm që i nënshtrohen rregullimit paraparak janë:

1. Elementët që mund të ndikojnë përfitueshmërinë e shërbimit të tilla si kërkesa për ofrimin e një shërbimi universal, tarifa sociale të veçanta, kufizimet mbi rritjen e tarifave të përdoruesve etj.
2. Rregullimi i cmimeve duke përcaktuar kompromisin nëpërmjet metodologjive të përcaktimit të çmimit si çmimet fikse, çmime tavan rregullore mbi normën e kthimit etj.

9. Analiza e kontratës së koncesioneve

Analiza e kushteve kryesore të kontratës së koncesionit një të dhënat e nevojshme për një vlerësim paraparak të elementeve që mund të ndikojnë në nivelin e konkurrencës në treg.

Në këtë mënyrë duhet të analizohen afatet/kushtet më të rëndësishme në kontratat ndërmjet shtetit dhe koncesionarit, të drejtat dhe detyrimet e koncesionarit, specifikim të tarifave, investimeve, niveleve të shërbimit ose të pagesave që do ti paguhen qeverisë (nëse ka) etj.

Nga kjo analizë shihet nëse në kontratë janë përcaktuar kushte teknike, profesionale ose financiare të cilat janë të tepërta dhe në disproporcion me subjektin e koncesionit.

10. Si rregullohet ri-negocimi në konceptimin e koncesionit? ⁶

Autoriteti koncesionar nuk mundet të eliminojë plotësisht mundësinë e ri-negocimit. Disa hapa që mund të minimizojnë riskun e sjelljeve oportuniste në fazën e dhënies së koncesionit përfshijnë:

- Strukturimin e kontratave në mënyrë që të krijojnë sa më shumë konkurrencë të jetë e mundur pas dhënies së koncesionit, duke i ofruar agjencisë sa më shumë alternativa të ofrimit të shërbimeve dhe kështu reduktohet mundësia e marrëveshjeve nga koncesionari;
- Shmangja e përdorimit të kritereve të ankandit, që ka shumë të ngjarë të ndryshohen menjëherë pas dhënies së koncesionit, të tilla si tarifatat ose që janë subjekt i manipulimit të tilla si propozime teknike;
- Duke e bërë të shtrenjtë për fituesit që të paguajnë, p.sh duke kërkuar marrëveshje performance/përmbushjeje;
- Duke lejuar qeverinë që të ndërmarrë ushtrimin e koncesionit, kur koncesionari nuk po e ushtron sipas standardeve të veçanta të specifikuar;
- Duke vendosur mbi koncesionarin detyrimin që të vazhdojë ofrimin e shërbimit, deri sa një koncesionar i ri të jetë zgjedhur.

⁶ Kontratat e koncesionit nga natyra janë “të paplota” përderisa jo të gjitha variablat/ndryshoret që ndikojnë në kushtet e tyre mund të jenë të njohura paraparakisht (p.sh kostot e sakta të ofrimit të shërbimit ose shuma e shërbimit që do të kërkohet). Në veçanti në koncesionet me kohëzgjatje të gjatë, palët mund të hyjnë në ri-negociata me qëllim që të rregullojnë kushtet e kontratës që i përshtaten realitetit të tregut. Por mundësia për ri-negocim, mundet gjithashtu të promovojë sjellje oportuniste. Një ofertues mund të pranojë një marrëveshje konkurruese në fazën e dhënies së koncesionit, me shpresën se mund të rikuperojë këto “humbje” gjatë ri-negocimeve. Pas dhënies së koncesionit, balanca e negociatave mund të kthehet dramatikisht në favor të koncesionarit. Fituesi mund ta “mbajë” qeverinë nëpërmjet kërcënimit të mosplotësimit, mundësisht duke privuar qytetarët nga një produkt ose shërbim jetësor. Ka shumë shembuj të kësaj sjelljeje.

II.4. Mënyrat e zgjedhura për dhënien e koncesionit:

11. Procedura konkurruese e përzgjedhjes (ankandi)

Dhënia e koncesioneve nëpërmjet një procedure konkurruese të përzgjedhjes⁷, konsiderohet si mënyra më e mirë me qëllim që të sigurojë konkurrencën e duhur në treg. Konceptimi i kësaj procedure është një faktor i rëndësishëm për konkurrencën në treg. Elemente të konceptimit të ankandit që duhen pasur parasysh janë:

- a) Lloji i ankandit që është zgjedhur (p.sh një “ankand me ofertë zbritëse “ ose një “ankand me ofertë të mbyllur - të çmimit të parë”)?
- b) Rrethanat që kanë përcaktuar konceptimin e ankandit të zgjedhur.
- c) Kriteret janë zgjedhur si subjekt për ankandin (pagesa që koncesionari do ti paguajë qeverisë apo çmimi ose tarifa që koncesionari do ti ngarkojë klientëve të tij)⁸?

11.1 Parandalimin e marrëveshjes së fshehtë

Konceptimi/hartimi i ankandit mund të lehtësojë marrëveshjen e ndaluar nëpërmjet proceseve që lejojnë komunikimin ndërmjet ofertuesve

Përveç komunikimit direkt (p.sh në një takim sekret në një dhomë hoteli) , ofertuesit ndonjëherë komunikojnë nëpërmjet “sinjaleve”. Ofertuesit mund të komunikojnë apo ti bëjnë të ditura qëllimet e tyre indirekt nëpërmjet deklaratave në gazeta ose nëpërmjet mënyrave në të cilat ata strukturojnë ofertat e tyre. Literatura mbi Politikën e konkurrencës dhe praktika gjyqësore ka shumë shembuj të metodave të sinjalizimit për ushtruesit e kartelit. Konceptimi i ankandit mund të ndihmojë në pengimin e disa prej këtyre metodave. Ofertat e vulosura mund të jenë më të mira se sa ankandet e hapura si një mjet për kufizimin e mundësive të komunikimit ndërmjet ofertuesve. Ka mjete të tjera që mund të merren, por çdo situatë është e veçantë dhe asnjë model i veçantë nuk është gjithmonë më i miri.

konceptimi i ankandit mundet indirekt të lehtësojë marrëveshjen e fshehtë ndërmjet palëve private dhe të korruptojë zyrtarët e qeverisë kur ka mungesë të proceseve formale dhe transparente gjatë dhënies së koncesionit dhe konteksti i përgjithshëm nuk ofron sanksione për zyrtarët publikë.

11.2 Lehtësimi i hyrjes atraktive (të një numri të madh ofertuesish)?

Në veçanti:

Proçesi i ankandëve duhet të konceptohet në mënyrë që të tërheqë një numër sa më të madh ofertuesish të kualifikuar. Kjo mund të arrihet me anë të p.sh, një reklamë mbi ankandin, që redukton kostot e përgatitjes së ofertës, përdorimin e ofertave të mbyllura për tërheqjen e ofertuesve më të dobët, një informacion i përshtatshëm për të gjithë ofertuesit (veçanërisht në situatat e koncesioneve të përsëritura ku operatori kryesor me fuqi ekonomike më të mëdha perceptohet se ka avantazhe për sa i përket informacioneve të cilat mund të dekurajojnë hyrësit e rinj) etj.

⁷ Sipas nenit 2 pika 2 e ligjit për koncesionet “procedura konkurruese e përzgjedhjes është procedura për përzgjedhjen e koncesionarit në përputhje me nenet 10 deri 21 të këtij ligji. Në këtë udhëzues do të përdoret termi “ankand” për këtë lloj procedure.

⁸ Eksperiencia ka treguar se pagesa e kontratës është kriteri më i mirë. Në mënyrë të paevitueshme, tarifata do të caktohen në përgjigje të ndryshimeve në mjedisin e biznesit, duke kërkuar negociata të reja, të cilat mund të rezultojnë në një eliminim të disa nga përfitimeve të konkurrencës të arritura nga ankandi.

Një mënyrë për të nxitur pjesëmarrjen e sa më shumë ofertuesve është lejimi i paraqitjes së ofertave të përbashkëta të dy ose më shumë palëve. Nëse autoriteti konkencionar, ndalon plotësisht ofertat e përbashkëta, kjo do të ketë efekte negative të eliminimit të ofertuesve, të cilët mund të marrin pjesë vetëm bashkërisht nëse do të lejoheshin ofertat e përbashkëta nga dy ose më shumë palë, ku secila prej tyre mund të ofertonte në mënyrë të ndarë dhe ka efektin e dukshëm të reduktimit të numrit të ofertuesve. Një mënyrë e mesme, është ndalimi i formimit të një marrëveshjeje të ofertës së përbashkët në kohën e ankandit. Kjo do të ndihmonte në parandalimin e marrëveshjes strategjike të përbashkët të formuar me qëllim reduktimin e konkurrencës.

12. Instrumentet e tjera të dhënies së koncesionit

Në raste të veçanta Qeveria mund të zgjedhë (si një alternativë për ankandet) instrumente të tjera si *“negocim pa procedurë konkurruese”*⁹ apo propozimet e pa kërkuara¹⁰. Këto instrumente duhet të përdoren në mënyrë sa më të kufizuar me qëllim shmangien e korrupsionit si dhe mbrojtjen e konkurrencës.

Për sa më sipër duhet të përcaktohet se:

- a) **A është dhënë koncesioni në zbatim të procedurave përzgjedhëse konkurruese në zbatim të nenit 11-21 të ligjit për koncesionet?**
- b) **A është procedura përzgjedhëse konkurruese (në zbatim të nenit 11-21 të ligjit të koncesioneve) e prejardhur nga një prezantim prej një *“propozimi të pakërkuar”* (në zbatim të nenit 23 të Ligjit “Për Koncesionet”)?**
 - Nëse është kështu, është ftuar ndjekësi/i interesuari që të marrë pjesë në procedurën përzgjedhëse konkurruese?
 - Cila është shuma e bonuseve dhënë të interesuarit sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave (deri në një maximum prej 10% të pikëve) mbi rezultatet e tij teknike dhe/ose financiare? Si është përcaktuar kjo?
 - A është identiteti i të interesuarit, ekzistenca dhe shuma e bonuseve, e përcaktuar në dokumentet e procedurës përzgjedhëse konkurruese?
- c) **A është dhënë PA ANKAND koncesioni, për çmimin simbolik prej 1 Euro (në zbatim të nenit 4, par. 3 të Ligjit “Për Koncesionet”)?**

Në këtë rast, koncesioni i përmendur më sipër në “listën e asetëve që do të jepen në koncesion” a është miratuar nga Këshilli i Ministrave sipas propozimit të Ministrit përgjegjës për ekonominë, në përputhje me nenin 4 paragrafi 3 i Ligjit “Për Koncesionet”.

- A është ofruar koncesioni *“Në raste të veçanta, për nxitjen e investimeve ... apo për sektorë të tjerë parësorë në zhvillimin ekonomik të vendit, në përputhje me objektivat strategjike,”*?
- Koncesioni, është ofruar për një apo më shumë subjekte? Për investitorë vendas apo ndërkombëtarë?
- d) **Është dhënë koncesioni pa procedurë konkurruese apo me propozime të pakërkua në zbatim të nenit. 22 dhe 23 të Ligjit “Për Koncesionet”?**¹¹

⁹ Neni 22 i ligjit për koncesionet.

¹⁰ Neni 23 I ligjit për koncesionet.

¹¹ Shiko nenin 22 të Ligjit “Për Koncesionet”.

- Nëse është kështu, koncesioni i negociuar nga autoriteti kontraktues ka qenë më parë i miratuar nga Këshilli i Ministrave?
- Koncesioni në lidhje me një projekt që ndikon në cënimin e sigurisë kombëtare a është miratuar sipas vendimit të Këshillit Kombëtar të Sigurisë? Procedura përzgjedhëse nuk ishte e mundur të zbatohet për shkak të një nevojë urgjente për të siguruar vazhdueshmërinë e veprimtarisë deri në përfundimin e kontratës së koncesionit, për shkak të një shkeljeje serioze nga koncesionari dhe kontrata e koncesionit nuk duhet të tejkalojë periudhën prej 12 muajsh?

II.5. Roli i Autoritetit të Konkurrencës në analizimin e koncesionit

13. Në mënyrë që të sigurohet konkurrenca e lirë dhe efektive në treg, është veçanërisht e rëndësishme që ligji për mbrojtjen e konkurrencës të zbatohet në mënyrë të plotë dhe efektive në të gjithë sektorët ku ka koncesione. Autoriteti kontraktor duhet të mbajë parasysh veçanërisht zbatimin e neneve, 69 dhe 70 të ligjit për mbrojtjen e konkurrencës gjatë procedurës së dhënies së koncesionit dhe pas zbatimit të marrëveshjes së koncesionit. Autoriteti kontraktor duhet të informohet nëse ka pasur ndërhyrje të mëparshme të Autoritetit të Konkurrencës në të njëjtët sektorë ose sektorë të ngjashëm.
14. Në zbatim të Ligjit Autoriteti i Konkurrencës duhet të përfshihet në proces.
15. Në mënyrë që të sigurohet përfshirja e autoritetit të konkurrencës duhet të sigurohen instrumentet për tu lajmëruar në lidhje me mundësinë e një marrëveshjeje të fshehtë, në fazën e dhënies së koncesioneve ashtu si dhe në fazën pas dhënies së koncesioneve (në ato pjesë të sektorëve ku konkurrenca ekziston).



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS

VENDIM

Nr. 210, Datë 21.12.2011

“Për disa rekomandime AKEP-it në lidhje me tregun e komunikimeve elektronike”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Servete Gruda Anëtar
- Koço Broka Anëtar
- Rezana Konomi Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 21.12.2011, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Për disa rekomandime AKEP-it në lidhje me tregun e komunikimeve elektronike;

Baza ligjore: Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, nenet, 2 pika c), 24 pika d), dhe 70.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të informacionit në lidhje me rastin e bashkimit me përthithje të dy shoqërive Albtelcom Sh.a dhe Eagle Mobile Sh.a,

VËREN SE:

- 1) Pranë Autoritetit të Konkurrencës është depozituar për vlerësim paraprak transaksioni i pritshëm i cili do të realizohet në formën e bashkimit me përthithje të shoqërisë Eagle Mobile nga Albtelcom, me qëllim rritjen e efijencës dhe sinergjisë ndërmjet dy shoqërive pjesëmarrëse.
- 2) Bashkimi i synuar ndjek prirjen e përhapur në tregun botëror të telekomunikacionit e cila ka qenë e suksesshme në vende të tjera të Europës dhe Ballkanit. Meqenëse shoqëria target i transaksionit të pritshëm (Eagle Mobile) zotërohet në masën 100% nga shoqëria përthithëse (Albtelcom) atëherë transaksioni pritshëm i cili konsiston në një ndryshim të strukturës organizative/menaxhariale të të dy shoqërive pjesëmarrëse nuk konsiston në një ndryshim cilësor të kontrollit në shoqërinë target. Bashkimi operacional mes Albtelkom Sh.A dhe Eagle Mobile Sh.A në kuptim të nenit 10, pika 1, a nuk përbën përqëndrim që duhet t'i nënshtrohet procedurës së

kontrollit nga ana e Komisionit të Konkurrencës për shkak se ndërmarrjet nuk janë të pavarura nga njëra- tjetra, por kontrollohen dhe janë pjesë e të njëjtit grup, Çalik Holding.

- 3) Njësia e re e bashkuar (AT/EM) do duhet të orientohet drejt nevojave të klientit për shërbimet e thirrjeve zanore dhe të të dhënave për telefoninë fikse dhe të lëvizshme si dhe drejt sfidave të konvergencës së telefonisë fikse dhe asaj të lëvizshme.
- 4) Ekonomia e shkallës gjithashtu mund të sigurojnë sinergji. Si rrjedhojë, si rezultat i krijimit të këtyre sinergjive kompania e re mund të ndryshojë shërbimin dhe produktet e saj duke përmirësuar apo duke zgjeruar gamën e tyre. Konvergjenca e fiksit me mobile garanton përfitime si për operatorët edhe për konsumatorët finale: për operatorët e telefonisë fikse - ajo lejon përballimin e uljes së të ardhurave nga shërbimet tradicionale të telefonisë fikse, ndërkohë për operatorët mobile – përbën një mundësi për të hyrë në segmentin e aksesit të konsumatorit final dhe të konkurrojë me ish operatorët monopolist.
- 5) Përfitimet për konsumatorët janë domethënëse duke konsideruar jo vetëm përdorimin e një terminali të vetëm për të gjithë shërbimet e telekomunikacioneve por edhe për të realizuar one stop shopping që do të thotë pajisja me një faturë të vetme për të gjitha shërbimet e telefonisë- (të gjitha këto të shoqëruara me një transparencë totale ndaj përdoruesve si për kushtet e tarifimit por edhe për kushtet e përdorimit të shërbimeve të integruara të tipit fiks-mobile).
- 6) Integrimi midis shërbimeve fiks- mobile pritet të çojë në krijimin e operatorëve me dimensione gjithmonë e më të mëdha por mund të shoqërohet me: rritjen e nivelit të përqendrimit të sektorit e cila përkthehet në daljen nga tregu të operatorëve më të vegjël; por edhe me rritjen e hapësirave më të mëdha të ekzistencës së konkurrencës jo vetëm në nivel horizontal por edhe në nivel vertikal (nepërmjet produkteve të integruara fiks-mobile).
- 7) Ofrimi i shërbimeve të integruara fiks-mobile mund të shoqërohet me efekte negative të mundshme mbi konkurrencën (dhe si rezultat edhe mbi përdoruesit/konsumatorët), në rastet kur operatori i integruar që konkurren me operatorë të tjerë të ndodhur jo në të njëjtat kushte me të, mund të ketë sjellje antikonkurrese për të përjashtuar apo disavantazhuar rivalët e vet nëpërmjet diskriminimit të tyre në lidhje me aksesin dhe tarifën e vendosura për të. Në integrimin vertikal të operatorit dominant, çmimi i aksesit duhet të jetë i njëjtë për ndërmarrjen e integruar dhe atë jo të integruar.
- 8) Për të mos lejuar diskriminimin e operatorëve të tjerë nga ana e operatorit të integruar por edhe për të shmangur sjelljen antikonkurrese nëpërmjet ngushtimit të marzhit të fitimit të konkurrentëve (price squeeze), është e nevojshme ruajtja e transparencës në lidhje me tarifën e aksesit apo interkoneksionit nëpërmjet mbajtjes së llogarive të ndara për çdo produkt që ofron (ndarja e llogarive midis telefonisë fikse dhe asaj mobile).

PËR KËTO ARSYE

Në bazë të nenit 24, shkronja d, dhe nenit 70, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar), Komisioni i Konkurrencës.

VENDOSI:

- I-** T'i rekomandojë Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare, që në autorizimin përkatës të kërkojë nga shoqëria pas bashkimit:
1. Ndarjen e llogarive për telefoninë fikse dhe atë të lëvizshme e cila do të bëjë të mundur verifikimin e burimit të gjenerimit të të ardhurave për të siguruar parimin e diskriminimit të operatorit OFNT në telefoninë fikse AT ndaj operatorëve konkurrentë të Eagle Mobile në telefoninë e lëvizshme;;
 2. Detyrimin e transparencës, shoqëria pas bashkimit duhet të zbatojë parimin e transparencës për konkurrentët, klientët dhe konsumatorët fundorë dhe AKEP duhet të miratojë paraprakisht ofertat për produktet/shërbimet e shoqërisë para aplikimit.
 3. Detyrimin për akses dhe interkoneksion dhe përdorimin e përbashkët të faciliteteve të tregut përkatës. Shoqëria pas bashkimit duhet të ofrojë akses dhe interkoneksion në mënyrë të drejtë dhe të barabartë për të gjithë operatorët ekzistues dhe potencial në treg.
 4. Detyrimin e mosdiskriminimit, që nënkupton se AT si operator me fuqi të ndjeshme në treg(OFNT duhet të aplikojë të njëjtat çmime/tarifa terminimi dhe/ose tranzitimi për të gjithë operatorët e telefonisë së lëvizshme.
 5. Në rastin e ofertave të përbashkëta mes segmenteve të tregut të telefonisë fikse, celulare dhe shërbimit të internetit, operatori duhet t'i paraqesë dhe të marrë paraprakisht miratimin e AKEP për të siguruar mbrojtjen e konsumatorëve nga aplikimi i tarifave të padrejta dhe jo-transparente.
- II-** Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e vendimit për Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare dhe palëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURENCËS

Servete Gruda

(_____)

Anëtar

Koço Broka

(_____)

Anëtar

Rezana Konomi

(_____)

Anëtar

Lindita Milo (Lati)

K R Y E T A R



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 211, Datë 23.12.2011

Për

hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike, ndaj ndërmarrjeve: “Eurogjici Security” Sh.p.k, “Eurogjici Security 1” Sh.p.k, “Toni Security” sh.p.k, “Sajmiri AL” sh.p.k, “Nazeri 2000” sh.p.k dhe “Dea Security” sh.p.k

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Servete Gruda Anëtar
- Koço Broka Anëtar
- Rezana Konomi Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 23.12.2011, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Hapja e hetimit paraprak në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike, ndaj ndërmarrjeve: “Eurogjici Security” Sh.p.k, “Eurogjici Security 1” Sh.p.k, “Toni Security” sh.p.k, “Sajmiri AL” sh.p.k, “Nazeri 2000” sh.p.k dhe “Dea Security” sh.p.k, për të parë nëse ka ose jo shenja të kufizimit të konkurrencës;

Baza ligjore: Nenet 24, shkronja d); 26; 28, shkronja b); neni 4, pika 1; dhe neni 42, pika 1, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:

- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm “Mbi hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike, ndaj ndërmarrjeve: “Eurogjici Security” Sh.p.k, “Eurogjici Security 1” Sh.p.k, “Toni Security” sh.p.k, “Sajmiri AL” sh.p.k, “Nazeri 2000” sh.p.k dhe “Dea Security” sh.p.k”,

VËREN SE:

1. Sipas të dhënave paraprake të marra nga Autoriteti i Konkurrencës rezulton se shoqëritë e Shërbimit të Ruajtjes dhe Sigurisë Fizike: “Eurogjici Security” Sh.p.k, “Eurogjici

Security 1” Sh.p.k, “Toni Security” Sh.p.k, “Sajmiri AL” sh.p.k, “Nazeri 2000” sh.p.k dhe “Dea Security” sh.p.k”; kanë marrë pjesë në procedurat e prokurimit publik të zhvilluara nga autoritete të ndryshme kontraktore, ku ndërmarrjet konkurrojnë me të njëjtat kapacitete. Kështu p.sh: duke i dhënë zyra me qera, automjete me qera njera-tjetres; duke mbuluar shërbimet nga salla operative të njëjta etj.

2. Nga të dhënat paraprake rezulton se në shumicën e tenderave që futen shoqëritë e mësipërme duke mbështetur njëra-tjetrën janë fitues njëra nga këto shoqëri.
3. Bazuar në nenin 4, pika 1, të Ligjit Nr .9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si dhe Udhëzimin “Mbi luftimin e marreveshjeve të ndaluara në oferta në prokurimet publike”, këto shenja tregojnë për kufizime të mundshme të konkurrencës nëpërmjet një marrëveshjeje në oferta midis operatorëve në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në zbatim të nenit 42, pika 1, të Ligjit Nr .9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, me propozim të Sekretariatit,

V E N D O S I:

- I. Të miratojë hapjen e hetimit paraprak në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike, ndaj ndërmarrjeve: “Eurogjici Security” Sh.p.k, “Eurogjici Security 1” Sh.p.k, “Toni Security” Sh.p.k, “Sajmiri AL” Sh.p.k, “Nazeri 2000” Sh.p.k dhe “Dea Security” sh.p.k (“Ire-zan”), për të parë nëse ka ose jo shenja të kufizimit të konkurrencës.
- II. Periudha e hetimit do të jete 1 janar 2009 – 31 dhjetor 2011.
- III. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për ndjekjen e procedurave hetimore të parashikuara në ligj dhe aktet nënligjore përkatëse, si dhe përgatitjen e raportit të hetimit paraprak jo më vonë se data 31.03.2012.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete Gruda

(_____)

Anëtar

Koço Broka

(_____)

Anëtar

Rezana Konomi

(_____)

Anëtar

Lindita Milo (Lati)

K R Y E T A R

